

POLITIKA E CAKTIMIT TË DËNIMIT PENAL NË SHQIPËRI

Aleks Nikolli

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Luan Gjonçaj

Numri i fjalëve: 78100

Tiranë, Dhjetor 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

© E drejta e autorit: Aleks Nikolli

Në përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje sipas kërkesave të Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës, nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKTI

Politika e caktimit të dënimit penal që ndiqet në një vend të caktuar është çështja kryesore dhe më e rëndësishme e së drejtës penale, pasi ajo përcakton vetë thelbin e saj. Në 20 vite jetë të K. Penal shqiptar, legjislativi ka kryer 16 shtesa dhe modifikime në të, shumica e të cilave janë orientuar në drejtim të miratimit të veprave të reja penale dhe ashpërsimit të dënimeve për veprat ekzistuese. Duke u përpjekur të tregojnë vullnet të qartë politik për të goditur një fenomen të caktuar antisocial, maxhorancat e ndryshme politike e kanë bërë këtë në mënyrën më të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë, por jo më efektiven dhe të arsyeshmen.

Për shkak të politikave penale populiste, Shqipëria ka arritur sot nivelet më të larta të dënimeve në Evropë dhe si rrjedhojë e tyre prej një dekade përballet me një mbipopullim të lartë të burgjeve dhe me një varësi kronike ndaj amnistive. Mbështetur në studimet e shumta empirike të cilat kanë konfirmuar mungesën e efekteve frenuese të burgimit, shumica e vendeve evropiane e kanë kufizuar në maksimum aplikimin e tij, ndërkohë që në vendin tonë ai është shndërruar në një mjet gjerësisht të përdorur për zgjidhjen e shumë problemeve sociale. Po ashtu, rendja me fushata represive ndaj sjelljeve të caktuara, e ka shndërruar K. Penal në një korpus dispozitash kaotike, pa një ligjësi të qartë në përcaktimin e nivelit të sanksioneve penale dhe të mënyrës së ushtrimit të diskrecionit gjyqësor.

Ky punim synon të analizojë të gjithë elementët e politikës së caktimit të dënimit në vendin tonë, duke filluar me themelet filozofike të dënimit penal dhe qëllimet që ai ndjek, larminë e dënimeve që parashikohen nga sistemi ligjor, parimet, kriteret dhe praktikat ligjore të caktimit të tij nga gjykata dhe efektivitetin e dënimeve penale të ashpra në kontrollin e kriminalitetit. Në kryejën e këtij punimi është përdorur një literaturë e gjerë shkencore vendase dhe e huaj, dhe po ashtu gjatë analizimit të pyetjeve kërkimore dhe të hipotezës së tij janë përdorur të dhëna të shumta kriminologjike nga burime vendase dhe të huaja.

Nga ky studim rezulton se politika e dënimit penal e ndjekur në vendin tonë është thellësisht e paarsyeshme dhe paraqet një nevojë të ngutshme për vendosjen e saj në shina shkencore.

Fjalët kyçe: Dënim penal; Dënim i ashpër; Politikë e caktimit të dënimit; Diskrecion gjyqësor; Parandalim i përgjithshëm.

ABSTRACT

The sentencing policy that is carried out in a certain country is the main and most important issue of the criminal law, since it defines its own essence. In the 20 years of the Albanian Criminal Code, the legislature has conducted 16 amendments and modifications, most of which are oriented towards the adoption of new criminal offenses and aggravation of sanctions for existing ones. Trying to show a clear political will to fight a certain antisocial phenomenon, different political majorities have done so in the most apprehensible way to the common people, but not by the most effective and reasonable way.

Due to populist criminal policies, Albania has now reached the highest levels of criminal punishments in Europe and consequently from a decade is facing high levels of overcrowded prisons and a chronic dependence on amnesties. Based on numerous scientific studies that have confirmed the lack of deterrent effect of imprisonment, most European countries have restricted its application to the maximum, while in our country it has become a widely used tool for answering many social problems. Also, after running heavy repressive campaigns against certain behaviors it has transformed our Criminal Code into a bulk of chaotic provisions, without a clear nomocracy in determining the level of criminal sanctions and the way that judicial discretion is exercised.

This paper aims to analyze all the elements of sentencing policy in our country, starting with the philosophical foundations of criminal punishment and purposes that pursues, the diversity of punishments provided by the legal system, the principles, criterias and legal practices of sentencing followed by the courts and the effectiveness of harsh criminal sentences on crime control. To conduct this dissertation a wide body of both domestic and foreign scientific literature has been used and also during the analysis of its research questions and the hypothesis have been used multiple criminological data from domestic and foreign sources.

From this study it turns out that the criminal sentencing policy persued in our country is deeply irrational and demonstates an urgent need for placing it on scientific rails.

Keywords: Criminal punishment; Harsh sentence; Sentencing policy; Judicial discretion; General deterrence.

DEDIKIMI

Dedikuar familjes sime . . .

FALENDERIME

Nietzsche ka thënë se thelbi i të gjitha arteve është mirënjohja. Duke qenë se nuk është kurrë vonë për të thënë “faleminderit”, ndiej nevojën që rreshtat e fundit të këtij punimi tia kushtoj shprehjes së kësaj ndjenje të bukur njerëzore.

Së pari dua të shpreh mirënjohje dhe falënderime për udhëheqësin tim të parë shkencor, Dr. Mirgen Prençe dhe atë të dytë Prof. Dr. Luan Gjonçaj, për mbështetjen akademike dhe teknike që më kanë dhënë gjatë rrugës së studimeve doktorale dhe hartimit të disertacionit.

Mirënjohje për kryetarin dhe kolegët e nderuar gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilët më duruan, më mbështetën, por edhe më nxitën për thellimin në shumë problematika të punimit doctoral. Falenderoj përzemërsisht edhe një grup të spikatur kolegësh profesionistë të së drejtës penale, prokurorë dhe avokatër, besadat dhe debatet me të cilët kanë lënë gjurmë në këtë punim.

Një falenderim i posaçëm shkon për shumë miq dhe bashkëpunëtorë, punonjës të sistemit të drejtësisë, të cilët më kanë dhënë një ndihmë të vyer në gjetjen dhe mbledhjen e mjaft të dhënave statistikore mbi çështjet objekt i studimit doctoral. Po ashtu falenderoj dy miqtë e mi IT, Aleksandrin dhe Mondin të cilët më kanë ndihmuar pa përtesë në shumë çështje teknike të editimit dhe formatimit të punimit.

Nuk mund të lë pa përmendur në këto rreshta ndihmën dhe lehtësimet e të gjithë Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës, e në mënyrë të veçantë të Prof. Dr. Romeo Gurakuqit, As. Prof. Dr. Arbi Agalliut, Dr. Hemion Brahos dhe Dr. Besarta Vladit, si dhe të stafit administrativ të sekretarisë së kësaj shkolle. Falenderime shkojnë edhe ndaj departamentit të së drejtës publike të fakultetit juridik dhe në mënyrë të posaçme për stafin e pedagogëve të së drejtës penale.

Matanë trashëgimisë gjenetike, i shpreh mirënjohjen e pafund dy prindërve të mi, për transmetimin e edukatës së punës, këmbënguljes dhe të qëndresës ndaj vështirësive, si dhe për ngrohtësinë dhe kurajon e injektuar tek unë përmes mbartjes dhe shqetësimit të tyre për shqetësimet e mia.

Falenderimi i fundit shkon për familjen time, e cila më ka ofruar dashurinë dhe energjinë e domosdoshme për një sfidë të tillë, për Blertën me të cilën kam bashkëndarë shumicën e mendimeve dhe shqetësimeve të këtij punimi dhe për dy ëngjëjt e mij, Anja dhe Sara, pa të cilët ky punim as nuk do të ishte nisur!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

POLITIKA E CAKTIMIT TË DËNIMIT PENAL NË SHQIPËRI

Lista e shkurtimeve.....	
Lista e grafikëve dhe tabelave.....	

HYRJE.....	1
-------------------	----------

KAPITULLI I: DËNIMI PENAL

1.1. Kuptimi i sanksionit penal.....	10
1.2. Të përbashkëtat dhe dallimet e dënimit penal me llojet e tjera të sanksioneve (administrative, disiplinor, civile etj.).....	11
1.3. Qëllimi i dënimit penal.....	13
1.3.1. <i>Teoritë absolute mbi qëllimin e dënimit</i>	13
1.3.2. <i>Teoritë relative mbi qëllimin e dënimit</i>	14
1.3.3. <i>Teoritë e përziera</i>	17
1.3.4 <i>Qëllimi i dënimit penal sipas të drejtës penale shqiptare</i>	18
1.3.4.1 <i>Qëllimi i dënimit penal sipas jurisprudencës shqiptare</i>	20
1.3.5 <i>Rëndësia praktike e qëllimit të dënimit penal</i>	21
1.3.6 <i>Pesha e kontributit të dënimit penal në luftimin e kriminalitetit</i>	23

KAPITULLI II: SISTEMI I DËNIMEVE PENALE

2.1. Përmbajtja e sistemit të dënimeve.....	25
2.1.1. Sanksionet ekonomike.....	25
2.1.1.1. <i>Dënimi me gjobë</i>	26
2.1.1.2. <i>Konfiskimet e pasurisë</i>	27
2.1.2. Sanksionet paaftësuese.....	28
2.1.2.1. <i>Dënimi me burgim</i>	28
2.1.2.1.1. <i>Relativizmi i dënimit me burgim. (Llojet e burgjeve)</i>	29
2.1.2.1.2. <i>Kriza e dënimit me burgim. Mbipopullimi i burgjeve</i>	30
2.1.2.2. <i>Dënime të tjera paaftësuese</i>	32
2.1.3. Sanksionet trupore.....	34
2.1.3.1. <i>Dënimi me vdekje</i>	35
2.1.3.2. <i>Dënimet e tjera trupore</i>	37
2.2. Llojet e dënimeve aktuale në disa vende të botës.....	38

2.2.1. Llojet e dënimeve në sistemin anglosakson (SHBA dhe Britani).....	38
2.2.1.1. Llojet e dënimeve në Britaninë e Madhe.....	38
2.2.1.2. Llojet e dënimeve në SHBA.....	41
2.2.2. Llojet e dënimeve në Evropën kontinentale (Francë, Gjermani dhe Itali).....	43
2.2.2.1. Llojet e dënimeve në Francë.....	43
2.2.2.2. Llojet e dënimeve në Gjermani	45
2.2.2.3. Llojet e dënimeve në Itali.....	46
2.2.3. Llojet e dënimeve në Evropën Nordike (Danimarkë, Suedi, Norvegji dhe Finlandë).....	48
2.2.4. Llojet e dënimeve në Ballkan (Kosovë, Mal të zi, FYROM dhe Greqi).....	50
2.3. Sistemi i dënimeve sipas kodit penal shqiptar.....	53
2.3.1. Dënimet kryesore.....	53
2.3.1.1. Dënimi me vdekje.....	55
2.3.1.2. Dënimi me burgim të përjetshëm.....	56
2.3.1.3. Dënimi me burgim.....	58
2.3.1.4. Mbipopullimi i burgjeve në Shqipëri.....	59
2.3.1.5. Dënimi me gjobë.....	61
2.3.2. Dënimet plotësuese.....	66
2.3.2.1. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike.....	68
2.3.2.2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.....	69
2.3.2.3. Ndalimi për të drejtuar automjete.....	70
2.3.2.4. Heqja e dekoratave dhe e titujve.....	70
2.3.2.5. Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie.....	71
2.3.2.6. Heqja e të drejtës së ushtrimit të detyrave drejtuese.....	71
2.3.2.7. Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative.....	71
2.3.2.8. Nxjerrja jashtë territorit.....	72
2.3.2.9. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.....	72
2.3.2.10. Humbja e përgjegjësisë prindërore.....	72
2.3.3. Mënyra e vuajtjes së dënimeve plotësuese.....	73
2.3.4. Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë.....	73
2.3.5. Masat mjekësore dhe edukuese.....	75
 KAPITULLI III: ÇAKTIMI I DËNIMIT	
3.1. Shqyrtime hyrëse. Kuptimi i çaktimit të dënimit.....	78
3.1.1. Individualizimi ligjor i dënimit.....	78
3.1.2. Aspekti politik i dënimit	81

3.1.3. Individualizimi administrativ i dënimit.....	82
3.1.4. Individualizimi gjyqësor i dënimit	83
3.2. Parimet mbi të cilat mbështetet caktimi i dënimit penal.....	84
3.2.1. Parimi i ligjshmërisë.....	84
3.2.1.1. Zbatimi i ligjit favorizues.....	85
3.2.1.2. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.....	86
3.2.2. Parimi i proporcionalitetit.....	86
3.2.2.1. Parimi i domosdoshmërisë.....	90
3.2.2.2. Parimi i ekonomisë së dënimit, ose vlerësimi kosto-përfitim.....	91
3.2.3. Parimi i barazisë.....	93
3.2.4. Konsistenca në caktimin e dënimit.....	96
3.2.5. Parimi i drejtësisë.....	97
3.2.6. Parimi i humanizmit.....	97
3.3. Caktimi i dënimit penal nga gjyqtari.....	98
3.3.1. Diskrecioni i gjyqtarit.	98
3.3.2. Vështirësi krahasues i diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit.....	101
3.3.3. Qëllimet e ndryshme të dënimit, si një pengesë e kufizimit të diskrecionit gjyqësor.....	104
3.3.4. Justifikimi i besimit të pushtetit diskrecional nga gjyqtari.....	106
3.4. Kriteret ligjore të caktimit të dënimit sipas K. Penal shqiptar.....	108
3.4.1. Dispozitat e pjesës së përgjithshme të K. Penal që kanë lidhje me caktimin e dënimit....	108
3.4.2. Respektimi i kufijve të dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale.....	111
3.4.3. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale.....	113
3.4.4. Shkalla e fajit.....	116
3.4.5. Rrezikshmëria e autorit të veprës penale.....	117
3.4.6. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese.....	119
3.4.6.1. Rrethanat lehtësuese.....	120
3.4.6.2. Rrethanat rënduese.....	123
3.4.7. Zbatimi praktik i kriterëve të caktimit të dënimit.....	126
3.4.8. Përfshirja ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat.....	128
3.4.9. Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar në ligj.....	128
3.4.10. Caktimi i dënimit për të miturit.....	129
3.4.10.1. Dënimi me burgim për të miturit.....	130
3.4.10.2. Përfshirja e të miturit nga dënimi.....	130
3.4.11. Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë.....	131

3.4.12. <i>Bashkimi i dënimeve për disa vepra penale</i>	132
--	-----

KAPITULLI IV: DËNIMET ALTERNATIVE

4.1. Roli i dënimeve alternative në sistemin sanksionator.....	135
4.2. Shërbimi i provës.....	137
4.3. Gjysmëliria.....	139
4.4. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.....	139
4.5. Qëndrimi në shtëpi.....	143
4.6. Monitorimi elektronik.....	144
4.7. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.....	145
4.8. Lirimi me kusht.....	148

KAPITULLI V: POLITIKA E CAKTIMIT TË DËNIMIT PENAL NË SHQIPËRI DHE KRIMINALITETI. PARANDALIMI I PËRGJITHSHËM, SI JUSTIFIKIM POLITIK I DËNIMEVE TË ASHPRA

5.1. Orientimi i politikës së dënimit në Shqipëri.....	151
5.2. Niveli i dënimeve penale në Shqipëri.....	154
5.3. Dënimet e ashpra penale si një strategji për frenimin e krimit.....	158
5.4. Analizimi i ndikimit të dënimeve të ashpra në uljen e kriminalitetit në Shqipëri.....	162
5.4.1. <i>Efekti frenues i dënimeve të ashpra tek vrasjet me dashje</i>	163
5.4.2. <i>Analizimi i efektit frenues të dënimeve të ashpra tek disa vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore</i>	170
5.4.3. <i>Analizimi i efektit frenues të dënimeve të ashpra tek veprat e përhapura</i>	175
5.5. Arsytueshmëria e dënimeve të ashpra penale në vendin tonë	180
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	185
BIBLIOGRAFIA	202

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Grafiku nr. 1. Dinamika e shkallës së burgosjes në Shqipëri	60
Grafiku nr. 2. Dinamika e pezullimit të dënimit me burgim 2003-2014.....	140
Grafiku nr. 3. Dinamika e vrasjeve me dashje të konsumuara në vitet 1991-2014.....	165
Grafiku nr. 4. Shkalla e vrasjeve me dashje në total për 100.000 banorë për vitet 2001-2011.....	166
Grafiku nr. 5. Dinamika e personave të dënuar për vrasje me dashje nga gjykatat e rretheve.....	167
Grafiku nr. 6. Dinamika e çështjeve të vrasjeve me dashje në Shkodër.....	168
Tabela nr. 1. Krahasoni i marzheve të dënimit për disa vepra penale.....	157
Tabela nr. 2. Dinamika e të dënuarve për disa vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore.....	170
Tabela nr. 3. Dinamika e çështjeve të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në Shkodër.....	173
Tabela nr. 4. Dinamika e personave të dënuar për disa vepra të përhapura në rang vendi.....	176
Tabela nr. 5. Dinamika e personave të dënuar për disa vepra të përhapura nga GjRREGJ Tiranë...	176

LISTA E SHKURTIMEVE

DPB-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

ESCCJS- European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics

etj. – e të tjerë

f.- faqe,

GJA-Gjykata e Apelit

GJEDNJ-Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut,

GJK- Gjykata Kushtetuese

GJL-Gjykata e Lartë

GJRRGJ-Gjykata e Rrethit Gjyqësor

ICPC- Institute for Crime Prevention and Control

ICPS- International Centre for Prison Studies

IEVP-Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

K. Penal- Kodi penal

K. Pr. Penale- Kodi i procedurës penale,

KEDNJ-Konventa evropiane e të drejtave të njeriut,

KE-Këshilli i Evropës

KPGJL-Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

MD- Ministria e drejtësisë,

ME-Mbikëqyrja elektronike

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

nr.-numër

OKB-Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE-Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

SHBA-Shtetet e Bashkuara të Amerikës

UNODC- United Nations Office on Drugs and Crime

WODC- Wetenschappelijk Onderzoek- en Documentatiecentrum

HYRJE

Procesi penal ndaj një personi që ka kryer një vepër penale është i ndarë në dy faza: faza e parë merret me çështjen e provimit të fajësisë së tij, ndërsa në fazën e dytë shqyrtohet çështja e caktimit të dënimit penal për veprën e kryer. Megjithëse procesi i provimit të fajësisë është shumë i rëndësishëm dhe kërkon zbatimin e një morie rregullash kushtetuese, penale dhe proceduralo - penale, në fund të fundit gjithë kjo rëndësi është në funksion të caktimit të dënimit penal. Për këtë arsye politika e dënimit penal që ndiqet në një vend të caktuar përcakton vetë thelbin e së drejtës së tij penale. Ajo është elementi kryesor i politikës penale dhe përbën boshtin e saj (Muçi, 1989: 68). Në vende të ndryshme janë kryer një numër i madh studimesh shkencore mbi politikën e dënimit penal, të cilat eksplorojnë themelet filozofike të dënimit penal, larminë e dënimeve që parashikohen nga sisteme të ndryshme penale, praktikat ligjore të caktimit të tij nga gjykata dhe efektivitetin e dënimit në kontrollin e kriminalitetit.

Aktualisht, shkenca e së drejtës penale është akoma e paunifikuar në përcaktimin e arsyes së vërtetë (rationale) që qëndron pas saj, ndërkohë që rritja e kërkesës publike për drejtësi dhe besim në rendin ligjor ka shtyrë shpesh legjislatorët që në mënyrë të padrejtë të adresojnë zgjidhjen me mjete dhe metoda penale të problemeve të shumta sociale, me besimin se një strategji e tillë mund të përputhet me miratimin e shoqërisë. Nën këtë kontekst, teoritë abolicioniste dhe ato të “tolerancës zero”, janë paraqitur si ide dhe slogane të kundërta penale, duke nxjerrë në pah natyrën radikale dhe ekstreme të qasjeve respektive (Giunta, 2004: 148). Ndërsa e para duket jo realiste në kërkesën për ndalimin e dënimit penal, pasi manifeston probleme praktike procedurale, e dyta mbështetet në ashpërsimin e dënimeve pa marrë parasysh ndonjë vlerësim të përfitimeve dhe pasojave të saja. Qeveritë duke u përpjekur të tregojnë vullnet politik për të frenuar një fenomen të caktuar antisocial, e bëjnë këtë në mënyrën më të shkurtër dhe më të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë, por për fat të keq jo më të drejtën dhe më efektiven, duke parashikuar sjelljet antisociale si të dënueshme penalisht, e në rastet kur ato kanë qenë më parë të parashikuara, nëpërmjet ashpërsimit të mëtejshëm të llojeve apo masave të dënimit për ato sjellje (Herring, 2013: 14).

Shumë vende demokratike e kanë konsoliduar ndikimin e studimeve shkencore në reformat penale, duke treguar maturi dhe stabilitet (Albrecht, 2013: 211; Von Hofer, 2011) me qëllim që ato t’i shërbejnë në afat të gjatë funksioneve të së drejtës penale. Mirëpo reflektimi i politikës së ditës në të drejtën penale i ka ndarë edhe vendet e ashtuquajtura demokratike në dy grupe, në ato ku politika përcakton thelbësisht sanksionet penale dhe ato ku ajo luan një rol më të tërhequr. Përfaqësuese tipike e grupit të parë është SHBA me një politikë agresive penale (Whitman, 2003), ndërsa pjesë e grupit të dytë janë vendet me një politikë të butë penale, ku spikasin vendet nordike dhe Gjermania. Megjithë afërsinë gjeografike dhe ngjashmëritë formale si pjesë e sistemit të së drejtës së kodifikuar me këto vende, në dy dekadat e fundit Shqipëria ka huazuar më shumë nga fryma

amerikane, duke ashpërsuar gjithnjë e më tepër sanksionet penale, jo vetëm për vepra të rënda, por edhe për vepra të lehta. Kjo qasje është reflektuar në vijimësi nga çdo maxhorancë e re politike shqiptare që ka ardhur rishtazi në pushtet, në përpjekje për të çertifikuar në elektorat vullnetin e saj për të luftuar paligjshmërinë dhe padrejtësinë. Ashpërsimet galopante të sanksioneve të filluara menjëherë pas miratimit të K. Penal në vitin 1996, kanë vazhduar në vijimësi deri në këto momente, duke i ngritur marzhet e dënimeve penale në nivele rekord për historikun e sanksioneve penale në vendin tonë dhe të pakrahasueshme me asnjë vend tjetër të Evropës Perëndimore.

Justifikimi politik i ashpërsimit të dënimeve në K. Penal shqiptar është zbatuar me fushata periodike, sa herë që në opinionin publik dhe mediatik është ngritur shqetësimi për rritjen apo përhapjen e madhe të një fenomeni të caktuar kriminal, apo kur maxhorancat kanë vlerësuar si opurtune tërheqjen e vëmendjes mbi këto çështje. Këto qëndrime thellësisht populiste, mund të kenë arritur të japin rezultat në aspektin politik, pasi në afat të shkurtër kanë mundur që të fashisin kritikën publike për mungesë efikasiteti në luftën ndaj kriminalitetit, mirëpo, në afat të gjatë ato nuk kanë arritur të justifikojnë mungesën e efektit të tyre frenues për uljen e kriminalitetit. Rendja e të gjitha formacioneve politike në pushtet pas politikave të tilla të “tolerancës zero me krimin”, e ka shndërruar mbështetjen për dënime të ashpra, në etalonin matës të qëndrimit publik për vullnetin qeveritar për të luftuar krimin.

K. Penal i ri i miratuar në vitin 1995 nuk arriti të reflektonte kënaqshëm shumë forma të reja të kriminalitetit të cilat u shfaqën rishtazi në sajë të transformimeve social-ekonomike që shoqëria shqiptare pësoi në vitet në vijim, mirëpo përpjekjet e shumta ligjore për riparimin e tyre në masën më të madhe kanë qenë të pastudiara mirë, jo vetëm sa i takon teknikës legjislative dhe konceptimit të K. Penal si një korpus dispozitash të harmonizuara, por së pari në aspektin substancial, sa i takon thelbit dhe qëllimit të kryerjes së tyre.

Ashpërsimet e vazhdueshme të llojeve dhe masave të dënimit nga legjislatori dhe promovimi në debatin publik i një fryme pro dënimeve të ashpra ndaj personave që kryejnë vepra penale ka shërbyer si nxitësi kryesor i kryerjes së këtij studimi shkencor. Besimi i rremë mbi efektivitetin e burgimit ka rritur në nivele rekord jo vetëm mbipopullimin e burgjeve dhe klimën e dhunës shtetërore, por nga ana tjetër nuk ka ndikuar në uljen e kriminalitetit. Ndryshimet e palogjikshme dhe të paharmonizuara në nivelin e sanksioneve penale e kanë shndërruar K. Penal në një grumbull normash kaotike, pa një ligjësi të qartë, duke vështirësuar kështu kontrollimin e zbatimit të drejtë dhe konsekuent të ligjit nga gjykatat gjatë procesit të caktimit të dënimit. Një faktor jo më pak ngacmues ka qenë nga ana tjetër paarsyetueshmëria me të cilën ligjvënësi është përpjekur të riparojë dëmet që kanë ardhur nga zbatimi i një politike represive penale, duke e bashkëshoqëruar ashpërsimin e dënimeve me amnisti të shumta pasuese. Paraqitja para opinionit publik dhe atij profesional e amnistive si reforma humane dhe depenalizuese, nuk mund të gjejë miratim me

qëndrimin konstant për ashpërsim dënimesh.

Nga pikëpamja strukturore punimi është konceptuar në pesë kapituj dhe ndjek logjikën formale të procesit të caktimit të dënimit dhe më pas atë të matjes së efektshmërisë së tij.

Në kapitullin e parë jemi ndalur në trajtimin e koncepteve bazë që kanë të bëjnë me dënimin penal, të përbashkëtat dhe dallimet e tij me llojet e tjera të sanksioneve ligjore (administrativ, disiplinor, civil etj.), teoritë bashkohore mbi qëllimin e dënimit dhe reflektimin e tyre mbi doktrinën dhe jurisprudencën shqiptare etj. Duke qenë se përcaktimi i qëllimit që ndjek dënimi penal nuk është thjeshtë një çështje filozofike, morale apo humanizmi, por së pari një çështje esenciale e politikës së caktimit të dënimit (Muçi, 2012: 265), ajo është rimarrë dhe trajtuar nga këndvështrime të ndryshme edhe në kapitujt e tjerë të punimit. Qëllimi që ndjek dënimi penal ndikon drejtpërdrejtë në larminë e dënimeve dhe masat që parashikohen nga ligji, në kriteret e individualizimit të tyre dhe në mënyrën dhe standardet e ekzekutimit të tyre.

Pas një trajtimi teorik të klasifikimit të llojeve të sanksioneve penale, në kapitullin e dytë jemi ndalur në një trajtim krahasues të sanksioneve penale në disa nga sistemet ligjore të cilat paraqesin një interes më të madh shkencor për vendin tonë. Trajtimin e kemi nisur me paraqitjen e dënimeve në sistemin anglosakson (SHBA dhe Britani), duke vijuar me Evropën kontinentale (Francë, Itali dhe Gjermani), Evropën nordike (Danimarkë, Suedi, Norvegji dhe Finlandë) dhe duke e mbyllur me llojet e dënimeve në Ballkan (Kosovë, Mal të Zi, FYROM dhe Greqi). Më tej në këtë kapitull kemi analizuar në detaje llojet e sanksioneve që parashikon legjislacioni penal shqiptar, duke u ndaluar në problematikën e madhe që ai paraqet në planin formalo-strukturor, por më së shumti në atë substancial.

Një vëmendje e posaçme në këtë kapitull i është kushtuar burgimit dhe dënimit me gjobë. Burgimi ka qenë prej më se dy shekujsh dënimi kryesor në shumicën e shoqërive perëndimore, mirëpo në dhjetëvjeçarët e fundit, falë një debati të gjerë shkencor filozofik, penalogjik, ekonomik dhe politik rreth shkallës së aplikimit dhe arsytueshmërisë së tij, pesha e aplikimit të tij ka rënë në shumicën e vendeve demokratike. Dënimi me burgim është sot një simbol i fuqishëm i aftësisë shtetërore për të ndëshkuar dhe njëkohësisht i dështimit të tij për të integruar të gjithë qytetarët në sistemin e tij të normave (Crewe, 2007: 123). Megjithëse GJK dhe GJL në jurisprudencën e tyre¹ kanë afirmuar se përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* vetëm kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme, përsëri ato mbeten akte sporadike të pamjaftueshme nga pikëpamja e detyrueshmërisë, për të ndryshuar rrënjësisht frymën e praktikës gjyqësore. Nga ana tjetër është e qartë se këto vendime kanë pasur fare pak ose aspak impakt në procesin ligjvënës, për t'u mbajtur në konsideratë gjatë ndërhyrjeve për miratimin e

¹ Vendimet nr. 19, datë 01.06.2011 dhe nr. 47 datë 26.07.2012 të GJK dhe vendimet nr. 224 (28), datë 26.01.2012, nr. 1325 (194), datë 04.07.2012, nr. 1672 (347), datë 19.12.2012 dhe nr. 1535 (278), datë 30.10.2013 të KPGJL.

veprave penale dhe në përcaktimin e nivelit të sanksioneve. Në vend që gjoba të merrte një shtrirje më të gjerë dhe një pozitë dominuese në gjithë sistemin sanksionator, fryma politike dhe publike pro burgimit ka ndikuar jo vetëm në ngushtimin e hapësirave ligjore për aplikimin e saj, por drejtpërdrejtë ka ndikuar në praktikën gjyqësore për uljen e për zgjedhjes së saj. Ndërkohë që shumica e vendeve të Evropës kanë adaptuar sistemin e gjobave ditore, jo vetëm si një nxitës të aplikimit të këtij lloji dënimi, por së pari si një zgjidhje më e drejtë për një trajtim substancialisht të barabartë të personave me të ardhura të ndryshme, legjislatori shqiptar ka rritur marzhet e dënimit me gjobë në nivele të papranueshme për realitetin tonë ekonomik.

Pas trajtimit të sistemit sanksionator, natyrshëm vjen caktimi i dënimit, trajtimi i të cilit është bërë në kapitullin e tretë. Megjithëse caktimi i dënimit mendohet si një veprim procedural gjyqësor, ai është së pari një akt ligjor dhe politik i legjislatorit. Është legjislatori organi shtetëror i cili definon në vija të trasha llojet dhe masat e dënimit që do të caktohen për një vepër konkrete. Në dallim nga individualizimi ligjor, i cili përcakton dënimin që duhet të caktohet hipotetakisht për kryerjen e një veprë abstrakte, individualizimi gjyqësor është caktimi i llojit dhe masës konkrete të dënimit ndaj një të pandehuri konkret. Mirëpo, kur legjislatori cakton marzhet e dënimit për vepra të veçanta, përgjithësisht ai ka parasysh një mashkull të shtresës së mesme, rreth të tridhjetave, i cili megjithëse ka një punë, një shtëpi dhe një jetë të qetë, zgjedh me ndërgjegje të prishë rregullin dhe rendin publik. Duke qenë se në bankën e të akuzuarve ky stereotip “kriminel hipotetik”, ndeshet rrallë, në mos kurrë, është e nevojshme që gjykatës t’i garantohet një diskrecion i nevojshëm, në mënyrë që dënimi ndaj personit konkret të jetë i drejtë dhe i merituar.

Hapësira e lirisë që legjislatori i njeh gjykatës në caktimin e dënimit në një rast konkret duhet të jetë e përshtatshme (as panevojshmërisht e gjerë as tepër e ngushtë) dhe sipas një ligjësie logjike, duke marrë në konsideratë nga njëra anë nevojën për të respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë së dënimit dhe nga ana tjetër pamundësinë që legjislatori të parashikojë me precizion çdo lloj veprë dhe të pandehuri hipotetik. Ndryshe nga ç’ mund të mendohet rëndom, procesi i caktimit të dënimit nuk duhet të jetë një akt i lirë vullneti i gjyqtarit/ëve, por një proces i normuar dhe i kontrollueshëm. Në caktimin e dënimit gjykata duhet t’i nënshtrohet disa parimeve të detyrueshme kushtetuese dhe ligjore si ai i ligjshmërisë, i proporcionalitetit, i barazisë dhe i humanizmit. Po ashtu diskrecioni gjyqësor është kufizuar më tej nga neni 47 i K. Penal, i cili parashikon kriteret ligjore mbi bazën e të cilave gjykata përmbush teknikisht procesin e caktimit të dënimit konkret. Përveç dispozitave të pjesës së përgjithshme të K. Penal dhe kufijve të dënimeve të parashikuar në pjesën e posaçme, gjykata duhet të mbajë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore konkrete të veprës penale, shkallën e fajit, rrezikshmërinë e autorit të saj dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Megjithëse në pamje të parë, caktimi i dënimit mund të duket një detyrë e thjeshtë dhe mekanike, në praktikë kjo është detyra më e vështirë e punës së një gjyqtari, pasi për kryerjen e saj kërkohet

të mbahen në konsideratë shumë dispozita ligjore dhe një mori rrethanash komplekse të cilat tërheqin në drejtime të ndryshme. Ky proces është komplikuar edhe më tej me diversifikimin e qëllimeve të dënimit penal dhe nevojën për të përzgjedhur qëllimit prioritar që do të ndiqet në rastin konkret si dhe për të harmonizuar sa të jetë e mundur këtë qëllim me qëllimet e tjera. Gjithsesi, në përfundim të analizës së kriterëve dhe rrethanave që mbahen parasysh në individualizimin e dënimit, pavarësisht ndarjeve apo këndvështrimeve të ndryshme ligjore, etike apo filozofike, në fund të fundit rezultati praktik i prekshëm është përfundimi se i pandehuri duhet të dënohet më shumë apo më pak. Pra në thelb pas peshimit të të gjitha të dhënave objektive gjyqtari duhet të vendosë nëse të pandehurit duhet t'i caktohet një lloj dënimi më i rëndë apo një lloj tjetër dënimi më i butë, dhe më tej një masë e rëndë apo një masë më e lehtë. Kriteret e caktimit të dënimit janë në funksion të vetë dënimit penal, prandaj të metat në caktimin e tij passjellin paefektshmëri të dënimit të dhënë.

Trajtimi i aspekteve të ndryshme të caktimit të dënimit është bërë me një frymë analize kritike, duke u përpjekur të evidentohen problemet ligjore dhe të jurisprudencës gjyqësore dhe më tej duke sugjeruar zgjidhje të vlefshme logjike për to.

Në respekt të strukturës aktuale të K. Penal, dënimet alternative dhe roli që ato luajnë në politikën e dënimit është trajtuar në kapitullin e katërt të këtij punimi. Megjithëse alternativat e dënimit me burgim janë parashikuar që me miratimin e K. Penal, fillimisht ato janë aplikuar nga gjykatat në mënyrë të kursyer. Një hap i madh pozitiv në aplikimin e këtyre alternativave u hodh me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, ku u përmirësuan dispozitat që lidhen me alternativat e dënimit me burgim dhe sidomos me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, i cili miratoi krijimin e Shërbimit të provës (Leskoviku, 2009: 78). Dispozitat e dënimeve alternative i janë nënshtruar ndryshimeve të mëtejshme dhe bashkë më rritjen e trajnimeve të gjyqtarëve, filloi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore në drejtim të aplikimit më të gjerë të tyre. Një kontribut të pamohueshëm nxitës dhe inkurajues në drejtim të aplikimit të dënimeve alternative në vitet e fundit kanë dhënë GJK dhe GJL me jurisprudencën e tyre. Megjithëse aplikimi i dënimeve alternative ka ardhur duke u rritur, kjo rritje vetëm sa ka mbuluar ekspansionin që ka pësuar K. Penal përmes shtimit të veprave të reja, apo rritjen e numrit të personave të proçeduar nga prokuroria për vepra të lehta.

Ndonëse, konstatohet se dënimet alternative janë një nga momentet e vetme ku reflektohet një frymë pozitive për reformimin e sistemit të sanksioneve penale, në vlerësimin tonë ato janë përsëri të pjesshme dhe të pamjaftueshme. E drejta jonë penale nuk duhet të mbesë peng e klisheve të vjetra dhe as të dorëzohet para sfidave dhe dështimeve të aplikimit të ideve të reja për rritjen e humanizmit, efikasitetit dhe barazisë thelbësore në trajtimin e kryerësve të veprave penale. Në mënyrë të veçantë, e drejta jonë penale duhet të përqendrohet në shqyrtimin e alternativave efikase të cilat ngushtojnë hendekun mes një të drejtë “klasike” penale për “personat e rrezikshëm” të cilët

vijnë nga shtresat e ulëta të shoqërisë (si të varfrit, të paarsimuarit, të pastrehët, të papunët, narkomanët, të sëmurët mendorë etj.) dhe një drejtësie “moderne”, apo “humane” vetëm për shtresat më të larta shoqërore. Në këtë drejtim, duhen eksploruar dënime të përshtatshme alternative edhe për kategoritë e marxhinalizuara shoqërore, duke kontribuar kështu jo vetëm në uljen e ndjeshme të popullatës së burgjeve, por edhe në ndryshimin e raportit të shtresave sociale në këtë popullatë.

Duke qenë se në pjesën më të madhe ashpërsimi i politikës së dënimit në vendin tonë është justifikuar me premtimin për uljen e kriminalitetit, në kapitullin e pestë të punimit kemi analizuar realizimin e kësaj hipoteze me ndihmën e metodave të ndryshme shkencore. Pas trajtimit kronologjik dhe sistematik të ndryshimeve që ka pësuar K. Penal në lidhje me politikën e dënimit dhe një trajtimi krahasues të ashpërsisë së dënimeve në raport me vende të tjera të Evropës, kemi përshkruar rezultatet e studimeve më relevante kriminologjike në lidhje me efektin frenues të ashpërsimit të dënimeve penale. Analizimi i ndikimit të dënimeve të ashpra në uljen e kriminalitetit në Shqipëri është ndarë për tre grupe të ndryshme veprash penale.

Fillimisht kemi analizuar në detaje nëse ashpërsimet e dënimeve në K. Penal kanë dhënë ndonjë efekt të dukshëm frenues tek veprat penale të vrasjeve me dashje². Më pas kemi analizuar nëse dënimet e rënda kanë arritur ndonjë efekt frenues tek një numër i madh veprash të përhapura me një rrezikshmëri të lartë (apo relativisht të lartë) shoqërore. Po ashtu, duke vlerësuar rëndësinë e saj praktike aktuale, në këtë seksion kemi analizuar dhe efektin që kanë pasur politikat e dënimeve të rënda tek disa vepra me një përhapje shumë të gjerë në vendin tonë. Gjatë seksioneve të këtij kapitulli kemi analizuar poashtu nëse pohimi i Beccaria-s se: “siguria e një dënimi, edhe pse i butë, do të bëjë gjithnjë një përshtypje më të madhe sesa frika e një tjetri më të tmerrshëm, i cili shoqërohet me shpresën e pandëshkueshmërisë” (1973: 66), gjen apo jo zbatim në realitetin shqiptar. Në fund të këtij kapitulli kemi analizuar arsyetueshmërinë e dënimeve të ashpra penale, duke marrë në konsideratë aspektet penale, kriminologjike, sociale, ekonomike dhe humane të këtyre politikave dhe shqyrtimit të alternativave të tjera më efikase dhe më të zgjuara.

Megjithëse kriminaliteti është një fenomen shqetësues për shoqërinë, shteti duhet ta rendisë luftën me metoda penale ndaj tij nga fundi i listës së luftërave që ai duhet të ketë prioritet për të zhvilluar. Për një luftë të suksesshme ndaj krimit, shteti dhe shoqëria, duhet të organizojnë dhe fitojnë luftën ndaj varfërisë ekstreme, papunësisë, injorancës, sëmundjeve dhe polarizimit të skajshëm social. Nëse shoqëria dhe shteti e përqendrojnë luftën ndaj krimit, vetëm duke parashikuar vepra penale dhe dënime të ashpra në K. Penal, e drejta jonë penale do të vazhdojë të jetë penale, por jo e drejtë.

² Në këtë koncept kemi përfshirë përveç nenit 76 të K. Penal të gjitha vrasjet e kryera me dashje.

Hipoteza e punimit.

Hipoteza kryesore e punimit doktoral është se ashpërsimi i politikës së dënimit penal përmes rëndimit të vazhdueshëm të llojeve dhe masave të dënimit nuk ka sjellë ulje të kriminalitetit në vendin tonë. Që nga miratimi i tij në vitin 1995, Kodi Penal shqiptar ka pësuar plot 16 ndryshime, shumica e të cilëve kanë synuar në ashpërsimin e politikës penale dhe rrallë herë është vërejtur ndonjë nismë depenalizuese apo zbutëse. Pjesa më e madhe e këtyre ndryshimeve janë kryer me justifikimin e zhvillimit të një lufte të pakompromis me krimin, me qëllim çrrënjosjen e tij dhe arritjen e paqes sociale dhe publike. Analizimi i arritjes së efektit frenues të dënimeve të rënda dhe hulumtimi i alternativave më të arsyeshme përbëjnë boshtin e këtij punimi.

Pyetjet kërkimore të punimit

Pyetja kryesore kërkimore është: A është dënimi penal në vendin tonë në harmoni me qëllimet që e drejta penale moderne synon të arrijë dhe cilat janë të metat më të mëdha në aspektin ligjor, doktrinar dhe jurisprudencial në raport me të drejtën penale të vendeve të zhvilluara demokratike. Më në detaje pyetja mund të ndahet në disa nënpyetje, në varësi të etapave të shtjellimit të punimit, si:

1. Cilat janë qëllimet që ndjek dënimi penal në vendin tonë?
2. Cilat janë tendencat e legjislacioneve të vendeve të ndryshme demokratike në parashikimin e sanksioneve penale?
3. A janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme dënimet penale të parashikuara në K. Penal shqiptar për arritjen e këtyre qëllimeve?
4. Cilat janë të metat dhe avantazhet e secilit prej dënimeve kryesore, plotësuese dhe të masave të tjera me karakter penal të parashikuara në K. Penal?
5. Sa ndikim kanë qëndrimet politike në përcaktimin e politikës së caktimit të dënimit?
6. Sa i arsyeshëm është diskrecioni gjyqësor i njohur me ligj dhe hapësirat mes minimumeve dhe maksimumeve të dënimeve në dispozitat e pjesës së posaçme?
7. A janë të formuluar drejtë dispozitat ligjore që përcaktojnë parimet dhe kriteret e caktimit të dënimit penal dhe a zbatohen siç duhet nga praktika gjyqësore shqiptare?
8. Sa të plota dhe të arsyeshme janë alternativat e dënimit me burgim?
9. Cila është tendenca e politikës penale në vendin tonë dhe a ka qenë ajo e suksesshme?
10. Sa të arsyeshme kanë qenë reformat për ashpërsimin e dënimeve dhe cilat janë zgjidhjet më të arsyeshme të provuara nga vendet e tjera demokratike?

Metodologjia dhe metodat shkencore të përdorura

Për shkak të mungesës së studimeve të mëparshme të thelluara rreth çështjeve të politikës së caktimit të dënimit penal në vendin tonë, krahas çështjeve të shumta me interes praktik, në punim

i kemi kushtuar një pjesë të konsiderueshme trajtimit teorik doktrinar të qëndrimeve të mbajtura nga literatura bashkohore botërore dhe përjasjes së saj mbi realitetin ligjor shqiptar. Për këto arsye, në këto pjesë të disertacionit do të përdoren si bosht i saj metodat e analizës deduktive dhe ajo krahasimore. Duke qenë se punimi ka një natyrë transdisiplinore me implikime të shkencave të filozofisë së të drejtës, së drejtës penale, kriminologjisë, penologjisë, politikës penale dhe asaj kushtetuese, ai përbën një ndërthurje të modelit të kërkimit shkencor deskriptiv dhe analitik me një formë diagnostifikuese. Si i tillë, jemi përpjekur që punimi të përmbajë brenda tij si modelin zhvillimor ashtu edhe atë vlerësues, me synimin që ai të jetë një studim impaktësor, përveçse identifikues. Për shkak të këtyre objektivave, një pjesë e mirë e analizës dhe e konkluzioneve të punimit është mbështetur mbi aplikimin e metodave statistikore të të dhënave të mbledhura, ndërsa qasjes historike i është rezervuar një hapësirë minimale në analizimin e evolimit të sanksioneve penale në botë dhe një peshë më e madhe në trajtimin e evolimit të ashpërsisë së sanksioneve në vendin tonë në 20 vitet e fundit. Megjithatë analiza e çështjeve të ndryshme të punimit përmes metodave sasiore është dominuese, analiza individuale cilësore e çështjeve të veçanta zë një pjesë të konsiderueshme në të pesë kapitujt e punimit.

Pjesa e parë e punimit do të mbështetet në analizën teorike të qëllimeve të dënimit penal dhe përmbushjes praktike të tyre në praktikën gjyqësore, përmes studimit dhe analizimit të thellë të korpusit ligjor, doktrinės dhe jurisprudence gjyqësore. Për analizimin krahasues të aspekteve të dënimit penal me vende të tjera janë përdorur tekstet e ligjeve dhe kodeve penale dhe një literaturë e gjerë doktrinare rreth tyre. Gjatë trajtimit dhe analizimit të aspekteve dhe instituteve të ndryshme të dënimit penal janë përdorur të dhëna të shumta dytësore kriminologjike dhe penalogjike nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja si vjetarët statistikorë të MD, publikime të DPB, të Prokurorisë së Përgjithshme, të MPB dhe të Policisë së Shtetit, të GJRRGJ Tiranë dhe Shkodër, të Prokurorisë Shkodër, si dhe të dhëna të marra nga dokumente dhe studime të publikuara nga institucione ndërkombëtare si buletinet e KE, WODC dhe ICPC (ESCCJS) mbi statistikën evropiane të kriminalitetit, ICPS mbi popullimin e burgjeve, të agjensive të OKB mbi kriminalitetin etj. Së fundmi, nisur nga synimi impaktësor i punimit, në trajtimin e instituteve dhe aspekteve të dënimit penal në vendin tonë i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë qëndrimeve jurisprudenciale të mbajtura nga sistemi ynë gjyqësor (kryesisht GJK dhe GJL, por edhe GJA dhe GJRRGJ) dhe nga GJEDNJ. Qëndrimi i praktikës gjyqësore do të analizohet me metoda cilësore gjatë trajtimit të aspekteve të ndryshme praktike dhe të problematikës së evidentuar nga punimi dhe me metoda sasiore në shtjellimin e disa nga pyetjet kërkimore, veçanërisht në kapitullin e pestë ku i rezervohet një vëmendje më e madhe testimit të hipotezës së punimit.

Kufizimet e këtij punimi dhe mundësitë e studimeve të ardhshme

Kufizimi i parë i këtij punimi ka qenë mungesa e literaturës dhe e studimeve empirike vendase në fushën kriminologjike dhe atë penale në matjen e efektivitetit të sanksioneve penale. Trajtimet teorike vendase të hasura në lidhje me çështjet të cilat ka për objekt studimi ky disertacion, më së shumti shtjellojnë kalimthi dhe sipërfaqësisht ato, duke mos shpjeguar qartë metodologjinë e kryerjes së tyre, burimet e tyre të informacionit dhe poashtu manifestojnë një karakter të theksuar teorik. Mungesa e studimeve të mirëfillta aktuale me fokus politikën e caktimit të dënimit, na ka shtyrë jo vetëm që në punim t'i rezervohet një pjesë e konsiderueshme rrahjes së aspekteve teorike, por edhe referimit me patjetër në studime të kryera në vende të tjera. Mungesa e studimeve të tilla të mëparshme në sasi dhe cilësi, bën poashtu të pashmangshme që objekti i trajtimit të tij punimi të ketë një natyrë relativisht të gjerë.

Kufizim i dytë në kryerjen e punimit kanë qenë vështirësitë në sigurimin e të dhënave statistikore të sakta dhe të plota mbi të gjithë treguesit e kriminalitetit dhe të reagimit shtetëror mbi to. Megjithatë shumica e të dhënave të përdorura në studim kanë qenë zyrtare, jemi të vetëdijshëm se ato nuk paraqesin me saktësi të plotë panoramën e kriminalitetit dhe dinamikën e tij ndër vite³. Këtyre pasigurive u shtohen mungesa e studimeve empirike sociologjike dhe kriminologjike për shkallën e kriminalitetit në vendin tonë pas fillimit të viteve '90. Po ashtu, me qëllim izolimin sa më të mirë të variablave dytësor të cilët ndikojnë në uljen apo rritjen e kriminalitetit, do të ishin dashur të dhëna më të plota dhe të sakta në rang vendi mbi reagimin shtetëror ndaj tij, si: numri i veprave penale të ndodhura realisht, numri i atyre të kallëzuara, numri i personave të dyshuar si të përfshirë në krim, e më tej numri i procedimeve të mosfilluara, të pezulluara, të pushuara dhe të marra pafajësi në të tre shkallët e gjyqësorit.

Megjithë përpjekjet për cekjen e çështjeve kryesore gjatë këtij punimi, ai nuk merr përsipër të ketë natyrë shteruese. Me vetëdije të plotë pranojmë se shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me caktimin e dënimit nuk janë trajtuar, apo janë trajtuar tangencialisht. Për këto arsye, ky punim përpiket të transmetojë tek auditori shkencor dhe i praktikantëve, këndvështrimin dhe përfundimet e autorit për disa nga çështjet më të rëndësishme të politikës së dënimit penal në vendin tonë. Mbetemi me shpresë se ky punim do të shërbejë edhe si shkëndijë nxitëse për një debat më të gjallë shkencor dhe eventualisht për studime të tjera të thelluara rreth aspekteve të veçanta të politikës së dënimit penal në vendin tonë.

³ Kjo për shkakë metodologjike të mbledhjes së të dhënave, të mungesës së kapaciteteve njerëzore apo madje edhe për arsye politike.

KAPITULLI I: DËNIMI PENAL

1.1. Kuptimi i sanksionit penal

Që nga format më primitive të organizimit të shoqërisë njerëzore, kjo e fundit është përpjekur për të gjetur mënyra për të luftuar sjelljet devijante, të cilat binin ndesh me interesat dhe pikëpamjet e pjesës dominuese të shoqërisë (Miethe & Lu, 2005: 1). Përgjatë historisë njerëzore, grupet dominuese shoqërore kanë vendosur një seri rregullash të cilat duhej të zbatoheshin nga anëtarët e saj, në të kundërt ndaj tyre do të aplikoheshin sanksione të caktuara. Në kuptimin sociologjik sanksioni mund të përkufizohet si një mjet i njohur ligjor shtrëngues nëpërmjet të cilit bëhen përpjekje për të siguruar përputhshmërinë e sjelljeve me normat e paravendosura (Hirst, 1994: 266). Në tërësinë e normave të sistemit juridik, e drejta penale zë një pjesë fare të vogël të saj dhe po ashtu volumi i sjelljeve antishoqërore për të cilat parashikohet një sanksion penal është i vogël. Ligjvënësit parashikojnë si vepra penale vetëm ato sjellje të cilat dëmtojnë apo rrezikojnë disa nga vlerat më të larta dhe më prioritare të shoqërisë apo në masën më të papranueshme dhe në eventualitetin e kryerjes së tyre parashikon dhe zbatimin e një sanksioni shtrëngues për to.

Çështjet e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti kanë qenë dhe mbeten një nga sfidat më të mëdha të të gjitha shoqërive (Fiandaca & Musco, 2010: 16), mirëpo mjetet dhe mënyrat e përzgjedhura kanë variuar në varësi të shkallës së zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe human. Format fillestare të ndëshkimeve penale kanë qenë cënimet fizike, si: gjymtimi i pjesëve të trupit, nxjerrja e syve, prerja e kokës (Lewis, 2003: 21) etj. Më vonë, me zhvillimin dhe përsosjen e organizimit të shtetit, ndaj personave fajtorë filluan të aplikoheshin si ndëshkime edhe burgimi, internimi apo privimet pasurore, si: djegia e shtëpisë, konfiskimi i pronave etj. Padyshim që idetë iluministe të Rousseau (Ruso), Bentham, Montesquieu, Beccaria (Muçi, 2012: 35) etj. kanë sjellë një kontribut të madh në transformimin e konceptit të së drejtës penale dhe të sanksioneve penale. Debati mbi funksionin dhe efektshmërinë e të drejtës penale dhe të sanksioneve penale si mjeti kryesor i saj, ka vazhduar intensivisht edhe në shekullin e kaluar dhe vazhdon të jetë shumë aktiv edhe në ditët tona.

Sanksionet penale përfshijnë në gjirin e tyre të gjitha masat penale (Salihu, 2012: 416) që ndërmerren në kuadër të së drejtës penale, duke përfshirë dënimin penal, masat penale ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, masat edukuese ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi si dhe masat penale ndaj personave juridikë⁴. Vetë K. Penal e paraqet shprehimisht këtë koncept në nenin 1 të tij, kur parashikon se: “*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre..*”. Dënimi penal është lloji kryesor i sanksionit penal dhe në thelb ai përbën arsyen kryesore të ekzistencës së vetë të së drejtës

⁴ Masa të parashikuara në nenet 45 dhe 46 të K. Penal të Republikës së Shqipërisë.

penale. E drejta penale nuk mund të kuptohet se mund t'i shërbejë efektivisht shoqërisë, pa dënimin penal si një mjet shtrëngues i cili u jepet personave që kryejnë vepra penale.

Mirëpo nga ana tjetër natyra e pashmangshme shtrënguese dhe ndëshkuese e dënimit penal nuk duhet të kuptohet si arsye e mjaftueshme për të qenë maksimalisht e ashpër dhe johumane. Dënimet penale (edhe ato të cilat kufizojnë në shkallë të lartë drejtat e të dënuarve si p.sh. dënimi me burgim) duhet gjithsesi të jenë humane dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe standardet më të larta të të drejtave të njeriut. Dënimi penal nuk duhet të konsiderohet si zgjidhja e parë e aq më pak e vetme për kontrollin social ndaj sjelljeve devijante. Shoqëritë demokratike bashkëkohore të cilat çmojnë vlerat e çdo qenie njerëzore e konsiderojnë të drejtën penale dhe dënimin penal si një mjet *ultima ratio* (Melander, 2013) për arritjen e paqes dhe të sigurisë shoqërore.

1.2. Të përbashkëtat dhe dallimet e dënimit penal me llojet e tjera të sanksioneve (administrative, disiplinore, civile etj.)

Dënimi penal si një sanksion shtetëror është vetëm njëri nga masat e shumta që vendos Ligjvënësi ndaj shkelësve apo devijuesve të ligjit. E drejta penale dhe arma e saj kryesore, dënimi penal (Bianchi, 1994: 333), janë në pamje të parë mjeti më i fuqishëm dhe efektiv në vendosjen e ligjshmërisë dhe kontrollit social. Mirëpo sistemi ligjor bashkohor është i mbushur me një numër të madh ligjesh të cilët parashikojnë sanksione administrative, disiplinore dhe civile. Vetëm po të mjaftohemi në përmendjen e numrit të ligjeve apo akteve nënligjore që parashikojnë sanksione të ndryshme (pa hyrë në brendësi të tyre për sjelljet konkrete) mund të themi se ato janë me mijëra. Shteti dhe organizmat e tjerë socialë parashikojnë sanksione të ndryshme në çdo fushë të jetës, që nga lëvizja, qëndrimi, puna, aktiviteti tregtar, arsimi, mjekësia, ndërtimi, e deri tek e folura apo veshja.

Shumica e autorëve bien dakord nga ana tjetër se dënimi penal është forma më radikale dhe më e rëndë e kufizimit të të drejtave të njeriut nga shteti, si rrjedhojë e cënimit paraprakisht nga kryerësi të një të mire me vlerë të posaçme për shoqërinë. Kjo është e evidente p.sh. në vepra të tilla si vrasja, tortura, vjedhja me armë, përdhunimi, apo rrëmbimi i personit, mirëpo vjen e zbehet me uljen e vlerës që një e mirë e caktuar ka, si p.sh. në veprat penale ndaj moralit, besimit fetar, etj. Për shkak të shkallës përgjithësisht të lartë të kufizimit të lirive të të dënuarit, dënimi penal ka disa karakteristika formale që e dallojnë nga sanksionet e tjera që imponon shteti. Të tilla janë p.sh. fajësia në kryerjen e veprës, parimi i ligjshmërisë së shprehur, karakteri individual, karakteri veçanërisht ndëshkues, dhënia e tij vetëm nga gjykata dhe ndryshimi në statusin juridik të personit të dënuar (Elezi, Kaçupi, & Haxhia, 2013: 219). Në ndryshim nga e drejta penale, në atë civile njihet edhe përgjegjësia pa faj dhe fajësia e debitorit prezumohet, duke i ngarkuar barrën e provës shkaktuesit të dëmit (Semini, 2006: 190).

Mirëpo dallimi i dënimit penal, kryesisht me sanksionet administrative, por edhe me ato civile dhe disiplinore nuk është gjithmonë aq i lehtë në kuptimin substancial, sa i takon shkallës së ashpërsisë së tij. Kështu p.sh. praktika gjyqësore ka aplikuar gjerësisht dënime me gjobë nga 50 mijë deri në 200 mijë lekë gjobë (Nikolli, 2015d) për kryerjen e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a §1 i K. Penal, ndërkohë që INUV-i ka vendosur si sanksion administrativ shembjen e ndërtimit të paligjshëm. Pra për të njëjtin veprim të paligjshëm, sanksioni administrativ i aplikuar e kapërcen në ndonjë rast deri në qindra herë dënimin penal të caktuar nga gjykata. Po ashtu, nga praktika gjyqësore vërehet se masa e dënimit me gjobë për kryerjen e veprës penale të shpifjes ka qenë në shumicën e rasteve ndjeshëm më e ulët se masa e shpërblimit që gjykata civile ka vendosur si detyrim ndaj të paditurve për cënim të reputacionit të paditësve (pra për shpifje)⁵.

Situata të ngjashme mund të ilustrohen edhe me plot vepra të tjera penale si p.sh. me nenin 290 §1, apo §2 të K. Penal, ku gjykata e ka dënuar të pandehurin me gjobë në masën 500.000 lekë, ndërkohë që gjykata civile e ka detyruar atë të paguajë në favor të Byrosë së Shqiptare të Sigurimeve shuma disa herë më të mëdha⁶. Po njësoj, në raste tëaktuara edhe sanksioni disiplinor i largimit nga puna (ku punëmarrësit përveçse mund t'i shkatërrohet karriera, mund t'i vijë edhe një dëm i konsiderueshëm financiar vjetor), mund të rezultojë një masë më e rëndë sesa një dëmim i zakonshëm i caktuar nga gjykatat shqiptare për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.

Me humanizimin e të drejtës penale, përmes shtimit të llojit të dënimeve plotësuese dhe të alternativave të dënimit me burgim, shpeshherë është e pamundur të identifikosh për nga ashpërsia e tij, një dëmim penal me një sanksion administrativ. Njëri nga llojet e dënimeve kryesore, dënimi me gjobë, parashikohet edhe si sanksion administrativ standard në të gjitha ligjet që parashikojnë kundërvajtje administrative dhe po ashtu masa të tilla si heqja e të drejtës për të drejtuar automjete

⁵ GjRRGJ Tiranë me vendimin nr. 38 datë 19.01.2012 ka vendosur deklarin fajtore të të akuzuarës S. Sh. për kryerjen e veprës penale të "Fyerjes", parashikuar nga neni 119/1 i K. Penal dhe dënimin e saj me 50.000 lekë gjobë. E njëjta gjykatë me vendimin nr. 570 datë 24.03.2014 ka vendosur deklarin fajtore të të akuzuarit, A. G. për kundërvajtjen penale të "Shpifjes", parashikuar nga neni 120/2 i K. Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 90.000 lekë gjobë. KPGJL me vendimin nr. 8, datë 05.06.2015 ka vendosur deklarin fajtore të pandehurin E. P. për veprën penale të shpifjes së kryer botërisht dhe në bazë të nenit 120/2 të K. Penal, dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë. Ndërkohë GJA Tiranë me vendimin nr. 267, datë 05.02.2013 ka lënë në fuqi vendimin e GjRRGJ Tiranë nr. 5189, datë 21.05.2012, duke detyruar të paditurin Z. D. që t'i paguajë paditësit F. S. shumën prej 250.000 lekë si dëmshpërblim për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga shpifja. GjRRGJ Tiranë me vendimin 8269, datë 24.10.2011, ka vendosur detyrimin e të paditurit S. T. që t'i paguajë paditëses A. V. shumën prej 3.333.333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë si dëmshpërblim për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga cenimi i nderit dhe personalitetit të saj (shpifje). GJA Tiranë me vendimin nr. 16, datë 11.01.2013, megjithëse e ka ulur këtë masë dëmshpërblimi në shumën një milion lekë, përsëri kjo shumë është disafish më e lartë se masa e një gjobe penale.

⁶ Me vendimin nr. 2798, datë 23.11.2012 GJA Tiranë ka vendosur detyrimin e të paditurit Sh.Z. t'i paguajë paditësit Byroja Shqiptare e Sigurimeve shumën prej 1 375 224 lekësh, ndërkohë që gjykata penale e ka dënuar atë vetëm me 500 000 lekë gjobë.

(Kodi rrugor, 2015), konfiskimi i sendeve⁷ apo nxjerrja jashtë territori (Ikonomi, 2009: 67) janë edhe dënime penale plotësuese edhe masa administrative.

1.3. Qëllimi i dënimit penal

Pyetjes se përse duhet të dënohen kryerësit e veprave penale mund t'i jepen përgjigje të shumta. Ajo përfshin brenda saj çështje të natyrës juridike, filozofike, shoqërore dhe pse jo edhe ekonomike. Këtë temë e kanë trajtuar shumë juristë dhe filozofë të njohur që nga kohërat antike e deri në ditët e sotme. Sipas teorisë të së drejtës penale angleze (Herring, 2013: 62), teoritë mbi dënimin mund të ndahen në konsekuencialiste (të quajtura edhe relative), jokonsekuencialiste (të quajtura ndryshe dhe absolute) dhe mikse. Teoritë konsekuencialiste justifikojnë caktimin e dënimit nisur nga fakti se ai sjell pasoja të dobishme për shoqërinë, ndërsa teoritë jokonsekuencialiste nuk marrin në konsideratë pasojat e dënimit.

1.3.1. Teoritë absolute mbi qëllimin e dënimit

Sipas teorisë retributive, dënimi justifikohet me faktin se me sjelljet e tij kryerësi e meriton atë. Kjo teori e ka origjinën fillestare që me *lex talionis* me parimin "sy për një sy, dhëmb për një dhëmb, dhe një jetë për një jetë" (Hudson 1996: 38). Sipas retribuicionistëve pasi shoqëria ka vendosur një sërë rregullash ligjore, për anëtarët e shoqërisë lind detyrimi i respektimit të tyre. Sipas këtyre teorive dënimi duhet të caktohet për arsye se i pandehuri ka pasur mundësi para se të kryejë veprën penale, që të zgjedhë: ta kryejë veprën penale apo mos ta kryejë atë (Herring, 2013: 63). Meqë vetë ka zgjedhur kryerjen e veprës penale, ai duhet të dënohet sepse ka bërë gabim, duke cenuar normat hyjnore, morale apo ligjore⁸ (Halili, 2014: 56).

Një variant komplementar i teorisë retributive, është teoria e mosmiratimit, apo e meritave të drejta *just deserts* (Von Hirsch, 2003a: 9), sipas së cilës shoqëria shfaq gjykimin dhe ndjenjën e saj të përbuzjes dhe dënimit ndaj sjelljes së kryerësit të saj. Në kontekstin e së drejtës penale, mosmiratimi i komunikohet kryerësit nëpërmjet deklaramit të tij fajtor, ose nëpërmjet një dënimi të ashpër, si burgu, gjoba apo puna në interes publik (Duff, 1999: 51). Një shpjegim tjetër i teorisë së shpagimit është përpykja për ta parë dënimin si një mjet të rivendosjes së drejtësisë, për përfitimin e padrejtë që kryerësi ka marrë nga shoqëria nëpërmjet kryerjes së krimit (Ten, 1987: 5).

Sipas Nozick (1981: 365), ka një dallim mes shpagimit dhe hakmarrjes, sepse ndërsa e para bëhet pas një veprimi të gabuar, hakmarrja mund të bëhet edhe pas një veprimi të drejtë; ndërsa shpagimi është i drejtë dhe proporcional mbi bazën e seriozitetit të shkeljes, hakmarrja nuk njeh limite

⁷ P.sh., sipas nenit 93 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit të pasurisë në pronësi të tatimpaguesit.

⁸ Duke u ndarë kështu më tej teoria retributive në teorinë hyjnore, morale, apo ligjore.

(1981). Po ashtu hakmarrja ka një ngjyresë emocionale dhe personale për ta parë tjetrin të vuajë, ndërsa shpagimi bëhet pa ndikime emocionale apo personale. Shpagimi bëhet vetëm ndaj fajtorit, ndërsa hakmarrja mund të drejtohet edhe ndaj të afërmeve të pafajshëm.

Këtyre teorive u bëhen kritika, sepse ato nuk marrin në konsideratë shkaqet dhe rrethanat sociale që mund ta shtyjnë një person në kryerjen e një krimi dhe as nuk interesohen për efektivitetin e dënimit të dhënë. Aktualisht teoria retributive i përgjigjet më shumë pyetjes se përse duhet të dënojmë (motivimin), sesa për qëllimin që ka dënimi penal (Fiandaca & Musco, 2010: 714). Teoritë më të reja të ashtuquajtura neoretributive shtojnë se në aspektin e psikanalizës, sjelljet kriminale duhen ndëshkuar, pasi kryerësi i një veprë penale me shfaqjen e veprimit të tij, përbën një shembull “ngjitës” për personat e tjerë për të thyer ndalimet ligjore (Fiandaca & Musco, 2010: 716). Teoria e meritës së drejtë u ravijëzua në vitet 80 në SHBA, si një kundërshtim ndaj pasigurisë dhe mungesës së konsekuencës që prodhonin në masat e dënimeve, praktikat e caktimit të dënimeve mbi bazën e nevojave rehabilituese apo riedukative të të dënuarve, apo përcaktimi i datës së lirimit me kusht nga borde jogjyqësore (Hudson 1996: 39).

Mendime të tilla bazohen në pikëpamjet e drejtësisë absolute, qoftë varianti i drejtësisë hyjnore, morale apo ligjore. Në këtë mënyrë dënimi bëhet qëllimi i vetvetes, sepse ai nuk ka qëllime të tjera. Personi që ka kryer veprën penale dënohet vetëm sa për t’iu kthyer e keqja në të njëjtën masë ose më tepër, e jo që ai në të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera e të përmirësohet. Pra sipas tyre personi delinkuent dënohet pse ka gabuar në të shkuarën e jo që në të ardhmen të mos gabojë përsëri. Në këtë mënyrë hakmarrja dhe shpagimi paraqiten si kërkesa të drejtësisë absolute, si domosdoshmëri të drejtësisë hyjnore. Nuanca të këtyre teorive zbatohen akoma sot në disa vende si Algjeri, Iran, Indonezi, etj., por edhe në vende të zhvilluara demokratike si SH.B.A. dhe më pak në vendet e tjera të traditës anglo-saksone. Vetë ekzistenca e dënimit me vdekje tregon për ndikimin aktual të këtyre teorive në shumë vende të botës.

1.3.2. Teoritë relative mbi qëllimin e dënimit

Me kontributin e filozofëve si Beccaria, Feuerbach (Fojerbah), Rousseau, Bentham etj. është konsoliduar mendimi juridik se dënimi nuk duhet të jepet si shpagim për veprën e kryer, por që t’i shërbejë shoqërisë për të ardhmen (Halili, 2014: 56). Sipas këtyre pikëpamjeve, dënimi paraqitet si mjet për mbrojtjen e shoqërisë dhe pengimin e kriminalitetit. Në dallim nga teoritë absolute të cilat qëllimin e dënimit e kanë të orientuar nga e kaluara, teoritë konsekuencialiste (apo relative) qëllimin e dënimit e drejtojnë nga përfitimet për të ardhmen. Qëllimi i dënimit sipas tyre është që në të ardhmen të pengohet kryerja e krimeve të tjera nga autori i veprës penale dhe nga të tjerët. Qëllimi i dënimit sipas teorive relative është parandalimi special, parandalimi i përgjithshëm, paaftësimi, rehabilitimi dhe drejtësia restauruese (Herring, 2013: 62).

Teoria e parandalimit të posaçëm synon në ndikimin tek kryerësi i veprës penale që nëpërmjet dënimit ai të mos përsërisë më vepra penale në të ardhmen. Pra kjo teori fokusohet në parandalimin e recidivizmit të kryerësve të veprave penale. Në varësi të formave se si është propozuar parandalimi i recidivizmit, teoria e parandalimit të posaçëm ndahet në teorinë e frikësimit, kujdestarisë, e përmirësimit (riedukimit) dhe riintegritit (Halili, 2014: 57). Siç do të trajtohet më gjerë në kapitujt në vijim, teoria e frikësimit (qoftë në parandalimin e përgjithshëm, qoftë në atë specifik) aktualisht është e kritikuar gjerësisht për mungesën e një mbështetjeje logjike dhe etike (Kambovski, 2007: 455), ndërsa nënteoritë e kujdestarisë dhe të riedukimit megjithë entuziazmin fillestar për reformim rrënjësor të sistemit penal, nga studimet e fundit rezulton se po ndeshin në vështirësi praktike për bërjen e tyre efektive (Fiandaca & Musco, 2010: 718; Milla, 2008: 91).

Teoritë e parandalimit të përgjithshëm. Sipas këtyre teorive, qëllimi i dënimit është ndikimi në publik, që qytetarët e tjerë të mos kryejnë vepra penale. Këto teori burojnë nga teoritë utilitariste⁹ dhe janë mirëfilli pragmatiste, pasi synojnë të ardhmen dhe nuk marrin në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprave apo gjendjen e autorëve në momentin e kryerjes së veprës. Qëllimi i parandalimit të përgjithshëm është argumenti më i pëlqyer i retorikës politike (Wright, 2010: 6), pasi nëpërmjet tij politikanët përpiqen të mbështesin idenë e të qenit të ashpër me krimin. E drejta penale e realizon parandalimin e përgjithshëm nëpërmjet dy mekanizmave, nëpërmjet frikës së zbulimit dhe kapjes që kanë autorët eventuale të veprave penale dhe nëpërmjet frikës së marrjes së një dënimi të rëndë për veprimet e tyre (Wright, 2010: 2). Diskutimi i efektivitetit të secilit prej këtyre dy mekanizmave në parandalimin e përgjithshëm është një çështje me rëndësi prioritare praktike, sepse ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve më produktive për uljen e kriminalitetit. Megjithëse në vijim të këtij punimi do të përpiqemi të analizojmë efektivitetin e të dy këtyre mekanizmave frenues të dënimit penal, fokus qendror i tij do të jetë analizimi i efektivitetit të ashpërsimit të dënimeve penale.

Një problem i madh i preventivës gjenerale në kohët moderne është kakofonia e informacionit që publiku merr mbi ligjin, mbi qëndrimet politike mbi të dhe zbatimin praktik të tij nga ana e gjykatave dhe çorientimin që ky informacion (shpeshherë, së paku në dukje kontradiktor) shkakton. Sot transmetimi i efekteve të vërteta të së drejtës penale nuk bëhet më nëpërmjet shfaqjeve të ekzekutimeve publike, por nëpërmjet *mass-medias* (Mathiesen, 1994: 219). Për pasojë duke marrë në konsideratë përparësitë apo qëndrimet editorialiste të vetë mediave të ndryshme, përcjellja e mesazhit të së drejtës penale dhe të dënimit penal tek publiku është i transformuar apo i filtruar (Erikson, Baranek & Chan, 1991: 31).

⁹ Të ideuara nga filozofi, juristi dhe reformatori social britanik Jeremy Bentham.

Teorisë së parandalimit të përgjithshëm i bëhen kritika sepse nuk mbështetet mjaftueshëm në moral, pasi e përdor kryerësin e veprës penale si një mjet në funksion të qëllimit të frikësimit të tjerëve (Walker, 1994: 210). Pyetjes se a është e drejtë që të sakrifikojmë të drejtat e një personi konkret në mënyrë që të mbrojmë të drejtat e një personi hipotetik në të ardhmen (Mathiesen, 1994: 233), teoria e së drejtës penale akoma nuk i ka dhënë përgjigje. Akoma më rëndë, menjëherë mund të na vijë në mendje pyetja pasuese se a është e drejtë të dënohen ashpër njerëz të varfër, të paarsimuar apo në nevojë, me arsyetimin se kjo do të parandalojë sjellje të njëjta edhe të kategorive më të gjera sociale? GJK italiane¹⁰ është shprehur se individit duhet të konsiderohet nga ligji si një qëllim dhe jo si një mjet në funksion të politikës penale.

Teorisë së parandalimit të përgjithshëm i bëhet edhe një kritikë në thelbin e motivimit të saj, pasi nga studimet e ndryshme empirike të zhvilluara nuk është arritur të provohet bindshëm se parandalimi i përgjithshëm funksionon (Walker, 1991; Walker, 1994: 213; Nagin & Pepper, 2012). Ilustrimi provues më i preferuar i kësaj kritike është sistemi amerikan i drejtësisë penale, i cili megjithëse parashikon dënime shumë më të rënda sesa ai evropian (duke përfshirë dhe aplikimin e dënimit me vdekje në disa shtete të saj), në vend që të sillte uljen e kriminalitetit, ka sjellë normën më të lartë botërore të të burgosurve¹¹.

Teoria e paaftësisimit synon të neutralizojë aftësinë kriminale të autorit të një veprë penale për të kryer vepra të tjera në të ardhmen. Në format më të egra ajo zbatohet nëpërmjet prerjes së gjymtyrëve apo ekzekutimit me vdekje si paaftësimi më i sigurtë. Megjithëse kjo teori i referohet kryesisht dënimeve të gjata me burgim, ajo nuk përjashton edhe forma më humane dhe moderne të paaftësisimit si p.sh. monitorimi i të liruarve me kusht (Ten, 1987: 8) nëpërmjet byzylykëve elektronikë, heqja e të drejtës së ushtrimit të mjeshtrisë, ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike etj. Kjo teori kritikohet për faktin se i dënon kryerësit e veprave të shkuara për një rrezik të pasigurtë se ata mund të kryejnë përsëri vepra penale në të ardhmen. Kjo duket moralisht e padrejtë, pasi askush nuk mund ta dijë me siguri se sa nga kryerësit e veprave penale do t'i rikryejnë ato nëse nuk dënohen, apo nëse nuk dënohen me një masë të caktuar dënimi.

Teoria e rehabilitimit. Sipas kësaj teorie personi duhet dënuar që të rehabilitohet dhe të bëhet i aftë për shoqërinë. Ajo i kushton një vëmendje më të madhe kryerësit të veprës penale dhe nevojave të tij sociale, psikologjike dhe intelektuale për përmirësim (Cullen & Gilbert, 2009: 28). Për të kryer këtë funksion, kërkohet sqarimi i rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe i situatës sociale që kanë shtyrë të pandehurin në kryerjen e veprës dhe më pas krijimi i kushteve dhe rrethana për përmirësim (Raynor, 2009: 25). Sipas këtyre teorive lloji dhe masa e dënimit nuk

¹⁰ Decizione nr. 364, 23-24, marzo 1998, rivista Dir e proc pen. 1998, f. 706.

¹¹ Sipas të dhënave të marra në "U.S. Bureau of Justice Statistics", në vitin 2012 në SHBA ishin 2 228 424 të dënuar me burgim ose në një normë prej 707 të burgosur për 100 000 banorë.

duhet të përcaktohet as mbi bazën e ashpërsisë së veprës së kryer as mbi bazën e nevojës së parandalimit të përgjithshëm, por mbi bazën e nevojave personale të të dënuarit për përmirësim. Kësaj teorie i ka dhënë jetë në praktikë parashikimi i dënimeve të pacaktuara (Indeterminate sentences), sipas të cilave masa e dënimit që do të vuhet nuk përcaktohet nga gjyqi, por nga institucione të tilla si bordet e lirimit me kusht, oficerët e provës apo nga punonjës social.

Në aplikimin e tyre në praktikë kjo teori ka hasur vështirësi të mëdha në vitet '70 dhe është kritikuar për mungesë efijense, imoralitet, diskriminim dhe inkompatibilitet me disa nga konceptet bazë të drejtësisë (Rotman, 1994: 281). Nga ana tjetër mbështetësit e kësaj teorie theksojnë se e drejta penale do të mbetet e varfër nëse nuk mban në konsideratë të gjitha rrethanat subjektive të autorit të veprës penale. Sipas tyre është e pakuptimtë që rrethanat subjektive të autorit të mbahen në konsideratë vetëm gjatë përcaktimit të shkallës së përgjegjësisë penale, por të lihen pas dore në fazën e vuajtjes së dënimit (Rotman, 1994: 285). Mbyllja dhe izolimi afatgjatë i të dënuarve nga shoqëria nuk është në përputhje me rehabilitimin, prandaj ata propozojnë mbajtjen e kontakteve dhe të lidhjeve me familjen, shoqërinë dhe punën.

Teoria e drejtësisë restauruese e përqendron qëllimin e dënimit në rikthimin në gjendjen e mëparshme të situatës për të dëmtuarin nga vepra penale. Ajo ka dy degëzime. Njëra fokusohet në riparimin e marrëdhënies së dëmtuar mes viktimës dhe autorit të veprës dhe e dyta fokusohet në zhdëmtimin apo kompensimin e viktimës për dëmin që i është shkaktuar (Herring, 2013: 62). Kjo teori vuan nga një mbështetje argumentesh për besimin që ka në arritjen e pajtimit mes viktimave, shoqërisë dhe të pandehurve. Po ashtu mund të ndodhë që të shtrembërohet rëndësia e vërtetë e veprës penale të kryer për shkak të perceptimit të ndryshëm që viktimat e veprës ka për vlerën e dëmit të pësuar. Gjithsesi duhet theksuar se idealet e admirueshme që kjo teori sjell për reformimin e së drejtës penale nuk duhet lejuar që të vdesin a të veniten për shkak të vështirësive të implementimit praktik të tyre. Në vend që e drejta penale të dorëzohet para vështirësive të tilla, ajo duhet të përpiket më shumë për të eksploruar zgjidhje të tjera inovative, me qëllim humanizimin dhe bërjen e saj më efektive dhe më të arsyeshme.

1.3.3. Teoritë e përziera

Siç mund të sugjerojë terminologjia, këto teori theksojnë se dënimi nuk mund të ketë si qëllim të vetëm shpagimin apo vetëm parandalimin. Mbështetësit e këtyre teorive përpiqen të harmonizojnë apo të përafrojnë pikëpamjet kontradiktore të teorive konsekuencialiste dhe jokonsekuencialiste. Sipas Herbert Hart, dënimi duhet të shfrytëzojë argumentet retributive për të përcaktuar se kush duhet të dënohet dhe ata konsekuencialistë për të përcaktuar mënyrën se si duhet të dënohen (1968: 233). Teoritë e përziera paraqiten në disa variante, në varësi të pikëpamjeve sunduese filozofike nga të cilat anon autori i tyre (pra më shumë retributive, parandaluese, rehabilituese etj.). Ajo që

të gjithë bien dakord sipas kësaj teorie është nevoja për një polifunksionalitet të dënimit (Palazzo, 2005: 36).

Ajo çka mund të konstatojë me lehtësi çdo studiues i saj, është se e drejta penale e vendeve demokratike ka bërë shumë hapa përpara në drejtim të humanizimit dhe liberalizimit të saj. Në legjislacionet penale evropiane është hequr dënimi me vdekje dhe dënimi me burgim duhet të respektojë dinjitetin njerëzor dhe të mos shërbejë vetëm si izolues¹². Po ashtu dënimet alternative dhe mundësia e lirimit para kohe me kusht i kanë dhënë përsëri shpresë idesë risocializuese dhe rehabilituese të së drejtës penale. Megjithë progresin e përmendur, duhet theksuar se në legjislacionet penale bashkohore dhe në praktikat e ekzekutimit të dënimeve, retribucioni, paaftësimi dhe parandalimi i përgjithshëm mbisundojnë në konceptin e dënimit penal. Abolicionistët dhe idetë e tyre për reformim radikal të vetë të drejtës penale (Bianchi, 1994: 336) theksojnë se që me ngritjen e shtetit modern rreth shekullit të XIX e deri më sot, shteti nuk e ka mbajtur premtimin për çrrënjosjen e kriminalitetit me dënime penale. Ai vetëm sa përpigjet të bindë opinionin publik me stereotipin e “armikut të shoqërisë”, në mënyrë që të justifikojë dënimin e tij.

1.3.4. Qëllimi i dënimit penal sipas të drejtës penale shqiptare

Kodi penal i vitit 1927¹³ nuk parashikonte një dispozitë të veçantë mbi qëllimet që ndiqte dënimi penal. Megjithatë nga kuptimi i dispozitave penale që kanë të bëjnë me dënimin penal (nenet 11-90) dënimi penal kishte qëllim ndëshkues dhe parandalues (Muçi, 2012: 262). Ndërsa në ligjin nr. 599 datë 13.5.1948 “Mbi pjesën e përgjithshme të K. Penal”¹⁴, në nenin 2 parashikohej si qëllim i dënimit penal zhdukja e çdo veprimtarie shoqërisht të rrezikshme, ndalimi i ekzekutorit të kryente vepra të tjera penale, të riedukonte dhe përmirësonte autorin dhe të influenconte që pjesëtarët e tjerë të shoqërisë të mos kryenin vepra penale. Kodi i parë i plotë penal socialist i vitit 1952¹⁵ në kapitullin e tretë, në nenin 15 të tij ashtu si ligji i mësipërm (vetëm se me një gjuhë më të qartë) parashikonte se dënimi penal ka për qëllim të dënojë fajtorin, ta ndalojë atë që të kryejë krime të reja, ta edukojë dhe të përmirësojë fajtorin dhe të ushtrojë influencë mbi anëtarët e lëkundur të shoqërisë. Kodi penal i vitit 1977¹⁶, megjithëse rikonfirmoi qëllimet e sipërpërmendura, në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 16 e parashihte shprehimisht karakterin politik dhe ideologjik të dënimit penal duke e konsideruar atë “*armë të fuqishme të diktaturës së proletariatit në luftën kundër armiqve të saj...*”. Kjo ngarkesë me karakter politiko-ideologjik e së drejtës penale është

¹² Në çështjen pilot *Torreggiani and Others v. Italy* (application no. 43517/09) datë 08.01.2013, mbi çështjen e mbipopullimit të burgjeve në Itali, GJEDNJ e konsideroi cënim të nenit 3 të konventës mbajtjen në qeli të vogla të 3 të burgosurve, në kushte me mungesa të gjata në ujë e ngrohtë, dritë dhe ventilim.

¹³ I hyrë në fuqi me 1 janar 1928.

¹⁴ I shpallur me dekreten nr. 615, datë 13.05.1948, hyrë në fuqi më 01.09.1948.

¹⁵ I miratuar me ligjin nr. 1470 datë 23 Maj 1952, hyrë në fuqi me 1 shtator 1952.

¹⁶ I miratuar me ligjin nr. 5591, datë 15.6.1997, hyrë në fuqi më 1 tetor 1997.

pasqyruar edhe në literaturën apo studimet juridike në vitet pasuese të regjimit komunist¹⁷.

Në ndryshim nga tradita 50 vjeçare, në kodin e ri penal të vitit 1995¹⁸ nuk është parashikuar një dispozitë e posaçme që të përcaktojë funksionet apo qëllimet e dënimit penal. Megjithatë, ky boshllëk është përpjekur të plotësohet nga doktrina e së drejtës penale. Sipas një grupi autorësh (Elezi et al, 2013: 221) dënimi penal në vendin tonë ka si qëllim të parë ndëshkimin e fajtorit e më tej ndalimin e veprimtarisë së tij të mëtejshme kriminale si dhe edukimin e tij (i quajtur ndryshe sipas tyre si parandalimi i posaçëm). Qëllim tjetër kryesor i dënimit penal sipas këtyre autorëve është edukimi i shtetasve të tjerë me ndjenjën e respektimit të ligjeve të shtetit (i quajtur ndryshe prej tyre si parandalimi i përgjithshëm). Autori Shfaqet Muçi shfaq mendimin se mbështetur në detyrat që e drejta penale ka në vendin tonë, dënimi penal ndjek të njëjtat objektiva që ndjek e drejta penale moderne e shteteve perëndimore e që janë: a) ndëshkimi i autorit për veprën e kryer, b) ndalimi i autorit në vijimin e veprimtarisë kriminale, c) riedukimi dhe rehabilitimi i autorit dhe d) edukimi i shtetasve të tjerë me ndjenjën e respektimit të ligjit (2012: 262).

Nisur nga vlerat pozitive dhe afërsia shumëplanëshe me vendin tonë, çmojmë me vend të hedhim një vështrim edhe nga kodi i ri penal i Republikës së Kosovës¹⁹, i cili në nenin 41 parashikon si qëllime të dënimit:

- “1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;*
- 2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;*
- 3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe*
- 4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.”*

Siç vërehet K. Penal i Kosovës përveç dallimeve të mirëkuptueshme në formulim, parashikon si qëllim të dënimit penal edhe drejtësinë restauruese (kompensimin e viktimave dhe komunitetit nga dëmet e veprës). Megjithëse drejtësia penale restauruese përbën një këndvështrim të ri edhe për vendet më të zhvilluara demokratike, kjo nuk duhet të përbëjë pengesë që të trajtohet edhe nga e drejta penale shqiptare (Elezi, 2008).

¹⁷ Autori Shfaqet Muçi në punimin e doktoraturës (Universiteti i Tiranës, 1989) shprehët ndër të tjera se: “dënimi penal ka si detyrë ta riedukojë të pandehurin me botëkuptimin e ri si dhe të ndikojë në forcimin e ndërgjegjes juridike socialiste tek personat e tjerë të lëkundur” dhe më tej “dënimi penal është një nga armët kryesore për dënimin e armiqve të pushtetit popullor” (fq.1 dhe 4).

¹⁸ Miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, hyrë në fuqi me 1 qershor 1995.

¹⁹ I miratuar me ligjin nr. 04/L-082 datë 20.04.2012, hyrë në fuqi me 01.01.2013. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.

Nëse do të përpqemi të kryejmë një vlerësim tonin në lidhje me këtë çështje dhe të përcaktonim një renditje (prioritare) të qëllimeve të dënimit penal në vendin tonë, mund të themi se ai ndjek qëllimin ndëshkues, paaftësues, parandalues (frenues) të posaçëm, parandalues të përgjithshëm, rehabilitues dhe restaurues. Për shkak të dënimeve të rënda që K. Penal shqiptar parashikon²⁰, kritereve të caktimit të dënimit²¹ dhe mënyrës së ekzekutimit të tyre²², mund të themi me bindje se më së pari ai ndjek qëllim ndëshkues. Parashikimi i dënimit me burgim të përjetshëm si një dënim ekstrem kryesor, i disa dënimeve plotësuese²³ (të ndalimit për të ushtruar funksione publike, ndalimi për të drejtuar automjete, heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie, heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative, nxjerrja jashtë territorit dhe humbja e përgjegjësisë prindërore), si dhe e disa detyrimeve të parashikuara ndaj të dënuarit të vënë në provë (pikat 4-10 të nenit 60 të K. Penal), janë tregues i qartë i qëllimit paaftësues të dënimit penal. Po ashtu ndryshimet e shpeshta të K. Penal të shoqëruara me ashpërsime të njëpasnjëshme të dënimeve për shumë vepra, me bindjen se këto aksione ligjore do të ulin kriminalitetin, tregojnë se dënimi penal në vendin tonë ndjek me fanatizëm edhe qëllimin e parandalimit të përgjithshëm.

Megjithëse fokusi i drejtpërdrejtë i ashpërsimeve të dënimeve është frenimi i personave të lëkundur në kryerjen e veprave në të ardhmen, ky efekt frikësues shtrihet edhe ndaj personave të dënuar në mënyrë që ata të mos përfshihen më në aktivitete kriminale (pra ndjek si qëllim parandalimin e posaçëm). Nga ana tjetër ndryshimet ligjore në drejtim të shtimit të dënimeve alternative dhe sidomos krijimi i institucionit të Shërbimit të provës, shtimi i detyrimeve gjatë periudhës së provës, ndryshimet ligjore dhe përpjekjet për përmirësimin e kushteve në burgjet e vendit, kanë konkretizuar fillimin e ndjekjes së qëllimit edukues dhe rehabilitues të dënimit penal në vendin tonë. Së fundmi, parashikimi i mundësisë së ngritjes së padisë civile në procesin penal, detyrimi i të dënuarit që gjatë kohës së provës të riparojë (shlyejë) dëmin civil të shkaktuar me anë të veprës së kryer prej tij²⁴, trajtimi si rrethanë lehtësuese, i pajtimit mes viktimës dhe të pandehurit si dhe mundësitë për tërheqjen e ankimit sipas nenit 59 dhe 284 të K. Pr. Penale²⁵, megjithëse në një masë më të vogël, tregojnë po ashtu se dënimi penal në vendin tonë ka për qëllim edhe funksionin restaurues dhe paqtues (normalizimin e marrëdhënieve mes të pandehurit dhe të dëmtuarve).

²⁰ Kjo çështje do të trajtohet në detaje në kapitullin V.

²¹ Ku sipas nenit 47 të kodit penal mbahet parasysh fillimisht rrezikshmëria e veprës penale, e autorit të saj dhe shkalla e fajit.

²² Këtu mbajmë parasysh dhe kushtet reale në burgje dhe kapacitetet praktike të zbatimit të standardeve ligjore të shkruara që kanë të bëjnë me vuajtjen e dënimit me burgim.

²³ Të parashikuara në nenet 30/1, 3, 5, 6, 7, 8, 10 dhe 35, 37, 39, 40, 41, 42, 43/a të K. Penal.

²⁴ Detyrimi i parashikuar në nenin 60 pika 3 e K. Penal.

²⁵ Duke u vendosur pushimi i çështjes, pavarësisht provave në ngarkim të të pandehurit.

1.3.4.1. *Qëllimi i dënimit penal sipas jurisprudencës shqiptare*

Nisur nga fakti se kodi ynë penal nuk ka një dispozitë të veçantë në të cilën të përcaktojnë qëllimet që ndjek dënimi penal, jurisprudenca gjyqësore e vendit ka qenë shumë fluide në drejtim të arsyetimit të qëllimit konkret që ai duhet të ndjekë. Duke qenë se është e pamundur dhënia e një opinionit kategorik mbi studimin e të gjithë praktikës gjyqësore të vendit, mund të kufizohemi vetëm në konstatimin e përgjithshëm se në shumicën e rasteve gjykatat i referohen si qëllime të dënimit atij të parandalimit të posaçëm dhe të përgjithshëm, të edukimit dhe rehabilitimit të autorit. Trajtimi nga gjykatat i çështjes së qëllimit të dënimit penal ndeshet kryesisht në ato raste kur shtrohet për diskutim aplikimi i dënimeve alternative dhe më rrallë në rastet e tjera. Kështu me vendimin nr. 751 (149) datë 30.05.2012 KPGJL ka lënë në fuqi vendimin e GJA Korçë²⁶ ndaj të gjykuarit L.M. i akuzuar se ka kryer veprat penale të “Korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Falsifikim i dokumenteve shkollore”, parashikuar nga nenet 259 dhe 187/2 të K. Penal. Sipas këtij vendimi: “...qëllimi më i qenësishëm i dënimit penal dhe synimi final i tij është riedukimi i autorit të veprës penale dhe riintegrimi i tij në shoqëri pas kryerjes së dënimit.” Nga ana tjetër, GJL thekson se duhet pasur në konsideratë edhe qëllimi parandalues i dënimit penal (i përgjithshëm dhe i posaçëm).

Po ashtu me vendimin nr. 1123 (142) datë 23.05.2012 KPGJL, megjithëse i pandehuri akuzohej për kryerjen e një veprë të rëndë penale²⁷, shprehet se: “Në rastin konkret çmohet se pezullimi i dënimit të të gjykuarit G. C. dhe vënia e tij në provë për një farë kohe, do t’i shërbente rehabilitimit të tij dhe mospërsëritjes së këtyre veprave penale, apo të ndonjë veprë tjetër penale më të rëndë”. Në një rast tjetër²⁸ KPGJL ka mbajtur një qëndrim të kundërt me të mësipërmin, duke rënduar masën e dënimit ndaj të pandehurit me arsyetimin se: “..masa e dënimit prej 6 vitesh burgim (e dhënë nga gjykata e shkallës së parë), vlen për rehabilitimin e të gjykuarit dhe për parandalimin e masivizimit të kësaj veprë në shoqëri”.

Siç vërehet nga këto vendime e mijëra të tjera të shqyrtuara (të cilat për arsye hapësire nuk mund të citohen në këtë punim) gjykatat hezitojnë të përmendin qëllimin retributiv (ndëshkues), paaftësues dhe atë restaurues të dënimit penal. Pavarësisht arsyeve apo motiveve përse nuk përmenden qëllime të tilla të dënimit penal, mosbërja e saj e gjymton dhe e shtrembëron thelbin e

²⁶ E cila kishte ndryshuar vendimin e GRRGJ Korçë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të pandehurit L.M.

²⁷ Me këtë vendim KPGJL ka ndryshuar vendimin nr. 280, datë 22.09.2010 të GJA Vlorë ndaj të pandehurit G. C., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes”, mbetur në tentativë dhe në aplikim të nenit 59 të K. Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e pavuajtur të tij.

²⁸ Me vendimin nr. 978 (134) datë 16.05.2012 KPGJL ka ndryshuar vendimin nr.182, datë 07.04.2009 të GJA Vlorë, duke lënë në fuqi të vendimin nr.16, datë 07.02.2008 të GJRRGJ Lushnjë, e cila e ka dënuar këtë të pandehur me 6 vite burgim.

tij, sidomos në rastet e dënimeve të rënda me burgim, apo në rastet e shqyrtimit të pajtimit dhe shpërblimit të dëmit nga i pandehuri.

1.3.5 Rëndësia praktike e qëllimit të dënimit penal

Çështja e përcaktimit të qëllimit që duhet të ndjekë dënimi penal nuk ka vetëm rëndësi teorike, për t'u trajtuar nga filozofia dhe doktrina e së drejtës penale, por ka një rëndësi parësore praktike në determinimin e vetë thelbit dhe vlerës së të drejtës penale në shoqëri. Ndërkohë që në fillimet e shoqërisë njerëzore të organizuar, qëllimi hakmarrës, frikësues dhe eliminues (paaftësues për të kryer vepra të tjera) kryejnë nëpërmjet dënimeve të tilla si dënimi me vdekje, dëbimi, gjymtimi etj. (Halili, 2014: 35), në shoqëritë demokratike po i jepet gjithnjë e më tepër vlerë, nga njëra anë qëllimit edukues dhe rehabilitues të vetë kryerësit të veprës penale, dhe nga tjetra, drejtësisë restauruese (Elezi, 2008: 42).

Në demokracitë moderne kushtetuese, funksioni i së drejtës penale orientohet si ndaj mbrojtjes së të drejtave të personave që mund të cënohen nga veprat penale ashtu edhe ndaj mbrojtjes së të njëjtave të drejta të personave që akuzohen se i kanë kryer këto vepra (Toscano, 2012: 211). Shoqëria moderne duhet ta mbajë në konsideratë se nëpërmjet burgimit të autorit të dyshuar të veprës penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë”²⁹, atij i cënohet e njëjta e drejtë që i është cënuar viktimës së kësaj vepre penale, ashtu sikurse nga gjoba që i caktohet një autori, cënohen të njëjtat të drejta pasurore, sikurse të drejtat e një personi të mashtruar apo që i është vjedhur pasuria.

Megjithë dëshirën e mirë që dënimi penal të shkëputet nga natyra e tij represive dhe shtrënguese, qëllimi i tij retributiv, paaftësues dhe parandalues, mbetet prioritar akoma në ditët e sotme në të gjitha legjislacionet penale moderne (apo së paku në shumicën prej tyre). Megjithëse në shumë aspekte qëllimi ndëshkues vjen në kundërshtim jo vetëm me qëllimin edukues dhe rehabilitues, por madje edhe me atë të parandalimit të përgjithshëm, shumica e legjislacioneve botërore akoma e pranojnë bashkekzistencën e njëkohshme të tyre. Nga ana tjetër, nuancat dhe pesha që këto qëllime zënë në secilin prej legjislacioneve penale bashkëkohore, i bënë këto sisteme në mjaft raste të duken praktikisht sikur s'kanë asnjë të përbashkët me njëri tjetrin.

Kështu, në vendet të cilat i japin një prioritet më të madh funksionit ndëshkues dhe paaftësues të dënimit penal, mbizotërojnë dënimet e rënda me burgim dhe në rastet ekstreme dënimi me vdekje (Frase, 2001: 262), ndërsa në vendet që mbizotëron qëllimi rehabilitues dhe edukues jo vetëm që dënimi me vdekje, ai me burgim të përgjeshëm apo me gjymtime janë abroguar me kohë, por që shumica e të pandehurve dënohen me dënime alternative, me gjobë apo me burgim në afate jo të gjata (Salihu, 2012:78). Në grupin e vendeve të para bëjnë pjesë përveç vendeve me një nivel të ulët demokratik, edhe vende të zhvilluara, ku më e spikaturat prej tyre është SHBA, ndërsa në

²⁹ Neni 110 i K. Penal.

vendet me një sistem sanksionesh “të buta” mund të përmendim vendet nordike dhe Gjermaninë (Von Hofer, 2003; Nestler, 2004). Ndërmjet këtyre dy “tipeve” qëndrojnë shumica e vendeve të tjera demokratike të botës dhe miksimi i të dy tipareve bën të vështirë që një vend të kualifikohet se i takon njërit “tip” apo tjetrit. Ajo çfarë konstatohet nga shumica e studiuesve të së drejtës penale bashkëkohore, është se, megjithëse më hapa të ngadaltë, qëllimi i dënimit penal po përparon në drejtim të humanizimit dhe zbutjes së ashpërsisë së sanksioneve dhe fokusimit të tij nga rehabilitimi dhe riedukimi i kryerësit të veprës penale.

Në varësi të qëllimit që ndjek dënimi penal, përcaktohet edhe mënyra dhe kriteret se si bëhet individualizimi i dënimit ndaj kryerësit të veprës. Qëllimi ndëshkues ka në themel të tij parimin e proporcionalitetit të dënimit në varësi të rëndësisë së veprës së kryer dhe fajit (dhe nuk i kushton rëndësi sjelljes së autorit pas kryerjes së veprës apo nevojave të tija edukuese), qëllimi i parandalimit të përgjithshëm nga ana tjetër kërkon të trembë dhe edukojë komunitetin me frymën e ligjit dhe nuk interesohet jo vetëm për nevojat rehabilituese të të pandehurit, por as për motivet dhe situatën sociale dhe psikologjike të tij para kryerjes së veprës. Nga krahu tjetër sipas teorisë rehabilituese lloji dhe masa e “dënimit” (nëse mund të quhen të tilla, pasi një term më i drejtë do të ishte “masat trajtuese”) duhet të caktohen në bazë të nevojave përmirësuese të autorit dhe s’kanë të bëjnë me rrezikshmërinë e veprës apo me bindjen e komunitetit në respektimin e ligjit. Qëllimi restaurues ndikon jo vetëm në konsiderimin si rrethanë lehtësuese të pajtimit dhe shlyerjes së dëmit nga i pandehuri, por nga ana tjetër për një kategori veprash të lehta mund të bëhet shkak për pushimin tërësisht të ndjekjes penale.

Përcaktimi i qëllimit kryesor të dënimit penal, ndikon jo vetëm në aspektin legjislativ, sa i takon politikës së dënimit penal të një vendi, por në mos më shumë, të paktën njësoj ndikon edhe në këndvështrimin ndaj sistemit penitenciar dhe fazës së ekzekutimit të dënimeve penale. Vendet që besojnë në rehabilitimin dhe edukimin e personave me sjellje devijante, aplikojnë gjerësisht burgjet e hapura (Hysi, 2012:104) dhe ato në të cilat të dënuarit kanë mundësi të arsimohen, të marrin profesione dhe të mos humbasin kontaktet me shoqërinë. Në këto institucione punësohen mjekë, psikologë, sociologë, specialistë të fushave pedagogjike, etj. dhe fokusi i tyre është rehabilitimi dhe përmirësimi social i të dënuarit. Ndërsa në sistemin e “ashpër”, fokusi i burgut është siguria që i burgosuri të mos largohet, (Morris & Rothman, 1998), megjithëse nuk përjashtohen edhe përpjekjet e kufizuara për edukimin e tij.

1.3.6 Pësia e kontributit të dënimit penal në luftimin e kriminalitetit

Kriminaliteti është tërësia e veprimeve shoqërisht të rrezikshme që kryhen në një vend gjatë një kohe të caktuar dhe që parashikohen paraprakisht me ligj si vepra penale. Ai përbën një fenomen socio-penal të pashmangshëm, i cili ndryshon e përsëritet vazhdimisht (Gjonçaj & Gjonçaj, 2013: 167). Megjithëse dënimi penal është arma kryesore që e drejta penale ka në luftimin e

kriminalitetit, vetë e drejta penale nuk është mjeti i vetëm e aq më pak më efikasi për luftimin e tij. Gjatë historisë moderne të së drejtës penale janë zbatuar forma dhe qasje të ndryshme ndaj kriminalitetit, por asnjëra prej tyre nuk ka arritur ta çrrënjosë atë plotësisht (Latifi, 2013: 167). Megjithatë, kjo nuk përbën argument se të gjitha zgjidhjet e aplikuara kanë qenë të gabuara, apo se e drejta penale nuk ka asnjë efekt ndaj kriminalitetit, por vetëm sa rikonfirmon faktin se e drejta penale është vetëm njëri nga mjetet e shumta që shoqëria duhet të angazhojë në luftimin e tij. E drejta penale e lufton kriminalitetin *post factum*, ashtu siç një mjek përpiqet të luftojë sëmundjet tek pjesëtarët e komunitetit ku ai punon.

Dënimi penal, nuk është çelësi i “kurimit” të kriminalitetit, por është një mjet *ultima ratio* (Kambovski, 2007: 433), i cili duhet zbatuar në rastin e dështimit të gjitha përpjekjeve të bëra me mekanizma, apo mjete të tjera për parandalimin e tij. Shumë studime empirike (Walker, 1994; Nagin & Pepper, 2012; Latifi, 2013) kanë treguar në mënyrë bindëse se dënimet e ashpra nuk janë çelësi i kontrollit apo uljes së kriminalitetit. Në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, grupit të zërave kritikë ndaj së drejtës penale tradicionale dhe sistemit të sanksioneve të ashpra penale, i është shtuar edhe grupi radikal i abolicionistëve (Bianchi & Van Swaaninger, 1982) të cilët kërkojnë reformimin tërësor të saj dhe të qasjes ndaj krimit.

Implikimet praktike të qëllimeve të dënimit penal do të rimerren në kapitujt vijues në këndvështrime të ndryshme, ndërsa analizimi i efektivitetit të dënimeve të ashpra penale në vendin tonë do të analizohet gjerësisht në kapitullin e V të këtij punimi.

KAPITULLI II: SISTEMI I DËNIMEVE PENALE

2.1. Përmbajtja e sistemit të dënimeve.

E drejta penale ka në themel të saj sanksionin penal si një pasojë kryesore e gjetjes së një personi fajtor për kryerjen e një vepre penale. Sanksionet penale përfshijnë në gjirin e tyre të gjitha masat penale që ndërmerren në kuadër të së drejtës penale (Salihu, 2012: 416), duke përfshirë dënimin penal, masat penale ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, masat edukuese ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi si dhe masat penale ndaj personave juridikë³⁰. Në këtë kapitull do të trajtojmë vetëm tërësinë e sanksioneve penale formale (Newman, 1978: 7) që ligji penal parashikon se mund të caktohen ndaj personave të përgjegjshëm penalisht, e njohur ndryshe si sistemi i dënimeve penale.

Sistemi i dënimeve ka pësuar një transformim rrënjësor përgjatë kohëve, nën ndikimin e përparimeve humane dhe të drejtave të njeriut. Disa sanksione të cilat kanë qenë dikur të zakonshme, sot konsiderohen si barbare dhe çnjerëzore. Parimet e mbrojtjes të së drejtave të njeriut të cilat kanë kufizuar këto sanksione janë mishëruar nga pikëpamja formale në instrumente të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga Konventa ndërkombëtare e të drejtave civile dhe politike, KEDNJ, konventat e OKB dhe të KE për ndalimin e torturës dhe të trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, konventa e OKB për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, rekomandimet e KE për dënimet dhe masat komunitare dhe mbi rregullat evropiane të burgut³¹, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë etj.

Sanksionet penale mund të grupohen në grupe apo kategori të ndryshme dhe teoricienë të ndryshëm të shkencave penale kanë bërë klasifikime të ndryshme, por një nga klasifikimet më të fundit i bërë nga autorët amerikanë Miethe dhe Lu (2005: 53) i ndan sanksionet penale në tre grupe të mëdha: 1) sanksionet ekonomike të cilat përfshijnë pasojat ekonomike dhe financiare për të pandehurin, 2) sanksionet paaftësuese (incapacitative) të cilat kufizojnë fizikisht mundësinë e përsëritjes së sjelljeve devijante dhe 3) dënimet trupore, të cilat përfshijnë vdekjen dhe vuajtjet fizike të shkaktuar nga ushtrimi direkt i forcës fizike mbi trupin njerëzor. Ky lloj klasifikimi është bërë duke marrë në konsideratë pasojën e parë dhe më të rëndësishme që i shkaktohet të pandehurit.

2.1.1. Sanksionet ekonomike

Sanksionet ekonomike janë masa penale të cilat janë aplikuar gjerësisht për qëllime shpaguese, parandaluese dhe restorative. Në një masë më vogël në disa raste ato mund të përdoren edhe për qëllime paaftësuese siç mund të jetë p.sh. heqja e licencës së ushtrimit të një profesioni apo

³⁰ Masa të parashikuara në nenet 45 dhe 46 të K. Penal të Republikës së Shqipërisë.

³¹ Rekomandimi nr. R (92) 16 i Komitetit të ministrave të KE, mbi rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, i miratuar me 19.10.1992 dhe Rekomandimi nr. R (2006) 2 mbi rregullat evropiane të burgimit, i miratuar me 11.01.2006.

veprimtarie, apo dhe konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës, apo i të ardhurave rrjedhura nga aktiviteti kriminal. Vendosija e një gjobe të rëndë ndaj një personi që kryen një aktivitet fitimprurës dhe gjatë të cilit ai kryen një krim, ka padyshim një efekt shpagues. Po ashtu parashikimi i një gjobe të rëndë për nivelin e të ardhurave të një individi, ka edhe një efekt të pritshëm parandalues. Nga ana tjetër dënime të tilla si detyrimi i shlyerjes së dëmit ndaj të dëmtuarit kanë një efekt restorativ.

Disa nga dënimet më të përhapura me natyrë ekonomike janë: gjobat penale, konfiskimet e pasurive, heqja e përfitimeve ekonomike, heqja e licencave apo autorizimeve, vendosja e detyrimeve të ndryshme me natyrë civile në vendimin penal³² etj.

2.1.1.1. Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë është një nga sanksionet kryesore ekonomike (Miethe & Lu, 2005: 53) të cilat shteti i përdor për luftimin e fenomeneve të paligjshme. Megjithëse paraqitja e tij në format më të para daton që në antikitet (Halili, 2014: 93), vlera dhe përhapja e tij në shoqëritë moderne ka marrë një përhapje dhe aplikim shumë më të gjerë. Pavarësisht se dënimi me gjobë njihet nga të gjitha familjet e sistemeve ligjore, shkalla dhe natyra e aplikimit të tij varion nga sistemi në sistem (Miethe & Lu, 2005: 53). Kështu megjithëse dënimi me gjobë për vepra jo shumë të rënda është një praktikë e zakonshme e vendeve të zhvilluara perëndimore (Morris & Tonry, 1991: 32) në vendet e së drejtës islamike pagesa e një dënimi me gjobë ndaj familjarëve të viktimës mund të bëjë që gjykata të revokojë dënimin me vdekje të autorit të vrasjes (Miethe & Lu, 2005: 55). Edhe brenda vetë vendeve të zhvilluara ka dallime të dukshme në lidhje me shkallën e aplikimit të dënitimit me gjobë. Gjobat ditore (të njohura në anglisht si *day fines*)³³ janë një praktikë e përhapur gjerësisht në të drejtën penale të shumicës së vendeve të Evropës Perëndimore, si atë Gjermane, Austriake, Franceze, Suedeze, Daneze, Finlandeze (Kantorowicz, 2015: 26) etj. Gjithsesi nga ana tjetër aplikimi i saj i gjerë ka ndeshur në vështirësi në disa vende të tjera të zhvilluara si Anglia, Australia apo Hungaria (Miethe & Lu, 2005: 55). Dominimi i aplikimit të dënitimit me gjobë ka rënë jo vetëm për shkak të problemeve të manifestuara gjatë aplikimit të tij në praktikë, por edhe si rezultat i shtimit të alternativave të tjera të dënitimit me burgim (Albrecht, 2012: 33). Nëse para viteve '70 të shekullit të kaluar burgimi ka qenë alternativa e vetme e dënitimit me gjobë, aktualisht gjykata ka një hapësirë më të gjerë zgjedhjeje në përshtatje me rrethanat konkrete të kryerjes së veprës dhe të vetë autorit.

³² Siç parashikohet në pikat 2 dhe 3 të nenit 60 të kodit tonë penal, përkatësisht detyrimi i të dënuarit për „Shfrytëzimin e pagës dhe të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare“ dhe detyrimi „Të riparojë dëmin civil të shkaktuar“.

³³ Gjobat ditore janë sistemi i caktimit të gjobës penale i cili ndahet në dy faza. Në fazën e parë caktohet numri i njësive të gjobave që meriton të caktohen ndaj të pandehurit për veprën e kryer, ndërsa në fazën e dytë përcaktohet vlera konkrete e një njësie gjobe, nisur nga niveli i të ardhurave të të pandehurit.

Dënimi me gjobë përdoret gjerësisht dhe ka një justifikim të arsyeshëm antropologjik dhe kulturor për vepra me një rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore. Vjedhjet me vlerë jo të madhe dhe konfliktet ndërpersonale mund të kompensohen përmes pagesës së një vlere më të madhe se vlera e veprës penale. Gjobat zbatohen gjerësisht për shkeljet në trafik në shumicën e vendeve dhe po ashtu në veprat penale të kryera nga kompanitë, apo punësimi i të miturve etj. (p.sh. në vendet në zhvillim si India, apo Egjipti).

2.1.1.2. Konfiskimet e pasurisë

Konfiskimi i pasurisë ka në thelb të tij aftësinë e qeverisë për t'u hequr keqbërësve nga zotërimi pasurinë e vënë gjatë aktivitetit kriminal dhe kalimin e saj në pronësi të shtetit. Nëpërmjet konfiskimit prishet infrastruktura e aktivitetit kriminal duke eliminuar apo ulur aftësinë e të pandehurit për të drejtuar aktivitetet e paligjshme. Konfiskimi i pasurive mund të prekë mjetet, pajisjet, të hollat kesh apo në llogari bankare, përfitimet e një aktiviteti dhe në raste të caktuara edhe vetë produktin apo aktivitetin tregtar të një kriminelit apo organizate kriminale, duke u pamundësuar atyre vijimin e operimit kriminal. Konfiskimi i pasurive ka të bëjë kryesisht me aktivitete të tilla kriminale, si: trafiku i narkotikëve, i armëve, i qenieve njerëzore apo krimeve në fushën e ekonomisë, mirëpo në SHBA programi i FBI-së mbi krimin e jakave të bardha është kontribuesi kryesor i programit të konfiskimit të kësaj agjencie (FBI, 2015).

Konfiskimi penal ndryshon nga ai civil, pasi i pari konsiderohet si një veprim *in personam*, d.m.th. që veprimi i konfiskimit drejtohet ndaj personit, ndërsa konfiskimi civil konsiderohet si një veprim *in rem*, d.m.th. që drejtohet vetëm ndaj pasurisë së tij. Dy veprimet dallojnë në disa aspekte duke përfshirë: (1) pikën në procedim, në të cilën pasuria mund të sekuestrohet; (2) barrën e provës për të sekuestruar një pasuri; dhe (3) në disa raste, lloji i pasurisë që intereson për t'u konfiskuar.

Konfiskimi i pasurisë nuk shtrihet vetëm në pasurinë e përfutur drejtpërdrejtë nga aktiviteti kriminal, por edhe ato të rrjedhura në mënyrë indirekte nga shfrytëzimi i aseteve kriminale. Pasuria mund të konfiskohet edhe tek palë të treta tek të cilat është transferuar pa shpërbllim, me qëllim fshehjen apo tjetërsimin e saj, me kusht që personi i tretë të ketë qenë në dijeni se ajo pasuri rrjedh nga një aktivitet kriminal. Nisur nga rëndësia që ka konfiskimi i pasurisë kriminale në luftën ndaj krimit, ajo ka gjetur mishërim në shumë konventa ndërkombëtare, si: Konventa e KE e Strasburgut “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” (CETS No. 141, datë 08.11.1990); Konventa e KE e Varshavës, datë 16.05.2005 “Për parandalimin e terrorizmit” (CETS No. 196); Konventa e KE e Varshavës, datë 16.05.2005 “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” (CETS No. 197); Konventa ndërkombëtare e OKB “Për luftën kundër financimit të terrorizmit”, datë 09.12.1999; Konventa e OKB “Kundër korrupsionit”, datë 31.10.2003; Konventa e OKB e Palermos “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, datë

12.12.2000 dhe dy protokolle shtesë të saj; Konventa e OKB “Kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope” datë 19.12.1988³⁴etj.

2.1.2. Sanksionet paaftësuese

Në këtë kategori të sanksioneve penale përfshihen të gjitha ato masa të cilat u heqin apo kufizojnë individëve mundësinë fizike të kryerjes së sjelljeve të caktuara antiligjore. Këto lloj sanksionesh janë aplikuar në të gjitha etapat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe në çdo rajon gjeografik apo kulturor të globit. Megjithëse efekti i parë i kësaj kategorie sanksionesh është parandalimi nëpërmjet kufizimit të mundësive për të kryer një sjellje të caktuar, në rrethana të caktuara ato mund të ndjekin fare mirë edhe funksione të tjera të dënimit penal si ndëshkimi, parandalimi, apo edukimi. Dënimet me natyrë paaftësuese janë vënë në jetë përgjatë historisë me anë të mjeteve, teknikave apo strukturave të shumta, ndër të cilat përmenden dëbimi apo ekzili, përdorimi i zinxhirëve, lidhja në shtyllë, heqja apo kufizimi i lirisë në forma dhe intensitete të ndryshme, si: burgimi, kampet e punës, mbikëqyrja elektronike etj. Lidhja me zinxhirë, vendosja e qaforeve apo mjeteve të ndryshme kufizuese të gjymtyrëve, janë dënime të cilat për shkak të vuajtjeve fizike dhe poshtërimit të dinjitetit njerëzor nuk mund të aplikohen më në shoqëritë e përparuara, ndërsa dënimet e tjera pamundësuese në një formë apo tjetër aplikohen përsëri në të gjitha sistemet e së drejtës.

2.1.2.1. Dënimi me burgim

Dënimi me burgim është një nga sanksionet më të hershme që shoqëria njerëzore ka vendosur ndaj personave me sjellje antishoqërore (Welch, 2003; Gjonçaj & Gjonçaj, 2009: 68). Testamenti i vjetër i Biblës informon për përdorimin e burgimit që në antikitet në Egjipt, në Asiri dhe në Babiloni (Morris, & Rothman, 1998). Megjithë lashtësinë e aplikimit të burgimit, duhet thënë se deri në fund të mesjetës shumica e dënimeve ishin trupore dhe me vdekje. Aplikimi i burgimit si një lloj dënimi kryesor ka filluar me lindjen e ideve humaniste të Shekullit XIIX, me qëllim zëvendësimin e dënimeve të ashpra trupore më një dënim më njerëzor.

Prej më se dy shekujsh, burgimi ka qenë dënimi kryesor në shumicën e shoqërive perëndimore, mirëpo në dhjetëvjeçarët e fundit ka një debat të gjerë filozofik, penalogjik dhe politik rreth shkallës së aplikimit dhe arsyetueshmërisë së tij. Sipas Crewe, dënimi me burgim është sot një simbol i fuqishëm i aftësisë shtetërore për të ndëshkuar dhe njëkohësisht i dështimit të tij për të integruar të gjithë qytetarët në sistemin e tij të normave (2007: 123). Dallimet në aspektin filozofik rreth vlerësimeve mbi burgimin bën që akoma të mos ketë një marrëveshje universale mbi qëllimin e aplikimit të tij në shoqërinë moderne (Coyle, 2005). Megjithëse më lart e kualifikuam burgimin

³⁴ Konventa këto të ratifikuara, apo në të cilat vendi ynë ka aderuar me ligj të Kuvendit.

si një nga llojet e dënimeve paaftësuese, ai përdoret dhe justifikohet edhe për arritjen e qëllimit ndëshkues, parandalues dhe rehabilitues.

Burgimi realizon qëllimin ndëshkues, pasi ai i shkakton të dënuarit dhimbje për shkak se e izolon nga ambienti i tij social. Mirëpo së paku në letër, burgjet moderne nuk duhet t'i shkaktojnë të dënuarit vuajtje fizike për shkak të keqtrajtimeve, mungesës së ushqimit, apo mungesës së kushteve të tjera minimale të jetesës. Burgimi duhet të përdoret si një ndëshkim i fajtorit vetëm për kryerjen e veprave të rënda penale, për të cilat dënimi me gjobë, apo puna në komunitet janë të papërshtatshme me rëndësinë e veprës, apo rrezikshmërinë e autorit. Burgimi mendohet se ka një efekt parandalues të posaçëm tek i dënuari, i cili supozohet se për shkak të frikës së ripërjetimit të këtij dënimi që po vuan, nuk do të përsërisë në të ardhmen sjellje të paligjshme dhe efekt parandalues të përgjithshëm, duke stepur personat e lëkundur për të kryer vepra të ngjashme penale.

Ideali rehabilitues i burgimit i shfaqur në shekullin e kaluar filloi nga ndryshimi i terminologjisë së institucioneve të heqjes së lirisë, nga “burgje” në “institucione korrektuese” (Rotman, 1995). Mirëpo, megjithë përpjekjet për ta përdorur burgimin si një institucion që shërben për edukimin dhe rehabilitimin e kryerësve të veprave penale, suksesi i arritjes së tyre është vënë në pikëpyetje nga të dhënat empirike. Në shumë vende, rehabilitimi përshkruhet shpesh si një ndërmarrje e dështuar, ose më së paku si një objektiv i kaluar në dorë të dytë (Logan & Gaes, 1993: 252) dhe terminologjia e përshkrimit të institucioneve të heqjes së lirisë në këto vende ka evoluar përsëri, duke i quajtur ironikisht si “depo” apo “magazina” të burgosurish (Miethe & Lu, 2005: 32).

2.1.2.1.1. Relativizmi i dënimit me burgim (Llojet e burgjeve)

Evoluimi i natyrës së burgjeve ka qenë aq i madh sa që vetë fjala “burg” është e paaftë të përshkruajë përmbajtjen e tij të vërtetë në të gjithë larmitë dhe format e aplikimit të tij. Burgimi ka udhëtuar së bashku me vetë shtetin dhe funksionin e tij në shoqëri. Fillimisht si burgje janë përdorur puse të thella apo bodrumet e kalave, ku mbijetesa për një kohë të gjatë ka qenë shumë e vështirë (Jonson, 1974: 33) dhe ku keqbërësit mbaheshin aty përkohësisht deri në marrjen e dënimit përfundimtar (Gjonçaj & Gjonçaj, 2009: 69). Në burgje të tilla me karakter preventiv mbylleshin prostitutat, endacakët, apo lypësit si një lloj mase sigurimi me qëllim preventiv. Shprehja e Ulpianus (Ulpianit) “Burgjet duhet të përdoren vetëm për mbajtjen e keqbërësve dhe jo për ndëshkimin e tyre” ka gjetur zbatim deri në fundshekullin XVIII, me parashikimin e dënimit me burgim në K. Penal francez të vitit 1792 (Stefani, Lavasseur & Jambu-Merlin, 1982: 301) dhe më vonë në K. Penal të Napolonit të vitit 1810.

Pas ideve humaniste të shekullit XVIII, në fazën e parë burgimi është paraqitur si dënim në shumë vende të Evropës në disa forma si: internimi, burgimi i thjeshtë, burgimi me punë të rëndë, burgimi policor, burgimi i rëndë, burgimi i përjetshëm (Halili, 2014: 101) etj. Faza e dytë e këtij dënimi

fillon me përpjekjet për transformimin e qëllimit të dënimit me burgim dhe të vetë burgut si një institucion korrektimi dhe vazhdon edhe në ditët e sotme. Idetë dhe teoritë e ndryshme filozofike dhe sociologjike mbi dënimin me burgim janë materializuar në një larmi sistemesh dhe metodash të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe në nxitjen e alternativave të tjera të tij. Megjithëse në shumicën e vendeve të zhvilluara vazhdon të parashikohet dënimi me burgim të përtjetshëm (si lloji i dënimit më të rëndë) për persona të rrezikshëm të cilët kanë kryer vepra shumë të rënda, kushtet dhe standardet e vuajtjes së këtij dënimi janë shumë herë më humane se ato të një burgu të zakonshëm të para disa dekadave. Nga ana tjetër, implementimi i formave të reja, si: burgu i hapur, burgu i fragmentuar (duke u paraqitur vetëm 2- ditë në javë, apo vetëm natën), qendrat e trajtimit të të alkoolizuarve, apo toksikomanëve, apo deri tek burgu në shtëpi, kanë tjetërsuar dhe shkëputur tërësisht burgimin nga koncepti i vjetër origjinal i izolimit, duke e orientuar më shumë drejt kurimit dhe përmirësimit të të dënuarit si dhe ruajtjes së lidhjeve sociale të tij me komunitetin ku jeton. Kjo qasje e re e largon burgun nga detyra e thjeshtë e izolimit të keqbërësit dhe e përball atë me detyrën e vështirë të çrrënjësjes së faktorëve të vërtetë kriminogjen që e kanë shtyrë individin në thyerje të ligjit.

Liberalizimi dhe diversifikimi i burgimit në mjaft vende është mbështetur në studimet empirike dhe ato krahasuese të cilat kanë provuar se burgimi i zakonshëm klasik bën pak ose aspak për përmirësimin e personave të dënuar. Vendet si SHBA dhe pjesërisht Britania e Madhe, të cilat kanë ndjekur një politikë dukshëm më të ashpër penale se vendet e tjera të zhvilluara perëndimore, nuk kanë pasur sukses në uljen e nivelit të kriminalitetit. Nga ana tjetër studimet e zhvilluara mbi eksperiencën gjermane kanë provuar se personat e dënuar me gjobë kanë një shkallë rikriminalizimi (përsëritje të një veprë tjetër penale pas dënimit të dhënë) prej 28%, ato të dënuar me burg me kusht 41% dhe ata me burg 52% (Jehle et al, 2010). Këto studime dhe eksperiencat e vendeve nordike, mbështesin qëndrimin se burgimi është një mënyrë e kushtueshme për të bërë keqbërësit njerëz akoma më të këqinj (Söring, 2004: 54). Thënie të tilla vlejné akoma më shumë, për ndikimin e burgut ndaj të miturve, apo personave të cilët janë përfshirë për herë të parë apo në rrethana rastësore në një aktivitet kriminal.

2.1.2.1.2. Kriza e dënimit me burgim. Mbipopullimi i burgjeve.

Dënimi me burgim ka ndeshur në disa vështirësi të mëdha teorike dhe praktike në dekadat e fundit. Çështja e ashpërsisë së dënimeve penale dhe posaçërisht e dënimit me burgim si manifestim i një nga formave më të ashpra të ndërhyrjes së shtetit në liritë qytetare, është bërë objekt kritikash të shumë studiuesve të fushës. Grupimi i kritikëve të sistemit penal aktual (me fokus të kritikës së tyre atë Amerikan dhe Britanik), e quajtur si lëvizja abolicioniste, argumenton se e drejta penale ka dështuar në mbajtjen e premtimeve të saja për uljen e kriminalitetit. Sipas këtyre qëndrimeve, krimi dhe kriminaliteti është rezultat i kundërshtive sociale në një shoqëri dhe për pasojë burgimi

nuk ka se si të jetë zgjidhja e këtij problemi (Kambovski, 2007: 474). Sipas autorëve kritikë të burgimit, vetë shteti është një organizatë monopol, menaxherët e së cilës synojnë të mbajnë gjallë shtirjen se ata po bëjnë çmos të mbrojnë shoqërinë nga një e keqe e madhe siç është kriminaliteti (Bianchi, 1994: 337). Duke qenë se shteti ka dështuar në mbajtjen e premtimeve për çrrënjosjen e krimit, atëherë menaxherët e tij janë në kërkim të vazhdueshëm të mbështetjes publike, për ta mbajtur gjallë frikën nga stereotipi i "armikut të shoqërisë" dhe shpresën se sistemi penal është zgjidhja e vetme. Shteti i konsideron me ligj të pandehurit si armiq dhe kështu vetë shoqëria harron se ata janë pjesë e saj, ashtu si heretikët në kohën e inkuizicionit.

Kritika të tjera të burgimit drejtohen edhe nga studiues të cilët e shohin atë si një mjet apo armë të shtetit për të shtypur të varfrit dhe të marxhinalizuarit. Shumë autorë kanë nënvizuar se në pjesën më të madhe popullata e të burgosurve përbëhet nga shtresat më të pambrojtura dhe më fatkeqe të shoqërisë, si: të papunët, të paarsimuarit, të pastrehët, të sëmurët mendorë, të alkoolizuarit apo toksikopendentët³⁵, jetimët, emigrantët, apo minoritetet racore. Nga ky këndvështrim burgu përpiket të zëvendësojë mungesën e një sistemi mirëqenieje dhe përkujdesjeje shoqërore dhe shëndetësore e cila neglizhon shtresat më nevojtare të shoqërisë (Taylor, 2011). Nëpërmjet penalizimit dhe burgosjes në masë të këtyre shtresave të qytetarëve, shteti fsheh problemet e vërteta sociale që qëndrojnë në rrënjët e tij, duke përdorur burgun si një kosh gjyqësor, ku hidhen mbeturinat e tregut shoqëror (Wacquant, 2009: 9). Marxhinalizimi dhe padrejtësia e sistemit penal ndaj të varfërve thellohet po të mbahet në konsideratë se këto shtresa janë në të shumtën e rasteve të privuara nga mundësia e një mbrojtjeje efektive, pagesa e lirimit me garanci pasurore, apo konvertimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë.

Një problem i tretë dhe shumë i mprehtë, i cili shkon ngjitur me dy të parët është dhe mbipopullimi i burgjeve. Për shkak të përhapjes së gjerë të kulturës së burgimit, mbipopullimi i burgjeve është kthyer në një problem global. Nga 194 vende për të cilat janë mbledhur të dhëna nga 'World Prison Brief' i Qendrës ndërkombëtare për studime të burgimit (International Centre for Prison Studies), 118 prej tyre kanë një tejkalim të kapaciteteve mbajtëse të të burgosurve, 15 prej të cilave kanë një mbipopullim mbi 200 % dhe 33 të tjerë një shkallë mes 150 dhe 200 %. (prisonstudies.org: 2011). Çështja e mbipopullimit të burgjeve mund të shihet nga dy këndvështrime të ndryshme. Aspekti i parë i mbipopullimit të burgjeve ka të bëjë me të drejtat e të burgosurve të cilët vuajnë dënimin në to, ku për këtë shkak nuk arrin të plotësojë nevojat bazike humane për qëndrim, pushim, ushqim

³⁵ Kështu p.sh. ka rezultuar se në Britani në vitin 2012, 47% e të dënuarve nuk kishin asnjë kualifikim profesional, 41% e meshkujve dhe 30% e femrave dhe 52% e të miturve kanë qenë më parë të përjashtuar nga shkolla, në 47% të rasteve veprat penale janë kryer nën efektin e alkoolit dhe 64% e tyre kanë deklaruar se kishin konsumuar drogë në periudhën 4 javore para arrestimit të tyre. Po kështu, ka rezultuar se 15% e tyre kishin qenë të pastrehë, 13% e tyre nuk kishin punuar kurrë, 32% e tyre kishin qenë të papunë në kohën e arrestimit dhe 48% e tyre kishin kaluar një histori borxhesh (prisonreformtrust, 2014: 7).

apo higjenë. Aspekti i dytë ka të bëjë me anën sociale, ekonomike dhe kriminologjike të problemit, apo me çështjen e zgjidhjeve të alternativave për nivelin e kriminalizimit të shoqërisë së një vendi, e thënë thjeshtë me politikën penale të atij vendi. Parë nga këto dy aspekte, megjithëse përgjithësisht mbipopullimi i burgjeve është drejtpërdrejtë i shoqëruar me një politikë agresive penale dhe më së shumti ndeshet në vendet me një shkallë të lartë të burgosurish (e shprehur në të burgosur për 100.000 banorë) dhe që zbaton një sistem të ashpër dënimesh (UNODC, 2013b), nuk mund të themi se çdo vend me këto kushte mund të vuajë me patjetër nga mbipopullimi i burgjeve (pasi, megjithë shkallën e lartë të të burgosurve mund të investojë shuma të mëdha në rritjen e kapacitete akomoduese).

Burgimi në kohët e sotme ka nxjerrë në pah edhe dy probleme të cilët duke tërhequr secili në kahje të kundërt kanë vënë akoma edhe më shumë në pikëpyetje dobinë e tij si një mjet për luftimin e kriminalitetit. Kështu, nga njëra anë shkalla e lartë e burgosjes së qytetarëve ka kosto të larta humanitare, sociale dhe ekonomike për vendin. Mirëpo, megjithëse kostot vjetore të mbajtjes së një të burgosuri janë shumë të larta³⁶ dhe tejkalojnë shpenzimet për arsimin, ndihmën ekonomike, madje dhe pagën mesatare të një qytetari, përsëri institucionet ndërkombëtare dhe organizatat humanitare bëjnë thirrje të vazhdueshme për përmirësimin e mëtejshëm të regjimit të trajtimit të të burgosurve³⁷.

Nga ana tjetër përmirësimi i kushteve të jetesës në burgje ka bërë që efekti ndëshkues dhe frikësues i burgut të ulët në atë masë sa për shumë shtresa sociale, si: të pastrehët, të papunët, personat e alkoolizuar, të droguar apo me probleme mendore si dhe ata me sjellje habituale kriminale, ai të mos përbëjë një dhimbje të madhe dhe për rrjedhojë as një faktor që ndikon në frenimin për të kryer vepra penale. Duke qenë se argumentet për një trajtim më të ulët të të burgosurve vështirë të gjejnë përkrahje, kjo ka bërë më imediate nevojën për të shqyrtuar seriozisht alternativa të tjera sociale të burgimit, të cilat ulin kostot dhe rrisin shkallën e kontrollit të kriminalitetit.

2.1.2.2. Dënime të tjera paaftësuese

Dënimet të cilat paaftësojnë apo pamundësojnë fizikisht të pandehurin në kryerjen e veprave të tjera penale janë të shumta, por shkurtimisht do të përmendim ato më të përhapurat. Një ndër dënimet më të hershme me natyrë paaftësuese është dëbimi apo ekzili (Kokona, 2004: 39), i cili në format më moderne mund të marrë terminologji të ndryshme. Në formën e saj aktuale dëbimi ka të bëjë me të drejtën e shtetit që të nxjerrë jashtë territorit të tij persona që nuk mbajnë shtetësinë

³⁶ Sipas statistikave të KE (2013: 148) mesatarja evropiane e shpenzimeve për një të burgosur në ditë është 112 euro, ndërkohë që sipas këtyre të dhënave në Shqipëri është rreth 15.25 euro në ditë. Këtë shifër të përafërt (439 euro në muaj) ka deklaruar edhe ambasadori i OSBE në vendin tonë Raunig (2014). Duhet mbajtur në konsideratë se këto kosto mbulojnë vetëm shpenzimet direkte shtetërore për mbajtjen e një të burgosuri, por nuk përfshijnë shumë kosto anësore të cilat mund t'i tejkalojnë këto të parat disafish.

³⁷ E konvertuar kjo në rritje të mëtejshme të shpenzimeve për stafe më të mëdha, ambjente më të bollshme dhe kushte më të mira jetese.

e tij, të cilët kanë kryer një vepër penale dhe për të cilët vlerësohet se nuk duhet të qëndrojnë më në territorin e tij (Henckaerts, 1995: 4).

Të gjitha vendet ruajnë të drejtën për të deportuar të huajt të cilët kanë kryer në vendin e tyre krime të rënda, kanë hyrë ilegalisht në territorin e tyre, kanë thyer kushtet e lejes së qëndrimit apo vizës, apo kanë humbur të drejtën e qëndrimit në atë vend. Deportimi apo nxjerrja jashtë territorit të shtetit mund të bëhet përmes procedurave thjesht administrative, apo përmes një procedure penale gjyqësore (Forsythe & Lawson, 1996: 53). Procedura administrative është më e lehtë dhe më e zakonshme pasi kalon nëpër një proces më të thjeshtëzuar legal, duke kursyer kohë dhe shpenzime, ndërsa ajo penale gjyqësore aplikohet në rastet kur personi gjykohet për kryerjen e një veprë penale.

Deportimi i një shtetasi të huaj është një praktikë e zakonshme e të gjitha vendeve të zhvilluara, pasi nëpërmjet tij shteti pritës lirohet nga rreziku potencial i një shtetasi të huaj, tek i cili ka humbur besimin se mund të jetë një rezident i cili i zbaton ligjet e atij vendi. Nisur nga kostot e larta të mbajtjes në institucione korrektuese dhe efekti i sigurtë paaftësues që ofron deportimi, në vend të dënimit me burgim, ndaj shkelësve të lehtë të ligjit, gjykatat (apo administrativisht vetë policia apo struktura të tjera shtetërore) zgjedhin nxjerrjen jashtë territorit dhe riatdhesimin e tyre. Në vitin 2006 në Britaninë e madhe u detyrua të dorëhiqej Ministri i brendshëm (Home secretary) Clarke, pas zbulimit të një skandali se në vitet 1999- 2006 mbi një mijë të dënuar nga gjykatat britanike nuk ishin deportuar jashtë vendi, megjithë rekomandimin gjyqësor për ta bërë pas vuajtjes së dënimit të dhënë. Ky skandal u kthye në lajm kryesor kur vetë ministri Clarke pranoi se 5 nga të dënuarit për krime të rënda nga gjykatat kishin kryer krime të tjera të rënda pas daljes nga burgu (Freiberg & Gelb, 2013: 231).

Një lloj tjetër dënimi paaftësues janë kufizimet e lëvizjes në formën e ndalimit për të shkuar diku, për të mos lëvizur prej diku, apo për të mos u takuar me persona të caktuar. Këto lloj dënimesh synojnë të shkëpusin të dënuarin nga një ambient apo persona të cilët kanë promovuar apo kontribuar tek ai në kryerjen e veprës penale. Larmia e disponimeve të kësaj natyre është e madhe (Nappi, 2010: 171) dhe mund të variojë nga rasti në rast në varësi të rrethanave konkrete të kryerjes së veprës. Dënime të tilla mund të vendosen për të kufizuar daljen nga banesa në orare të caktuara, vajtjen në një vend ku ka bashkëpunëtorë, apo rrethana të tjera që shtojnë mundësitë e kryerjes së veprave të tjera penale.

Me zhvillimet teknologjike, në shërbim të kësaj kategorie dënimesh janë vënë edhe pajisje elektronike apo teknika të cilat monitorojnë më mirë ekzekutimin e rregullt dhe në kohë reale të këtyre lloj dënimesh (Bottomley et al, 2004: 79). Pajisjet elektronike të monitorimit janë një teknologji e miratuar nga gjykata mbi bazën e një programi të vendosur për të mbikëqyrur një të dënuar me lëvizje të kufizuar, të cilat përfshijnë pajisje të monitorimit të banesës, byzylykë dore,

byzylykë këmbë (kërciri), monitorues fushe, pajisje të testimit të nivelit të alkoolit, apo të verifikimit të zërit etj. (NLECTC, 1999).

Pajisjet e monitorimit janë shfaqur së pari në Meksikë në vitin 1984 dhe menjëherë më pas edhe SHBA e miratuan këtë teknologji (Whitfield, 1997). Anglia e ka adaptuar në sistemin e drejtësisë penale 15 vjet më vonë monitorimin elektronik, vetëm pas kryerjes së disa provave të përsëritura në të gjithë vendin. Me gjithë hezitimin fillestar për përdorimin e kësaj teknologjie, pas pak vitesh ajo u përqaftua gjerësisht aq sa nga 9000 byzylykë që ishin vënë në vitin 1999, në vitin 2004 shkoi në 53,000 (National Audit Office, 2006). Rritja e aplikimit të monitorimit elektronik si në Britani ashtu dhe në Kanada është nxitur nga nevoja për të trajtuar çështjet e mbipopullimit të burgjeve në një mënyrë ekonomike (Payne & Gainey, 2004: 497). Sipas National Audit Office report (2006: 13), një ditë në burg kushton rreth £72.2, ndërsa një ditë në burgim shtëpie nën monitorim elektronik vetëm £14.4 (pra vetëm 1/5).

Megjithë avantazhet e pamohueshme, pajisjeve të monitorimit elektronik i është bërë një kritikë pasi në vend që ato të ulin mbipopullimin në burgje, vetëm sa mund të zgjerojnë rrethin e personave që do të kriminalizohen për vepra më të lehta, të cilat më parë nuk janë trajtuar penalisht (Payne and Gainey, 2004: 414).

Një tjetër lloj dënimi paaftësues janë heqjet e licencave, lejeve apo të drejtës për të ushtruar detyra apo funksione publike. Zakonisht dënimi i ndalimit apo pezullimit të ushtrimit të një aktiviteti apo profesioni jepet në rastet kur i pandehuri e ka kryer veprën penale në lidhje me atë aktivitet. Është e kuptueshme se në këto raste autorit të kësaj veprë i hiqet mundësia fizike që ta kryejë përsëri një vepër të tillë gjatë periudhës që atij i është hequr leja apo licenca. Kështu p.sh. heqja e licencës së dentistit apo mjekut është një dënim i përshtatshëm për rastet kur mbajtësi i kësaj licence abuzon me dashje apo me pakujdesi të rëndë me profesionin e tij. Po ashtu është e zakonshme në shumicën e legjislacioneve penale që personave të cilët abuzojnë me detyrën apo funksionin publik t'u ndalohet për një periudhë kohe e drejta që të ushtrojnë detyra apo të përfshihen në shërbim publik (Auby, Breen, & Perroud, 2014: 170). Këto lloj dënimesh në sistemin kontinental të së drejtës parashikohen përgjithësisht si dënime plotësuese të cilat mund të caktohen nga gjykata krahas dënimit kryesor (Newman, 2010: 119). Për shkak të efektit paaftësues për kategorinë e veprave penale që kanë lidhje me profesionin apo aktivitetin e të pandehurit, këto lloj dënimesh kontribuojnë në uljen e nevojës për dënime të tjera paaftësuese si burgimi, sidomos në rastet kur niveli i rrezikshmërisë së autorit dhe e veprës nuk janë shumë të larta.

2.1.3. Sanksionet trupore

Sanksionet trupore janë masa të cilat shkaktojnë dhimbje fizike mbi trupin e të dënuarit. Këto lloj dënimesh kanë si synim të parë të tyre shkaktimin e dhimbjeve dhe vuajtjeve të forta fizike. Këto lloj dënimesh janë përdorur përgjatë historisë së dënimit penal për të arritur qëllime të ndryshme

si hakmarrjen, parandalimin e posaçëm, parandalimin e përgjithshëm, edukimin e të pandehurit, apo deri tek marrja e pohimit, apo deklarimeve të caktuara prej tij. Mjetet dhe mënyrat e zbatimit të dënimeve trupore kanë qenë të shumta dhe janë kufizuar vetëm nga fantazia e ekzekutorëve dhe niveli i pranueshmërisë së humanizmit të kohës (Miethe & Lu, 2005: 34). Dënimet trupore janë aplikuar gjatë gjithë historisë njerëzore, por frekuenca e zbatimit të tyre ka qenë më e madhe në periudha mizorish të rrjedhura nga inkuizicioni, diktaturat, revolucionet, luftërat apo pushtimet koloniale (Scott, 2010). Dënimet më të përhapura trupore janë, rrahjet apo fshikullimet me kamxhik, lidhjet në shtylla, lidhjet me kokë poshtë, tërheqjet e ndryshme të gjymtyrëve, hedhja e ujit në gojë, goditjet me shkop, prerjet e gjymtyrëve, shëmtimet, shoku elektrik dhe deri tek dënimi me vdekje.

2.1.3.1. Dënimi me vdekje

Dënimi me vdekje i quajtur ndryshe dhe dënimi kapital (Kronenwetter, 2001: 202)³⁸, përbën dënimin më ekstrem trupor që shoqëria e organizuar ndërmerr ndaj një pjesëtari të saj. Dënimi me vdekje është një nga format më të vjetra të ndëshkimit të personave fajtorë për kryerjen e veprave penale, i dokumentuar që nga kodi i Hamurabit në Babiloni (Anastasi, 2006: 29) në vitin 1754 para Krishtit, ku parashikohej si dënim për 25 krime, apo në kodin Drakonian të Athinës (Schabas, 2002: 35), ku ky dënim parashikohej si dënimi i vetëm. Ky dënim ka vazhduar të ekzistojë në të gjitha etapat e zhvillimit të shoqërisë deri në ditët e sotme. Format e ekzekutimit të tij kanë qenë nga më barbarët, si: vrasja me gurë, kryqëzimi, gijotina, prerja e kokës me shpatë, djegia në turrën e druve, varja, e deri në format "moderne" të ekzekutimit të këtij dënimi, si: pushkatimi, dhomat e gazit, karrigia elektrike, apo injeksionet vdekjeprurëse (Grossman, 1998).

Fushata botërore kundër këtij dënimi ka bërë që nga viti në vit numri i ekzekutimeve me vdekje dhe mbështetja publike ndaj këtij dënimi të bjerë. Me 18 dhjetor të vitit të kaluar Asambleja e Kombeve të Bashkuara miratoi me 117 vota pro një rezolutë, e cila u bënte thirrje për një memorandum global të dënimit me vdekje, me synimin drejt shfuqizimit të tij. Nga vendet pjesëmarrëse 38 shteteve votuan kundër dhe 34 shtete të tjera abstenuan. Dy vjet më parë e njëjta rezolutë kishte marrë vetëm 111 vota pro, duke treguar trendin e pakthyeshem drejt abolicionit total të tij (worldcoalition.org: 2014). Megjithëse SHBA votuan kundër kësaj rezolute, aplikimi i dënimit kapital ka rënë ndjeshëm në këtë vend, sikurse në vende të tjera. Në vitin 2014 SHBA ka pasur numrin më të ulët të ekzekutimeve me vdekje në 20 vitet e fundit dhe numrin më të ulët të dënimeve me vdekje të caktuara nga gjykatat në 40 vitet e fundit (DPIC, 2015). Në vitin 2012 vetëm 9 shtete të SHBA-së kryen ekzekutime me vdekje. Kur Kombet e Bashkuara u krijuan në 1945, vetëm 8 shtete nuk aplikojnë dënimin me vdekje, ndërsa sot 95 nga 193 vende nuk e

³⁸ Termi kapital e ka origjinën nga latinishtja capitalis, që i referohet ekzekutimit përmes prejes së kokës.

parashikojnë fare dënimin me vdekje, ndërsa 42 të tjera nuk e zbatojnë në praktikë (deathpenaltyinfo.org: 2015).

Megjithëse dënimi me vdekje ka ardhur duke u tkurrur si në aplikim ashtu edhe në parashikimin formal në legjislacionet e shumë vendeve të globit, përsëri ai aplikohet në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim (Amnesty International: 2013). Sipas raportit për vitin 2012 të kësaj organizate, në total gjatë këtij viti është raportuar se së paku 21 shtete në botë kanë kryer ekzekutime të dënimit me vdekje. Nga 193 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara, 174 prej tyre nuk kanë kryer ekzekutime gjatë vitit 2012. SHBA dhe Bjellorusia janë vendet e vetme anëtare të organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë që kanë zbatuar ekzekutime me vdekje. Pesë nga 54 anëtarë të Bashkimit Afrikan po ashtu janë konstatuar se kanë zbatuar dënime me vdekje mbi bazë vendimesh gjyqësore: Botsuana, Gambia, Somalia, Sudani i Jugut dhe Sudani. Tridhjetë e një vende të kësaj organizate e kanë shfuqizuar dënimin me vdekje ose nuk e aplikojnë në praktikë. Shtatë nga 21 vendet e Ligës Arabe janë konfirmuar po ashtu se gjatë këtij viti kanë ekzekutuar dënime me vdekje, ndër të cilat Iraku, Palestina, Arabia Saudite, Somalia, Sudani, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Jemeni. Po ashtu pesë nga 54 shtetet anëtare të Komonuelthit konkretisht Bangladeshi, Botsuana, Gambia, India dhe Pakistani kanë aplikuar dënime me vdekje. Japonia dhe SHBA janë dy vende të G8 që kanë kryer ekzekutime me vdekje.

Në mjaft vende të cilat aplikojnë dënime me vdekje ndeshen defekte të ngjashme dhe të rënda të sistemit të drejtësisë penale, të cilat së bashku apo veç e veç tregojnë se dënimi me vdekje nuk mund të mbrohet. Dënimi me vdekje vazhdon të zbatohet për krime, si: “tradhtia bashkëshortore”, “apostazia”³⁹, apo kryerja e marrëdhënieve seksuale me pëlqim mes të rriturve pa kurorë, akte këto të cilat jo vetëm që nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare për t’u konsideruar si “krime të rënda”, por madje nuk duhet të trajtohen fare si krime.

Ajo çfarë është e rëndësishme të përmendet për qëllimet e këtij punimi është se Këshilli Kombëtar i Kërkimit (i Akademive) në SHBA, ka rikonfirmuar në raportin e Prillit 2012 atë që shumë studime të tjera shkencore kanë konfirmuar më parë, se: *“Kërkimet shkencore të deritanishme mbi efektin e dënimit kapital mbi vrasjet nuk provojnë se ky dënim ndikon në uljen, apo ngritjen e numrit të vrasjeve në këtë vend”*. Për pasojë ky komitet sugjeron që këto studime të mos përdoren për të justifikuar mbajtjen e dënimit me vdekje me qëllim uljen e vrasjeve në këtë vend (Nagin & Pepper, 2012: 2).

Dënimi me vdekje është një simptomë e kulturës së dhunës, jo një zgjidhje për të. Cesare Beccaria që në vitin e largët 1764 ka thënë në librin e tij “Dei delitti e delle pene” (1973) se: *“Dënimi me vdekje nuk mund të jetë i dobishëm për shkak të shembullit të barbaritetit që u jep njerëzve...duket*

³⁹ Ndryshimi i besimit fetar. Një praktikë e njohur aktualisht në vendet islame të cilat dënojnë braktisjen e besimit islam dhe konvertimin në çdo besim tjetër fetar.

absurde për mua që ligjet...të cilat duhet të dënojnë vrasjen, janë ato të cilët e kryejnë atë vetë...".

Dënimi me vdekje nuk ka ndonjë efekt të matshëm parandalues dhe argumentet për zbatimin e tij për këtë shkak janë një mit (KE, 2011: 18). Kanadaja (e cila e ka shfuqizuar dënimin me vdekje që në vitin 1975), një vend me kulturë të përafërt me SHBA ka nivel më të ulët kriminaliteti se kjo e fundit, e cila e aplikon këtë dënim në disa shtete të saj. Edhe brenda vetë SHBA nuk ka asnjë tregues se shtetet të cilat e aplikojnë përsëri dënimin me vdekje kanë një nivel më të ulët kriminaliteti të rëndë se ato shtete që e kanë shfuqizuar apo nuk e ekzekutojnë.

Gjyqtari i Lartë i Floridës Charles M. Harris në një analizë të tij të kufizuar vetëm në argumente kosto/përfitim (duke lënë pas dore ato humanitar) ka deklaruar se: *"Nëse dënimi me vdekje nuk është një masë parandaluese, dhe faktet tregojnë se nuk është, dhe nëse dënimi me vdekje nuk na bën neve më të sigurtë, dhe faktet tregojnë se jo, atëherë ai është vetëm një hakmarrje me kosto të lartë"* (2012).

Siç u shprehëm më lart, jo vetëm që ka një mungesë të dallueshme të provave që të provojnë efektin frenues të dënimin kapital, por përkundrazi ka shembuj të shumtë shqetësues se ai përdoret për qëllime politike. Një pjesë e ekzekutiveve me vdekje të kryera janë për qëllime politike, si masa populiste për t'u dukur para opinionit si të ashpër me krimin, apo për t'i mbyllur gojën disidentëve.

2.1.3.2. Dënimet e tjera trupore

Siç u shprehëm më lart dënimet trupore janë aplikuar gjerësisht në të shkuarën për ndëshkimin e keqbërësve, por megjithë arritjet e shoqërisë njerëzore bashkohore në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, këto lloj dënimesh aplikohen ligjërisht edhe në ditët sotme në shumë vende të Afrikës dhe të Lindjes së Mesme (Nalla, 2010: 78). Dënimet trupore janë zhdukur si dënime të dhëna nga gjykatat në të gjitha vendet demokratike perëndimore, por ana tjetër, kjo nuk do të thotë se praktika të tilla abuzive nuk aplikohen në mënyrë të paligjshme edhe në vendet me ndriçimin më të madh të standardeve të të drejtave të njeriut. Vrasja përmes rrahjes dhe torturimit të një të riu shqiptar në burgjet greke është rasti më i freskët i një dënimi trupor jo ligjor (Shekulli, 2015), por i dhënë nga vetë institucionet shtetërore, të cilat kanë për detyrë të kujdesen për jetën dhe shëndetin e të burgosurve. Po ashtu raste të shumta të torturës janë ndeshur në mjaft vendime të GJEDNJ në rastet e pretendimeve për shkelje të nenit 3 të KEDNJ (KE, 2001: 884).

Dënimet trupore gjyqësore aplikohen sot në disa ish koloni Britanike, si: Singapori, Barbados, Botsuana, Brunei, Trinidad dhe Tobago, Zimbabve etj., ku aplikimi i tyre shkon deri në 12 raste për 100 000 banorë (Dammer & Albanese, 2010: 235). Po ashtu forma të ndryshme dënimesh trupore aplikohen në shumë vende me shumicë popullsie myslimane, si: Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Arabia Saudite, Irani, Nigeria, Sudani, Jemeni, Indonezia, Afganistani, etj. Në shumicën e këtyre vendeve për një kategori veprash penale, si p.sh. vjedhjet, parashikohet dhe

aplikohet si një lloj dënimi ligjor amputimi i gishtave, duarve, apo këmbëve, (Çiğdem, 2007). Amputimi apo forma të tjera dëmtimi në organet gjenitale (si heqja e klitorit tek femrat), aplikohen në shumë vende islamike (Amnesty International, 2015). Po ashtu dënimet me fshikullim me kamxhik, parashikohen për vepra të tilla, si: të bërit seks pa u martuar, pirja e alkoolit, luajtja e kumarit, shpifja e të bërit seks jashtë martese etj. (endcorporalpunishment.org, 2012).

2.2. Llojet e dënimeve aktuale në disa vende të botës

Shoqëritë e organizuara kanë vendosur gjithnjë sanksione ndaj personave të cilët kanë shkelur normat dhe ligjet në fuqi. Me kalimin e kohës, natyra e sanksioneve penale ka evoluar shumë. Shumë lloje sanksionesh të cilat dikur kanë qenë të zakonshme, si: dëbimi, puna e rëndë e detyruar, apo dënimet trupore nuk janë më të pranueshme për shumicën e shoqërive moderne. Në çdo kohë sanksionet në fuqi pasqyrojnë filozofinë mbisunduese që drejton një shoqëri dhe mënyrën sesi ajo shoqëri qeveriset. Sistemet ligjore moderne e kanë kufizuar autoritetin për të vendosur sanksione vetëm nga shteti dhe kanë për synim që dënimet të mos jenë arbitrare dhe johumane.

Përtej kësaj, gjithsesi duhet pranuar se edhe brenda atyre shoqërive të konsideruara si “demokratike”, ka një dallim të konsiderueshëm në aplikimin dhe ashpërsinë e sanksioneve të ndryshme penale. Brenda suazave dhe synimeve të një punimi të tillë, në këtë seksion do të kufizohemi në paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të sistemit të dënimeve të aplikuara në disa vende tipike të cilat përfaqësojnë sistemet kryesore ligjore dhe kulturore perëndimore dhe që paraqesin interes më të madh studimi për vendin tonë.

2.2.1. Llojet e dënimeve në sistemin anglosakson (SHBA dhe Britani)

Sistemi ligjor penal i shumicës së vendeve anglishtfolëse mbart dallime të dukshme me sistemin kontinental ligjor të Evropës Perëndimore. E drejta penale e Anglisë dhe SHBA-së rrjedh nga e drejta penale tradicionale angleze *common law*, e cila e ka origjinën në vendimet gjyqësore të mishëruara në precedentët e mëparshëm. Dy vendet më të rëndësishme të sistemit anglosakson që meritojnë vëmendje janë Britania e Madhe dhe SHBA.

2.2.1.1. Llojet e dënimeve në Britaninë e Madhe

Anglia ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme përpjekjet për një kodifikim legjislativ të së drejtës penale (De Burca & Gardner, 1990). Megjithatë në Angli dhe Wells, llojet e dënimit që mund t'i caktohen një të pandehuri për kryerjen e një veprë penale janë të parapara në statute. Statuti kryesor aktual në lidhje me dënimet është “Criminal Justice Act” i vitit 2003, i cili ka ngritur një sistem të dënimeve nga të cilat mund të zgjedhë gjykata. Megjithëse akti vendos disa kritere dhe faktorë të cilët gjykata duhet t'i mbajë në konsideratë në momentin e caktimit të dënimit, pesha që i jepet çdo faktori në një rast konkret është një çështje që lihet në vlerësimin e vendimmarrësit. Në Angli dhe Wells, Këshilli i caktimit të dënimeve (The Sentencing Council) ndihmon për të detajuar

procesin e caktimit të dënimit, duke ofruar guida të tij (sentencing guidelines), të cilat sugjerojnë një nivel të caktuar për çdo rast hipotetik. Vendimmarrësi duhet të mbajë në konsideratë këto guida dhe në rast se vendos që të caktojë një lloj dënimi të ndryshëm nga ai i sugjeruari, ai duhet të tregojë arsyet përse e ka bërë (parliament.uk, 2009).

Gjykata ka një meny me dënime nga të cilat mund të zgjedhë një dënim konkret. Në rend zbritës sipas ashpërsisë ato paraqiten në katër grupe: dënime me izolim (custodial sentences), dënime komunitare (community sentences), gjoba (fines) dhe lirim (discharges). Gjykata mundet poashtu të japë urdhra plotësues, si: shpenzimet, urdhrat e kompensimit dhe heqjet apo kufizimet e të drejtave të lejeve të drejtimit të mjeteve.

Sistemi i sanksioneve penale në Britaninë e madhe ndahen në dënime për të rriturit dhe për të miturit. Në Angli të miturit konsiderohen nën 21 vjeç, por ata nga 18-21 kanë një trajtim të ndryshëm nga ata nën 18 vjeç. Këta të fundit diferencohen në katër grupmosha, përkatësisht nën 18, nën 16, nën 14 dhe nën 12 vjeç. Për të pandehurit e mitur ka një numër të konsiderueshëm dënimesh të cilat jepen nga gjykatat për të mitur. Sipas këtij akti, të pandehurit 18-21 vjeç e vuajnë dënimin me heqje lirie në institucione të veçanta, ndërsa ata mbi 21 vjeç e vuajnë në burgje.

Dënimet me heqje lirie për të rriturit variojnë nga 5 ditë deri në burgim të përjetshëm dhe mund të jenë: 1) dënim i përjetshëm diskrecional, apo i detyrueshëm; 2) dënime me afat fiks; 3) dënime të copëzuara; dhe 4) pezullim i dënimit me burgim. Një rregullim interesant dhe shumë i rëndësishëm për këtë studim është neni 152 i *Criminal Justice Act*, i cili parashikon se përveç krimeve të rënda për të cilat është përcaktuar një dënim fiks me burgim, gjykata nuk mund të caktojë një dënim me burgim, përveçse nëse krimi apo krimet janë të një rëndësie të tillë që gjoba apo një dënim komunitar nuk mund të justifikohet. Gjykata duhet gjithnjë të shpjegojë arsyet nëse vendos një dënim me burgim.

Dënimi me burgim të përjetshëm të detyrueshëm, megjithëse literalisht sugjeron kalimin e gjithë jetës në burg, rrallëherë zbatohet ashtu, pasi në shumicën e rasteve gjyqtari cakton një minimum vitesh para të cilave i dënuari nuk mund të lirohet me leje (Lipscombe, 2012; 1).

Ligji ka përcaktuar poashtu disa minimume në të cilat mund të fillojë burgimi i përjetshëm, në varësi të rrethanave konkrete të veprës penale, ku për vrasjen p.sh. janë burgim përjetë (pra rasti kur gjithë jeta kalohet në burg), 30 vite, 25 vite, 15 vite dhe 12 vite (për të mitur nën 17 vjeç).

Dënimi me burgim të përjetshëm diskrecional parashikohet si dënim opsional për vrasjen pa paramendim, përdhunimin dhe grabitjen. Përveç këtyre rasteve të gjitha dënimet e tjera janë të caktueshme.

Nenet 224 dhe 227 të *Criminal Justice Act* sanksionojnë se gjykata mund të caktojë dënim me burgim të zgjatur: 1) në rastet e krimeve të dhunshme apo seksuale, apo nëse ligji parashikon

dënim fiks me burgim mbi 10 vite dhe 2) nëse ekziston një rrezik i konsiderueshëm për shkaktim dëmi ndaj publikut nga një i pandehur që ka kryer disa vepra të rënda penale.

Lloje të tjera dënimi me burgim janë ato me minimum të përcaktuar ku përfshihen dy lloj veprash “trafikimi i narkotikëve”, kryer më shumë se 3 herë, për të cilat parashikohet 7 vite burgim në minimum dhe “Vjedhja e banesave”, kryer më shumë se 3 herë, për të cilën parashikohen 3 vite burgim si minimum. Në varësi të rrethanave të veprave dhe të autorëve edhe për këto raste gjykata mund ta ulë dënimin nën këtë minimum.

Akti i krimit dhe trazirave (The Crime and Disorder Act, 1998) lejon lirimin nga burgimi me kusht që i dënuari të mbyllet në shtëpi në orare të caktuara dhe të monitorohet me pajisje elektronike. Kohëzgjatja e detyrimit për izolim në shtëpi është e lidhur me kohëzgjatjen e burgimit të caktuar. Një lloj tjetër i ngjashëm dënimi është pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, i cili jepet për vepra të cilat nuk konsiderohen shumë të rënda dhe për të cilat është caktuar një dënim deri në 2 vite burgim. Koha e kushtit është 6 muaj deri në kohëzgjatjen e dënimit (që maksimalisht është 2 vite) dhe ky dënim mund të shoqërohet edhe me caktimin e një gjobe. Nëse i dënuari nuk zbaton detyrimet e vendosura apo kryen vepër tjetër penale, pezullimi mund të revokohet.

Criminal Justice Act ka mundësuar caktimin e dënimit komunitar (community order) ndaj një të pandehuri dhe përbëhet nga disa kushte apo detyrime të ndryshme, të cilat dallohen për të pandehurit 16-18 vjeç, për ata 18-25 vjeç dhe ata mbi 25 vjeç. Për të pandehurit mbi 18 vjeç gjykata mund të caktojë një ose disa nga këto detyrime: të punojë pa pagesë, të kryejë një aktivitet apo të ndjekë një program (rehabilitues, edukativ etj.), të ndalohet të bëjë apo të ndjekë një aktivitet, të kufizohet të mos shkojë në një vend, të kufizohet në banesë në orare të caktuara, të ndjekë programe shëndetësore (rehabilitimi nga droga, alkooli apo të shëndetit mendor), apo të mbikëqyret nga shërbimi përkatës (Martin, 2013: 94) etj.

Gjoba është dënim më i zakonshëm që caktohet nga gjykatat e magjistratëve (gjykatat më të ulëta në Angli) dhe kanë 5 nivele të kufijve maksimalë: niveli 1 deri në £200, niveli 2 deri në £500, niveli 3 deri në £1000, niveli 4 deri në £2500 dhe niveli 5 deri në £5000. Në raste të veçanta këto gjykata mund të caktojnë deri në £20,000. Nga ana tjetër gjykatat e kurorës mund të caktojnë gjoba pa limit në maksimum.

Dënimi me lirim (discharge) mund të jetë me kusht deri në 3 vite që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale ose absolute kur i pandehuri lirohet pa asnjë masë penale. Në rastin e lirimit me kusht, nëse i pandehuri gjatë periudhës së kushtit kryen një vepër tjetër, atëherë gjykata shqyrton rrethanat dhe i cakton dënimin për veprën e parë. Megjithatë në dënimin me lirim gjykata nuk cakton dënim kryesor, ajo mund të caktojë dënime plotësuese si detyrimi mbi shpenzimet apo kompensimi i dëmeve.

Një alternativë tjetër e dënimit me burgim është shtyrja e vuajtjes së tij (deferred sentences). Ky vendim merret për një afat deri në 6 muaj, kur vlerësohet se i pandehuri do të ndryshojë dhe dënimi i caktuar nuk do të jetë më i nevojshëm ose se një dënim më i lehtë mund të jetë i përshtatshëm. Ky dënim jepet vetëm me pëlqim të të pandehurit.

Gjykata ka të drejtë të caktojë dhe dënime plotësuese (ancillary orders) të cilat kanë si synim kompensimin e viktimave dhe heqjen e përfitimeve të paligjshme nga i pandehuri. Dënime të tilla janë: kompensimi i viktimës apo kthimi i gjendjes së mëparshme, heqja e lejes për të drejtuar automjete për një periudhë jo më pak se 1 vit, konfiskimi i sendeve të kryerjes së veprës penale, etj.

2.2.1.2. Llojet e dënimeve në SHBA

E drejta penale në SHBA rrjedh nga e drejta Angleze *common law*, por është përshtatur me kushtet amerikane. Kodi penal model (MPC) është një statut në nivel federal i hartuar nga American Law Institute (ALI) në vitin 1962 dhe modifikimi i fundit i është bërë në vitin 1981. Miratimi i MPC ka qenë stimulimi dhe ndihma ndaj legjislatorëve shtetërorë për të përafruar dhe standardizuar legjislacionin penal mes shteteve anëtare të SHBA (Kadish, 1978). Që nga miratimi i tij MPC ka luajtur një rol të fuqishëm në standardizimin e kodifikimit të së drejtës penale në SHBA. Megjithëse formalisht MPC nuk përbën një ligj dhe burim të së drejtës penale në juridiksionet shtetërore, ai ka shërbyer si modeli për zëvendësimin e mbi 2/3 të kodeve penale të shteteve anëtare (Robinson, 2012: 39). Disa shtete kanë kopjuar disa pjesë të këtij kodi ndërsa disa të tjerë, si: Nju Jorku, Nju Xhersi dhe Oregoni kanë miratuar pothuajse të njëjtat dispozita si MPC në kodet shtetërore (Robinson, 2012: 24). Në shumicën e shteteve amerikane e drejta penale *common law* është zëvendësuar me kode apo statute, të cilat në thelb përsëri janë kodifikim i kësaj të drejte.

Duke qenë se në SHBA janë në fuqi 52 K. Penale të veçanta, në këtë punim do të prekim në mënyrë të përmbledhur tendencën e sanksioneve penale më të zakonshme të parashikuara në MPC. Fillimisht duhet të theksojmë se sistemi penal amerikan përfaqëson legjislacionet më të ashpra në të gjitha vendet demokratike të botës. Siç u trajtua më sipër, SHBA nuk përmenden vetëm si vendi i vetëm demokratik perëndimor i cili vazhdon të aplikojë dënimin me vdekje, por edhe si një vend me një politikë të ashpër penale të orientuar drejt burgimit. Sistemi i të drejtës penale amerikane është objekt studimesh dhe kritikash të shumta në lidhje me sanksionet e ashpra që aplikohen krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore (Whitman, 2003). SHBA kanë aktualisht shifra shumë të larta të kriminalizimit të popullsisë dhe normën më të lartë botërore të të burgosurve⁴⁰. Në vitin 2013 në SHBA më shumë se 1 në çdo 100 të rritur ka qenë në burg. Me këto shifra SHBA jo vetëm që kanë normën më të lartë të burgosjes në botë, por nivelet e saj variojnë me një mesatare

⁴⁰ Numri i të burgosurve në këtë vend ka arritur në 2.3 milionë, apo rreth 0.75 % e popullsisë së këtij vendi.

nga 6 deri në 10 fish më të lartë se vendet e tjera të industrializuara. Ligjet e dënimeve fikse apo të detyrueshme (mandatory), zgjatjet e afateve të dënimit me burgim dhe varësia prej këtij lloji dënimi si shpëtimi i vetëm nga krimi, kanë bërë që jo vetëm të arrihet në shifra të tilla të burgosurish, por madje që shpenzimet për burgjet të tejkalojnë ato për shëndetin, edukimin dhe strehimin⁴¹. Sot në SHBA një në 25 meshkuj është nën mbikëqyrjen e sistemit penal (i burgosur, i dënuar me kusht, i liruar me kusht etj.), ndërsa ndër afroamerikanë me ngjyrë të moshës 20-29 vjeç është një në çdo tre meshkuj.

Kritikat ndaj politikës penale amerikane fokusohen më së shumti në faktin se në këtë vend dënohen me burgim një pjesë e madhe e veprave penale jo të dhunshme, si veprat me lëndë narkotike, vjedhjet jo të dhunshme etj., të cilat në vendet evropiane (Blumstein & Beck, 1999) konsiderohen si vepra të lehta, apo çrregullime të sjelljes.

MPC parashikon në nenet 6.0 - 6.13 llojet e dënimeve që mund të caktojë gjykata, ndërsa në nenet 7.0 - 7.09 kriteret dhe rrethanat që duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e dënimit.

Sipas nenit 6.01 krimet ndahen në tre kategori sipas rëndësisë së tyre dhe neni 6.02 përcakton se për kryerjen e një krimi mund të caktohet dënim me vdekje, me burgim, me gjobë, dënim me kusht, pezullim i dënimit, apo caktimin e çdo lloji dënimi plotësues, si: heqje licence, ndalim i një aktiviteti apo konfiskim pasurie. Neni 6.03 përcakton se dënimi me gjobë ndahet në 5 nivele, duke përcaktuar si maksimum për kundërvajtje të lehta \$ 500 dhe për krime të shkallës së parë jo më shumë se \$10.000 apo jo më shumë se dyfishi i përfitimit të veprës penale. Neni 6.05 parashikon detajime për dënimin e të rinjve të rritur (16-22 vjeç), për të cilët kur gjykata vlerëson ata nuk përbëjnë rrezik për publikun dhe kjo shërben për rehabilitimin e tyre, zëvendëson dënimin që parashikon dispozita me një dënim deri në 4 vite burgim. Po ashtu kjo dispozitë parashikon vuajtjen e dënimit me burgim në institucione të veçanta dhe alternativa të dënimit me burgim për ta.

Sipas nenit 6.06 dënimi me burgim për krime të shkallës së parë varion nga 1-10 vite burgim dhe në maksimum 20 vite apo burgim të përjetshëm, për krime të shkallës së dytë nga 1-3 vite dhe në maksimum jo më shumë se 10 vite, për krime të shkallës së tretë nga 1-2 vite dhe në maksimum jo më shumë se 5 vite. Neni 6.07 parashikon afate më të gjata burgimi në minimum se neni i mësipërm për raste të përcaktuara në nenin 7.03. Neni 6.08 parashikon se për kundërvajtjet e lehta nuk mund të caktohet më shumë se 30 ditë burgim, ndërsa për ato të zakonshmet jo më shumë se 1 vit, ndërsa neni 6.09 parashikon afate më të zgjatura burgimi për kundërvajtjet, të cilat shkojnë nga 1 në 3 vjet për kundërvajtjet e zakonshme dhe nga 6 muaj deri në 2 vite për kundërvajtjet e

⁴¹ Vetëm shpenzimet direkte për burgjet (pa llogaritur humbjet që pëson ekonomia nga burgosja e një individi) për vitin 2010 në SHBA ka arritur në \$39 miliardë, apo mesatarisht rreth \$31.000 për të burgosur në vit. (Henrichson & Delaney, 2012: 10).

vogla. Dispozitat vijuese parashikojnë mundësinë që për shkak të rrethanave të veprës apo të të pandehurit gjykata mund të ulë shkallën e një krimi dhe për rastet e të alkoolizuarve apo të drogëuarve të vendosë vetëm mjekimin e tyre të detyrueshëm, duke mos caktuar dënim kryesor.

2.2.2. Llojet e dënimeve në Evropën kontinentale (Francë, Itali dhe Gjermani)

Në Evropën Perëndimore e drejta penale moderne rrjedh nga kodifikimet e saj. Më i hershmi dhe më i rëndësishmi është K. Penal francez i vitit 1792 dhe më vonë K. Penal i Napolonit i miratuar me 3 qershor 1810, i cili ka vazhduar të jetë në fuqi deri në vitin 1994. K. Penal i Napolonit ka shërbyer si model për shumë kode penale evropiane gjatë shekullit të XIX dhe në shekullin XX, për disa vende të Amerikës Latine, të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës frankofone. K. Penal gjerman i vitit 1871 është bërë model për vende të tjera të Evropës, Japoninë dhe Korenë e Jugut. K. Penal italian (Rocco) i vitit 1930 (i cili është akoma në fuqi), paraqet një nga përpjekjet më të zhvilluara të teknikës legjislative të kohës dhe ka pasur një ndikim në disa vende të Amerikës Latine. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar shumica e vendeve evropiane kanë miratuar kode të reja penale ose kanë ndërmarrë ndërhyrje thelbësore në ato ekzistuese. Në këtë pjesë të punimit do të trajtojmë sistemet e dënimeve në të drejtën penale franceze, gjermane dhe italiane.

2.2.2.1. Llojet e dënimeve në Francë

Kodi i ri penal francez u miratua në vitin 1992 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1994⁴². Ai përbën një kod shumë të detajuar dhe është i ndarë në 7 libra, ku libri i parë (nga neni 11-1 deri në 133-17, gjithsej 195 nene) përmban pjesën e përgjithshme, ndërsa 6 librat e tjerë (705 nene) përmbajnë figura veprash penale të ndara sipas objekteve grupore. Sipas rëndësisë, kodi i ndan veprat penale në 3 kategori, në kundërvajtje (contraventions), në delikte (délits) dhe në krime (crimes).

Në titullin III (nenet 131-1 deri 133-1) parashikohen dënimet që mund të caktojë gjykata. Dënimet për krime të rënda ndahen në 4 shkallë, ku maksimumi i shkallës së parë parashikon burgim të përjetshëm, maksimumi i shkallës së dytë 30 vite burgim, i shkallës së tretë 20 vite dhe i shkallës së katërt 15 vite burgim. Për deliktet kodi parashikon dënim me burgim, dënim me kufizim lirie, dënim me gjobë apo gjobë ditore, dënim me kurs qytetarie, dënim me shërbim publik, dënim me konfiskim pasurie, apo heqje të drejte, dënim për riparim dëmi apo dënim tjetër plotësues. Për deliktet dënimi me burgim ndahet në 8 shkallë, përkatësisht 1° maksimumi deri në 10 vite; 2° maksimumi 7 vite; 3° maksimumi 5 vite; 4° maksimumi 3 vite; 5° maksimumi 2 vite; 6° maksimumi 1 vit; 7° maksimumi 6 muaj; dhe 8° maksimumi 2 muaj.

Një dënim inovator me kufizim lirie i miratuar në vitin 2014, i ngjashëm me pezullimin e dënimit me kusht, është ai i cili zëvendëson burgimin për vepra që parashikojnë deri në 5 vite burgim. Një lehtësim në aplikimin e dënimit me burgim është edhe parashikimi i konvertimit të dënimit me

⁴² Gazeta Zyrtare 23 Dhjetor 1992, hyrë në fuqi me 1 Mars 1994 (i përditësuar deri në korrik 2014).

burgim në gjoba ditore, ku numri maksimal i tyre nuk mund të kalojë 360 njësi. Vlera e një gjobe ditore përcaktohet nga të ardhurat neto ditore të të dënuarit. Dënime të tjera alternative për burgimin për delikte janë dhe ndjekja e një kursi qytetarie, kryerja e një pune në komunitet pa shpërblim (40-210 orë), konfiskimi i një pasurie, heqja e patentës, ndalimi i një veprimtarie, ndalimi për të shkuar diku, apo për t'u shoqëruar me dikë etj. Edhe K. Penal francez parashikon caktimin e një dënimi plotësues krahas atij me burgim, kur ligji e parashikon për kryerjen e një krimi apo delikti, por kur gjykata e vlerëson të përshtatshme mund të kufizohet vetëm në caktimin e dënimit plotësues.

Kundërvajtjet janë vepra për të cilat kodi parashikon dënim me gjobë deri në €3000. Për kryerjen e një kundërvajtjeje kodi parashikon si dënim gjobën, konfiskimin e pasurisë apo kufizimin e të drejtave (të cituara më lart si alternativa të dënimit me burgim) si dhe riparimin e dëmit. Gjocat për kundërvajtje ndahen në 5 shkallë, përkatësisht, 1° maksimumi €38; 2° maksimumi €150; 3° maksimumi €450; 4° maksimumi €750; dhe 5° maksimumi €1,500, shumë e cila mund të ngrihet deri në €3,000 në rast të një përsëritësi.

K. Penal francez parashikon një numër të madh dhe një rregullim të detajuar të dënimeve plotësuese, si konfiskimi i pasurisë, deportimi i të huajve, largimi nga një vend i caktuar, ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike, ndalimi i drejtimit të automjeteve, ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie, ndalimi i pjesëmarrjes në tendera, publikimi i vendimit etj. Një institut interesant i së drejtës penale franceze është dhe vënia në mbikëqyrje socio-gjyqësore, e cila shërben për kufizimin e recidivizmit. E veçanta e kodit francez është se për delikte afati i mbikëqyrjes mund të jetë deri në 10 vite, ndërsa për krime deri në 20 vite. Për kryerjen e krimeve që parashikojnë dënime deri në 30 vite, afati i mbikëqyrjes mund të zgjatet deri në 30 vite, ndërsa për dënime me burgim të përjetshëm afati i mbikëqyrjes mund të jetë i përjetshëm, por jo më pak se 30 vite.

Megjithëse siç vërehet K. Penal francez ofron alternativa të shumta të dënimit me burgim, pasja e një shkalle të lartë inkriminimi dhe përcaktimi i dënimeve me burgim me minimum fiks (të implementuara në vitin 2007, në kohën e presidentit Sarkozy) ka bërë që edhe ky vend të ketë probleme të lehta me mbipopullimin e të burgosurve dhe kushtet e tyre në këto institucione (Beatrix, 2011). Prej vitit 2010, Franca ka pasur një stabilitet të të dënuarve me burgim, pas një rritjeje konstante që nga viti 2001 dhe aktualisht ka 98 të burgosur për 100.00 banorë (prisonstudies.org, 2015).

Një reformë e rëndësishme iu bë K. Penal francez me ligjin e 15 Gushtit 2014 (ndër të tjera) u lejon gjykatave që caktimin e dënimit ta bëjnë në një seancë tjetër, pas seancës për caktimin e fajësisë (*Id.* arts. 5-6.) Kjo i lejon gjykatës që të shqyrtojë më mirë personalitetin e të pandehurit dhe rrethanat e tij, në mënyrë që të zgjedhë dënimin më të përshtatshëm për të.

2.2.2.2. Llojet e dënimeve në Gjermani

Pas ribashkimit të tyre, Gjermania miratoi kodin e ri penal në vitin 1998. Ashtu si kodet e tjera kontinentale, ai ndahet në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme. Kodi i ndan veprat në krime të cilat dënohen në minimum me 1 vit burgim dhe kundërvajtje të cilat dënohen më pak se 1 vit burgim në minimum ose me gjobë. Dënimet parashikohen në kreun III, titulli i parë, në nenet 38-45b të tij. Sipas nenit 38, përveç rasteve të burgimit të përjetshëm⁴³, dënimi me burgim varion nga një muaj deri në 15 vite burgim. Dënimet me burgim më pak se një vit përcaktohen në javë të plota dhe në muaj, ndërsa ato mbi një vit, në muaj dhe në vite.

K. Penal gjerman parashikon në nenin 40 sistemin e gjobave ditore. Minimumi i një gjobe mund të jetë 5 njësi gjobe ditore dhe maksimumi 360 njësi gjobe ditore. Vlera e një gjobe ditore përcaktohet nga gjykata në bazë të të ardhurave neto ditore të të pandehurit. Gjithsesi një njësi nuk mund të jetë më pak se një euro dhe jo më shumë se 30 000 euro. Dënimi me gjobë mund të caktohet krahas dënimit me burgim, në rast se i pandehuri ka shtuar pasurinë e tij si rezultat i kryerjes së veprës penale. Në rastet kur provohet se i pandehuri nuk ka mundësi ta paguajë gjobën njëherësh, gjykata mund të caktojë pagimin me këste, të shtyjë afatin e pagimit të tyre, apo të heqë fare afatin e pagimit të tyre. Revokimi i afatit të pagimit të kësteve bëhet edhe nëse provohet se detyrimi për pagimin e gjobës po pamundëson shlyerjen e dëmit ndaj të dëmtuarit. Sipas nenit 43, mospagimi i gjobës bën që ajo të zëvendësohet me burgim, ku një njësi gjobe ditore konvertohet në një ditë burgim. Përveç parashikimeve të mësipërme, kur ligji e parashikon, gjykata mund të urdhërojë edhe pagesën e një shume të hollash në rastet kur caktohet burgim i përjetshëm, apo dënim me burgim jo më pak se 2 vite. Masa e kësaj shume përcaktohet në varësi të pasurisë së të pandehurit.

Në nenet vijuese parashikohen caktimi i dënimeve plotësuese. Neni 44 parashikon pezullimin e të drejtës për të drejtuar automjete për një periudhë nga 1-3 muaj, neni 45 parashikon humbjen e funksionit publik, të drejtës së votës, apo të të zgjedhurit për 5 vjet, nëse personi është dënuar më shumë se 1 vit burgim për kryerjen e një krimi.

Në titullin e IV të këtij kreu në nenet 56-58, parashikohet në detaje pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim. Sipas nenit 56 për dënime deri në 1 vit burgim, gjykata mund ta pezullojë zbatimin e dënimit me burgim pa kusht, ndërsa për burgime deri në 2 vite gjykata mund ta pezullojë ekzekutimin duke e vënë në provë të pandehurin për një afat nga 2-5 vite. Gjatë periudhës së provës gjykata mund të vendosë detyrime apo kufizime ndaj të dënuarit, të cilat mbikëqyren nga oficerët e provës. Lirimi para kohe me kusht parashikohet pas vuajtjes së ½ të dënimit për të dënuarit për herë të parë dhe 2/3 e dënimit për të pandehurit e tjerë. Të dënuarit me burgim të përjetshëm mund

⁴³ Edhe burgimi i përjetshëm në fakt kualifikohet sipas nenit 57/a për lirim para kohe me kusht pas vuajtjes së 15 viteve burgim.

të lirohen para kohe pas vuajtjes së 15 viteve burgim. Të liruarit me kusht vihen nën mbikëqyrje për një periudhë prove pranë oficerëve të provës.

Më tej në titullin V, në nenet 59-60 parashikohen dy alternativa humane dënimesh si paralajmërimi me shtyrje të dënimit, apo përjashtimi nga dënimi. Në titullin VI (nenet 61-72) parashikohen në detaje masat penale të rehabilitimit dhe të paaftësisimit, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e shoqërisë nga personat e rrezikshëm për të cilët nuk vlen parimi i fajësisë (Albrecht, 2004), ndërsa në titullin VII (nenet 73-76a) parashikohen në detaje konfiskimet dhe deprivimet e ndryshme.

Në mënyrë të përmbledhur nga parashtrimi i mësipërm mund të konstatohet se Gjermania përbën një model të së drejtës penale humane dhe sociale. Këto dispozita të pjesës së përgjithshme, së bashku me masat e arsyeshme të dënimit të parashikuara nga pjesa e posaçme e K. Penal, kanë bërë që Gjermania prej 40 vitesh të ketë në vijimësi, një aplikim të gjerë të dënimit me gjobë, në mbi 80% të të dënuarve dhe për pjesën e mbetur, shumica e tyre dënohen me kusht (Heinz, 2006). Aplikimi i dënimit me burgim në Gjermani zë një pjesë të vogël dhe kohëzgjatja e tij është më e ulët se në mjaft vende të tjera për të njëjtat vepra penale⁴⁴. Për ilustrim mund të përmendim se në vitin 2012, vetëm 5% e çështjeve penale përfunduan me një vendim dënimi me burgim, ndërkohë që 82% e dënimeve ishin gjoba (Statistisches Bundesamt, 2014). Kjo ka bërë që Gjermania të dallojë për shkallën e të burgosurve jo vetëm nga SHBA, por edhe me vende të Evropës perëndimore, si: Anglia, Spanja, Italia apo edhe Franca (ICPS, 2013). Nga të dhënat më të freskëta, aktualisht Gjermania ka një shkallë të popullimit të burgjeve prej 76 të dënuar për 100.000 banorë (prisonstudies.org. 2015).

2.2.2.3. Llojet e dënimeve në Itali

K. Penal Rocco, i miratuar nën sundimin fashist në vitin 1930, vazhdon t'i rezistojë kërkesave për një kod të ri (Padovani, 2006: 7), duke i përballuar ato vetëm përmes reformave të shumta modifikuese. Megjithatë fillimisht sistemi i dënimeve penale në Itali udhëhiqej nga qëllimi retributiv, dhe preventiv (i posaçëm dhe gjeneral), me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re italiane⁴⁵, në nenin 27, paragrafi i tretë u parashikua se: *“Dënimet nuk mund të përdoren në kundërshtim me dinjitetin njerëzor dhe duhet të synojnë riedukimin e të dënuarit”*. Pajtimi i këtyre funksioneve të ndryshme ka ngritur debate të mëdha teorike dhe probleme praktike (Fiandaca & Musco, 2009: 700-722). Një nga përpjekjet për t'i pajtuar këto qëllime të ndryshme ka qenë interpretimi se riedukimi nuk është një qëllim primar i caktimit të dënimit, por një synim i cili i besohet fazës së ekzekutimit të dënimit (Bettioli, 1964).

K. Penal italian e rregullon sistemin e dënimeve në titullin II, në nenet 17-38. Në nenin 17

⁴⁴ Për veprat penale më të rënda minimumet e dënimit janë përcaktuar në kod, ku minimumi i dënimit është një vit burgim. Gjithsesi, për krime të rënda (si grabitja, përdhunimi, trafiku i drogës dhe vrasja) minimumi i dënimit shkon në dy, tre, apo pesë vite dhe në raste përjashtimore deri në 10 vite burgim (Albrecht, 2013).

⁴⁵ E miratuar nga Asambleja Kushtetuese me 22 dhjetor 1947.

parashikon këto dënime kryesore për krime: 1) vdekje (shfuqizuar që me 10 gusht 1944 dhe zëvendësuar me burgim të përjetshëm); 2) burgim i përjetshëm (ergastolo); 3) burgim (reclusione) dhe 4) gjobë (multa). Për kundërvajtje penale parashikohen këto dënime kryesore: 1) burgim (arresto) dhe 2) gjobë (ammenda). Dënimi me burgim të përjetshëm nënkupton qëndrimin në burg përjetë dhe vuhet në institucione të veçanta. Burgimi për krime shtrihet nga 15 ditë në 24 vite, ndërsa për kundërvajtje nga 5 ditë deri në 3 vite. Megjithëse për të dy llojet e dënimeve me burgim njihet e drejta e punës jashtë burgut, regjimet e këtyre dy lloj burgimesh janë të ndryshme, me një liri më të madhe për kundërvajtësit. Si pak vende në Evropë, Italia akoma nuk ka përqafuar sistemin e gjobave ditore⁴⁶, duke ruajtur sistemin komulativ të gjobave (të sheshta). Kodi parashikon se gjoba për krime varion nga 50-50.000 euro, ndërsa për kundërvajtje nga 20-10.000 euro. Për krime të kryera për motive përfitimi, gjykata mund të caktojë krahas dënimit me burgim edhe një gjobë që varion nga 50-25.000 euro. Në nenin 133 bis., parashikohet se në përcaktimin e masës së gjobës, përveç kritereve të përgjithshme, mbahen parasysh edhe kushtet ekonomike të të pandehurit. Gjyqtari mund të trefishojë apo ta ulë deri në 1/3 gjobën e parashikuar nga ligji, nëse kushtet e të pandehurit tregojnë se maksimumi është ineffikas, apo se minimumi është tepër i rëndë. Për kryerjen e krimeve parashikohen këto dënime plotësuese:

1. Ndalimi nga shërbimet publike.
2. Ndalimi nga ushtrimi i një profesioni apo arti.
3. Ndalimi legal.
4. Ndalimi nga funksionet drejtuese të personave juridikë dhe të sipërmarrjeve.
5. Paaftësia për të kontraktuar me administratën publike.
6. Ndalimi i marrëdhënieve të punës apo të nëpunësit.
7. Dekadenca apo pezullimi nga ushtrimi i pushtetit prindëror nga prindërit.

Për kryerjen e kundërvajtjeve mund të caktohet pezullimi nga ushtrimi i një profesioni apo arti, ose pezullimi nga funksionet drejtuese të personave juridikë dhe të sipërmarrjeve. Po ashtu një dënim i përbashkët plotësues për krime dhe kundërvajtje është publikimi i vendimit penal të dënimit.

Për dënime me burgim deri në 2 vite, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e dënimit, duke e vënë në provë të pandehurin, përkatësisht deri në 5 vite për kryerjen e një krimi dhe deri në 2 vite për kryerjen e një kundërvajtjeje. Nëse i pandehuri ka qenë nën 18 vjeç, gjykata mund të pezullojë dënimet deri në 3 vite burgim. Për personat e moshës 18-21 dhe ata mbi 70 vjeç, mund të aplikohet pezullimi i dënimit me burgim për dënime deri në 2 vite e 6 muaj burgim. Veçoria e K. Penal

⁴⁶ Në fakt komisioni për reformën e K. Penal, i krijuar me 30 korrik 2006 (i quajtur komisioni Pisapia) propozoi ndër të tjera adaptimin e sistemit të gjobave ditore, por puna e tij u ndërpre për shkak të krizës politike dhe pasimin e zgjedhjeve të vitit 2008.

italian në lidhje me këtë institut është se, krahas dënimit me burgim, mund të pezullohet edhe dënimi me gjobë (e konvertuar në kohëzgjatje burgimi si më sipër) si dhe dënimet plotësuese. Megjithëse kodi ofron një diskrecion të gjerë gjyqësor, pasi parashikon si kusht të aplikimit të këtij instituti vetëm bindjen e gjyqtarit se i pandehuri nuk do të kryejë vepra të tjera penale (pra nuk kërkon kushte të shprehura), ai kufizon aplikimin e tij për të dënuarit e mëparshëm me burgim për krime dhe ata habitual për kundërvajtje si dhe për personat ndaj të cilëve duhet t'u caktohet një masë sigurimi⁴⁷ (sepse janë objektivist të rrezikshëm). Gjykata nuk mund të pezullojë poashtu ekzekutimin e burgimit për herë të dytë, nëse të dy dënimet bashkë kalojnë masën e dënimit të parashikuar si limit për aplikimin e këtij instituti. Ndaj të dënuarit të vënë në provë mund të caktohen disa detyrime, shumica e të cilëve fokusohen në drejtim të shlyerjes së dëmit dhe drejtësisë restauruese.

Në lidhje me lirin para kohe me kusht K. Penal italian parashikon një regjim relativisht të ashpër, ku për t'u kualifikuar për lirim para kohe në rastin e burgimit të përjetshëm duhet të vuhet së paku 26 vite dhe për të burgosurit e tjerë jo më pak se 30 muaj, por gjithnjë jo më pak se gjysma e dënimit të caktuar. Për të dënuarit përsëritës dënimi i vuajtur duhet të jetë minimalisht $\frac{3}{4}$ e dënimit të caktuar.

Në përmbledhje konstatohet se K. Penal italian ka një sistem relativisht agresiv dënimesh (krahasuar me atë gjerman, apo të vendeve nordike), me një aplikim mbizotërues të dënimit me burgim ndaj atij me gjobë. Kjo ka bërë që në vijimësi Italia të ketë një shkallë më të lartë të burgosurish se këto vende, e shoqëruar kjo me një problematikë të mbipopullimit të burgjeve. Gjithsesi, nga 112 të burgosur për 100.00 banorë që kishte në vitin 2010, për 4 vite (në vitin 2014) Italia ka arritur të ulë përsëri popullimin e burgjeve në 87 të burgosur (prisonstudies.org. 2015).

2.2.3. Llojet e dënimeve në Evropën Nordike (Danimarkë, Suedi, Norvegji dhe Finlandë)

Vendet Skandinave meritojnë një trajtim më vete në këtë kapitull, për shkak të veçorisë së tyre në aplikimin e ulët të dënimit me burgim në raport me vendet e tjera të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Sipas të dhënave të publikuara nga ICPC në buletinin më të fundit (2014), këto vende megjithëse kanë një nga shkallët më të larta në Evropë të personave të deklaruar fajtorë nga gjykatat e këtyre vendeve, ato kanë shkallën më të ulët të personave të dënuar me burgim për 100.000 banorë. Kështu p.sh. në vitin 2012 këto vende renditen në fund të listës së aplikimit të dënimit me burgim, ku shquhet Finlanda me një shkallë prej vetëm 1.5% të të dënuarve, Danimarka 3.2 %, Suedia 4 % dhe Norvegjia 22% (e cila ka një normë shumë më të ulët të personave të deklaruar fajtorë për vepra më të lehta, sesa tre vendet e tjera). Vendet nordike jo

⁴⁷ Bëhet fjalë për masat e sigurimit ndaj personave të rrezikshëm (si masat mjekësore për të sëmurët mendorë, narkomanët, të alkoolizuarit etj.) dhe jo masat e sigurimit personal, që caktohen ndaj kryerësve të përgjegjshëm të veprave penale.

vetëm që kanë një shkallë të lartë të personave të deklaruar fajtorë për kryerjen e veprave penale (pra një nivel të lartë të zbatimit të ligjit në praktikë), por ndryshe nga ç'mund të jetë mit në vendin tonë, ato kanë dhe një shkallë të ngjashme të kriminalitetit të dhunshëm me vendet e tjera evropiane, madje në vepra të veçanta si sulmet fizike apo kanosjet kanë një shkallë ndjeshëm më të lartë (Von Hofer, 2003).

Aplikimi më i rrallë i dënimit me burgim është njëri nga treguesit e shkallës së ndëshkueshmërisë, pasi një tregues tjetër i rëndësishëm është dhe niveli i marzheve të dënimit me burgim të parashikuar nga ligji dhe të zbatuar nga gjykatat. Nisur nga shumatorja e dënimeve me burgim, e cila matet nga shkalla e të burgosurve në një vend, mund të konstatohet lehtë se këto vende aplikojnë masa të ulëta dënimi në krahasim me disa vende të tjera të Evropës. Këto vende në vitin 2013 kishin shkallën më të ulët të të burgosurve në botë duke filluar nga 53 të burgosur për 100.000 banorë që ka Finlanda, në më të lartën 73 të burgosur për 100.000 banorë që kishte Danimarka⁴⁸ (ICPS, 2013).

Shpjegimi, pas këtij sistemi të butë dënimesh në këto vende, qëndron në faktin se së pari politika e tyre penale ndjek prioritete të ndryshme nga ndëshkimi i rëndë i personave fajtorë dhe parandalimi i krimeve të ardhshme. Këto vende konsiderojnë një synim me vlera të mëdha riparimin e pasojave të atyre krimeve, të cilët nuk kanë arritur të parandalohen nga e drejta penale. Për shumë penalistë të vendeve të tjera evropiane dhe botërore, parandalimi i krimit mund të jetë detyrë kryesore e së drejtës penale, por jo e një skandinavi. Shumë studime empirike të kryera në këto vende provojnë bindshëm se mjete dhe mënyra të tjera të ndërhyrjeve sociale janë disa herë më efektive sesa efekti i masave penale (Lappi-Seppälä, 2008: 20) .

Po të trajtojmë në brendësi sistemin e dënimeve të parashikuara në kodet respektive penale mund të vihet re se dënimi më i rëndë penal në Danimarkë, Suedi dhe Finlandë është burgimi i përjetshëm, i cili në fakt është vetëm 15 vite burgim. Norvegjia nuk e parashikon fare burgimin e përjetshëm, por dënimi me burgim në kontrast me 3 vendet e tjera shkon deri në 21 vite. Për kryerjen e një veprë të vetme maksimumi i masave të dënimit në Danimarkë është 16 vjet, në Finlandë 12 dhe në Suedi 10 vite. Dënimi me burgim aplikohet vetëm për veprat më të rënda penale dhe pjesa dominuese e sanksioneve penale zihet nga alternativa të tjera. Gjohet që kanë qenë një dënim kryesor gjatë shekullit të kaluar dhe vazhdojnë të aplikohen gjerësisht përsëri, ku Danimarka, Suedia dhe Finlanda aplikojnë sistemin e gjobave ditore.

Për veprat penale me një rrezikshmëri mesatare zakonisht aplikohen dënimet komunitare, ku më i zakonshmi është burgimi me kusht. Në Finlandë pezullohen shumica e dënimeve deri në dy vite burgim dhe në Suedi ato deri në tre vite, ndërsa Norvegjia dhe Danimarka nuk kanë limite në

⁴⁸ Krahasuar p.sh. me shkallën prej 148 të burgosurish që ka Britania, 475 Rusia, apo 716/100.000 banorë SHBA.

aplikimin e dënimit me kusht (Lappi-Seppälä, 2008: 23). Puna në shërbim publik është një lloj dënimi më vete në Finlandë dhe Norvegji, ndërsa në Suedi dhe Danimarkë mund të caktohet bashkë me një lloj dënimi tjetër. Maksimumi i orëve të punës varion nga 200 që ka Finlanda në 420 që ka Norvegjia.

Ndërmjet vendeve Skandinave, Danimarka dhe Suedia kanë një shkallë më të lartë aplikimi të dënimeve komunitare. Suedia aplikon gjerësisht edhe monitorimin elektronik si pjesë të sistemit të provës. Këto dy vende aplikojnë poashtu edhe masat e ndryshme trajtuese si pjesë të alternativave të dënimeve. Në Finlandë nga ana tjetër masat trajtuese (si mjekimi psikiatrik, apo trajtimi i personave të varur nga alkooli apo droga) nuk caktohen nga gjykata, por nga autoritetet mjekësore. Norvegjia ka një rregullim mes dy sistemeve të mësipërme për masat mjekësore.

2.2.4. Llojet e dënimeve në Ballkan (Kosovë, Mal të zi, FYROM dhe Greqi).

Me përjashtim të Greqisë, deri në fund të viteve '90 Kosova, Mali i Zi dhe FYROM (Maqedonia) kanë pasur një sistem të së drejtës penale të orientuar nga e drejta penale sovjetike. Për pasojë me shpërbërjen e ish Jugosllavisë këto republika të reja kanë adaptuar kode të reja penale të frymëzuara nga kodet penale të vendeve perëndimore. Kosova ka kodin më të ri penal në Ballkan⁴⁹ të hartuar me ndihmën e ekspertëve më të mirë evropianë (Salihu, 2012: 116) dhe për pasojë dhe sistemi i dënimeve pasqyron zhvillimet më të fundit të së drejtës penale perëndimore. Maqedonia ka miratuar kodin e ri penal në vitin 1996, Mali i Zi në vitin 2003, ndërsa Greqia ka zgjedhur të modifikojë herë pas here kodin e saj penal të vitit 1950⁵⁰. K. Penal grek përbën bërthamën e legjislacionit penal, pasi pjesa më e madhe e tij është e shpërndarë edhe në shumë ligje të tjera, të cilat parashikojnë vepra dhe sanksione penale të ndryshme, si K. Penal ushtarak, Ligji mbi rregullimin e tregut, Ligji mbi rregullat e trafikut, Kodi doganor, Ligji mbi evazionin fiskal, Ligji mbi drogat etj.

Kodet penale të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi nuk i ndajnë veprat penale në kategori, ndërkohë që K. Penal grek i ndan (në nenin 18) veprat penale në tre kategori (si Franca) në krime, kundërvajtje dhe vepra të lehta.

Në Malin e Zi (në nenin 4) sanksionet penale ndahen në dënime, masa paralajmëruese, masa sigurimi dhe masa edukative. K. Penal maqedonas (në nenin 4) parashikon të njëjtat masa me një ndryshim se në vend të masave paralajmëruese, parashikon masat alternative. Kodi kosovar dhe ai grek parashikojnë si sanksione dënimet dhe masat e trajtimit të detyrueshëm (apo masa sigurimi të njohura në Greqi). Në Kosovë (neni 4) dënimet ndahen në dënime kryesore, dënime alternative, dënime plotësuese dhe vërejtja gjyqësore. Ndërsa si masa të detyrueshme parashikohen trajtimi i

⁴⁹ K. Penal i Republikës së Kosovës, i miratuar me ligjin nr. 04/L-082 datë 20.04.2012.

⁵⁰ K. Penal grek, i miratuar në vitin 1950 me ligjin 1492/1950, hyrë në fuqi me 1 janar 1950. Ky kod zëvendësoi kodin e mëparshëm të vitit 1833. Kodi aktual është ndikuar në masë të madhe nga K. Penal Gjerman i vitit 1871 dhe K. Penal i Bavarisë i vitit 1813, i cili në fakt mbështetej në K. Penal francez të vitit 1810 (Spinellis & Spinellis, 1999).

detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, apo trajtim i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli (njësoj i parashikon në nenin 61 edhe kodi maqedonas). Mali i Zi konsideron si masa sigurimi (sipas nenit 67) përveç këtyre të triave edhe masa të cilat në sisteme të tjera konsiderohen si dënime plotësuese si ndalimi i ushtrimit të profesionit, ndalimi i drejtimit të mjeteve, konfiskimi i sendeve, nxjerrja jashtë shteti dhe publikimi i vendimit gjyqësor. Njësoj edhe Greqia konsideron si masa sigurimi mbajtjen e të pandehurve në një institucion terapeutik (për të sëmurët psikik, apo shurdhmemecët sipas nenit 69), mbajtjen e të alkoolizuarve dhe të droguarve në një institucion terapeutik (neni 71), dërgimin në një ambient pune për të pandehur parazitë, endacakë apo që bëjnë një jetë të çrregullt (neni 72 i cili në praktikë nuk është zbatuar) dhe masa të tjera si ndalimi për të qëndruar diku, nxjerrja jashtë territori i të huajve dhe konfiskimi i sendeve të sekuestruara.

Në Malin e Zi dënimi me 30 vite burgim është dënimi më i rëndë. Ai nuk mund të caktohet ndaj personave nën 21 vjeç, ndaj personave që vuajnë nga sëmundje mendore dhe për veprat e mbetura në tentativë. Dënime të tjera kryesore janë burgimi, dënimi komunitar dhe gjoba. Gjoba mund të caktohet edhe si dënim aksesor. Dënimi me burgim zgjat nga një muaj deri në 20 vite. Dënimi me gjobë varion nga € 200 deri në € 20.000 dhe në rastet kur vepra është kryer nga lakmia e pasurisë mund të shkojë deri në € 100.000. Kur gjoba caktohet si një dënim kryesor, masa e saj ndahet në 6 shkallë duke filluar nga € 200- € 2.000 për vepra që dënohen deri në tre muaj burgim dhe duke vazhduar më tej në mënyrë progresive për vepra më të rënda (ku minimumi i saj shkon në € 1200). K. Penal malazez parashikon poashtu në nenin 40 zbatimin e gjobave ditore ndaj të pandehurit, në rastet kur të ardhurat dhe shpenzimet e një të pandehuri mund të përcaktohen nga gjykata. Shuma e një njësie gjobë ditore nuk mund të jetë më pak se €10 dhe më shumë se € 1.000. Numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më pak se 10 njësi dhe nuk mund të tejkalojë 360 gjoba ditore.

Në Maqedoni burgu dhe gjoba janë dënime kryesore, por gjoba mund të jetë dhe dënim sekondar. Dënimi me burgim varion nga 30 ditë deri në 15 vite dhe për krimet më të rënda dënimi me burgim të përjetshëm mund të shkojë deri në 20 vite burgim. Së fundmi dhe Maqedonia ka përqafuar sistemin e gjobave ditore, duke sanksionuar se numri i tyre varion nga 5-360 njësi. Vlera e një gjobë ditore nuk mund të jetë më e ulët se një euro dhe jo më shumë se 5000 euro.

Dënimet kryesore në Kosovë janë dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Dënimi me burgim zgjat nga 30 ditë deri në 25 vite. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se € 100 dhe jo më shumë se € 25.000.

Dënime alternative janë dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme. Dënimi me kusht mund të shoqërohet me urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, apo urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. Dënime plotësuese janë heqja e të drejtës për t'u zgjedhur; urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës, ndalimi i drejtimit të automjetit, marrja e lejes së vozitjes, konfiskimi, publikimi i aktgjykimit dhe dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës. Gjykata mundet të mos caktojë dënim penal, dhe ta lirojë të pandehurin nga dënimi ose të mjaftohet me shqiptimin e një vërejtjeje gjyqësore për vepra të lehta që parashikojnë dënim deri në 1 vit burgim dhe në raste të veçanta deri në 3 vite burgim. Në Kosovë dhe në Maqedoni, dënimi me kusht mund të caktohet jo vetëm si alternativë e dënimit me burgim, por edhe kur caktohet dënim me gjobë.

Greqia i ndan dënimet në kryesore dhe në plotësuese. Dënimet kryesore janë dënimet me burgim, me gjobë dhe dënimet komunitare. Në dënimet komunitare bëjnë pjesë pezullimi i dënimit me apo pa mbikëqyrje, qëndrimi në shtëpi, konvertimi i dënimit me burgim në gjoba ditore dhe puna në komunitet. Burgimi në Greqi ndahet në dy kategori, nga 10 ditë deri në 5 vite (neni 53) dhe nga 5 vite deri në 20 vite, apo përjetë (neni 52). Kodi grek parashikon dhe heqjen e lirisë për një afat të pacaktuar për të dënuar përsëritës habitual, por ai nuk është zbatuar në praktikë (Spinellis & Spinellis, 1999). Shërbimi i provës është implementuar formalisht (në nenin 100a) në vitin 1991 (me ligjin 1941/1991), por për shkak të moskrijimit si strukturë monitoruese, ky dënim nuk është vënë në jetë. Në vitin 2010 kodi grek është ndryshuar duke modifikuar dënimet alternative, me qëllim që t'u japë një hapësirë më të madhe, duke tentuar të reduktojë zbatimin e dënimit me burgim vetëm për vepra të rënda. Një dënim i ri alternativ i shtuar në vitin 2010 është dhe pajtimi penal për vepra të caktuara të kryera mes individëve (si vjedhja, mashtrimi etj.). Shërbimi në komunitet është një dënim alternativ i cili aplikohet për të rriturit, ndërsa për të miturit zbatohet në kuadër të masave edukuese që caktojnë gjykatat e të miturve. Dënimi i qëndrimit në shtëpi jepet ndaj personave të moshuar mbi 75 vjeç.

Dënimet monetare ndahen në dy kategori, në gjoba monetare të cilat variojnë nga € 150- € 15.000 dhe gjoba të cilat variojnë nga € 29- € 590 (Newman, 2010: 143). Konvertimi i dënimeve me burgim në dënime me gjobë ka një histori të gjatë në Greqi, megjithëse në totalin e dënimeve nuk e ka kaluar asnjëherë mbi 10% (Lambropoulou: 2005).

Kodet penale të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë parashikojnë mundësinë që për shkak të rrezikshmërisë së pakët të veprës penale, gjykata mund të mos e konsiderojë një veprim të caktuar si vepër penale, apo ta përjashtojë të pandehurin nga çdo lloj dënimi⁵¹.

⁵¹ Neni 11 i K. Penal të Kosovës, neni 9 i K. Penal të Malit të Zi, neni 7 i K. Penal të Maqedonisë dhe nenet 13/b, 308/3 apo 377(1) dhe 387 të K. Penal grek.

Megjithëse këto vende të rajonit të trajtuara më lart parashikojnë formalisht një rregullim të kënaqshëm të alternativave të dënimit me burgim, aplikimi i tij në praktikë ka qenë i pamjaftueshëm, duke u përballur me probleme të mbipopullimit të burgjeve. Greqia ka prej vitesh një shkallë të lartë të të burgosurve deri në 109/100.000 banorë dhe një mbingarkim deri në 147% të kapacitetit mbajtës të burgjeve (Lambropoulou, 2008: 392). Mali i Zi në vitin 2011 raportohet se kishte një normë prej 214 të dënuarish për 100.000 banorë, ndërsa Maqedonia 122/100.000 banorë, të shoqëruara me probleme dhe kritika për kushtet e të burgosurve. Në ndryshim nga këto tre vende, për shkak të një sistemi sanksionator më të butë (si në pjesën e përgjithshme ashtu dhe atë të posaçme të K. Penal) dhe një aplikim më të kufizuar në praktikë të burgimit, Kosova ka një normë të ulët të popullimit të burgjeve, të krahasueshme me vendet nordike që varion nga 49-79 të burgosur/100.000 banorë.

2.3. Sistemi i dënimeve sipas kodit penal shqiptar

Kodi i ri penal shqiptar i parashikon dënimet në kreun V të tij, nga neni 29 deri në nenin 46. Kodi i ri ka ruajtur një pjesë të strukturës së sistemit të sanksioneve penale të kodit të vitit 1977, duke përfshirë brenda kreut të dënimeve edhe masat ndaj personave të papërgjegjshëm dhe të miturve. Nga ana tjetër, në kodin e ri janë kaluar në një kre më vete alternativat e dënimit me burgim. Nga pikëpamja strukturore (në dijeninë tonë), ky sistem dënimesh nuk ngjason me ndonjë sistem tjetër dënimesh të vendeve të Evropës Perëndimore dhe siç do të trajtohet në vijim të këtij punimi, nuk gjen një justifikim të mjaftueshëm shkencor. Megjithatë, në respekt të vlerës së tij ligjore (për sa kohë do të jetë në fuqi), kjo strukturë e K. Penal do të shërbejë si udhëzues strukturor në këtë punim. Kështu fillimisht, më poshtë do të trajtojmë sistemin e dënimeve penale që gjykata mund të caktojë ndaj personave të përgjegjshëm penalisht dhe masat mjekësore dhe edukative të cilat caktohen ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të sëmundjes mendore, apo mospasjes së moshës minimale të përgjegjësisë penale. Në respekt të kësaj strukture aktuale, alternativat e dënimit me burgim do të trajtohen në një kre më vete.

K. Penal shqiptar ka ruajtur ndarjen e veprave penale në dy kategori, në krime dhe në kundërvajtje penale. Megjithëse siç u trajtua më lart, plot legjislacione të tjera nuk i ndajnë fare veprat penale në kategori, ndarja më së shumti ndihmon në formulimin dhe detajimin e instituteve të ndryshme të së drejtës penale, duke marrë në konsideratë ndarjen e veprave në bazë të rrezikshmërisë së tyre shoqërore. Kjo ndarje gjen zbatim në institute si tentativa, caktimi i dënimit për të miturit, lirimi para kohe me kusht, amnistia etj. Sa i takon dënimeve, K. Penal i ka ndarë ato në dënime kryesore dhe në dënime plotësuese. Dallimi i veprave penale në krime dhe në kundërvajtje penale i sanksionuar në nenin 1 të K. Penal është vijuar edhe në ndarjen e dënimeve kryesore për krime dhe për kundërvajtje penale.

2.3.1. Dënimet kryesore

Dënimet kryesore janë ato dënime të cilat përbëjnë thelbin e sistemit sanksionator penal dhe historikisht kanë zënë pjesën më të madhe të dënimeve të caktuara nga gjykatat. Si rrjedhojë e pozitës së tyre qendrore në tërësinë e dënimeve penale, caktimi i një dënimi kryesor është një rregull i cili duhet të shoqërojë çdo vendim penal fajësie. Autorë shqiptarë (Elezi, et al, 2006: 203) i konsiderojnë dënimet kryesore si dënime të cilat jepen më vete ndaj personave fajtorë, pavarësisht nëse jepen dënime të tjera apo jo. Ky qëndrim teorik është mbështetur edhe nga GJK e cila me vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 shprehet se në llojin e dënimeve kryesore, bëjnë pjesë ato vendime të cilat mund të jepen nga gjykatat e zakonshme më vete. Siç do të trajtohet më poshtë, me ndryshimet e vazhdueshme të K. Penal ky rregull gjithsesi ka njohur përjashtime substanciale dhe me shtimin dhe diversifikimin e sistemit sanksionator, roli i dënimeve kryesore do të vijë gjithnjë e më shumë duke humbur nga pozita e tyre dominante. Ajo që ka një rëndësi të dorës së parë është se në respektim të parimit të ligjshmërisë të mishëruar në nenit 2 të K. Penal, askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj. Nga ky parim kushtetues, buron detyrimi për parashikimin shprehimisht të dënimit kryesor në dispozitën e pjesës së posaçme të K. Penal (Milla, 2008: 22).

Neni 29 i K. Penal është dispozita e parë e kreut të dënimeve dhe parashikon dënimet kryesore. Ajo është formuluar si më poshtë:

"Për personat që kryejnë krime jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim të përjetshëm
2. Me burgim
3. Me gjobë

Për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim
2. Me gjobë

*Dënimi me burgim dhe gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi"*⁵².

Ndonëse vërehet një strukturë e njëjtë e sistemit të dënimeve, krahasuar me K. Penal të vitit 1977, në kodin e ri penal nuk parashikohen më dënime kryesore si riedukimi nëpërmjet punës dhe qortimi shoqëror. Fillimisht me miratimin e tij, neni 29 parashikonte si dënim kryesor për krime edhe dënimin me vdekje. Dënimi kapital parashihej si një dënim alternativ i dënimit me burgim të përjetshëm (Elezi, 1997) dhe është shfuqizuar me vendimin nr. 65 datë 10.12.1999 të GJK.

⁵² Shtuar paragrafi i fundit me nenin 2 të ligjit nr. 9086, datë 19.6.2003 dhe shfuqizuar me vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të GJK.

2.3.1.1. *Dënimi me vdekje*

Megjithëse prej 16 vitesh dënimi me vdekje është shfuqizuar nga legjislacioni penal shqiptar, vlerësojmë se për shkak të historikut të aplikimit të tij në vendin tonë, të natyrës së tij veçanërisht të ashpër si sanksion ekstrem dhe të disa reminishencave të herëpashershme masive pro tij, meriton një trajtim të veçantë në këtë punim.

Dënimi me vdekje ka qenë një dënim i cili ka shoqëruar të gjithë historikun e legjislacionit penal modern shqiptar. Ai është parashikuar si dënim kryesor që në K. Penal të Zogut të vitit 1927⁵³, më tej në K. Penal komunist të vitit 1952⁵⁴ ashtu edhe në atë të vitit 1977 dhe është zbatuar gjerësisht gjatë gjithë sistemit komunist (Elezi, 1999: 186). Me ndryshimet që iu bënë K. Penal me ligjin nr. 7769, datë 16.11.1993, dënimi me vdekje u shfuqizua për disa krime me natyrë politike (nenet 51, 52, 58, 60-a, 62 dhe 101 paragrafi i dytë). Megjithëse me miratimin e kodit të ri penal, numri i veprave të cilat parashikonin këtë dënim u reduktua, në pjesën e posaçme të tij ai u parashikua përsëri si dënim alternativ i dënimit me burgim të përjetshëm në 13 figura krimesh. Në vitet 1990-1999 ka pasur një numër të konsiderueshëm personash të dënuar me vdekje, shumica e të cilëve u dënuan pas trazirave të vitit 1996-1998, por pas presioneve të KE, në prag të anëtarësimit në këtë organizëm (në Qershor 1995), qeveria jonë mori angazhim për të pezulluar për tre vjet ekzekutimin e tij. Dënimi i fundit me vdekje në Shqipëri është ekzekutuar me varjen në litar të dy vëllezërve nga Libofsha e Fierit, ekzekutim i cili ka vazhduar të nxisë debatin mes mbështetësve dhe kundërshtarëve të këtij dënimi, nga njëra anë për shkak të makabritetit të krimit të kryer prej tyre dhe nga ana tjetër për shkak të procedurës së gjykimit dhe ekzekutimit të tyre publik⁵⁵.

Megjithëse pas trazirave të vitit 1997-1998 debati publik mbi dënimin me vdekje u rigjallërua duke u shtuar thirrjet për rifillimin e ekzekutimeve të dënimeve të caktuara nga gjykatat (Nikolli, 2003: 21), në Kushtetutën e re të Republikës u sanksionua (në nenin 21 të saj) parimi se: "*Jeta e njeriut mbrohet me ligj*". Më tej mbi kërkesën e GJL, GJK me vendimin nr. 65, datë 10.12.1999 e deklaroi dënimin me vdekje në kohë paqeje si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke e shfuqizuar nga K. Penal civil dhe ai ushtarak. GJK e interpretoi nenin 21 të Kushtetutës në lidhje të ngushtë me KEDNJ dhe me angazhimin e Shqipërisë për të ratifikuar protokollet nr. 1, 4, 7 dhe 11 brenda një viti dhe të nënshkruante, ratifikonte dhe zbatonte protokollin nr. 6 brenda një

⁵³ Miratuar me dekretin nr. 83-1 datë 28.05.1927, hyrë në fuqi me 1 janar 1928.

⁵⁴ Miratuar me ligjin nr. 1470, datë 23.05.1952, hyrë në fuqi me 01.09.1952.

⁵⁵ Të pandehurit (vëllezër) Josif dhe Dritëbardh Çuko nga fshati Libofshë i Fierit u shpallën fajtorë për vrasje të pesëfishtë në atë që u quajt "Masakra e Libofshës". Ngjarja ndodhi në 29 maj të vitit 1992 në fshatin Libofshë kur dy vëllezërit hynë në mesnatë në banesën e familjes Puto dhe qëllojnë grabitjen e tyre dhe vranë djalin e vogël të shtëpisë së bashku me nusen e tij, babain, nënën dhe në fund vranë mbesën 8 muajshe të familjes. Pas një gjyqi rekord të përshpejtuar prej vetëm 24 ditësh, të dy vëllezërit u shpallën fajtorë dhe u dënuan me vdekje, ekzekutim i cili u krye me varje në mes të qytetit të Fierit me 25 qershor 1992 dhe trupat u lanë të varur deri mbrëmjen tjetër për t'u parë nga turma njerëzish që erdhën edhe nga qytetet e tjera. Ky dënim u kundërshtua fort nga organizmat ndërkombëtarë, por gjeti mbështetje në opinionin vendas. (forumishqiptar.com, 2012).

afati prej tre vjetësh nga koha e pranimet në KE. Po ashtu në marrjen e këtij vendimi GJK mbështetet edhe në pikën 2 të nenit 17 të Kushtetutës ku thuhet se kufizimet që parashikohen në pikën 1, nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Në respektim të këtij vendimi, me ligjin nr. 8733 datë 24.01.2001, (neni 79) Kuvendi shfuqizoi dënimin me vdekje nga të gjitha dispozitat e pjesës së posaçme të K. Penal.

Megjithëse dënimi kapital është shfuqizuar, fatkeqësisht opinionin publik ka vazhduar të jetë në dominancë pro tij. Megjithëse për matjen e mbështetjes së tij nuk ka studime të mirëfillta shkencore, nga një kërkim i shpejtë i forumeve të shumta online dhe mediave elektronike rezulton se ai gëzon akoma një mbështetje dominuese. Nga një sondazh online i zhvilluar nga emisioni “Opinion”, 83,67 % e votuesve mbështesnin dënimin me vdekje të një pedofili i cili dyshohej se kishte përdhunuar dhe vrarë një të mitur⁵⁶, 15,67 mbështesnin dënimin me burgim të përjetshëm dhe vetëm 0,65% mbështesnin dënimin me 25 vite burgim (TV Klan, 2013). Rivendosja e dënimit kapital nuk mbështetet vetëm nga njerëz të thjeshtë, me mangësi kulturore në çështjet ligjore dhe ato të luftës ndaj kriminalitetit, por edhe nga subjekte politike⁵⁷ dhe individë me profil publik⁵⁸.

Në vlerësimin tonë ky qëndrim dominues publik ndaj dënimit me vdekje, duhet marrë seriozisht jo si shenjë e mungesës së demokracisë, por si një kampion alarmi për nivelin e lartë të dhunës dhe të emocioneve negative që promovohen në median shqiptare. Mbështetja e gjerë ndaj zgjidhjeve të dhunshme (pjesë e së cilës është padyshim dënimi me vdekje), nuk mund të ndihmojë për zgjidhjen e sfidave të shumta të shoqërisë sonë (një prej të cilave është dhe kriminaliteti i dhunshëm). Dënimi me vdekje nga shteti është një çështje që i përket së shkuarës, por nga ana tjetër, edukimi i mbarë shoqërisë me frymën e humanizmit, tolerancës dhe arsyes është një çështje që i përket së tashmes dhe së ardhmes. Siç u trajtua më lart shumica e vendeve të botës e kanë shfuqizuar formalisht apo në praktikë zbatimin e dënimit me vdekje dhe numri i vendeve dhe popujve që e aplikojnë po ulet çdo vit e më tepër. Ballafaqimi me argumente pro heqjes së dënimit me vdekje me ato pro zbatimit të tij, është përballja me shkencën dhe populizmit, me arsyes dhe emocioneve negative, me humanizmit dhe barbarisë.

2.3.1.2. Dënimi me burgim të përjetshëm.

Siç përcaktohet nga Penal Reform International (2011: 8), dënimi me burgim të përjetshëm mund të aplikohet në një nga tre format e mëposhtme:

⁵⁶ Për të cilin më pas rezultoi se nuk e kishte kryer.

⁵⁷ Partia Lëvizja e Legalitetit, e ka pjesë të programit të saj politik rivendosjen dhe ekzekutimin e dënimit me vdekje dhe ka kërkuar kryerjen e një referendumi për këtë çështje.

⁵⁸ Publicisti dhe analisti Artur Zheji, në një shkrim me titull “Të rikthejmë dënimin me vdekje?”, botuar në gazetën Mapo me 6 Shkurt 2012 mbështeste hapur rivendosjen e këtij dënimi.

1. Dënim i gjatë për një numër të caktuar vitesh, pas kalimit të të cilave i dënuari lirohet pa ndonjë kufizim tjetër.
2. Dënim për një minimum vitesh në burg, pas vuajtjes të së cilave i dënuari mund të konsiderohet për t'u liruar.
3. Burgosje deri në vdekje (natyrore), pa mundësi lirimi ose/dhe me mundësi teorike lirimi nga një falje.

Legjislacioni shqiptar ka adaptuar një qasje shumë të ashpër për dënimin me burgim të përjetshëm, duke zgjedhur në tre variantet e mësipërme një kombinim mes tipit të dytë dhe të tretë. Sipas neneve 29 dhe 33 të K. Penal personi i dënuar me burgim të përjetshëm qëndron në burg deri në vdekjen e tij. Sipas nenit dhe 65 të K. Penal, vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim dhe, kur gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Përsëri edhe kjo mundësi e largët kufizohet nga neni 64/3, i cili ndalon lirimin para kohe me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe 5 vepra të rënda penale, duke e bërë praktikisht në këtë mënyrë dënimin me burgim të përjetshëm një dënim i cili në çdo rast përfundon me vdekjen e të dënuarit në burg.

Në aspektin komparativ, duhet të kemi parasysh se dy vende ballkanike: Kroacia dhe Sllovenia dhe tre vende të tjera evropiane: Norvegjia, Portugalia dhe Spanja nuk parashikojnë fare burgim të përjetshëm, ndërkohë që vetëm në pak të tjera të cilët e parashikojnë këtë dënim, ai nënkupton kalimin e të gjithë jetës në burg (Appleton & Groverf, 2007: 601).

Shqetësimi për ashpërsinë e dënimit me burgim të përjetshëm në legjislacionin shqiptar, nuk vjen vetëm nga arsye dhe motive humane, por edhe mbi arsye shkencore kriminologjike dhe penalogjike. Ndonëse të dënuarit me burgim të përjetshëm në Shqipëri janë vetëm rreth 0.13% në vit, në maj 2015 numri i total i tyre në burgjet shqiptare ishte 155 vetë apo 5.4% e totalit të të dënuarve (DPB, 2015). Po të ndiqet trendi prej 10-12 të dënuarish me burgim të përjetshëm që shtohen çdo vit, kjo kategori të burgosurish do të zërë në pak vite mbi 10% të totalit të të burgosurve. Dënimi me burgim të përjetshëm është një alternativë humane e dënimit me vdekje për të pandehur të rrezikshëm, autorë të veprave të rënda penale, por parashikimi i këtij sanksioni të rëndë edhe për vepra të kryera me pakujdesi, si nenet 110/a §5, apo 298 §3 është kritikuar nga disa autorë të së drejtës penale (Elezi, 2005: 61; Abdiu, 2012: 72).

Po ashtu vlerësojmë se sanksionimi në K. Penal i përfundimit të këtij dënimi me vdekjen në burg të të dënuarit, është në kundërshtim me qëllimet e dënimit penal dhe nga ana tjetër përbën një zgjedhje të gabuar përveç aspektit human, edhe në atë ekonomik dhe social. Mbajtja në institucionet penitensiare e të dënuarve me burgim të përjetshëm të cilët për shkak të moshës së thyer dhe/apo gjendjes së rënduar shëndetësore nuk paraqesin asnjë rrezikshmëri shoqërore, sjell

një ngritje të konsiderueshme të kostove për trajtimin e tyre në këto institucione. Duhet të kujtojmë këtu se Shqipëria është dënuar nga GJEDNJ për shkelje të nenit 3 të Konventës në rastin Gori kundër Shqipërisë (Aplikimi nr. 25336/04)⁵⁹, pasi ankuesi vuante nga multiskleroza dhe sipas gjykatës, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në nenin 3 të konventës.

2.3.1.3. Dënimi me burgim

Në kodin e ri penal, dënimi “me burgim” ka zëvendësuar terminologjinë “heqje lirie”, pasi në legjislacionin pozitiv shqiptar termi “heqje lirie” është më i gjerë sesa termi “burgim”. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 27/2 përmenden rastet e heqjes së lirisë një personi, ku dënimi me burgim është vetëm një nga rastet e heqjes së lirisë (pika a).

Neni 32 i K. Penal parashikonte fillimisht se dënimi me burgim për krime jepej për një kohë nga 5 ditë deri në 25 vjet, ndërsa për kundërvajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga 5 ditë deri në 2 vjet. Me ndryshimet e K. Penal të vitit 2013⁶⁰, maksimumi i dënimit me burgim për krimet pësoi një rritje të madhe, duke ndryshuar nga 25 në 35 vite burgim. Vuajtja e dënimit me burgim (duke përfshirë edhe dënimin me burgim të përjetshëm) bëhet në institucione të caktuara posaçërisht, mbështetur në kriteret e ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i ndryshuar). Në bazë të këtij ligji burgjet në vendin tonë ndahen në burgje të sigurisë së lartë, burgje të sigurisë së mesme, burgje të sigurisë së ulët dhe institute të veçanta. Të miturit dhe femrat e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga meshkujt e rritur. Megjithatë formalisht sipas nenit 9 të ligjit⁶¹, të dënuarit me burgim trajtohen dhe përgatiten për t'u rehabilituar dhe riintegruar në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, realizimi në praktikë i kësaj detyre mund të arrihet vetëm me krijimin e disa kushteve nëpër entet e vuajtjes së dënimit me burgim. Përdorimi i burgimit vetëm për “izolim” e të dënuarit nga shoqëria⁶², jo vetëm që nuk krijon asnjë premisë për riedukim dhe përmirësim (Travis & Waul, 2004: 33), por shkakton një dëmtim të rëndë psikologjik të tij, duke kontribuar në rritjen e predispozicionit të tij kriminal (Soering, 2004).

⁵⁹ Vendimi i GJEDNJ Gori kundër Shqipërisë (Aplikimi nr. 25336/04), datë 7 korrik 2009.

⁶⁰ Të pësuara me ligjin nr. 144/2013, datë 02.05.2013.

⁶¹ I ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

⁶² Sipas raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 konstatohet se për shkak të zbatimit formal të standarteve të trajtimit të të burgosurve (2015: 30), burgjet në vendin tonë janë vetëm një vend izolimi dhe nuk luajnë asnjë rol edukues dhe rehabilitues ndaj të burgosurve.

Dënimi me burgim është dënimi më i rëndë pas dënimit me burgim të përjetshëm, pasi ky dënim i kufizon personit një të drejtë themelore si ajo e lëvizjes. Ky dënim zë vend parësor në sistemin e sanksioneve penale shqiptare pasi parashikohet si dënim i alternativ me gjobën në 186 dispozita apo 55.7 % të tyre (vetëm 8 dispozita parashikojnë vetëm dënim me gjobë) dhe në 140 të tjera apo 42% parashikohet si dënim i vetëm ose së bashku me dënimin me burgim të përjetshëm (nga 334 nene të pjesës së posaçme të cilat parashikojnë figura veprash penale). Pesha e tij dominuese në opinionin publik shkon deri aty sa “burgimi” të konsiderohet gjerësisht nga shoqëria shqiptare si sinonim i fjalës “dënim penal”. Ky status i privilegjuar i tij në sistemin sanksionator shqiptar përforcohet edhe nga kreu VII i pjesës së përgjithshme, i cili në vend që të quhej “Dënimet alternative”, apo “Dënimet komunitare”, quhet “Alternativat e dënimit me burgim”.

Dënimi me burgim aktualisht parashikohet si dënim i vetëm jo vetëm për krime me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si: vrasjet, tortura, krimet seksuale, rrëmbimet, krimet kundër rendit kushtetues dhe sigurisë kombëtare etj., por edhe për vepra jo të dhunshme të drejtuara kundër pasurisë, si: “Vjedhja” (neni 134/2), “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën” (neni 135), “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” (neni 137), “Falsifikimi i monedhave” (neni 183), falsifikimet e ndryshme të dokumenteve (nenet 186-191), apo vepra të tjera jo shumë të rënda, si: “Shtytja e të miturve në krim” (neni 129), “Ndërtimi i paligjshëm” (neni 199/a), “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/b), “Mbajtja e lëndëve narkotike për përdorim personal” (neni 283), “Mbajtja e armëve të ftohta në vende publike” (neni 279/2), “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (neni 291) etj.


2.3.1.4. Mbipopullimi i burgjeve në Shqipëri

Megjithëse dënimi me burgim ka edhe shumë efekte të tjera negative në jetën e të dënuarve dhe familjarëve të tyre, një efekt i drejtpërdrejtë i zbatimit të tepruar të tij është mbipopullimi i burgjeve. Në vitin 1995 në Shqipëri kishte vetëm 7 institucione të vuajtjes së dënimit me një kapacitet maksimal prej 1200 të dënuarish apo vetëm 36 të burgosur/100.000 banorë (Council of Europe, 1999: 182). Më tej, vit pas viti kapaciteti pritës i të burgosurve u rrit me ndërtimin e burgjeve të reja dhe me hapjen e paraburgimit të ri në Elbasan në tetor 2012, kapaciteti i IEVP shkoi në 4537 të dënuar (DPB, 2012). Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 22 institucione burgimi dhe paraburgimi dhe janë në pritje për t’u vënë në efikasitet burgu i ri i Beratit dhe ai i Fierit, ndërkohë që është në ndërtim edhe një tjetër burg në Shkodër (Naço, 2014). Ndërtimi i këtyre institucioneve të reja megjithëse ka ndihmuar të lehtësojë situatën e mbipopullimit të institucioneve penitensiare, ajo nuk e ka zgjidhur atë pasi numri i të burgosurve është rritur në një shkallë më të madhe se rritja e kapaciteteve të burgjeve. Burgjet e reja të cilat planifikohen të hapen në muajt apo vitet në vijim nuk arrijnë të zëvendësojnë burgjet e vjetra të cilat tashmë janë jashtë standardeve normale të akomodimit. Ndër kërkesat imediate për mbyllje sipas kërkesës së

Avokatit të Popullit dhe Komitetit të Parandalimit të Torturës (CPT), janë burgu 313 dhe burgu i Burrelit (Totozani, 2014). Ndërsa Shqipëria ka çdo vit kërkesa imediate për burgje të reja, drejtori i burgjeve dhe shërbimit të provës suedeze, Nils Oberg, lajmëroi në nëntor 2013 se katër burgje të këtij vendi do mbylleshin si rezultat i një ulje të pazakontë të numrit të të burgosurve (2013).

Numri i të burgosurve për 100.000 banorë në Shqipëri ka ardhur duke u rritur që me miratimin e kodit të ri penal e në vijim. Në vitin 1995 Shqipëria kishte një shkallë prej 36 të burgosur për 100.000 banorë (Council of Europe, 2003: 196), ndërkohë që prej një viti ka tejkaluar 200 të burgosur (gjashtëfishuar). Më poshtë po paraqesim trendin e shkallës së burgosjes në Shqipëri nga viti 2000 deri në muajin maj 2015 në Shqipëri.

Grafiku nr. 1. Dinamika e shkallës së burgosjes në Shqipëri



Burimi: ICPS (World prison population list) dhe DPB.

Megjithëse në raportet e KE dhe të ICPS referohet për një shkallë më të ulët të burgosurish në vendin tonë⁶³, vlerësojmë me vend të saktësojmë se shkalla e paraqitur në këtë tabelë është më e saktë pasi mban në konsideratë popullsinë rezidente në Shqipëri (të deklaruar nga INSTAT) dhe jo popullsinë e regjistruar në gjendjen civile.

Shkaqet e mbipopullimit të burgjeve në vendin tonë janë disa, por ato mund të përmbledhen në ashpërsimin e politikës penale si në drejtim të shtimit të veprave të reja penale ashtu dhe në rëndimin e shumicës së sanksioneve për veprat ekzistuese (Nikolli, 2015c). Kjo frymë pro burgimit si rezultat i ashpërsimit të sanksioneve penale është reflektuar drejtpërdrejtë edhe në rritjen e numrit të të paraburgosurve. Nga studimi i 16 ndryshimeve ligjore të kryera në K. Penal vërehet se në pjesën e tyre më të madhe ato kanë ashpërsuar dënimet ekzistuese (Nikolli, 2015a: 306). Megjithëse prej një dekade Shqipëria është përballur me një mbipopullim të burgjeve, maxhorancat në pushtet kanë vijuar të mbështesin politika të ashpra dhe represive pro burgimit,

⁶³ Nga viti 2007 në këto buletine referohet për një shkallë rreth 15% më të ulët të burgosjes sesa shkalla e referuar nga ana jonë në grafikun nr. 1.

duke i konsideruar ato si zgjidhje të zgjuara për të luftuar kriminalitetin (Kuvendi, 2013a; Këshilli i Ministrave, 2014).

Në vitet e fundit është vërejtur një tendencë e legjislatorit për ta zgjidhur çështjen e mbipopullimit të burgjeve përmes amnistive. Kështu si rezultat i përfitimit nga ligji mbi amnistinë e muajit prill 2014⁶⁴ vihet re se numri i personave të dënuar është ulur me së paku 602 vetë, apo 19%, mirëpo përsëri edhe pas aplikimit të saj, burgjet shqiptare kanë qenë mbi kapacitetin normal. Po ashtu situata e mbipopullimit të burgjeve nuk është zgjidhur as nga amnistia e vitit 2012⁶⁵ ku numri i personave të kufizuar liria ka qenë ndjeshëm më i ulët. Megjithatë amnistitë kanë kontribuar ndjeshëm në uljen e numrit të të dënuarve në këto institucione, ato e kanë të pamundur të zgjidhin në afat të gjatë çështjen e mbipopullimit të burgjeve. Për më tepër që amnistitë janë të kritikueshme, pasi përbëjnë një zgjidhje të sforcuar dhe nuk afrojnë mundësitë e aplikimit të saj individual sipas rrethanave personale të të dënuarve apo rrethanave të kryerjes së veprave penale. Për shkak të mbipopullimit të burgjeve, në vitin 2014 Italia u gjet nga GJEDNJ me shkelje të nenit 3 të konventës⁶⁶ dhe mbi këtë rast i ka dhënë këtij vendi një vit afat për të zgjidhur situatën e mbipopullimit të burgjeve dhe për të shpërblyer viktimat. Shqipëria ka një normë mbi dy herë më të lartë të të burgosurve sesa Italia dhe padyshim ofron standarde më të ulëta të trajtimit të tyre në institucionet korrektuese, prandaj nëse shteti shqiptar nuk ndërmerr masa të shpejta dhe efektive për të ulur numrin e të burgosurve dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të tyre, probabiliteti i dënimit edhe të Shqipërisë nga GJEDNJ është shumë i lartë në rast eventual të ankimit pranë saj të ndonjë të dënuari me burgim.

2.3.1.5 Dënimi me gjobë

Në nenin 29 të K. Penal të Republikës së Shqipërisë dënimi me gjobë parashikohet si një nga dënimet kryesore për krimet dhe për kundërvajtjet penale. Dënimi me gjobë parashikohet aktualisht në K. Penal shqiptar si dënim i vetëm apo alternativ i dënimit me burgim në 194 nene të pjesës së posaçme të tij.

Prej disa vitesh Shqipëria po përballlet me një rëndim të situatës së mbipopullimit të burgjeve, e nxitur kjo nga një politikë e ashpër penale dhe nga një frymë politike dhe mediatike pro burgimit (Nikolli, 2015: 32). Kjo situatë ka bërë më imediate çështjen e eksplorimit të alternativave më moderne të burgimit, të cilat jo vetëm na afrojnë me standardet evropiane, por përbëjnë dhe një zgjidhje më të zgjuar për çështjet e mbipopullimit të burgjeve, të uljes së kostove ekonomike dhe njerëzore, dhe pse jo edhe për një proces më të suksesshëm rehabilitues të personave të dënuar.

⁶⁴ Në zbatim të ligjit nr. 22/2014 datë, 10.3.2014 “Për dhënie amnistie”.

⁶⁵ Në zbatim të ligjit nr. 107, datë 08.11.2012 “Për dhënie amnistie”.

⁶⁶ Çështja Torreggiani dhe të tjerë kundër Italisë, vendimi i datës 08.01.2013 mbi aplikimet nr. 43517/09, 46882/09, 55400/09, 57875/09, 61535/09, 35315/10 e 37818/10.

Një prej këtyre alternativave të cilat në mjaft vende kanë rezultuar të suksesshme është dhe sigurimi i një hapësire më të gjerë të aplikimit të dënimit me gjobë.

Sipas nenit 29 të K. Penal, dënimi me gjobë dhe ai me burgim janë dy dënimet kryesore të parashikuara si për krimet ashtu edhe për kundërvajtjet penale. Me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, në nenin 29 të K. Penal Kuvendi shtoi paragrafin e tretë, duke parashikuar se dënimi me burgim dhe gjobë mund të caktohen edhe bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij kodi. Ky ishte një përjashtim nga rregulli tradicional dhe që karakterizonte vetë dënimet kryesore, pra caktimi vetëm i një dënimi kryesor për një vepër penale të kryer (Muçi, 2012: 270). Pas shtimit të këtij paragrafi, këto ndryshime parimore u reflektuan edhe në pjesën e posaçme të K. Penal, ku në një numër dispozitash penale dënimi me gjobë u parashikua të jepej nga gjykata krahas dënimit burgim⁶⁷.

Pas kërkesës së GJA Vlorë për kontroll incidental të paragrafit të tretë të nenit 29, GJK me vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 e ka pranuar këtë kërkesë, duke e shfuqizuar këtë dispozitë si në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës. Në arsyetimin e saj GJK shprehet se parashikimi *a priori* njëkohësisht i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla, si: falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit, e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim. Shfuqizimi nga GJK i paragrafit të tretë të nenit 29 dhe të dënimit me gjobë në nenet 190 dhe 191 të pjesës së posaçme të K. Penal, u pasua me shfuqizimin në 44 nene të pjesës që parashikon si dënim kryesor edhe dënimin me gjobë, krahas dënimit me burgim⁶⁸.

Dispozita kryesore e K. Penal e cila detajon dënimin me gjobë dhe mënyrën e ekzekutimit të tij është neni 34 i tij. Kjo është një dispozitë e gjatë përshkruese, e cila ka pësuar ndryshime të shumta që nga viti 1995 dhe aktualisht është e përbërë nga 13 paragrafë. Dënimi me gjobë konsiston në pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit që aktualisht për kryerjen e një krimi varion nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë, ndërsa për kryerjen e një kundërvajtje penale, nga 50 mijë gjer në 3 milionë lekë. Në reflektim të vendimit nr. 47, datë 26.07.2012 të GJK, caktimi i dënimit me gjobë krahas dënimit me burgim u kufizua edhe për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi

⁶⁷ Pas disa ndryshimeve ligjore, në vitin 2012 numri i dispozitave penale të pjesës së posaçme që i parashikonin njëkohësisht të dy llojet e dënimeve kryesore arriti në 49 nene.

⁶⁸ Nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 124/a, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 197/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331, (por duke harruar pa kryer të njëjtat ndryshime edhe në nenet 114/b, 124/b dhe 206/a të K. Penal, në të cilat përsëri aktualisht janë fuqi caktimi i dy dënimeve kryesore).

të pasurive. Sipas formulimit që paragrafi i pestë i nenit 34 mori pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013, për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe vetëm në mungesë të tyre, vendos dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.

Një ndryshim po ashtu interesant i kësaj dispozite është sanksionimi i detyrimit të gjykatës që të hetojë rreth aftësisë paguese të personit përpara se të caktojë dënimin me gjobë. Aftësia paguese sipas këtij rregullimi përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to. Megjithëse ky paragraf vlerësohet si inovativ dhe i arsyeshëm nga aspekti i dhënies së një vendimi të bazuar gjyqësor, ai nxjerr në pah disa probleme procedurale që kanë të bëjnë me pozicionin pasiv të gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, me cenimin e paanësisë së saj në rast të kalimit të saj të përhershëm në një rol aktiv dhe së fundmi në shtyrjen e gjyqeve penale për të hetuar rrethana të tilla. Një zgjidhje në harmoni me këtë rregullim do të ishte caktimi i dënitimit në një fazë të dytë, pas shpalljes së vendimit në lidhje me fajësinë⁶⁹. Po ashtu, në ndryshim nga legjislacione të tjera penale bashkohore, neni 34 nuk e lidh gjendjen pasurore dhe financiare të të pandehurit me masën e gjobës që do të caktojë gjykata, por vetëm me aftësinë për ta paguar apo jo masën e gjobës që gjykata vlerëson se duhet të caktojë. Ky qëndrim i mbajtur edhe nga Shfaqet Muçi (2012: 270), mbështetet në frymën dhe në germën e nenit 34 dhe 47 të K. Penal⁷⁰. Një problem i madh praktik i implementimit të dënitimit me gjobë dhe prej saj, i humbjes së efektit ndëshkues, parandalues dhe edukues të këtij lloj dënimi, ka qenë ekzekutimi i tij. Përveç elementëve objektivë siç është pamundësia paguese e të dënuarit, kjo inefiçensë është nxitur edhe nga hapësirat ligjore, të metat e shërbimit përmbartimor dhe një mungesë zhdërvjelltësie në ndjekjen në një kohë të shkurtër të këtyre procedurave nga prokuroria dhe gjykata. Një rol tejet negativ në kulturën e mosekzekutimit të gjobave penale ka luajtur edhe shpeshësia e nxjerrjes së ligjeve amnistuese, të cilat kanë falur pjesën më të madhe të gjobave të caktuara nga gjykatat. Në një hapësirë prej 30 muajsh Kuvendi ka miratuar tre ligje për amnisti penale (ligjet nr. 107/2012, nr. 22/2014 dhe nr. 92/2015).

Pjesë e ngërçit ligjor në ekzekutimin e gjobave penale ka qenë dhe vendimi i GJK nr. 19, datë 01.06.2011, i cili ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën, paragrafin 8 të nenit 34 të K. Penal, i cili parashikonte zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur 5 mijë lekë për një ditë burgim, në rastin kur gjoba e caktuar nga gjykata nuk paguhej në afatin e caktuar. Në këtë

⁶⁹ Sipas modelit të ndryshimeve të bëra në K. Penal francez në vitin 2014.

⁷⁰ Ky paragraf parashikon se: “Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit”, por nuk shprehet se gjykata cakton masën e gjobës mbi bazën e aftësive paguese të tij. Megjithatë, duhet përmendur se autorë të tjerë të së drejtës penale (Elezi et al, 2013: 236) janë të mendimit se në caktimin e masës së gjobës, gjykata duhet të mbajë në konsideratë edhe gjendjen ekonomike të të pandehurit (siç parashikon K. Penal italian).

vendim GJK arsyeton se konvertimi i dënimit me gjobë në dënimin me burgim është në përputhje me funksionin riedukativ të dënimit, në rastin kur i dënuari me vullnetin e tij të lirë refuzon t'i bindet vendimit gjyqësor që e detyron të paguajë gjobën. Në të kundërt, kur personi është në pamundësi objektive për të shlyer gjobën nisur nga kushtet ekonomike të të dënuarit (pra nuk varet nga ana subjektive e autorit), konvertimi i dënimit me gjobë në burgim, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar të shtetasve vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës.

Pas këtij vendimi me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012 u riformulua edhe ky paragraf duke parashikuar dy faza të ndjekjes së ekzekutimit të dënimit me gjobë. Sipas pikës 9 të këtij neni kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e saj, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

- a. shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;
- b. kryerjen e një pune me interes publik.

Nisur nga mënyra se si është formuluar kjo dispozitë dhe nisur nga arsyet që e kanë shtyrë legjislatorin në këtë riformulim, duket se gjykata është e detyruar që të vendosë sipas njërës prej alternativave të kërkuara nga vetë i dënuari. Ky rregullim parashikon se vetëm në fazën e dytë, pra nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, atëherë gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim. Ky parashikim i ri e ka zgjidhur në një masë të madhe çështjen e mosburgosjes së shtetasve për shkak të paaftësisë së tyre paguese, megjithëse përsëri në disa raste më të pakëta mund të ngrihen përsëri pretendime për antikushtetueshmëri të kësaj norme⁷¹.

Sa i takon politikës së aplikimit të dënimit me gjobë ajo është paraqitur inferiore në raport me dënimin me burgim dhe në dy vitet e fundit ka pësuar një ulje të mëtejshme. Gjatë vitit 2012 nga totali i të dënuarve për krime dhe kundërvajtje penale vetëm 3114 persona, apo 35.8% e tyre janë dënuar me gjobë, në vitin 2013 ky numër është ulur në 2357 të dënuar, apo 27.5 % e totalit, ndërsa në vitin 2014, megjithëse ky numër u rrit në 2694 persona, kjo shifër përbën vetëm 19.7% të totalit të të dënuarve për këtë vit (Ministria e Drejtësisë, 2013; 2014; 2015). Raporti i të dënuarve me gjobë për kundërvajtjet është shumë më i lartë se për krimet. Kështu në vitin 2012 rreth 77.2% e kundërvajtësve janë dënuar me gjobë, ndërkohë që për krimet janë dënuar me gjobë vetëm 21.5% e tyre. Në vitin 2013 të dënuarit me gjobë për kundërvajtje zënë 60 %, ndërsa për krime vetëm 14.8%, ndërsa në vitin 2014 gjoba për kundërvajtësit ka rënë në 28%, ndërsa për për krime në 12%. Nisur nga ashpërsimi i politikës penale për disa vepra penale me një frekuencë të lartë, për

⁷¹ Në rast se i pandehuri ka rënë në pamundësi financiare pas shtyrjes së afatit të pagimit të gjobës, apo nëse ai është në pamundësi fizike për të kryer punën në shërbim publik.

të cilat dënimi me gjobë është hequr (si vjedhja e energjisë elektrike, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, ndërtimet e paligjshme, apo falsifikimet) dhe nga një frymë e dukshme pro burgimit, pesha e dënimit me gjobë për vitin 2015 ka prirje të jetë akoma më e ulët. Megjithatë akoma për këtë periudhë nuk ka të dhëna statistikore kombëtare të Ministrisë së Drejtësisë, nga analiza vjetore e vitit 2014 e GJRRGJ Tiranë (2015: 23) vërehet se dënimi me gjobë për këtë vit zë vetëm 13.4% të totalit, ndërsa nga ajo e GJRRGJ Shkodër (2015: 21) është 17.7 %. Këto shifra e provojnë dukshëm se konstatimi i disa autorëve për daljen në plan të parë të dënimit me gjobë në vendin tonë (Elezi et al, 2013: 236) është i pambështetur.

Nga një vëzhgim i praktikës gjyqësore i kryer mbi aplikimin e dënimit me gjobë, vërehet një ndryshim i ndjeshëm i aplikimit të saj për vepra me rrezikshmëri të ngjashme (Nikolli, 2015d). Kështu për kundërvajtjet ndeshet një aplikim i dënimit me gjobë në 98 % të rasteve për nenin 197 të K. Penal, 68% për nenin 89 dhe vetëm 44 % për nenin 84 të K. Penal. Nga ana tjetër për kampionin e krimeve rezultoi se dënimi me gjobë është aplikuar vetëm 10 % për “Vjedhje” (nenin 134/1 të K. Penal), ndërkohë që për “Mashttrim” (neni 143/1), “Mashttrim në sigurime” (neni 145), apo “Shkatërrimi i pronës” (neni 150) është aplikuar në mbi 30 % të rasteve. Shpjegimi logjik i një diferencimi të tillë (për vepra të ngjashme me objekt grupor pasurinë) vështirësohet edhe më tej po të mbahet në konsideratë fakti se nga kampioni i vendimeve rezulton se vlera mesatare e pasurisë së humbur nga vjedhja është më e vogël se e pasurisë së humbur/dëmtuar nga tre veprat e tjera.

Më tej nga ky vëzhgim rezultoi se 39 % të të dënuarve me gjobë për kundërvajtje janë dënuar nga 50.000 deri në 100.000 lekë, ndërsa 65 % të të dënuarve për krime janë dënuar nga 100.000-200.000 lekë. Megjithatë në shumicën e rasteve të analizuara në kampion, masa e dënimit me gjobë është shumë më afër minimumit sesa maksimumit të parashikuar nga neni 34 i K. Penal, në mjaft raste ajo është e lartë në krahasim me nivelin ekonomik mesatar të shoqërisë shqiptare. Është e paarsyeshme që minimumi i dënimit me gjobë sipas legjislacionit shqiptar të jetë (sa mesatarja e pagës bruto mujore të një zyrtari)⁷² dhe në vlerë absolute disa herë më e lartë se i Greqisë, Italisë, Finlandës, Francës apo Gjermanisë për të cilët siç u përmend më lart varion nga 1 euro deri në maksimumin e të ardhurave ditore të të pandehurit. Ndryshimet e bëra në K. Penal me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 të cilat kanë dhjetëfishuar masat e dënimit me gjobë (si për krime ashtu edhe për kundërvajtje)⁷³ kanë qenë të pastudiuara dhe kanë ndikuar negativisht në frenimin e aplikimit të këtij dënimi. Dënimi me gjobë ashtu si edhe dënimi me burgim kanë për qëllim edukimin e fajtorëve dhe të komunitetit dhe jo rrënimin e tyre ekonomik.

⁷² Ndërkohë që sipas nenit 46 §2 të K. Penal të Federatës Ruse, minimumi i gjobës është rreth 44 euro ose sa paga e 15 ditëve punë e të pandehurit.

⁷³ Për personat që kryenin krime, marzhet e dënimit me gjobë kanë qenë nga 10 mijë deri në 2 milionë lekë, ndërsa për personat që kryenin kundërvajtje gjoba varionte nga 5 mijë deri në 200 mijë lekë.

Këto masa të cilat janë në fuqi kanë në diferencë të madhe jo vetëm me masat e dënimit me gjobë që parashikohen në K. Penal ushtarak⁷⁴, por vijnë në kontradiktë logjike edhe me minimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga neni 32 i K. Penal dhe konvertimin e tij në gjobë⁷⁵. Po ashtu masa e minimumit të gjobës ka një hendek logjik akoma më të dukshëm edhe me parashikimet e nenit 63 të K. Penal ku gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit me burgim duke detyruar kryerjen e një pune në interes publik për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë (pra nga 5 deri në 30 ditë pune). Këto diferenca të dukshme dhe mungesa e një diskrecioni më të gjerë të gjykatës për të përcaktuar masën e gjobës nisur nga mundësitë reale ekonomike të të pandehurit (sidomos për persona që kanë shumë më pak se 10.000 lekë të ardhura për frymë në muaj) nxisin nevojën e një rimendimi të marzheve të dënimit me gjobë dhe mënyrës së llogaritjes së saj.

Adaptimi i sistemit të gjobave ditore, megjithëse fillimisht mund të ndeshë në hezitime për shkak të një pabarazie formale mes të pandehurve, do të nxiste barazinë substanciale në trajtimin e të pandehurve dhe nga ana tjetër përmes një aplikimi më të gjerë të këtij lloji dënimi do të shërbente jo vetëm në uljen e mbipopullimit të burgjeve, uljen e kostove të sistemit të drejtësisë penale, por edhe në riedukimin dhe përmirësimin më të suksesshëm të personave të dënuar (sidomos ata me një rrezikshmëri të vogël shoqërore të cilët aktualisht vetëm për këtë shkak po dënohen panevojshmërisht me dënime të shkurtra me burgim). Gjambat ditore janë përqafuar nga shumica e legjislacioneve penale të vendeve të Evropës Perëndimore, ku shembulli gjerman është modeli më i mirë i suksesit të aplikimit konsistent të saj për një periudhë shumë të gjatë.

Për një politikë më të drejtë dhe të zgjuar penale, është e nevojshme ulja e minimumit të masës së dënimit me gjobë si dhe shtimi i neneve në pjesën e posaçme të K. Penal të cilat lejojnë konvertimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë (siç është aktualisht vetëm neni 291 i K. Penal). Vetëm ndërmarrja e këtyre ndryshimeve thelbësore në dënimin me gjobë, do ta kthente atë në dënimin dominues penal në vendin tonë.

2.3.2. Dënimet plotësuese.

Siç vërehet edhe nga paragrafi i parë i nenit 30 të K. Penal, dënimet plotësuese janë ato sanksione që mund të caktohen nga gjykata ndaj personave që kanë kryer krime apo kundërvajtje penale, së bashku me dënimin kryesor. Tipar themelor i dënimit plotësues është dhënia e tij si shoqërues apo plotësues i dënimit kryesor. Në ndryshim nga dënimi kryesor i cili duhet patjetër të jetë i parashikuar në dispozitën që parashikon figurën konkrete të veprës penale (Milla, 2008: 22), dënimet plotësuese nuk përmenden, por bazuar në nenin 30 jepen nga gjykata si shoqërues të

⁷⁴ Sipas nenit 9 të K. P. Ushtarak për personat që kryejnë krim, gjoba jepet nga 10 mijë deri në 2 milionë lekë, ndërsa për personat që kryejnë kundërvajtje gjoba jepet nga 5 mijë deri në 200 mijë lekë.

⁷⁵ Sipas nenit 32 dënimi me burgim fillon si për krimet dhe për kundërvajtjet me pesë ditë burgim të cilat sipas nenit 57 të K. Penal konvertohen në 25.000 lekë gjobë.

dënimet kryesor. Po ashtu, me përjashtim të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike dhe konfiskimit të mjeteve të kryerjes së veprës penale, të cilat janë të detyrueshme për t'u caktuar në disa raste, dënimet e tjera plotësuese kanë një natyrë diskrecionale dhe lihen në çmimin e gjykatës nëse duhet të caktohen apo jo.

Në ndryshim nga dënimet kryesore të cilët caktohen të vetëm⁷⁶, dënime plotësuese mund të jepen disa, p.sh. në rastin e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K. Penal, gjykata mund të caktojë krahas dënimit kryesor edhe dënimet plotësuese të konfiskimit të të hollave të përfituara në mënyrë të paligjshme dhe ndalimin e së drejtës për të ushtruar detyra si nëpunës shtetëror ose në shërbim publik. Tipar tjetër i dënimeve plotësuese është se këto lloj dënimesh nuk zbatohen në çdo rast, por vetëm për vepra apo të pandehur specifik me qëllim realizimin sa më të plotë dhe të suksesshëm të funksioneve të së drejtës penale (Muçi, 2012: 272). Këto dënime në ndryshim nga ç 'parashikohet për dënimet kryesore, nuk ndahen në dënime plotësuese për krime dhe dënime plotësuese për kundërvajtje penale, megjithëse duhet pranuar se në praktikë shumica e tyre aplikohen vetëm për krime.

Megjithëse në K. Penal të ri nuk u parashikua mundësia që për vepra me rrezikshmëri të vogël shoqërore, gjykata të mund të përjashtojë autorin nga përgjegjësia penale apo nga dënimi, apo t'i caktojë atij vetëm një vërejtje, paragrafi i fundit i nenit 30 parashikon se në raste të veçanta, kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme dhe kur ligji parashikon dënim me burgim deri në 3 vjet ose dënime të tjera më të lehta për veprën e kryer, gjykata mund të mjaftohet vetëm me caktimin e dënimit plotësues. Megjithëse një hap i pjesshëm, ky rregullim paraqet një lëvizje pozitive në drejtim të humanizimit dhe depenalizimit të K. Penal. Me "raste të veçanta" duhen kuptuar ato vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe ku autori i saj ka rrezikshmëri të vogël shoqërore. Dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme në rastin kur qëllimet e dënimit arrihen edhe me dhënien e një dënimi plotësues. Ky rregullim është zbatuar rrallë në praktikën gjyqësore, dhe kryesisht ka ndodhur për vepra, si: tregtimi i mallrave kontrabandë⁷⁷, prerja e paligjshme e pyjeve, peshkimi i ndaluar, vjedhja, apo ushtrimi i palicënsuar i veprimtarive financiare.

Dënimet plotësuese kanë marrë një shtrirje në numër, si rezultat i shtimit dhe larmisë së figurave të veprave penale dhe aktualisht parashikohen 10 dënime plotësuese të rregulluara në nenet 35-44 të K. Penal.

⁷⁶ Edhe në rastin e parashikuar nga neni 34/5 (paragrafi i ndryshuar që bën fjalë për rastin e kryerjes së krimeve për përfitime pasurore), dënimi me gjobë ka natyrën e një dënimi aksesori, pasi është zëvendësues i konfiskimit të përfitimeve të veprës penale.

⁷⁷ Vendimi nr. 626 (8810), datë 12.12.2012 i GJRRGJ Shkodër, me cilin gjykata ka caktuar ndaj të pandehurit L.G. vetëm dënimin plotësues të konfiskimit të mjeteve të kryerjes së veprës penale (66 paketa cigare të cilat tregëtoheshin pa pullë fiskale).

2.3.2.1. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike

Siç shihet ky lloj dënimi është renditur i pari në listën e dënimeve plotësuese. Ky dënim ka qenë i parashikuar në të gjitha kodet e mëparshme penale që nga ai i vitit 1927 e nganjëherë dhe si dënim kryesor (K. Penal i vitit 1952). Synimi i këtij dënimi është që të parandalojë punësimin në administratën shtetërore apo në shërbimin publik, jo vetëm të individëve të cilët më parë e kanë shpërdoruar funksionin publik, por edhe të personave të tjerë të cilët përmes kryerjes së veprave të tjera penale, kanë humbur besimin se zotërojnë moralin për t'i shërbyer komunitetit.

Neni 35 i K. Penal, i cili parashikon këtë dënim plotësues, ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, duke u bërë i detyrueshëm caktimi i tij për një kohë jo më pak se pesë vjet, ndaj personit që ka kryer një krim që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet. Nga praktika gjyqësore vërehet se ky dënim është zbatuar në rastet kur të pandehurit deklarohen fajtorë për vepra të tilla penale, si: “shpërdorimi i detyrës”, “vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, “korrupsioni pasiv” (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2014: 45), apo “falsifikimi i dokumenteve nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre”. Megjithë faktin se neni 35 §1 e parashikon si të detyrueshëm caktimin e këtij dënimi plotësues në këto dy raste të cituara më lart, në jo pak raste gjykatat nuk e kanë aplikuar atë, megjithëse i kanë deklaruar fajtorë të pandehurit për këto vepra.⁷⁸ Një fakt tjetër lehtësisht i konstatueshëm është se kohëzgjatja e këtij dënimi është gjithnjë në minimumin e parashikuar nga ligji (pra pesë vite), madje në raste të caktuara është ulur edhe nën minimum. Megjithëse caktimi i këtij dënimi plotësues është njësoj e detyrueshme në rastet e caktimit të dënimeve me burgim mbi 10 vite, janë pothuajse inekzistente rastet kur gjykatat e zbatojnë këtë detyrim.

Paragrafi i dytë i nenit 35 ka ruajtur karakterin fakultativ të caktimit të këtij dënimi duke parashikuar se ai mund të jepet nga gjykata për një kohë nga tre deri në pesë vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga një deri në tre vjet kur është caktuar dënim deri në tre vjet burgim. Megjithëse rastet e personave të deklaruar fajtorë në këto marzhe dënimi janë shumë herë më të përhapura se veprat penale të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 35 të K. Penal, lënia e caktimit të tij në diskrecion të gjykatës, ka bërë që frekuenca e aplikimit të këtij dënimi plotësues sipas paragrafit të dytë të jetë thuajse inekzistente. Madje vërehet se në ndonjë rast paragrafi i dytë është përdorur si referim për të caktuar heqjen e kësaj të drejte për një afat më të vogël se 5 vite, megjithëse rrethanat faktike kanë qenë ato të paragrafit të parë të këtij neni. Kështu KPGJL me vendimet nr. 1516 (1032), datë 07.12.2010 dhe 387 (33), datë 31.01.2013 ka lënë në fuqi vendimet e shkallëve më të ulëta, të cilët kanë deklaruar fajtorë respektivisht

⁷⁸ Shiko p.sh. vendimet nr. 1272 (261), datë 10.10.2012 dhe nr. 1559 (330), datë 04.12.2013 të KPGJL.

(përveç të tjerëve) të pandehurit A.Ç. për kryerjen e veprës penale të “korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe A.P. për “shpërdorim detyre”, ku *inter alia* i kanë hequr atyre të drejtën për të ushtruar funksione publike vetëm për një periudhë 3 vjeçare.

2.3.2.2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale

Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale është dënimi plotësues më i shpeshtë i aplikuar në praktikën gjyqësore, pasi fusha e zbatimit të tij prek një numër të madh veprash penale. Gjithsesi më shpesh ai aplikohet në vepra penale, si: kontrabanda, trafiket e ndryshme, korrupsioni, mbajtja pa leje e armëve dhe veprat e kryera nga krimi i organizuar. Neni 36 i K. Penal është riformuluar me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003, duke rregulluar në imtësi situata të ndryshme faktike. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit të sendeve që kanë shërbyer si mjete për kryerjen e veprës penale (*instrumentum sceleris*), të produkteve të veprës penale (*objectum sceleris*), të shpërblimeve të dhëna ose të premtuara për kryerjen e veprës, të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale (*fructa sceleris*) si dhe të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale. Paragrafët vijues parashikojnë se konfiskimi shtrihet pa limit edhe tek pasuritë e transformuara nga produktet e veprës penale, apo të bashkuara me pasuri të tjera të ligjshme, deri në vlerën e produkteve të veprës penale. Po ashtu i nënshtrohen njësoj konfiskimit edhe pasuritë të cilat janë krijuar nga vetë produktet e veprës penale (si: fitimet, qiratë, interesat në depozita etj.).

Shqipëria ka ratifikuar Konventat e KE "Mbi pastrimin, sekuestrimin, depistimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit" (CETS 141) e vitit 1990 dhe atë "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit" (CETS 198) datë 16.05.2005 e miratuar në Varshavë. Në respektim të këtyre angazhimeve ndërkombëtare me qëllim ndërmarrjen e masave më efektive ndaj krimit të organizuar, Kuvendi miratoi me datë 03.12.2009 ligjin nr. 10192, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i quajtur si "Ligji antimafia". Modeli i konfiskimit i implementuar në këtë ligj paraqitet si një kombinim i praktikës Amerikane dhe i disa vendeve të Evropës, duke huazuar elementë të këtyre sistemeve dhe atyre të parashikuara në Konventën Ndërkombëtare të OKB-së kundër Krimit të Organizuar (Mëçalla, 2013: 145). Nëse për konfiskimin e kryer *ad personam* sipas nenit 36 të K. Penal zbatohet parimi klasik i barrës së provës mbi prokurorinë (e cila ka detyrën të provojë se një objekt është mjet apo produkt i një veprë penale), për konfiskimin parandalues *in rem*, sipas ligjit antimafia, barra e provës është e ndarë mes prokurorisë dhe vetë të dyshuarit *balance of probabilities*, njësoj si në gjykimet civile (Selmani, 2007: 445). GJK në vendimin e saj nr. 4, datë 23.02.2011 ka saktësuar se parimi i prezumimit të pafajësisë i parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës lidhet ngushtësisht me proceset

penale, ndërsa konfiskimi sipas ligjit antimafia është një procedim i veçantë i pavarur nga procesi penal, prandaj për të nuk mund të gjejnë zbatim të njëjtat garanci.

Nisur nga fakti se konfiskimi i pasurive kriminale shërben si një mjet efektiv për goditjen në rrënjë të aktivitetit kriminal, i së njëjtës vlerë me hetimin mbi fajësinë është edhe përqendrimi i hetimeve sa më të hollësishme për përcaktimin e produkteve dhe përfitimeve të paligjshme të veprave penale (Jasini, 2006: 131-133). Me heqjen e këtyre pasurive nga aktiviteti i mëtejshëm kriminal, drejtësia penale bëhet më e plotë.

2.3.2.3. Ndalimi për të drejtuar automjete

Neni 37 i K. Penal parashikon se ky dënim mund të jepet nga gjykata ndaj personave që kanë kryer veprë penale, kur çmohet se do të ketë efekt parandalues, apo pajtohet me natyrën e veprës së kryer. Ky lloj dënimi ka karakter fakultativ dhe mund të zgjasë për një kohë nga një deri në pesë vite. Nisur nga natyra e këtij dënimi, ai zakonisht caktohet ndaj personave që kanë konsumuar veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, “largimit nga vendi i aksidentit”, apo “drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt” dhe shumë rrallë për vepra të tjera. Rrethi i veprave të tjera është i papërcaktuar, por logjikisht ai sugjeron aplikimin në rastet kur i dënuari ka kryer një veprimtari kriminale përmes drejtimit të automjeteve, si p.sh.: trafiket e ndryshme të qenieve njerëzore, ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, kontrabanda etj.

Megjithëse dispozita nuk e parashikon, në doktrinë janë mbajtur qëndrime se ky lloj dënimi mund të caktohet vetëm ndaj personave të cilët janë të pajisur me leje drejtimi (Muçi, 2012: 276). Në vlerësimin tonë ky lloj dënimi duhet shtrirë edhe për personat të cilët në kohën e gjyimit nuk janë të pajisur me leje drejtimi automjetesh, pasi në të kundërt do t'i lejonte këtë kategori që të privilegjohehin në mënyrë të padrejtë në raport me ata që kanë leje drejtimi. Parimisht, një i pandehur pa leje drejtimi (por që mund të pajiset me të pas gjyimit), i cili ka kryer një shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, është më i rrezikshëm për të ardhmen si drejtues mjeti, sesa një drejtues i cili është pajisur prej kohësh me të, por që për shkak të veprës penale të kryer vlerësohet se kjo leje duhet t'i hiqet për një periudhë kohe të caktuar.

2.3.2.4. Heqja e dekoratave dhe e titujve

Ky lloj dënimi plotësues i parashikuar në nenin 38 të K. Penal parashikohet të caktohet nga gjykata kur çmohet se mbajtja nga i pandehuri i dekoratave apo titujve të nderit nuk pajtohet me natyrën e veprës penale të kryer. Heqja e dekoratave dhe e titujve të nderit është e përhershme kur personi dënohet mbi dhjetë vjet burgim dhe nga një gjer në pesë vjet, kur dënohet gjer në dhjetë vjet burgim. Për shkak se ky lloj dënimi ka më shumë një karakter simbolik sesa ndëshkues dhe nuk ka gjetur ndonjë zbatim në praktikën gjyqësore, vlerësojmë se nuk meriton vëmendje të mëtejshme në këtë punim.

2.3.2.5. Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie

Ky lloj dënimi është riformuluar tërësisht me ligjin nr. 144/2013, datë 02.05.2013. Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie e ndalon të dënuarin të ushtrojë profesionin ose veprimtarinë, për të cilën është dhënë leje e veçantë, dëshmi, autorizim apo licencë nga organi kompetent. Ky dënim mund të jepet për një kohë nga një muaj deri në pesë vjet dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen duke i shpërdoruar ato, ose kur vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë apo profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete.

Ashtu si ndalimi për të drejtuar automjete, edhe ky lloj dënimi caktohet si kur autori të ketë kryer një vepër penale duke shpërdoruar profesionin apo veprimtarinë për të cilën është i licencuar, ashtu edhe kur vlerësohet se për shkak të veprës penale të kryer, ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë apo profesionit është i papajtueshëm. Ky lloj dënimi plotësues mund të zbatohet ndaj profesioneve të ndryshme të licencuara, si: mjekët, dentistët, farmacistët, psikologët, avokatët, noterët, përkthyesit, ekspertët, taksistët etj. dhe mund të zgjasë në varësi të nevojës për efektin e tij paaftësues nga një muaj deri në pesë vite.

2.3.2.6. Heqja e të drejtës së ushtrimit të detyrave drejtuese

Ky lloj dënimi plotësues i parashikuar në nenin 40 të K. Penal jepet vetëm në ato raste kur i dënuari ka shpërdoruar funksionet apo ka vepruar në kundërshtim me rregullat që lidhen me detyrat e drejtorit, administratorit, sipërmarrësit, likuidatorit si dhe çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik. Ky dënim i heq të dënuarit mundësinë të ushtrojë këto detyra drejtuese pranë personave juridikë për një kohë nga një muaj gjer në pesë vjet dhe nëse dënimi kryesor i caktuar nga gjykata është jo më pak se pesë vjet burgim, kjo e drejtë mund të hiqet për një kohë nga pesë deri në dhjetë vite.

Siç shihet ky lloj dënimi jepet vetëm ndaj subjekteve të posaçme drejtues të personave juridikë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, për kryerjen e veprave të tilla, si “Korrupsioni pasiv në sektorin privat”, veprat penale në fushën e falimentimit etj.

2.3.2.7. Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative

Ndalimi për të qëndruar në një apo disa njësi administrative jepet nga gjykata sipas nenit 41 të K. Penal, për një kohë nga një gjer në pesë vjet, kur çmohet se qëndrimi i të dënuarit në këto vende përbën rrezik për sigurimin publik. Në thelb ky dënim është vijim i aplikimit për një kohë të caktuar të dënimi plotësues të dëbimit, i cili ka qenë në fuqi edhe më parë në legjislacionin tonë penal (Muçi, 2012: 278). Ky dënim i kualifikuar në disa vende si një masë sigurimi ka një efekt paaftësues, pasi ndalon të dënuarin të shkojë në një apo disa vende të caktuara ku ai ka një predispozicion për të kryer përsëri vepra të njëjta penale, për shkak të njohjeve, apo rrethanave specifike që mund të ketë ai qytet/fshat, apo njësi vendore. Ashtu si ndalimi që të drejtojë

automjete të caktuara, edhe ndalimi të mos frekuentojë vende të caktuara është parashikuar nga neni 60 i K. Penal edhe si një detyrim i të dënuarit të vënë në provë.

2.3.2.8. Nxjerrja jashtë territorit

Me hapjen e vendit tonë dhe shtimin e qarkullimit të njerëzve, u paraqitën dhe veprat penale të kryera nga të huajt brenda territorit të vendit tonë. Për këto arsye në nenin 42 të kodit të ri penal u parashikua dhe një lloj dëbimi për personat me shtetësi të huaj apo pa shtetësi, të cilët kryejnë krime dhe çmohet nga gjykata se qëndrimi i mëtijshëm i tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk duhet të vazhdojë më në të ardhmen. Vendimi revokohet nga gjykata me kërkesën e të dënuarit, kur shtetasi i huaj apo ai pa shtetësi fitojnë shtetësinë shqiptare.

Ky lloj dënimi është i ngjashëm me shpalljen e një personi "*non grata*", mirëpo dallon nga organi që e jep (Ministria e jashtme) dhe nga fakti se "*non grata*" shpallen kryesisht personat me imunitet diplomatik (sipas nenit 10.6 të V.K.M. nr. 229, datë 23.04.2004) dhe se nxjerrja jashtë territorit ekzekutohet pasi personi të jetë shpallur fajtor me vendim të gjykatës dhe të ketë vuajtur plotësisht dënimin kryesor të dhënë. Në vlerësimin tonë ky lloj dënimi duhet të aplikohet gjerësisht si një dënim i përshtatshëm ndaj personave të cilët kanë hyrë apo qëndrojnë në vendin tonë me dokumente të falsifikuara duke shmangur aplikimin e dënimit me burgim, apo me gjobë (i cili rezulton i paekzekutueshëm) si dënim kryesor. Po ashtu caktimi i këtij dënimi duhet të shtrihet edhe për kryerjen e kundërvajtjeve penale, pasi aktualisht mungesa e një mundësie të tillë pengon zbatimin e tij për vepra tipike të lehta të kryera nga të huajt, siç është "kalimi i paligjshëm i kufijve".

2.3.2.9. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor

Publikimi i vendimit gjyqësor jepet nga gjykata kur çmon se njohja e përmbajtjes së vendimit ka interes për persona juridikë e fizikë. Publikimi i vendimit gjyqësor konsiston në detyrimin e të dënuarit që me shpenzimet e veta të publikojë në një apo disa gazeta apo stacione radiotelevizive, tërësisht apo pjesërisht vendimin gjyqësor sipas urdhërimit të bërë nga gjykata. Ky lloj dënimi nuk ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore dhe me shtimin e mediave elektronike dhe të intensifikimit të komunikimit në rrjetet sociale, rezulton pa ndonjë efekt të ndjeshëm, pasi publikimi i vendimeve me interes publik bëhet nga vetë mediat apo personat e interesuar.

2.3.2.10. Humbja e përgjegjësisë prindërore

Ky dënim plotësues është adaptuar së fundmi në K. Penal me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012. Sipas nenit 43/a, humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale. Ashtu si edhe dënimet e tjera plotësuese ky dënim jepet kryesisht për personat të cilët me veprimet e tyre shpërdorojnë përgjegjësinë prindërore, apo tregojnë se nuk janë të denjë të vazhdojnë të ushtrojnë një

përgjegjësi të tillë. Ky lloj dënimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve. Për zbatimin efektiv të këtij dënimi, duhet të forcohet mbështetja e shërbimeve sociale tek fëmijët e mbetur pa përkrahje prindërore, sepse në të kundërt ai do të kthehej në një dënim si për fajtorin ashtu edhe për viktimën.

2.3.3. Mënyra e vuajtjes së dënimeve plotësuese

Neni 44 përcakton fillimin e llogaritjes së afateve të vuajtjes së dënimeve plotësuese. Kjo dispozitë ka një formulim konfuz dhe të gabuar, pasi paragrafi i dytë kundërshton të parin. Gjithsesi nga një interpretim logjik pajtues i kësaj norme, mund të kuptohet se afati i vuajtjes së dënimeve plotësuese fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim, megjithëse edhe gjatë vuajtjes së tij i dënuari nuk mund t'i ushtrojë këto të drejta. Për dënimet plotësuese që s'kanë afat, por jepen vetëm një herë (konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale, heqja e dekoratave dhe titujve dhe publikimi i vendimit gjyqësor), nuk ka kuptim diskutimi i fillimit të vuajtjes së tyre, pasi ato ekzekutohen me marrjen formë të prerë të vendimit.

2.3.4. Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë

Përgjegjësia penale e personave juridikë ashtu si në shumë vende të tjera ka qenë një çështje e debatueshme në të drejtën tonë penale, pasi pas parashikimit të saj në kodin e ri penal, ajo u shfuqizua përsëri me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 dhe u rivendos pas 3 vitesh me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004.

Përgjegjësia penale e personave juridikë e ka origjinën në sistemin *common law*⁷⁹ dhe ka lindur si nevojë e kontrollimit të korporatave, të cilat duke u fuqizuar zinin një pjesë të madhe të tregut. Në Evropë përgjegjësia penale e personave juridikë ka ardhur me vonesë, madje një pjesë e vendeve e shohin përsëri me hezitim shtrirjen e përgjegjësisë penale matanë personit fizik (teoria e fiksionit). Një kontribut të veçantë për shtrirjen e përgjegjësisë penale të personave juridikë në shumë vende evropiane ka luajtur Konventa e OKB-së, "Kundër krimit të organizuar transnacional" e vitit 2000⁸⁰ dhe Konventa e KE "Për Pengimin e Korrupsionit" e vitit 1998⁸¹. Pas viteve 2000 shumë vende evropiane filluan të adaptojnë në legjislacionet e tyre penale, përgjegjësinë penale edhe për personat juridikë (teoria e realitetit).

Sipas nenit 45 të K. Penal aktual, personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Megjithatë, edhe njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, në rastet kur ato ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.

⁷⁹ Për herë të parë kjo ka ndodhur në vitin 1842 në SHBA, ku korporatat janë ngarkuar me përgjegjësi penale.

⁸⁰ Sipas kësaj konvente, shtetet detyrohen të parashikojnë përgjegjësi penale të personave juridikë për pjesëmarrje në krime serioze, që përfshin grupe të organizuara kriminale, si dhe për larje të produkteve të rrjedhura nga krimi.

⁸¹ Konventë e cila përfshin detyrimin e shteteve për vënien nën përgjegjësi penale edhe të personave juridikë.

Duke qenë se neni 45 i K. Penal nuk përcakton veprat penale dhe masat ndëshkuese që zbatohen ndaj personave juridikë, Kuvendi miratoi ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personit juridik”. Ky ligj u dërgua për kontroll incidental kushtetues, por GJK me vendimin nr. 38, datë 25.07.2013 e rrëzoi këtë kërkesë. Megjithëse GJK pranoi se ky ligj duhet të ndiqte procedurën e një ligji që miratohet me 3/5 e deputetëve, ajo argumentoi se ai nuk është antikushtetues, pasi Kuvendi ka respektuar kuorumin dhe shumicën prej 3/5 të anëtarëve të tij, të kërkuar nga neni 81, paragrafi i dytë, i Kushtetutës. Ky arsyetim i GJK është bërë objekt debati në doktrinë si përsa i takon argumenteve të shumicës ashtu dhe të pakicës së GJK (Bozheku & Elezi, 2014).

Sipas paragrafit të tretë të nenit 45, përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale. GJK me vendimin nr. 1731 (337) datë 12.12.2012, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm me këtë parashikim, duke arsyetuar se për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, nuk duhet të përgjigjet i pandehuri A. M. si administrator i Shoqërisë “A-AVIBAEM” sh.p.k., por vetë shoqëria konform nenit 45 të K. Penal. Në vlerësimin tonë përjashtimi nga përgjegjësia penale e individit dhe ngarkimi me përgjegjësi penale vetëm e personit juridik është e gabuar, pasi vetë personi juridik është një entitet i cili vepron përmes personave fizikë. Pra nëse asnjë person fizik, drejtues i personit juridik nuk ka përgjegjësi penale, sepse nuk ka faj, atëherë as vetë personi juridik s’mund të ketë përgjegjësi penale.

Vetë ligji nr. 9754, përcakton rrethin e personave fizikë përfaqësues ose ekzekutivë (Bala, 2008: 151), për veprimet e të cilëve mund të ngarkohet me përgjegjësi penale personi juridik. Edhe ky ligj i ndan dënimet për personat juridikë, në dënime kryesore dhe plotësuese. Si dënime kryesore parashikohet gjoba dhe mbarimi i personit juridik, ndërsa si dënime plotësuese neni 10 parashikon 7 të tilla⁸². Gjoba është dënimi kryesor i personave juridikë, i aplikuar gjerësisht në praktikën gjyqësore. Neni 11 parashikon tre nivele të gjobave (nga 25 milionë - 50 milionë lekë; 5 - 25 milionë lekë; dhe 500 mijë - 5 milionë lekë), në varësi të ashpërsisë së sanksionit që parashikon dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal. Ashtu si për dënimin me gjobë për personat fizikë, vlerësojmë se dënimet fikse kumulative për personat juridikë nuk janë të përshtatshme, pasi nuk ofrojnë një fleksibilitet të përcaktimit të tyre në raport me rrezikshmërinë e veprës dhe sidomos me mundësitë financiare të personit juridik, prandaj një mënyrë përlllogaritjeje e tyre mbi bazën e logjikës së sistemit të gjobave ditore, do të ishte më efektiv dhe i drejtë.

⁸² Së bashku me konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale bëhen 8 dënime plotësuese që mund të caktohen ndaj personave juridikë.

2.3.5. Masat mjekësore dhe edukuese

Masat mjekësore dhe edukuese janë dy lloj sanksionesh penale të cilat caktohen ndaj personave të papërgjegjshëm. Masat mjekësore caktohen ndaj personave që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, por që për shkak të sëmundjes mendore kanë qenë të papërgjegjshëm mendërisht, ndërsa masat edukuese caktohen ndaj personave që nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale. Masat edukuese mund t'i caktohen edhe të miturit i cili megjithëse ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, gjykata e përjashton nga dënimi konform nenit 52 të K. Penal. Në rastin e dytë kjo lloj mase ka më tepër karakterin e një dënimi alternativ sesa të një mase parandaluese. Masat mjekësore dhe edukuese jepen pa afat të caktuar, sepse mjekimi apo edukimi i të miturit nuk mund të përcaktohet me saktësi se kur mund të ndodhë.

Megjithëse e drejta jonë penale nuk e përdor termin masat e sigurimit, apo masat shtrënguese siç përdoret në shumë legjislacione të tjera penale (të ndryshme nga masat e sigurimit personal të cilat caktohen sipas K. Pr. Penale), në thelb masat mjekësore kanë një funksion parandalues për të mbrojtur shoqërinë nga njerëz të rrezikshëm, pavarësisht faktit se nuk mund të jenë subjekte të së drejtës penale. Ky përfundim del qartë nga formulimi i nenit 27/2 pika d) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“...2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: ... d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë....”*.

Nëse dënimi penal caktohet mbi bazën e shqyrtimit të kompleksitetit të rrethanave të kryerjes së veprës dhe të autorit, masa mjekësore caktohet mbi bazën e një rreziku hipotetik që i sëmuri mendor krijon për të ardhmen (Mantovani, 2001: 880). Megjithë qëllimin ekskluzivisht parandalues të masave mjekësore, ato zbatohen vetëm ndaj personave që kanë kryer më parë një vepër objektivisht të konsideruar penale, por nuk mund të caktohen ndaj çdo të sëmuri mendor të rrezikshëm. Ndaj këtyre të fundit (të cilët nuk kanë kryer ndonjë vepër) zbatohet neni 20 i ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar. Megjithëse baza ligjore e këtyre dy situatave është e ndryshme, thelbi i nevojës së zbatimit të tyre është e njëjtë, mbrojtja e shoqërisë nga personat e rrezikshëm dhe përpjekjet për kurimin dhe rehabilitimin e tyre psiko-social.

Neni 45 i K. Penal parashikon dy masa mjekësore, mjekimin e detyruar ambulator dhe mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor. Në përzgjedhjen e këtyre dy masave gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen psikike të të sëmurit në kohën e gjykimit dhe mundësitë e kurimit të tij (Myftari, 2014: 88) dhe jo rrezikshmërinë e veprës së kryer prej tij (megjithëse indirekt në raste të caktuara ajo mund të sugjerojë një rrezikshmëri edhe për të ardhmen). Ky përfundim del qartë nga funksioni parandalues që kanë masat mjekësore për të ardhmen dhe jo ndëshkues për të shkuarën. Në çmimin tonë, vetë fakti se masat mjekësore nuk janë të detyrueshme për t'u caktuar nga gjykata (kur personi është shëruar) dhe revokohen në çdo moment kur kryerësi i veprës është shëruar, tregon

se elementë përcaktues janë rrezikshmëria e tij në kohën e gjykimit (e përcaktuar në aktin e ekspertimit psikiatrik) dhe mundësitë për kurimin e tij më të mirë. Nisur nga fakti se mjekimi ambulator kufizon më pak lirinë, ka kosto më të ulëta dhe ofron një ambient më të përshtatshëm psiko-social përmirësues për të sëmurin, gjykata duhet të përzgjedhë gjithnjë si prioritare këtë masë (Peza et al, 1982: 295), në rastet kur nga akti i ekspertimit dhe nga rrethanat çmohet se arrin të garantojë ndjekjen e rregullt të mjekimit. Ky qëndrim konfirmohet edhe nga jurisprudenca më e fundit e GJL (në ndryshim nga ajo e mëparshmeja⁸³), ku me vendimin nr. 385 (27) datë 05.02.2014 ka lënë në fuqi vendimin e GJA Durrës, e cila kishte zëvendësuar shtetasit A.B. masën mjekim i detyruar në një institucion mjekësor, me mjekim të detyruar ambulator, megjithëse ai ishte akuzuar fillimisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 76- 22 dhe 278/2 të K. Penal.

Neni 46 parashikon si masë edukuese vendosjen e të miturit në një institucion edukimi. Masa edukuese ekzekutohet në institucione të ngritura posaçërisht për edukimin e të miturve, mirëpo ligji nuk përcakton nëse i mituri shkëput lidhjet me familjen gjatë kësaj periudhe, apo masa shtrihet vetëm gjatë procesit mësimor normal. Në doktrinë është mbajtur qëndrimi që kjo masë zbatohet në ambiente të cilat e mbajnë të miturin nën mbikëqyrje gjatë gjithë kohës, duke e larguar nga ambienti familjar. Fëmijës që vendoset në një institucion të tillë i kufizohen disa të drejta dhe liri, pasi institucione të tilla imponojnë një regjim strikt jetese dhe marrëdhënie të kontrolluara me familjen (Turkeshi, 2011: 43). Sipas ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” (i ndryshuar), dërgimi i të miturit në institucion edukues bëhet në mënyrë vullnetare nga prindi ose kujdestari mbi urdhrin e ekzekutimit të prokurorit. Kur nuk bëhet ekzekutimi vullnetar në datën e caktuar, ose kur i mituri nuk ka prindër apo kujdestar, ekzekutimi bëhet nga policia e rendit. Në Shqipëri që nga viti 1993 nuk ka asnjë institucion riedukimi për të miturit (Unicef, 2009: 20) dhe për pasojë neni 46 të K. Penal ka mbetur një dispozitë e vdekur teorike, pa një mundësi zbatimi në praktikë të masave edukuese.

Vendimi i gjykatës në rastet e marrjes se masave mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë, kur e kërkojnë personat e interesuar dhe janë zhdukur rrethanat për të cilat ky vendim është marrë. Në çdo rast është detyrim ligjor i gjykatës që edhe kryesisht të marrë në shqyrtim vendimin e saj, me kalimin e një afati një vjeçar nga dhënia e tij.

Në K. Penal shqiptar nuk parashikohen masa mjekësore për personat e varur nga alkooli dhe lëndët narkotike, apo masa të veçanta trajtimi ndaj personave me delinkuencë habituale siç kanë shumë vende të tjera. Duke marrë parasysh faktin se dënimi penal është krejtësisht i paefektshëm ndaj kësaj kategorie personash delinkuentë dhe duke u mbështetur në eksperiencat më të mira të

⁸³ Me vendimin nr. 1591 (298), datë 14.11.2012, KPGJL ka ndryshuar vendimin e GJA Korçë, duke caktuar ndaj të gjykuarit masën mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, pasi sipas GJL ai ka kryer një vepër penale mjaft të rëndë, ka tendencë vetëvrasëse, edhe spitali psikiatrik mund t’i japë ndihmë mjekësore të kualifikuar dhe gjithashtu izolohet nga ambienti ndaj të cilit paraqet një rrezik real.

vendeve të tjera, vlerësojmë se legjislatori shqiptar duhet të plotësojë legjislacionin penal me norma të veçanta për trajtimin e tyre special. Megjithëse jo i plotë, një hap i vogël pozitiv ka qenë shtimi në nenin 60 (tek detyrimet e të dënuarit të vënë në provë) i pikës 11 “Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues”. MD bëri përpjekje në vitin 2013 që t’i parashikonte si dënime plotësuese trajtimin e personave të varur nga alkooli dhe lëndët narkotike, por kjo nismë u rrëzua nga Kuvendi (2013b), duke shtuar me ligjin nr. 144/2013 vetëm nenin 60/a, i cili detajon pikën 11 të nenit 60 të K. Penal, për rastet e caktimit të këtij detyrimi dhe mënyrën e ekzekutimit të tij.

KAPITULLI III: ÇAKTIMI I DËNIMIT

3.1. Shqyrtime hyrëse. Kuptimi i caktimit të dënimit

Në kapitullin e mëparshëm trajtuam tërësinë e dënimeve që Legjislatori i ka vënë në dispozicion zbatuesit të ligjit penal, ndërsa në këtë kapitull do të trajtojmë kriteret dhe rregullat mbi bazën e të cilave këto dënime përzgjidhen ndaj një personi konkret të deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë konkrete penale. Sistemi i dënimeve hedh vetëm kolonat e përcaktimit të mundësive teorike që ka gjykata në përzgjedhjen e një dënimi, por deri në vendosjen e një dënimi konkret, duhet të kalohet përmes një procesi tjetër të gjatë dhe të komplikuar i cili konsiderohet nga e drejta jonë penale si “caktimi i dënimit penal”. Megjithëse legjislacioni ynë penal ka përdorur historikisht këtë terminologji, në mjaft legjislacione të tjera penale ky proces konsiderohet më afër termit “matja e dënimit”, ndërsa doktrina jonë e ka quajtur si individualizimi i dënimit (Muçi, 1989: 87; Elezi et al, 1999: 240).

Ndonëse caktimi i dënimit në kuptimin e ngushtë nënkupton vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me këtë proces, në kuptimin më të gjerë përfshin edhe procesin ligjor i cili e paraprin caktimin gjyqësor dhe caktimin administrativ, i cili përgjithësisht e pason atë. Duke u parë në këtë këndvështrim, caktimi i dënimit në kuptimin e gjerë i ngjan një hinke e cila vjen gjithnjë duke u ngushtuar, ku pjesa më e gjerë është gjithë sistemi i dënimeve dhe pjesa më e ngushtë është dënimi konkret i caktuar për të vuajtur nga personi i deklaruar fajtor nga gjykata.

Megjithëse s’ka dyshim se individualizimi ligjor i dënimit mban peshën më të madhe në konturimin e politikës penale të caktimit të dënimit që ndiqet në një vend, individualizimi gjyqësor (dhe më pak ai administrativ) i dënimit ka një rëndësi prioritare. Individualizimi ligjor dhe ai gjyqësor i dënimit duhet t’i shërbejnë funksionit të së drejtës penale për të qenë të qartë dhe të sigurtë. Në të kundërt, nëse individët nuk arrijnë të kuptojnë nivelin e ashpërsisë së sanksioneve penale për veprime konkrete të konsideruara si vepra penale, atëherë funksioni parandalues i dënimit penal është i kompromentuar. Caktimi i dënimit, është momenti kulmant i procesit penal dhe shënon materializimin e vetë qëllimit të ekzistencës të së drejtës penale. Mirëpo, megjithë rëndësinë e madhe të caktimit të dënimit, duhet pranuar se në vendin tonë këtij momenti i kushtohet një vëmendje shumë më e vogël në raport me procesin e provimit të fajësisë. Ky konstatim nuk vlen vetëm për disproporcionin kohor që i dedikohet këtij procesi nga prokuroria dhe gjykata, por është shtrirë edhe në mungesën e trajtimeve të thelluara teorike dhe doktrimore.

3.1.1. Individualizimi ligjor i dënimit

Individualizimi ligjor i dënimit përfshin gjithë normat e shkruara të cilat përcaktojnë në vija të trasha konturet dhe hapësirat e diskrecionit që i lejohen gjykatës në përzgjedhjen e dënimit konkret. Në sistemin e së drejtës penale të kodifikuar, këto norma gjenden në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të K. Penal (Muçi, 2012: 288). Neni 47/1 i K. Penal përcakton se gjykata cakton dënimin

duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën konkrete penale. Përveç normave të së drejtës materiale, në shumicën e rasteve në caktimin e dënimit duhet të mbahen parasysh dhe dispozita proceduralo-penale të cilat kanë të bëjnë me institute të tilla si gjykimi i shkurtuar⁸⁴, apo parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, të cilat kanë një ndikim shumë të madh në masën përfundimtare të dënimit që do të caktohet.

Në pjesën e përgjithshme, Legjislatori përcakton shkallën e penalizimit të të gjitha sjelljeve të konsideruara si vepra penale, ndërsa në dispozitat e pjesës së posaçme përcaktohen hapësirat brenda të cilave gjykata zgjedh llojin dhe masën konkrete të dënimit ndaj personit të gjetur fajtor për një vepër të caktuar penale. Individualizimi ligjor i dënimit përcakton edhe shkallën e diskrecionit të lejuar gjykatës në përzgjedhjen e dënimit konkret. Kështu p.sh. neni 134 §1 për “vjedhjen”, parashikon një dënim me gjobë ose burgim gjer në tre vjet burgim, ndërkohë që neni 135 i K. Penal parashikon për “vjedhjen duke shpërdoruar detyrën”, një dënim (nga pesë ditë) deri në 10 vite burgim. Neni 134 §1 i lejon gjykatës një marzh të arsyeshëm diskrecioni në përzgjedhjen e llojit dhe të masës së dënimit, ndërsa neni 135 nuk i lejon gjykatës diskrecion në përzgjedhjen e llojit të dënimit, por i lejon asaj një hapësirë tepër të gjerë në përzgjedhjen e masës së dënimit me burgim.

Megjithëse sistemi i dënimeve të papërcaktuara, i quajtur si sistemi arbitrar dhe ai i dënimeve fikse i quajtur si sistemi absolut (Salihu, 2012: 492) ia kanë lënë vendin sistemit bashkohor relativ (me minimum dhe maksimum të përcaktuar), përsëri në të drejtën tonë penale janë shfaqur reminishenca të dënimeve fikse. Kështu me ligjin nr. 8175 datë 23.12.1996 u ndryshuan shumë nene të pjesës së posaçme të K. Penal, duke vendosur për to dënimet fikse me burgim (Bala, 1996: 32). Mbi kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, GJK me vendimin nr. 13, datë 29.05.1997 i shfuqizoi këto ndryshime si antikushtetuese. Sipas GJK, dënimet fikse eliminojnë mundësinë e përcaktimit të shkallës së rrezikshmërisë së veprës penale të kryer dhe të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cunuar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë. Megjithë vendimin e mësipërm, Kuvendi ka miratuar përsëri dënimet fikse si neni 109 §3 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, neni 109/b/3 “Shtrëngimi për dhënien e pasurisë”, neni 221/2 “Kryengritja” dhe neni 334 §2 dhe 3 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

Në momentin e miratimit të veprave specifike penale, Legjislatori përcakton marzhet e dënimit bazuar në vlerësimin abstrakt të rrezikshmërisë shoqërore të asaj vepre penale (Von Hirsch, 2003: 77). Për të përcaktuar një hapësirë logjike mes minimumit dhe maksimumit, Legjislatori duhet të

⁸⁴ I cili zë pjesën më të madhe të gjykimeve.

niset nga objekti apo e mira konkrete juridike e cila cenohet nga ajo vepër penale dhe vlera që ajo e mirë ka për shoqërinë, si dhe nga niveli fajësisë apo patolerueshmërisë së asaj sjelljeje në shoqëri. Caktimi ligjor i dënimeve është hipotetik, pasi megjithëse duhet të mbështetet në përvojën e së shkuarës, ai projektohet për të gjetur zbatim në një situatë të pasigurtë të së ardhmes. Kjo sugjeron rëndësinë e madhe që duhet të ketë puna studimore shkencore në përcaktimin e marzheve të dënimit për një vepër konkrete penale. Ajo duhet të përpiqet të parashikojë situatat në të cilat ajo figurë veprë penale paraqet rrezikshmërinë minimale dhe situatat në të cilat ajo paraqet rrezikshmërinë maksimale. Në respektim të parimit të proporcionalitetit, Legjislatori duhet fillimisht të përcaktojë një lloj shkalle të penalizimit të veprave penale në bazë të objektit kryesor që mbron dispozita dhe më pas t'i ndajë ato në nëngrupe sipas veprave konkrete (Von Hirsch, 2003: 77). Më tej edhe brenda së njëjtës figurë veprë penale duhet të ketë ndarje në paragrafë, në varësi të rrezikshmërisë speciale që paraqesin situata të caktuara cilësuese të asaj veprë penale.

Aftësia për të parashikuar me objektivizëm limitet e dënimit përcakton cilësinë dhe jetëgjatësinë e një norme të pjesës së posaçme. Mungesa e një pune të tillë të thellë studimore duke u bazuar pse jo edhe në praktikat ligjore të vendeve më të zhvilluara demokratike (Elezi, 2005: 62) si dhe ndërhyrjet e shpeshta në sanksionet penale të shumicës së figurave të veprave penale (Nikolli, 2015a, 306), kanë sjellë një çoroditje të sanksioneve penale të parashikuara në pjesën e posaçme të kodit. Në jo pak nene është e pamundur të identifikohet një ligjësi e qartë se mbi çfarë kriteresh logjike janë përcaktuar nivele të caktuara sanksionesh, apo përse në atë rast aplikohen sanksione të ndryshme nga vepra të tjera me rrezikshmëri të ngjashme⁸⁵.

Edhe pse K. Penal shqiptar ka përqafuar sistemin relativ të individualizimit ligjor të dënimit (me përjashtime të vogla), shkalla e aplikimit të tij varion nga vepra në vepër. Në disa nene të pjesës së posaçme parashikohen hapësira të arsyeshme zgjedhjeje mes dy dënimeve kryesore dhe mes minimumit dhe maksimumit të sanksionit, por mjaft nene të tjera nuk parashikojnë mundësinë e zgjedhjes mes dy dënimeve kryesore, apo në anën tjetër parashikojnë hapësira të mëdha mes

⁸⁵ Kështu për ilustrim mund të përmendim nenin 181/a “moskryerja e detyrave nga organet tatimore”, (e cila në thelb është një lloj shpërdorim detyre) në paragrafin e parë parashikon vetëm dënim me gjobë (nga 50 mijë) deri në dy milionë lekë, ndërkohë që paragrafi i dytë i së njëjtës vepër parashikon burgim nga tre deri në 10 vite; neni 182/a §1 “prodhimi i mjeteve për falsifikim monedhash” (e cila logjikisht është shumë më e rëndë se përdorimi i një monedhe të falsifikuar), parashikon gjobë ose burgim nga një gjer në tre vjet, ndërkohë që për përdorimin e një apo disa monedhave të falsifikuara neni 184 §1 parashikon dënim me burgim gjer në pesë vjet; neni 207 “shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” parashikon vetëm dënim me gjobë edhe kur ka rrezikuar rëndë jetën e personave, ndërkohë që neni 206/b §2 “shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve”, parashikon dënim me burgim nga tre deri në tetë vjet; nenin 279 §2, ku për mbajtjen e një thike apo doreze (përforcuese grushti) në vende publike dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet, ndërsa mbajtja pa leje e një arme gjahu automatike në të njëjtin vend dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vite; shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen e një familjari (fëmijë, prind, bashkëshort) dënohet sipas nenit 290 §3 me burgim nga dy deri në dhjetë vjet, ndërsa vrasja me pakujdesi me armë zjarri apo çdo lloj mjeti tjetër dënohet sipas nenit 85 me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet etj.

minimumit dhe maksimumit të dënimit, si p.sh. nenet 135, 176 apo 289 §2 të K. Penal. Duke marrë në konsideratë edhe modifikimet me 16 ligjet që kanë ndryshuar K. Penal, mund të themi se aktualisht për shumicën e veprave penale, dënimet e parashikuara për to janë më shumë një pasqyrim i ngutjes politike për t'iu përgjigjur një problemi të momentit, sesa produkt i një mendimi të thellë dhe të harmonizuar, për një politikë të arsyeshme të caktimit të dënimit penal.

3.1.2. Aspekti politik i dënimit

Çështjet e zbatimit të ligjit janë të lidhura me politikën në disa aspekte. Teoria dominuese politike dhe ideologjike ndikon në strukturën, organizimin dhe pritshmëritë mbi institucionet e zbatimit të ligjit penal. Kuvendi si organ ligjvënës përbëhet 100% nga politikanë dhe për pasojë edhe sanksionet penale, si pjesë e ligjit penal s'mund të mos ndikohen nga ngjyresat e tyre politike. Mirëpo, në një shoqëri demokratike procesi ligjbërës e aq më tepër ai që ka të bëjë me kufizimin e të drejtave të njeriut (siç janë përcaktimi i sanksioneve penale) nuk mund të reduktohet vetëm në shfaqjen e vullnetit politik, por duhet të mbajë në konsideratë së pari edhe arritjet e shkencave penale dhe standardet e të drejtave të njeriut.

Shumë vende demokratike e kanë konsoliduar ndikimin e studimeve shkencore në reformat penale, duke treguar maturi dhe stabilitet (Albrecht, 2013: 211; Von Hofer, 2011) me qëllim që ato t'i shërbejnë në afat të gjatë funksioneve të së drejtës penale. Mirëpo reflektimi i politikës së ditës në të drejtën penale i ka ndarë edhe vendet e ashtuquajtura demokratike në dy grupe, në ato ku politika përcakton thelbësisht sanksionet penale dhe ato ku ajo luan një rol më të tërhequr. Përfaqësuese tipike e grupit të parë është SHBA me një politikë agresive penale (Whitman, 2003), ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë vendet me një politikë të butë penale, ku spikasin vendet Skandinave dhe Gjermania. Megjithë afërsinë gjeografike dhe ngjashmëritë formale si pjesë e sistemit të së drejtës së kodifikuar kontinentale me këto vende, në dy dekadat e fundit Shqipëria ka huazuar më shumë nga fryma amerikane, duke ashpërsuar gjithnjë e më tepër sanksionet penale, jo vetëm për vepra të rënda, por edhe për vepra të lehta. Ashtu siç është shprehur Krieger (2012: 260) qasjet e “tolerancës zero” mund të jenë aksione të suksesshme politike, por ato janë politika të këqija penale, pasi gjithnjë do të ketë më shumë vepra penale sesa është mundësia për të ndëshkuar.

Qeveritë duke u përpjekur të tregojnë vullnet politik për të frenuar një fenomen të caktuar antisocial, e bëjnë këtë në mënyrën më të shkurtër dhe më të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë, por për fat të keq jo më efektiven, nëpërmjet parashikimit të sjelljes antisociale si e ndëshkueshme penalisht, e në rastet kur ajo ka qenë më parë e parashikuar, nëpërmjet ashpërsimit të mëtejshëm të llojeve apo masave të dënimit për atë sjellje (Herring, 2013: 14). Kjo qasje është reflektuar në vijimësi nga çdo maxhorancë e re politike shqiptare që ka ardhur rishtazi në pushtet, në përpjekje për të certifikuar vullnetin e saj për të luftuar paligjshmërinë dhe padrejtësinë. Ashpërsimet galopante të sanksioneve të filluara menjëherë pas miratimit të K. Penal në vitin 1996, kanë

vazhduar në vijimësi deri në këto momente, duke i ngritur limitet e dënimeve penale në nivele rekord për historikun e sanksioneve penale në vendin tonë dhe të pakrahasueshme me asnjë vend tjetër të Evropës Perëndimore. Megjithëse nga historia e së drejtës penale shqiptare mund të kujtojmë “agjitacionin dhe propagandën” si veprën me karakter më tipik politik, edhe në ditët e sotme shumë vepra penale përdoren për qëllime të mirëfillta politike. Kështu ashpërsimet e dënimeve për vepra të lehta penale të cilat në dy vitet e fundit kanë pasur një frekuencë shumë të lartë gjyqësore, si ndërtimi i paligjshëm, vjedhja e energjisë elektrike, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt etj., janë bërë pa analizuar me objektivizëm se cilët kanë qenë shkaqet e përhapjes së këtyre fenomeneve të paligjshme.

Kapërcimi i menjëhershëm me fushata, nga paligjshmëri e gjerë, në një ndëshkim të gjerë për vepra të caktuara, jo vetëm që nuk do të sjellë ndonjë rezultat afatgjatë, por në terma afatshkurtër (sa do të zgjasin këto fushata) do të sjellë shfokusim të vëmendjes nga veprat penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Burimet financiare dhe njerëzore të prokurorive dhe gjykatave shqiptare janë tepër të kufizuara dhe për pasojë veprimtaria e tyre duhet të përqendrohet në çështjet penale më prioritare, duke ua lënë organeve të tjera të administratës publike trajtimin e pjesës më të madhe të sjelljeve antiligjore. Madje, vepra të tilla penale, si: “fshehja e të ardhurave”, “shpërdorimi i tokës”, “ndërtimi i paligjshëm” (në tokën e vet), “pushtimi i tokës”, “prerja e drurëve frutorë” etj., duhet të dekriminalizohen dhe kryerja e tyre për herë të parë të konsiderohet si kundërvajtje administrative.

Shumë vende i kanë zgjidhur çështjet e mbikriminalizimit dhe mbipenalizimit përmes emancipimit të vetë shoqërive të tyre dhe të mënyrës se si Legjislatorët e tyre ndërhyjnë në ligjet penale, ndërkohë që vende të tjera e kanë kufizuar këtë rrezik me ligj. K. Penal i Kosovës është një shembull ku në nenin 1 të tij parashikon kufizime ndaj legjislatorit për miratimin e veprave penale dhe nivelin e sanksioneve penale. Në të drejtën tonë penale nuk ka norma eksplicite të shkruara që kufizojnë politizimin e tepruar të së drejtës penale, por GJK e ka elaboruar këtë çështje nën suazën e parimit të proporcionalitetit, të cilin do ta trajtojmë më poshtë.

3.1.3. Individualizimi administrativ i dënimit

Individualizimi administrativ, paraqet një mënyrë të individualizimit të dënimit me burgim që zbatohet nga organet e institucioneve penitensiare. Ky lloj sistemi aplikohet në vendet e së drejtës *Common law* për kategorinë e dënimeve të papërcaktuara (indeterminate sentences). Këto struktura të quajtura bordet e lirimimit me kusht përcaktojnë kohën reale se kur i dënuari do të lirohet nga burgu. Ky rregullim mbështetet në faktin se në momentin e gjetjes së të pandehurit fajtor, nuk mund të dihet se si mund të shkojë procesi i riedukimit dhe përmirësimit të tij (Salihu, 2012: 493). Prandaj duhet sipas tyre, që lloji dhe masa (kohëzgjatja) e dënimit të jetë në diskrecionin e këtyre bordeve, të cilat analizojnë sjelljen e të dënuarit deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës për

lirim para kohe. Megjithëse kjo praktikë mund të duket interesante, fakti se këto borde nuk kanë cilësitë gjyqësore kanë bërë që shumica e vendeve të mos i besojnë organeve administrative të vendosin mbi kohëzgjatjen e burgimit. Në vendin tonë caktimi i dënimit nga një organ jogjyqësor ndalohet nga neni 27 §2.a i Kushtetutës, i cili parashikon se dënimet me burgim mund të caktohen vetëm nga një gjykatë kompetente.

3.1.4. Individualizimi gjyqësor i dënimit

Në dallim nga individualizimi ligjor, i cili përcakton dënimin që duhet të caktohet hipotetikisht për kryerjen e një veprë abstrakte, individualizimi gjyqësor është caktimi i llojit dhe masës konkrete të dënimit ndaj një të pandehuri konkret. Në rast se gjykata vlerëson se i pandehuri është fajtor për kryerjen e një veprë penale, atëherë, para saj shtrohet problemi i përzgjedhjes së llojit dhe të masës së dënimit. Megjithëse në pamje të parë, kjo mund të duket një detyrë e thjeshtë dhe mekanike, në praktikë kjo është detyra më e vështirë e punës së një gjyqtari, pasi për kryerjen e saj kërkohet të mbahen në konsideratë shumë dispozita ligjore dhe një mori rrethanash komplekse të cilat tërheqin në drejtime të ndryshme. Ky proces është komplikuar edhe më tej me diversifikimin e qëllimeve të dënimit penal dhe nevojën për të përzgjedhur qëllimit prioritar që do të ndiqet në rastin konkret si dhe për të harmonizuar sa të jetë e mundur këtë qëllim me qëllimet e tjera. Caktimi i një dënimi të bazuar në ligj dhe në prova është po aq i rëndësishëm sa edhe dhënia e një vendimi fajësie të bazuar në ligj dhe në prova. Një vendim i drejtë mbi fajësinë, por i gabuar mbi dënimin është një arritje e pjesshme e cila në fund të fundit jep pak ose aspak rezultate (në varësi të shkallës së gabimit).

Sisteme të ndryshme ligjore kanë adaptuar modalitete të ndryshme në lidhje me kriteret që duhet të mbahen parasysh në individualizimin e dënimit, por ajo që i bashkon është përcaktimi i detyrimit të gjykatës për t'u mbështetur në këto kritere, me qëllim që dënimi i caktuar të mos jetë një akt vullneti i gjyqtarit, por një zbatim korrekt i frymës së ligjit. Nga pikëpamja procedurale, në vendet e sistemit *common law* procesi i individualizimit të dënimit është i shkëputur nga procesi i shqyrtimit të fajësisë. Më parë juria apo gjyqtari shqyrtojnë faktin nëse provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri është fajtor apo jo dhe nëse i pandehuri gjendet fajtor, më pas në një fazë të dytë (që zakonisht ndodh pas disa javëve) shqyrtohen nga gjykata rrethanat për caktimin e dënimit ndaj tij (law.jrank.org, 2015). Ndryshe ndodh në vendet e sistemit kontinental të së drejtës së kodifikuar, ku në dominancë caktimi i dënimit është pjesë unitare e procesit të fajësisë dhe analizimi i të dy momenteve pasqyrohet në një akt të vetëm gjyqësor që është vendimi përfundimtar.

Të dy këto sisteme kanë avantazhet e veta, por në interes të këtij punimi duhet të themi se sistemi kontinental në të cilin bën pjesë edhe vendi ynë duhet të huazojë nga sistemi *common law* vlerësimin për rëndësinë e procesit të caktimit të dënimit. Megjithëse modeli unitar i procedurës

sonë penale kufizon ndjeshëm mundësinë e gjykatës për t'u investuar kryesisht në hetimin e rrethanave të cilat ndikojnë në caktimin e dënimit, kjo nuk ndalon përcaktimin me ligj, apo bërjen praktikë (të mirë) që prokuroria të kërkojë thellimin e hetimit paraprak dhe gjyqësor jo vetëm në drejtim të provimit të fajësisë, por me të njëjtin interes edhe për çështjen e caktimit të dënimit. Në vlerësimin tonë është i gabuar mendimi se prokuroria e ka kryer mirë detyrën e saj kur ka arritur të bindë gjykatën për fajësinë e të pandehurit, pavarësisht se çfarë dënimi cakton gjykata.

Siç u shprehëm në kapitullin II, megjithëse neni 34 §6 parashikon detyrimin e gjykatës për të hetuar rreth aftësisë paguese të të pandehurit, në rastin kur cakton dënim me gjobë, ky detyrim mbetet i pazbatuar në praktikë për shkak të pozicionit neutral të gjykatës (dhe prirjes për të shmangur paragjykimet mbi fajësinë, apo llojin e dënimit), mundësisë përjashtimore të saj për të hetuar kryesisht fakte objekt gjykimi dhe të faktit se kjo do të pamundësonte zhvillimin e gjykimit të shkurtuar (procedurë e cila ndiqet në gjykimin e shumicës dërrmuese të veprave penale të cilat parashikojnë gjobën si dënim). Është e pamjaftueshme që hetimi i prokurorisë për llojin dhe masën e dënimit të kufizohet në sigurimin e dëshmisë së penalitetit, ndërkohë që mbrojtja si palë e barabartë me të, investohet në shumicën e rasteve në provimin para gjykatës të rrethanave të ndryshme që kanë të bëjnë me caktimin e dënimit. Në të njëjtën masë që prokuroria ushtron të drejtën e saj të ankimit ndaj vendimeve të gjykatës për të cilat nuk është dakord, duhet të përmbushë edhe detyrimin për të hetuar (apo të kërkojë për të hetuar gjatë gjykimit) rrethana që kanë të bëjnë me caktimin e dënimit.

Caktimi i dënimit nga gjyqtari duhet të mbështetet në disa parime të rëndësishme të së drejtës penale, respektimi i të cilave kufizon diskrecionin e tij, duke e udhëzuar në dhënien e një dënimi të drejtë dhe të parashikueshëm. Trajtimi i parimeve dhe diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit do të bëhet në seksionet e mëposhtme.

3.2. Parimet mbi të cilat mbështetet caktimi i dënimit penal

Këto parime përbëjnë kolonat mbi të cilat zhvillohet gjithë procesi normativ dhe gjyqësor i caktimit të dënimit. Ato burojnë nga ligji më i lartë i vendit, Kushtetuta dhe zhvillohen në legjislacionin penal dhe në jurisprudencën gjyqësore. Si të tilla këto parime janë të përbashkëta si për individualizimin ligjor ashtu edhe për individualizimin gjyqësor të dënimit.

3.2.1. Parimi i ligjshmërisë

Parimi i ligjshmërisë është parimi bazë i legjislacionit penal pasi ai mbron qytetarët nga arbitrariteti dhe keqpërdorimi eventual i së drejtës penale nga gjykata. Megjithëse shprehjen e mirënjohur *nullum crimen, nulla poena, sine lege* e artikuloi i pari Feuerbach, kontributi kundër arbitraritetit shtetëror i iluministëve Montesquieu, Rousseau dhe Beccaria është i madh (Elliott; 2011: 6).

Ky parim është sanksionuar në nenet 4 dhe 29 të Kushtetutës dhe është elaboruar më tej në nenin 2 të K. Penal. Pjesa e parë e parimit “s’ka krim pa ligj”, ndalon deklarimin fajtor të një personi për një vepër e cila në kohën e kryerjes së saj nuk parashikohej si vepër penale nga një normë e shkruar. Me vendimin nr. 1, datë 12.01.2011, GJK arriti në përfundimin se neni 90 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon si vepër penale “ushtrimin pa licencë të këmbimit valutor”, vjen në kundërshtim me nenet 4, 29 dhe 81 pika 2 të Kushtetutës dhe si i tillë duhej shfuqizuar. Pjesa e dytë e këtij parimi “s’ka dënim pa ligj” ndalon caktimin ndaj një fajtori një lloj apo masë dënimi të paparashikuar më parë me ligj. Ky parim duhet zbatuar jo vetëm në lidhje me dënimet kryesore, por edhe ndaj çdo lloj detyrimi apo kufizimi që buron nga e drejta penale.

Parimi i ligjshmërisë është i përbërë nga disa komponentë (të cilët mund të quhen edhe nënparime të tij) dhe që janë: 1) detyrimi për të parashikuar vetëm me ligj vepra penale dhe dënime; b) ndalimi i zbatimit të analogjisë; c) ndalimi i veprimit retroaktiv të ligjit penal; dhe ç) qartësia e normave penale. Në lidhje me zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin e caktimit të dënimit penal, vlerësojmë se çështja e zbatimit të ligjit favorizues dhe e ndalimit të rëndimit të pozitës së të pandehurit meritojnë një trajtim të shkurtër teorik.

3.2.1.1. Zbatimi i ligjit favorizues

Parimi i ligjshmërisë lejon përjashtimisht zbatimin retroaktiv të ligjit penal *abolitio criminis* kur ligji i ri nuk dënon veprën penale. Në këtë rast, nëse personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, pushon. Sipas nenit 29 §3 të Kushtetutës dhe nenit 3 §3 të K. Penal, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Në zbatim të këtyre normave *ex post facto*, GJK me vendimin nr. 1 datë 20.01.2014 (V-1/14) ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-945 (144), datë 24.04.2013, të KPGJL, pasi kjo e fundit ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues ndaj të gjykuarit B.T., duke mos zbatuar ligjin nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”, i cili kishte hyrë në fuqi në kohën e gjyqimit të çështjes në GJL.

Në shumicën e rasteve, përzgjedhja e ligjit favorizues në caktimin e dënimit është e thjeshtë, por interesant është rasti kur ligji i ri ka ulur minimumin, por ka rritur maksimumin e sanksionit. Në këtë rast vlerësojmë se ligji më favorizues është ligji, i cili sipas rrethanave të faktit favorizon realisht të pandehurin. Pra nëse gjykata vlerëson se duhet të caktojë dënim në maksimum, ligji më favorizues është ai që parashikon dënimin më të ulët në maksimum dhe nëse gjykata vlerëson se duhet të caktojë dënim në minimum, zbatohet dispozita me minimumin më të ulët (Hoxha, 2013: 61; Elezi et al, 2009: 76) Ky qëndrim është mbajtur nga GjRREGJ Shkodër me vendimin nr. 609 (4319), datë 20.11.2014 për nenin 290 §2 të K. Penal. Çdo interpretim i kundërt do t’i hiqte thelbin

termit “ligj favorizues”. Gjithsesi, përzgjedhja logjike e ligjit më favorizues mes dy normave të kohëve të ndryshme, nuk duhet konfunduar me ndalimin e kombinimit të dispozitave të dy ligjeve, me qëllim nxjerrjen e përfitimit maksimal (Marinnucci & Dolccini, 2012: 81).

3.2.1.2. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit

Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit *reformatio in peius* është parashikuar në nenin 425 të K. Pr. Penale, mirëpo jurisprudenca e GJK⁸⁶ e konsideron atë një standard kushtetues (Zaganjori et al, 2011: 97; Pogaçe et al, 2013: 9), i cili i shtrin efektet e tij në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë edhe GJL. Baza juridike për zbatimin e këtij parimi gjendet si në nenin 7 të KEDNJ, në nenin 29 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 3 §2 të K. Penal. GJK është shprehur në jurisprudencën e saj⁸⁷ se: “*zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë, në mënyrë efektive, të drejtën për t’iu drejtuar me ankim gjykatës*”, si dhe se: “... *ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre.*

Ky parim është trajtuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të GJL me vendimin unifikues nr. 2 datë 06.02.2009. Në këtë vendim GJL shprehet se ndreqja e gabimeve të lejuara nga gjykata e gjykimit të mëparshëm, gjatë rigjykimit të çështjes, kur vendimi prishet mbi ankimin vetëm të të gjykuarit (pavarësisht shkaqeve të prishjes), nuk duhet të rëndojë pozitën e tij. Fakti që vendimi i mëparshëm, shpallet absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 128 të K. Pr. Penale, nuk do të thotë që edhe interesat thelbësore të personave të deklaruar fajtorë me vendimin përfundimtar të atij gjykimi, i cili në pikëpamje formalo-juridike, edhe ai, u shpall i pavlefshëm (sikurse janë lloji i veprës penale për të cilën ata ishin deklaruar fajtorë, nga njëra anë dhe sidomos lloji e masa e dënimit, caktuar për ta, nga ana tjetër), pësojnë fatin e atyre akteve.

3.2.2. Parimi i proporcionalitetit

Pas parimit të ligjshmërisë, parimi i proporcionalitetit është parimi më i rëndësishëm i së drejtës penale. Ai konsiderohet sot si parimi themelor i shtetit të së drejtës dhe elementi përcaktues i kushtetutshmërisë së dënimit penal.

Ky parim është zemra e teorisë moderne të dënimit të drejtë *just deserts*, e cila konsideron qëllimin ndëshkues të dënimit penal si qëllimin më të arsyeshëm. Kjo teori është trajtuar gjerësisht nga filozofi i së drejtës penale Andrew Von Hirsch, në botimin e tij “Censure and sanctions” (1993) dhe i kundërvihet jo vetëm teorive utilitariste të parandalimit, por dallon thelbësisht edhe nga propozimi retributiv kantian “dhëmb për dhëmb e sy për sy”. Ky parim kërkon që dënimet penale të jenë në proporcion me ashpërsinë dhe rëndësinë e veprimeve të të pandehurit (Von Hirsch, 2003: 29). Ky autor vë si njësi matëse të dënimit *censure*, apo mosmiratimin e thellë të shoqërisë për atë

⁸⁶ Vendimi nr. 15, datë 22.07.2008 i GJK.

⁸⁷ Vendimi nr. 13, datë 15.04.2003 i GJK.

veprim, e cila e mishëruar në sanksionin e vendosur, i bën thirrje njerëzve për të hequr dorë nga gabimi për ta kryer atë. Sipas tij, çështja e të dënuarit proporcionalisht është një çështje etike, pasi njerëzit i shohin si më të drejta dënimet që përputhen me rëndësinë e veprës së kryer (Von Hirsch, 2003: 6).

Në aspektin legjislativ, implementimi i parimit të proporcionalitetit reflektohet në praktikë me miratimin e marzheve të dënimit (minimum dhe maksimum) për vepra konkrete penale. Duke u fokusuar në “meritën” apo “shpërblimin” për veprën e kryer dhe jo në rehabilitimin dhe riedukimin e të pandehurit, kjo nënkupton kalimin nga dënimet me marzhe të papërcaktuara *indeterminate sentences*, në dënime me marzhe të përcaktuara *determinate sentences*. Më tej në aspektin gjyqësor, ky parim nënkupton që dënimi konkret i caktuar ndaj autorit të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e veprës konkrete dhe me shkallën e fajit të autorit.

Megjithë dukjen e saj të arsyeshme dhe të mbështetur në parime morale, teoria e *just deserts* është kritikuar gjithsesi për shkak se ajo fokusohet vetëm në qëllimin retributiv të dënimit dhe si e tillë ajo promovon në praktikë dënime të ashpra (Wilson, 1985; Tonry, 1994: 136). Në fakt duhet pranuar se vendet të cilat i kanë kushtuar më shumë vëmendje këtij parimi (kryesisht SHBA, por edhe Britania e Madhe) kanë dënimet më të ashpra dhe një fokusim më të madh tek dënimet me heqje lirie. Po ashtu kritika të tjera i referohen faktit se në praktikë është vështirë të gjendet një njësi orientuese konkrete për ndarjen e veprave penale në disa shkallë (siç propozon Von Hirsch) dhe çfarë distance në masë dënimi mund të kenë nga njëra-tjetra vepra të shkallëve pasuese. Në përgjigje të këtyre kritikave mbështetësit e dënimit të drejtë argumentojnë se dënimet e ashpra në SHBA nuk vijnë si pasojë e parimit të proporcionalitetit, por si pasojë e fokusimit në qëllime të tjera të dënimit penal, si paaftësimi dhe parandalimi i përgjithshëm, ose në rastin më të mirë si pasojë e keqpërdorimit të këtij parimi. Po ashtu fakti se ka vështirësi në përcaktimin e kriterëve orientuese për përcaktimin e shkallëzimit të veprave penale dhe të dënimeve për to, nuk e hedh poshtë dobishmërinë që ka proporcionaliteti në caktimin e dënimeve të drejta.

Në ndryshim nga SHBA, ku parimi i proporcionalitetit nuk ka arritur të përkthehet mjaftueshëm në dënime më të arsyeshme (duke filluar me dënimin me vdekje dhe atë me burgim të përjetshëm), ai ka zënë një vend kyç në drejtësinë kushtetuese të shumë vendeve të Evropës (Von Hirsch, 2009: 118)⁸⁸. Ky parim i aplikuar së pari në fund të shekullit XIX në të drejtën prusiane si një koncept i

⁸⁸ Neni 1, paragrafi 1, i Ligjit Themelor gjerman, përcakton thelbin e konceptit të dënimit dhe raportin e fajit me të, në kuptimin që çdo dënim duhet të jetë në një raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit (shih vendimet BVerfGE 19,342; BVerfGE 88, 203; BVerfGE 45, 187 të GJK gjermane). Po ashtu GJK italiane e ka trajtuar këtë parim në raport me nivelin e dënimeve penale në shume çështje (Toscano, 2012: 122), por ka pranuar shfuqizim të një norme penale vetëm me vendimin nr. 341 datë 19-25.06.1994 për veprën e fyerjes së një zyrtari publik. Me vendimin nr. 518 datë 15-21.11.2000 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së gjykatës kërkuese për shfuqizimin e veprës penale të inçestit.

së drejtës administrative (Frase & Sullivan 2008: 28) është përhapur sot në jurisprudencën e GJED (Gjykata Evropiane e Drejtësisë) dhe GJEDNJ. Neni 49(3) i Kartës së të drejtave themelore të BE shprehet se ashpërsia e dënimeve nuk duhet të jetë në shpërpjesëtim me veprën penale të kryer (Ministria e Integritetit, 2012: 384).

Parimi i proporcionalitetit është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ në kuadër të neneve 5, 8, 9, 10, 11 dhe nenit 18 të konventës. Neni 18 i KEDNJ parashikon shprehimisht se: *“Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.”* Në çështjen Ricci kundër Italisë⁸⁹ GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 10/2 të Konventës për cenim të lirisë së shprehjes. GJEDNJ e konsideroi në cënim të parimit të proporcionalitetit, dënimin me 4 muaj burgim të ankuesit për bërjen publike të komunikimit të brendshëm të sistemit të kompjuterizuar të RAI-t. Gjykata u shpreh (ashtu si në shumë çështje të tjera të mëparshme)⁹⁰ se megjithëse caktimi i dënimit penal është në parim një çështje e gjykatave kombëtare, caktimi i një dënimi me burgim për një vepër penale të kryer nga shtypi, mund të jetë e justifikueshme vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur dukshëm vepra ka cenuar rëndë të drejta të tjera themelore, si p.sh. ka nxitur urrejtje dhe ka shkaktuar dhunë.

Parimi i proporcionalitetit në Evropë ka marrë një kuptim më të gjerë se në Amerikë dhe konsiderohet si parimi bazë dhe universal i drejtësisë (Sandulli, 2006: 4643). Ai konsiderohet se është respektuar nëse përmbushen tre kushte: (1) ndërhyrja në të drejta duhet të jetë e përshtatshme, në kuptimin që duhet të zgjidhen mjetet në përputhje me qëllimet që synohen; (2) ndërhyrja duhet të jetë e domosdoshme, pra që qëllimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera më pak kufizuese; dhe (3) ndërhyrja duhet të jetë proporcionale në kuptimin e ngushtë, pra që kostot duhet të jenë më të vogla se përfitimet e arritura nga ndërhyrja. Në lidhje me kërkesën e parë të përshtatshmërisë, ngrihet problemi i qëllimit që ndjek dënimi penal, pra një mjet mund të jetë i përshtatshëm për arritjen e qëllimit retributiv, por jo të atij paaftësues, parandalues, apo riedukues.

Siç kuptohet në Evropë, parimi i proporcionalitetit fokusohet në një qasje ekskluzivisht utilitariste, duke lënë në plan të dytë qëllimin retributiv, i cili siç u trajtua më lart është prioritar në sistemin anglosakson. Megjithëse me justifikime logjike të ndryshme (Palazzo, 1999: 66), dy këndvështrimet e proporcionalitetit mund të gjejnë pika takimi për t'i shërbyer racionalizimit të dënimeve penale. Kështu përcaktimi i marzheve të dënimit ligjor mbi bazën e parimit të proporcionalitetit sipas teorisë së meritës së drejtë, shërben si një udhëzues i arsyeshëm për legjislatorin, ndërkohë që brenda këtyre marzheve, gjyqtari përdor konceptin utilitarist evropian të

⁸⁹ Ankimi nr. 30210/06, data e vendimit 08.10.2013.

⁹⁰ Si në çështjet Ceylan v. Turchia [GC], n. 23556/94, § 37, CEDU 1999-IV; Tammer v. Estonia, n. 41205/98, § 69, CEDU 2001-I; apo veçanërisht CUMPĂNĂ AND MAZĂRE v. ROMANIA, (Application no. 33348/96).

proporcionalitetit për të realizuar qëllimin paaftësues, parandalues dhe edukues të dënimit konkret (Honderich, 1989: 233; Morris, 1974).

Parimi i proporcionalitetit është parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës tonë dhe është bërë objekt i kontrollit kushtetues në disa raste⁹¹. Parimi i proporcionalitetit jo vetëm që është kundër dënimeve fikse, por kërkon që legjislatori t'i lejojë gjykatës diskrecionin e mjaftueshëm për të përzgjedhur një dënim të përshtatshëm dhe proporcional edhe në praktikë⁹². Në vendimin e saj nr. 12, datë 14.04.2010, GJK ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Gjykata shprehet se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, mirëpo ky diskrecion megjithëse i gjerë, nuk është tërësisht i pakufizuar. Në përfundim të analizës së plotësimit të këtyre elementëve GJK e konsideroi si antikushtetuese parashikimin e caktimit njëkohësisht si dënime kryesore të burgimit dhe gjobës, dënime të cilat mund të caktoheshin sipas nenit 29/3 të K. Penal.

Çështja e ashpërsisë së dënimeve për vepra konkrete penale është trajtuar nga GJK në vendimin nr. 55 datë 21.07.2015. Në kërkesën e saj GJRRGJ Shkodër, kërkoi shfuqizimin e togfjalëshit “...dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të K. Penal, si të papajtueshëm me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 17/1 të Kushtetutës⁹³. Megjithëse kjo kërkesë është rrëzuar me një shumicë të ngushtë 5 me 4, në vlerësimin tonë qëndrimi i shumicës është

⁹¹ Shih p.sh. vendimet nr. 12 të vitit 2010, nr. 19 të vitit 2011 dhe 47 të vitit 2012 të GJK.

⁹² Siç është shprehur GJK në vendimin e saj nr. 13, datë 29.05.1997.

⁹³ Shtetasi D. Sh. ishte konsumator i rregullt i lëndës narkotike heroinë që prej 6 vitesh dhe e konsumonte atë disa herë në ditë. Atij iu sekuestrua nga policia një sasi prej 0.8 gr. substancë me përmbajtje heroine (duke rrezikuar nga 7-15 vite burgim). Në zbatim të parimit të proporcionalitetit, GJRRGJ Shkodër vlerësoi se parashikimi për mbajtjen e lëndëve narkotike për përdorim personal, i një dënimi nga 5-10 vite burgim sipas paragrafit të parë dhe 7-15 vite sipas paragrafit të dytë të nenit 283 të K. Penal, njësoj sikurse për prodhuesit, shitësit, apo transportuesit në sasi të mëdha, paraqet një disproporcionalitet të dukshëm mes mjetit të përdorur dhe gjendjes që e ka diktuar atë. Argumentet e përgjithshme të luftës kundër krimit, apo të sigurisë publike, nuk përlligjin kufizimin disproporcional të lirisë së qytetarëve, për një veprim si mbajtja e lëndëve narkotike për përdorim personal, i cili dëmin më të madh ia shkakton vetë të pandehurit. Legjislatori nuk ka vetëm të drejtën të miratojë ligje sipas diskrecionit të tij politik (ndër të cilat edhe penale), por njëkohësisht ka dhe detyrimin të miratojë ligje të mira, të cilat së pari nuk bien në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe në radhë të dytë të jenë të zbatueshme dhe efektive në praktikë. GJRRGJ vlerësoi se burgosja e një konsumatori lëndësh narkotike në masë të tillë nuk i shërben asnjë prej qëllimeve të dënimit penal që ndjek legjislacioni shqiptar dhe ai botëror. Cenimi kaq rëndë i lirisë personale nuk përputhet me asnjë qëllim të ligjshëm për një veprim me një rrezikshmëri kaq të ulët për shoqërinë.

Prandaj, për shkak të ndërhyrjes drastike në të drejtat e njeriut, legjislatori duhet të mbajë në konsideratë nevojat reale për ndëshkime penale në rastet kur miraton vepra të reja penale apo rëndon llojet dhe masat e dënimit për vepra ekzistuese. Pa ekzistencën dhe dhënien jetë në praktikë të parimit të proporcionalitetit, kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet aq i zakonshëm dhe i pajustificuar sa mund t'i shndërrojë këto të drejta në mjete propagande dhe demagogjie dhe vetë shoqërinë në pseudodemokratike.

kontradiktor në arsyetimin e tij dhe përbën një hap pas⁹⁴, duke e kthyer parimin e proporcionalitetit në një parim pa asnjë ndikim në të drejtën penale.

Liria personale e lëvizjes përveçse në nenin 5 të KEDNJ, është parashikuar edhe në nenin 27 të Kushtetutës dhe dënimi me burgim nga gjykata kompetente është parashikuar nga pika “a” e paragrafit të dytë të këtij neni si një nga rastet e privimit të saj nga shteti. Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla, si: pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj.⁹⁵. Legjislacioni penal duhet të jetë për çdo vend demokratik një tregues kuptimplotë, i aftë që të balancojë nga njëra anë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër. Në vlerësimin tonë kjo është një arsye esenciale që e ka shtyrë Kushtetutëbërësin të kufizojë Legjislativin në ushtrimin e tagrit të tij ekskluziv për të miratuar ligje penale, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh dhe në atë masë, që të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Me rritjen e vëmendjes së jurisprudencës kushtetuese mbi këtë parim, shumë kode penale ballkanike, si ai i Kosovës, Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Malit të zi dhe Serbisë e kanë bërë parashikimin e parimit të proporcionalitetit apo/dhe të domosdoshmërisë së dënimit penal, pjesë integrale eksplicite të tyre.

3.2.2.1. *Parimi i domosdoshmërisë*

Parimi i domosdoshmërisë, apo *ultima ratio* është njëri nga elementët e parimit të proporcionalitetit në konceptin utilitarist. Legjislacioni penal cënon të drejtat e individëve përmes imponimit të sanksionit penal (p.sh. burgu kufizon lirinë, ndërsa gjoba të drejtën e pronës), prandaj ky parim kërkon kufizimin e këtyre të drejtave me mënyrën më të lehtë të mundshme. E drejta penale është mjeti më drastik i ndërhyrjes në duart e Legjislatorit, prandaj ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit *last resort* në testin e proporcionalitetit (Melandar, 2013: 49).

Ky parim shtrin efektet e veta në ndalimin e kriminalizimit të sjelljeve të gabuara të cilat për shkak të rëndësisë së tyre të vogël jodomosdoshmërisht duhet të konsiderohen si penale, dhe në ndalimin e aplikimit të dënimeve të rënda të cilat poashtu janë jo të domosdoshme. Megjithëse e drejta penale evropiane në një masë të madhe ka hequr dorë nga dënimet e ashpra duke e orientuar

⁹⁴ Është hap pas, pasi zhbën kufizimin e pushtetit ligjvënës në miratimin e ligjeve penale të paarsyeshme, të sanksionuar në vendimet e mëparshme të saja, të cituara më lart (madje për disproporcionalitete më të vogla se ky rast). Në vlerësimin tonë ky vendim i fundit i GJK është kontradiktor, pasi megjithëse në teori thekson se një ligj që kufizon të drejtat themelore përmbush kushtin për t’u konsideruar si i nevojshëm vetëm në rast se ligjvënësi nuk ka pasur mundësi të zgjidhte një mjet tjetër i cili mund të ishte efektiv në të njëjtën mënyrë, por mund të cenonte në një masë më të vogël ose aspak të drejtat themelore dhe është i përshtatshëm kur me ndihmën e tij mund të arrihet rezultati i kërkuar, gjatë argumentimit të rastit konkret, ai nuk i jep përgjigje kërkesës së GjRRGJ Shkodër, për mungesën e efektivitetit të provuar të këtyre masave drastike dhe tërësisht jologjike, të cilat janë të paprecedent në ndonjë vend tjetër demokratik të globit.

⁹⁵ Shih nenin 1/b të K. Penal.

sistemin sanksionator në drejtim të qëllimeve riedukuese dhe rehabilituese, është ngritur nga ana tjetër një shqetësim për mbikriminalizimin e sjelljeve të lehta, duke e rritur shumë numrin e veprimeve të cilat konsiderohen si kriminale (Bengoetxea, et al, 2013: 3).

Ashtu si gjithë parimi i proporcionalitetit, edhe *ultima ratio* shtrin efektet e saja si në aspektin legjislativ ashtu edhe në atë gjyqësor. Ky parim imponon detyrimin që gjykata të aplikojë dënimin më të lehtë të mundshëm, i cili vlerësohet si i mjaftueshëm (përshtatshëm) për të arritur qëllimin e dënimit penal. Pra gjykata duhet të zgjedhë dënimin me gjobë dhe jo atë me burgim, nëse burgimi në atë rast nuk është i domosdoshëm (për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe autorit), duhet të zgjedhë poashtu një dënim alternativ, nëse vuajtja e dënimit të caktuar/mbetur pa vuajtur nuk është i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve të dënimit penal.

GJK me vendimet nr. 19, datë 01.06.2011 dhe nr. 47 datë 26.07.2012 e ka konsideruar dënimin me burgim si një dënim ekstrem apo *extrema ratio*. Po ashtu edhe GJL në disa vendime të saj⁹⁶ ka referuar në Rekomandimin nr. R (99) 22, të KE, në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, për të argumentuar se përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Për këto arsye GJL arsyeton se: “...burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës, dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë ato të cilat nuk e bëjnë këtë.”

Megjithëse këto vendime sjellin një frymë të re me efekte pozitive për shtrirjen e aplikimit të parimit të domosdoshmërisë në praktikën gjyqësore penale, përsëri ato mbeten raste sporadike të pamjaftueshme nga pikëpamja e detyrueshmërisë, për të gjetur zbatim të gjerë. Nga ana tjetër është e qartë se këto vendime kanë fare pak ose aspak impakt në procesin ligjvënës, për miratimin e veprave penale dhe në përcaktimin e nivelit të sanksioneve. Për këto arsye, zgjidhja më optimale do të ishte miratimi i një norme të shkruar (optimalisht në tekstin kushtetues), e cila të implementonte qartësisht parimin e proporcionalitetit dhe të domosdoshmërisë në të drejtën penale shqiptare.

3.2.2.2. Parimi i ekonomisë së dënimit, ose vlerësimi kosto-përfitim

Megjithëse ky parim nuk përmendet shprehimisht në literaturën juridike, vlerësojmë se ai duhet marrë seriozisht në konsideratë në hartimin e politikave të dënimit si në aspektin legjislativ, ashtu edhe në atë gjyqësor. Ky parim rrjedh nga shkencat ekonomike dhe bazohet në analizën e raportit të kostove me përfitimin (Adler & Posner, 2001: 3). Ai ka për qëllim që të vlerësojë nëse shuma e shpenzuar nga fondet publike për të zbatuar një masë të caktuar penale ia vlen si logjikë

⁹⁶ Për ilustrim mund të përmendim vendimet nr. 224 (28), datë 26.01.2012, nr. 1325 (194), datë 04.07.2012, nr. 1672 (347), datë 19.12.2012 dhe nr. 1535 (278), datë 30.10.2013 të KPGJL.

ekonomike në raport me përfitimet që vijnë nga zbatimi i saj. Në rrafshin e së drejtës penale, ky parim synon që të orientojë politikën penale (ligjore dhe atë gjyqësore brenda diskrecionit të saj) në drejtim të zbatimit të alternativave sa më rentabël dhe ekonomikisht më të leverdishme, për arritjen e funksioneve të saj. Në ndryshim nga parimi i proporcionalitetit, i cili vepron nga optika e të drejtave të të pandehurit, parimi i ekonomisë së dënimit motivohet nga interesat e mbrojtjes së fondeve publike dhe rritjes së efikasitetit të tyre në çështjen e dënimit penal. Rëndësia e shqyrtimit të analizës kosto-përfitim në politikën e caktimit të dënimit është e madhe pasi mundësitë financiare dhe njerëzore janë në çdo kohë të pamjaftueshme për të plotësuar të gjitha aspiratat shoqërore edhe në këtë fushë⁹⁷. Për shkak të pamundësisë së plotësimit të të gjitha nevojave në të njëjtën kohë, shtrohet domosdoshmëria e përzgjedhjes së atyre mjeteve të cilat kushtojnë më lirë dhe ofrojnë një efikasitet më të lartë.

Ky parim duhet së pari të udhëzojë ligjvënësin në analizimin e rentabilitetit ekonomik të kriminalizimit të sjelljeve të caktuara me rrezikshmëri të vogël, pasi për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare, mbingarkimi i organeve të drejtësisë me çështje të parëndësishme, do të shmangte fokusimin nga prioritetet e trajtimit të përshtatshëm të veprave më të rënda penale. Për shumë vepra me frekuencë të lartë, por që paraqesin një rrezikshmëri të ulët, duhen hedhur hapa në drejtim të dekriminalizimit të tyre, duke i bërë kundërvajtje administrative (Elezi, 2005: 69), apo duke i njohur prokurorisë pushtet diskrecional për mosfillim procedimi penal për këtë shkak.

Së dyti, ky parim duhet ta orientojë ligjvënësin (por edhe gjykatën) në caktimin e atyre dënimeve të përshtatshme me natyrën e veprës, të cilat të japin rezultatin më të mirë në analizën kosto-përfitim, duke shqyrtuar çdo alternativë tjetër dënimi në dispozicion. Nga këndvështrimi ekonomik, padyshim që burgimi është masa penale më e kushtueshme⁹⁸ dhe nën dritën e këtij

⁹⁷ Kështu p.sh. është e kuptueshme se rritja e stafit të policisë dhe organeve ligjzbatuese në përgjithësi, përzgjedhja e individëve më të ndershëm dhe të motivuar, trajnimi i tyre më i mirë, rritja e pagave dhe e kushteve të punës, pajisja me mjete teknike të avancuara etj., do të ulte ndjeshëm numrin e veprave penale dhe për rrjedhojë edhe të të burgosurve, mirëpo kjo është e përealizueshme në praktikë në çdo vend, sado i pasur që ai të jetë.

⁹⁸ Çështja e kostove të larta është një ndër problemet më të kritikueshme të burgimit. Sipas një studimi të bërë në vitin 2010 raportohej se në Kaliforni shpenzohet më shumë se \$48,000 në vit për të mbajtur një individ në burg, apo mbi 4 herë më shumë se shpenzohet për të ndjekur Universitetin e Kalifornisë. Që nga viti 2010, ky shtet shpenzon nga buxheti i tij më shumë për burgjet sesa për arsimin e lartë (Washington L. Jr., 2011).

Nga ana tjetër në Shqipëri nuk është bërë ndonjë studim i detajuar në lidhje me kostot ditore të burgimit të një personi, mirëpo sipas një vlerësimi të OSBE kostoja mujore e një të burgosuri në Shqipëri është 439 euro në muaj apo 5300 euro në vit (Raunig, 2014). Këto kosto marrin parasysh vetëm shpenzimet që kanë në vit institucionet penitensiare në raport me numrin e të burgosurve, por nuk marrin në konsideratë kosto të tjera shtesë si shpenzimet qeveritare, apo donacionet për ngritjen e burgjeve të reja apo riparimin dhe përmirësimin e atyre ekzistues, shpenzimet që kryejnë familjet për të vizituar dhe kujdesur për të afërmit e tyre të burgosur, mosmarrja e të ardhurave që i burgosuri merrte kur punonte jashtë burgut, rënia e aftësive profesionale të të burgosurve etj. Nga ana tjetër megjithëse shuma prej 5300 euro në vit është shumë e vogël në krahasim me kostot e vendeve të zhvilluara perëndimore, përsëri për ekonominë e brishtë shqiptare këto janë kosto të konsiderueshme po të mbahet parasysh se GDP për frymë në vitin 2013 ishte vetëm 4,652 \$ (World Bank, 2014), apo rreth 3520 euro në vit.

kriteri duhet që ligjvënësi të mbajë në konsideratë rentabilitetin e tij në çdo rast për arritjen e qëllimeve që ai ka si dënim penal. Për shkak të kostove të tij të larta ekonomike, sociale dhe njerëzore, dënimi me burgim duhet të rezervohet vetëm për të pandehur të rrezikshëm dhe për të cilët janë të papërshtatshme alternativat e tjera⁹⁹. Për personat që kryejnë vepra jo të dhunshme dhe tek të cilët mund të realizohen qëllimet e dënimit edhe përmes masave të tjera, duhet zgjedhur ai lloj dënimi i cili siguron raportin më të lartë kosto-përfitim.

Dy dënimet më të admirueshme sipas kërkesave të këtij parimi janë dënimi me gjobë (për personat të cilët kanë të ardhura) dhe puna në shërbim publik (për personat e papunë dhe pa të ardhura). Një dënim (alternativ) me kosto minimale është dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë, apo vuajtja e dënimit në shtëpi, shpenzimet e të cilëve kufizohen vetëm në mbajtjen e strukturës së shërbimit të provës. Siç kanë provuar studimet empirike në Gjermani (Jehle et al, 2010), dënimi me gjobë dhe pas tij ai me kusht kanë një efektivitet më të lartë se burgimi afatshkurtër (për vepra jo të rënda) për uljen e recidivizmit. Nëse këto dy dënime janë më ekonomike dhe në të njëjtën kohë sigurojnë rezultate më të mira për edukimin dhe risocializimin e të dënuarve, mbetet që dënimi me burgim për vepra të lehta të aplikohet vetëm për qëllime ndëshkuese, pa asnjë justifikim utilitarist.

Një lloj i ri dënimi, ndjeshëm më i lirë se burgimi, por më i kushtueshëm se mbikëqyrja e thjeshtë nga shërbimi i provës, është mbikëqyrja intensive elektronike sipas ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”. Megjithatë siç do të trajtohet në kapitullin pasardhës, ky është një dënim alternativ i cili sapo ka filluar të aplikohet në praktikën gjyqësore shqiptare, ai duhet të aplikohet më gjerë ndaj personave të cilët kanë një rrezikshmëri mesatare, për të cilët nuk është i domosdoshëm burgimi i tyre, por që nga ana tjetër është e pamjaftueshme thjeshtë vetëm mbajtja e kontakteve javore apo mujore me shërbimin e provës.

3.2.3. Parimi i barazisë

Parimi i barazisë në sistemin tonë ligjor buron nga neni 18 i Kushtetutës i cili garanton trajtimin e barabartë të të gjithë shtetasve, pavarësisht rrethanave të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Sipas paragrafit të tretë të këtij neni, mund të lejohet një lloj diskriminimi për shkaqet e përmendura më lart nëse ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Parimi i barazisë sipas Aristotelit nënkupton që njerëz në rrethana të ngjashme, duhet të trajtohen ngjashmërisht (1980). I përkthyer në termat e së drejtës penale dhe të caktimit të dënimit, parimi i barazisë kërkon që për

⁹⁹ Në vlerësimin tonë p.sh. tingëllon tërësisht joekonomike shpenzimi nga shteti i një shume dhjetëra apo qindra herë më e madhe se vlera e sendit të vjedhur për mbajtjen në burg të një vjedhësi ordiner, kur me të njëjtën shumë do të kontribuojë në arsimimin apo punësimin e e tij dhe disa të tjerëve njëkohësisht.

të pandehur që kanë kryer vepra të njëjta, duhet të marrin dënim të njëjtë. Ky është kuptimi formal i barazisë dhe sipas tij, dy të pandehur që kanë vjedhur nga një njësi vlere malli duhet të dënohen njësoj.

Megjithëse në dukje me baza të forta morale, ky koncept i barazisë nxjerr probleme të mëdha në praktikë, pasi të gjithë individët janë të ndryshëm, dhe për pasojë koncepti i barazisë formale është një iluzion (Brest, 1976: 1). Kështu, megjithëse të dy autorët e mësipërm të vjedhjes kanë kryer të njëjtën vepër konkrete penale, ata mund të dallojnë nga njëri tjetri në justifikimin e dënimit që duhet t'u caktohet¹⁰⁰. Në vlerësimin tonë, barazia formale është vetëm një udhëzues fillestar, pasi gjykata duhet të orientohet drejt një barazie substanciale dhe të vërtetë. Por në mënyrë që barazia substanciale të mos jetë thjesht një pretekst abuziv për trajtimin e ndryshëm të qytetarëve, zbatimi i saj në praktikë duhet të kufizohet nga një parim tjetër që është ai i arsyetueshmërisë (Toscano, 2012: 84). Vetëm justifikimi i trajtimit të ndryshëm mbi të dhëna objektive dhe të arsyeshme, mund të legjitimojë diskrecionin gjyqësor për të zgjedhur llojin dhe masën e dënimit konkret.

Dualizmi mes barazisë formale dhe substanciale ngre probleme të mëdha teorike dhe praktike. Në aspektin teorik ngrihen probleme të përcaktimit të rrethanave të cilat janë të arsyeshme për të bërë një trajtim të diferencuar të personave të ngjashëm¹⁰¹, ndërkohë që në aspektin praktik ngre problemin e zbatimit të drejtë të këtij parimi, duke vështirësuar ndalimin në çdo rast të abuzimit me të. Për këto arsye vlerësojmë se mekanizmi më efektiv në kontrollin e zbatimit të drejtë të parimit të barazisë në caktimin e dënimit, është detyrimi për arsyetimin e qartë të rasteve kur gjykatat caktojnë dënime të ndryshme për të pandehur në rrethana “në dukje të ngjashme”¹⁰².

Me vendimin nr. 19 datë 1.06.2011 GJK shfuqizoi nenin 34 § 8 pasi sipas saj ai cenonte parimin e barazisë së shtetasve para ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Sipas gjykatës, konvertimi i dënimit me gjobë në burgim, kur personi është në pamundësi objektive për ta paguar

¹⁰⁰ P.sh., njëri mund të jetë i sëmurë apo i papunë dhe ka vjedhur për të blerë ilaçe apo ushqime, ndërkohë që tjetri ka një punë të mirëpaguar, por ka vjedhur për t'i bërë një dhuratë speciale të dashurës së tij; njëri është 16 vjeç dhe i padënuar më parë, ndërkohë që tjetri është 30 dhe i dënuar për të njëjtën vepër disa herë, njëri e ka shpjeguar vetë ngjarjen, është kryefamiljar me tre fëmijë të mitur për të cilët ka detyrë për t'u kujdesur, ndërkohë që tjetri nuk e pranon kryerjen e veprës etj.

¹⁰¹ P.sh. arsimimi i mirë, apo mangësitë në formimin kulturor të një të pandehuri duhet të shërbejnë si një rrethanë që justifikon një dënim më të butë apo më të ashpër? Në rastin e dhunës në familje, mungesa e një arsimimi solid dhe një formim kulturor patriarkal duhet ta shtyjë gjykatën në zbutjen e dënimit, mirëpo nga ana tjetër një person i arsimuar dhe që e ka pranuar fajësinë ka nevojë për një periudhë më të shkurtër burgimi apo prove me qëllim riedukimin e tij, pasi objektivist aftësitë e tij intelektuale janë më të mëdha. Numri i rrethanave të cilat nuk janë parashikuar nga ligji ynë penal, por që ndikojnë drejtpërdrejtë në caktimin e dënimit penal janë të shumta dhe do të trajtohen më poshtë në seksionet pasuese të trajtimit të diskrecionit gjyqësor.

¹⁰² GJK e ka trajtuar parimin e barazisë para ligjit në caktimin e dënimit në vendimin e saj nr.15, datë 22.07.2008. Rasti para saj kishte të bënte me shtetasin H.T. i cili ishte dënuar me 20 vite burgim, nga GJL, ndërkohë që të bashkëpandehurit e tjerë për të njëjtat vepra ishin dënuar me nga 17 vite burgim. Megjithëse GJK e rrëzoi këtë kërkesë (për këtë pretendim), pasi pala kërkuese nuk kishte paraqitur shkaqet se ku konsistonte realisht shkelja e barazisë, ky vendim shërben si një udhëzim për të orientuar në të ardhmen mbrojtjen e parimit të barazisë nga GJK, në rast se provohet se gjykata në mënyrë të pajustificuar ka caktuar një dënim të pabarabartë me të dënuar të ngjashëm.

atë (çka do të thotë se burgimi nuk varet nga ana subjektive e autorit, por nga kushtet ekonomike të tij), do të shkaktonte një trajtim të diferencuar vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës. Pas daljes së këtij vendimi, me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012, Legjislatori shtoi në paragrafin e gjashtë fjalinë: *“Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to”*. Duke qenë se neni 29 i K. Penal parashikon vetëm burgimin dhe gjobën si dënime kryesore, në zbatim të kësaj norme të re, gjykata duhet gjithnjë të caktojë dënim me burgim ndaj personave të cilët nuk kanë mundësi ekonomike të paguajnë masën e gjobës që meritojnë t’u caktohet sipas kriterëve të nenit 47 të K. Penal.

Zgjidhja që mund të vijë nga aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, nuk e zgjidh në thelb këtë diskriminim të rëndë të personave të varfër, pasi në raste të caktuara këto alternativa mund të jenë të paaplikueshme¹⁰³. Në vlerësimin tonë zgjidhjet e duhura kërkojnë ndërhyrje të thella në sistemin e sanksioneve penale. Mënyra e parë (siç jemi shprehur në kapitullin II) është adaptimi i sistemit të gjobave ditore, i cili ofron një barazi substanciale mes të pandehurve, pavarësisht mundësive të tyre ekonomike. Ky sistem i implementuar në shumicën e vendeve të Evropës ofron mundësinë që dënimi me gjobë të caktohet edhe ndaj një personi me të ardhura të pakta, në proporcion me rëndësinë e veprës së kryer dhe me mundësitë e tij ekonomike. Mënyra e dytë e korrigjimit të kësaj pabarazie ligjore është parashikimi i disa dënimeve alternative apo plotësuese si dënime kryesore (Tumminello, 2010: 278).

Nëse tashmë gjobat ditore janë një institut i gjithëpranuar nga shumë legjislacione moderne penale, pyetja që natyrshëm mund të shtrohet është nëse kjo logjikë mund të zbatohet edhe tek dënimi me burgim apo edhe dënimet plotësuese. Në respekt të konceptit utilitarist të qëllimit të dënimit, në rastin e dënimit me burgim kjo çon në rezultatin që dy autorë të cilët kanë kryer vepra penale me rrezikshmëri të njëjtë, duhet të marrin masa të ndryshme dënimi me burgim, në varësi të efektit që ka burgimi tek secili prej tyre. Pra nëse për njërin prej tyre një muaj burgim përjetohet shumë keq dhe përbën një traumë të rëndë, kjo sugjeron caktimin e një dënimi të shkurtër, ndërkohë që për një person më “rezistent” ndaj efektit traumatik të burgimit, duhet të caktohet një kohë më e gjatë. Megjithatë ky diferencim në teori duket i arsyeshëm për të mbështetur një trajtim të diferencuar, vlerësojmë se ai është shumë i rrezikshëm nëse implementohet në praktikë, pasi nuk mund të gjendet një etalon i cili të vlerësojë paraprakisht efektin ndëshkues, parandalues dhe edukues të një njësie kohe burgim për karaktere apo personalitete të ndryshme njerëzish.

¹⁰³ Alternativat e dënimit me burgim, nuk arrijnë të plotësojnë mjaftueshëm qëllimin ndëshkues të dënimit penal, i cili është i nevojshëm të ndiqet sidomos në rastet kur të pandehurit nuk e pranojnë fajësinë, ndërkohë që dënimi me gjobë arrin ta plotësojë këtë qëllim përmes dhimbjes që shkakton në uljen e pasurisë. Po ashtu nuk mund të aplikohet p.sh. puna në shërbim publik, nëse i pandehuri refuzon ta kryejë atë, është pensionist apo është i paaftë fizikisht për ta kryer.

3.2.4. Konsistenca në caktimin e dënimit

Konsistenca në caktimin e dënimit ka të bëjë me trajtimin e barabartë dhe të njëjlojtë të të pandehurve në kohë të ndryshme. Konsistenca në caktimin e dënimit është manifestimi në kohë i parimit të barazisë dhe ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e parashikueshmërisë së dënimit penal si pjesë e parimit të ligjshmërisë. Ky nuk është një parim eksplícit i së drejtës penale, por mund të trajtohet si një parim që përmbledh në vetvete zbatimin e disa parimeve, si atë të ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë dhe arsyetueshmërisë. Konsistenca nuk ka ndonjë vlerë morale nëse trajtohet si detyrimi i gjykatës për të caktuar lloje dhe masa dënimi të njëjta për raste “dukshëm të ngjashëm”, por vetëm nëse trajtohet si zbatim i njëjlojtë i parimeve të mësipërme në çdo rast të caktimit të dënimit. Pra gjykatat duhet që të vendosin në mënyrë konstante qëllimet (apo qëllimin primar dhe ato dytësore) që ndjek dënimi penal, dhe parimet mbi bazën e të cilave zgjedh llojin dhe masën e dënimit.

Vlen të silllet në vëmendje se qëndrueshmëria nuk nënkupton staticizëm absolut në interpretimin e parimeve dhe kriterëve të caktimit të dënimit, por një detyrim për t'i qëndruar precedentëve të mëparshëm, derisa të gjenden arsye të shëndosha të cilat shpjegojnë hollësisht se qëndrimi i mëparshëm ka qenë i gabuar, dhe ndryshimi i kësaj praktike në vijim, përbën një korrigjim të gabimit të së shkuarës. Vetëm në këtë kuptim konsistenca mund të kuptohet si një detyrim për dhënien e drejtësisë. Parimi i drejtësisë në caktimin e dënimit i parashikuar në nenin 1/c të K. Penal, nuk mund të kuptohet ndryshe, përveçse si zbatimi me korrektësi i të gjitha normave të shkruara (Elezi et al, 2013: 48) dhe i interpretimit që GJEDNJ, GJK dhe GJL u kanë bërë parimeve dhe kriterëve të caktimit të dënimit. Në këtë kuptim, testi i konsistencës së vendimmarrjes së gjykatës është mjeti i vetëm objektiv për të analizuar drejtësinë e vendimeve gjyqësore në raste konkrete. Duke sintetizuar konstatimet e mësipërme, mund të themi me siguri se provimi i konsistencës në caktimin e dënimit është çështja më e komplikuar dhe e vështirë e së drejtës penale. Në rrafshin praktik, sukcesi i analizimit të konsistencës kërkon një përcaktim të qartë ligjor të parimeve dhe kriterëve të caktimit të dënimit dhe në mungesë të tyre, një interpretim unifikues nga GJL për këto çështje shumë të rëndësishme të së drejtës penale. Nëse këto parime dhe kriterë nuk fiksohen në K. Penal dhe shtjellohen në mënyrë unifikuese nga GJL, atëherë konsistenca dhe drejtësia në caktimin e dënimit penal në vendin tonë do të mbetet jo vetëm e pareaalizuar, por madje edhe e paanalizuar. Kjo më tej lind nevojën e trajtimit të qëllimeve të dënimit penal, pasi përveç funksionit ndëshkues, i cili ka në princip proporcionalitetin e dënimit mbi bazën e shkeljes së kryer (pra pa dalluar karakteristikat e kryerësit), tek funksionet parandaluese, paaftësuese apo rehabilituese, karakteristikat e kryerësit kanë një rëndësi të dorës së parë.

3.2.5. *Parimi i drejtësisë*

Megjithëse, parimi i drejtësisë në caktimin e dënimit është parashikuar në nenin 1/c të K. Penal, në vlerësimin tonë ai nuk ka një kuptim konkret si një parim më vete i identifikueshëm dhe që ndikon në caktimin e dënimit. Siç u shprehëm më lart ai më së shumti mund të kuptohet si një term i cili përmbledh detyrimin e gjykatës për të respektuar parimet e tjera të caktimit të dënimit penal (ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe barazinë)¹⁰⁴, dhe nga ana tjetër rrethanat faktike të veprës dhe të pandehurit të sjella para gjykatës përmes provave të marra në gjykim.

3.2.6. *Parimi i humanizmit*

Parimi i humanizmit është parimi i fundit, i cili duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit. Ky parim shtrin zbatimin e tij në kuadrin e përcaktimit të përgjegjësisë penale dhe të caktimit të dënimit (Elezi et al, 2013: 50). Një pjesë e parimit të humanizmit (që ka të bëjë me caktimin e dënimit) është mishëruar në një sërë dispozitash, si: caktimi i dënimit për të miturit, ulja e dënimit nën minimumin ligjor, dënimet alternative, ndalimet e dënimeve johumane etj. (Muçi, 2012: 63). Mirëpo, në vlerësimin tonë parimi i humanizmit shtrin frymën e tij dhe duhet mbajtur në konsideratë edhe në caktimin e dënimit ndaj të pandehurve konkretë. Sa i takon caktimit të dënimit, megjithëse ky parim ka në përmbajtje të tij një nuancë joshkencore¹⁰⁵, ai buron nga arsyeja se njeriu është një qenie komplekse dhe e gabueshme, me një sërë nevojash dhe vështirësish.

Kur Legjislatori cakton marzhet e dënimit për vepra të veçanta, zakonisht ka parasysh një mashkull të shtresës së mesme, rreth të tridhjetave, i cili megjithëse ka një punë, një shtëpi dhe një jetë të qetë, zgjedh me ndërgjegje të prishë rregullin dhe rendin publik. Ky standard “kriminel hipotetik i zakonshëm”, ndeshet rrallë në mos kurrë në bankën e të akuzuarve, ku zakonisht ulen individë më së shumti me të shkuar të trishtë. Nga të dhënat empirike rezulton se sistemi penal është sistemi i cili merret më së shumti me keqbërjen e të varfërve, të paarsimuarve, personave të sëmurë mendorë, atyre të varur ndaj drogës dhe alkoolit (Hudson, 2009: 372), apo të braktisur nga shoqëria, prandaj do të ishte cinik caktimi i dënimit penal ndaj tyre vetëm mbi bazën e parimit të proporcionalitetit (qoftë sipas qëllimit retribucionist qoftë utilitarist).

Ky parim kërkon që gjyqtarët të mbajnë në konsideratë dhe ndjenja të tilla njerëzore, si: keqardhja, dhembshuria, mëshira, apo falja, të cilat duhet të ndikojnë në zbutjen e magnitudës së forcës shtrënguese të shtetit për keqbërjen e kryer. Kështu p.sh. është tërësisht e ligjshme për shkak të

¹⁰⁴ Parimi i drejtësisë në caktimin e dënimit, sipas nenit 6/1 të K. Penal të Federatës Ruse nënkupton që dënimi i caktuar ndaj të pandehurit duhet të jetë në përputhje me karakterin dhe shkallën e rrezikshmërisë së veprës së kryer, rrethanave të kryerjes së saj dhe personalitetit të të pandehurit.

¹⁰⁵ Në kuptimin që nuk mund të identifikohet një set rregullash mbi bazën e të cilave të mund të definohet qartë shkalla dhe mekanizmi i ndikimit të këtij parimi mbi dënimin penal. Pra është e kuptueshme se humanizmi është një parim i cili e shtyn gjyqtarin të mbajë në konsideratë të pandehurin si qenie njerëzore, por nuk mund të bëhet një parashikim i përafërt se në ç’masë do të ndikojë ky parim në çdo rast konkret.

keqardhjes dhe dhembshurisë, aplikimi i një dënimi alternativ ndaj një drejtuesi mjeti i cili nga aksidenti ka dëmtuar veten, apo ka shkaktuar vdekjen e familjarëve të tij. Do të ishte poashtu njësoj e ligjshme dhe e arsyeshme, aplikimi i një dënimi alternativ ndaj një të pandehuri, i cili megjithëse ka kryer një krim relativisht të rëndë (si mbajtje pa leje të armëve luftarake, apo kultivim i bimëve narkotike), ka detyrimin të kujdeset i vetëm për fëmijët e tij të mitur, apo të afërm të tjerë, të cilët në të kundërt do të merrnin edhe ata një dënim poashtu të rëndë dhe krejtësisht të padrejtë.

3.3. Caktimi i dënimit penal nga gjyqtari

Nuk ka ndonjë aspekt të administrimit të drejtësisë në të cilin pranimi publik i vendimmarrjes gjyqësore është më i rëndësishëm dhe më i vështirë që të mbështetet, sesa caktimi i dënimit ndaj të pandehurve.

A. M. Gleeson, Kryetar i Gjykatës së Lartë Australiane, 1998-2008 (New South Wales Attorney-General's Department, 1994: 2).

Caktimi i dënimit penal nga gjyqtari është një nga çështjet më kontroversiale të së drejtës penale, pasi përplas me njëra tjetrën nevojën për individualizimin e dënimit sipas rrethanave konkrete të kryerjes së veprës penale dhe të autorit të saj dhe nga ana tjetër faktin se ky individualizim është në dorën e gjyqtarit si qenie njerëzore me një dozë të lartë subjektivizmi. Roli i gjyqtarit në caktimin e dënimit përshkruhet më së miri nga parimi i diskrecionit (Sporer & Goodman, 2009: 381). Në këtë seksion do të trajtojmë përmbledhtazi diskrecionin gjyqësor në caktimin e dënimit dhe mekanizmat për ta bërë atë t'i shërbejë dhënies së drejtësisë.

3.3.1. Diskrecioni i gjyqtarit.

Diskrecioni absolut është një padron i pamëshirshëm që shkatërron lirinë më shumë se çdo shpikje tjetër njerëzore.

(United States v. Wunderlich, 1951)

Diskrecioni gjyqësor është hapësira e lirisë që vetë ligji i ka garantuar gjyqtarit për të përzgjedhur masat më të përshtatshme për të realizuar qëllimet e ligjit. Pra megjithëse diskrecioni është një hapësirë lirie e garantuar ndaj individit gjyqtar, justifikimi i njohjes së kësaj lirie është përsëri zbatimi sa më i mirë i ligjit në garantimin e trajtimit të barabartë dhe të drejtë të shtetasve para tij. Diskrecioni gjyqësor penal është i kufizuar sa i takon çështjes së fajësisë, pasi ligji ndalon zbatimin e ligjit me analogji, paqartësitë dhe mjegullnajën në tekstet e ligjeve që përcaktojnë veprat penale si dhe efektin prapaveprues të ligjit që parashikon një vepër të re penale (Danaj, 2012: 66). Nga ana tjetër në lidhje me caktimin e dënimit, gjykatës i është siguruar një diskrecion më i gjerë, pasi vetë legjislatori e ka të pamundur të parashikojë çdo lloj rrethane konkrete dhe kombinim rrethanash që kanë lidhje me këtë moment. Gjithsesi, duhet pasur parasysh se sanksioni penal kalon nëpër tre faza: faza e kërcënimit të dënimeve, momenti i caktimit të dënimit nga gjykata dhe

faza e ekzekutimit të dënimit (Zannotti, 1999: 723). Sa i takon fazës së kërcënimit, pra fazës së parashikimit ligjor të dënimit, mbi të vepron parimi i ligjshmërisë absolute, njësoj si në çështjen e fajësisë. Mirëpo ky diskrecion është relativisht i gjerë në fazën e dytë të caktimit të dënimit, saqë nga disa autorë kritikë (Ashworth, 1995: 331) është quajtur si “sistem kafeneje” i cili u lejon gjyqtarëve të zgjedhin pa kufizim motivimin që u leverdis për rastin. Po ashtu, megjithëse në masë më të vogël, diskrecionaliteti gjyqësor zbatohet edhe në fazën e ekzekutimit të dënimit, me qëllim që ai t’i përshtatet sa më shumë riedukimit të të dënuarit¹⁰⁶.

Megjithë kritikën, diskrecioni gjyqësor gjatë procesit të caktimit të dënimit, është mënyra e vetme për të siguruar sa të jetë e mundur një trajtim të barabartë para ligjit të rasteve të ndryshme. Realizimi në praktikë i këtij objekti ideal, është shumë i vështirë, nga njëra anë për shkak të kompleksitetit të elementëve të tij dhe nga tjetra për shkak se edhe vetë gjyqtari (ashtu si edhe i pandehuri) manifeston elementë të pamohueshëm të individualitetit njerëzor. GJK italiane¹⁰⁷ është shprehur se mjeti më i përshtatshëm për të arritur objektivat e ndëshkimit, madje edhe më i arsyeshëm se parimi i barazisë (formale), është fleksibiliteti i dënimit.

Diskrecioni gjyqësor në caktimin e dënimit ka të bëjë drejtpërdrejtë me parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike. Në rastin kur është gjyqtari, autoriteti i vetëm që vendos mbi dënimin apo jo të të pandehurit, si dhe llojin dhe sasinë e dënimit që do t’i caktohet, parashikueshmëria e dënimit është e pamundur. Ky rast i diskrecionit maksimal gjyqësor dhe i ligjshmërisë minimale është zbatuar në Romën e lashtë (Brasiello, 1964: 961) dhe vazhdon të zbatohet me një intensitet më të ulët edhe aktualisht në Arabinë Saudite (Newman, 2010: 359). Në rastin e kundërt të ligjshmërisë absolute, sanksionet penale janë të fiksuara me ligj dhe roli i gjyqtarit është i pavend për të bërë individualizimin e dënimit pasi atë e bën ligji për çdo kryerës të veprave penale, pavarësisht rrethanave të veprës dhe të autorit. Parimi i ligjshmërisë absolute në individualizimin e dënimit ka pasur aplikim më të gjerë në shekullin XVII (Dolcini, 1968: 25), por reminishenca të të këtyre tendencave kanë vijuar deri në ditët tona. Mjafton të risjellim në vëmendje faktin se me ligjin nr. 8175 datë 23.12.1996 u ndryshuan shumë nene të pjesës së posaçme të kodit sapomiratur penal¹⁰⁸, duke vendosur për to dënime fikse me burgim. Kjo praktikë ligjore është tashmë e ndaluar në të gjitha vendet demokratike, pasi cënon parimin e proporcionalitetit dhe të individualizimit të dënimit.

¹⁰⁶ P.sh. sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet mundësia e uljes nga gjykata të dënimit deri në 90 ditë në vit për sjellje shembullore, apo lirimi para kohe me kusht i parashikuar në nenin 64 të K. Penal, i cili ka një dozë të konsiderueshme diskrecioni e cila varion nga niveli i ashpërsisë së sanksionit të caktuar nga gjykata.

¹⁰⁷ Corte cost., 2-14 aprile 1980, n. 50, in Corte costituzionale della Repubblica Italiana.

¹⁰⁸ Praktikë e cila megjithëse u konsiderua si antikushtetuese me vendimin nr. 13, datë 29.5.1997 të GJK, u rishfaq përsëri në 4 dispozita të pjesës së posaçme të cilat akoma edhe sot janë në fuqi (shih më lart në nënseksionin “Individualizimi ligjor i dënimit”).

Në një pozicion të ndërmjetëm mes ligjshmërisë absolute dhe diskrecionalitetit absolut qëndron diskrecionaliteti i strukturuar (O'Connor & Rausch, 2007: 99), i cili mbështetet në gjetjen e një pike ekuilibri mes nevojës për ligjshmëri dhe parashikueshmëri dhe nevojës për individualizimin e dënimit (Bertoli, 2008: 15). Nëpërmjet njohjes së diskrecionit gjyqësor, legjislativi heq dorë vullnetarisht nga një pjesë e pushtetit të tij për të përcaktuar me ligj dënimet për vepra konkrete, duke u kufizuar në skicimin e shinave orientuese të ushtrimit të këtij diskrecioni, për vepra penale abstrakte. Ky lloj sistemi i caktimit të dënimit është e vetmja zgjidhje e pranueshme nga pikëpamja kushtetuese, për të pajtuar me njëra-tjetrën parimet e së drejtës penale që kanë të bëjnë me caktimin e dënimit¹⁰⁹.

Çështja vjen dhe komplikohet në zbatimin në praktikë të këtij parimi nga Ligjvënësi, gjatë miratimit të dënimeve për vepra konkrete. Në raste të tilla shtrohet pyetja se sa duhet të jetë marzhi i diskrecionit të lejuar gjyqtarit, brenda të cilit ai do të ketë hapësirë të vlerësojë rrethanat konkrete. Siç u trajtua edhe më lart, K. Penal shqiptar nuk ka ndjekur një ligjësi të qartë në garantimin e diskrecionit gjyqësor, pasi për vepra të ngjashme parashikohen jo vetëm dënime të ndryshme, por edhe hapësira diskrecioni të ndryshme¹¹⁰. Duke qenë se diskrecioni gjyqësor është i domosdoshëm për individualizimin e dënimit, për shkak të pamundësisë së parashikimit të çdo lloj rrethane konkrete, prej saj rrjedh një ide e vlefshme se çdo lloj hapësire diskrecioni do të vlerësohet e tepërt për rrethana të zakonshme, të cilat mund të parashikohen lehtë nga Ligjvënësi. Lënia gjykatës e një hapësire diskrecioni jo të domosdoshëm (Robinson, 1988: 459) vjen në kundërshtim me vetë *ratione-n* e garantimit të tij.

Pra fusha e vlerësimit gjyqësor duhet të rezervohet vetëm për situata dhe rrethana të veçanta, apo kombinime të tillash, të cilat nuk janë të përditshme dhe të sigurta se do të ndodhin. Për rrethanat të cilat parashikohen lehtë nga Ligjvënësi, lënia e dënimit në diskrecion të gjerë të gjykatës është tërësisht e pajustificuar. Rrethana të tilla mund të jenë të shumta, që nga ato të përbashkëta për shumë vepra penale, si: shkalla e fajësisë, pasoja të rënda, kryerja e veprës në bashkëpunim, apo më shumë se një herë etj. dhe rrethana të veçanta për vepra specifike.

Nga ky arsyetim mund të konkludojmë se në vend të garantimit të një diskrecioni tepër të gjerë gjyqësor, Ligjvënësi duhet t'i përshkallëzojë veprat penale në disa nivele me hapësira më të ngushta diskrecioni në varësi të rrethanave konkrete. Kjo nënkupton ndarjen e figurave të veprave

¹⁰⁹ Rekomandimi no. R (92) 17 i KE ofron udhëzime të dobishme për shtetet të cilat duan të reformojnë politikat e tyre penale. Ky rekomandim bashkon njëtrajtshmërinë dhe fleksibilitetin, duke përjashtuar qasjen e dënimeve të ngurta, të cilat mund të krijojnë pabarazi duke i trajtuar çështjet e ndryshme sikur të ishin të ngjashme (CMCE, 1992).

¹¹⁰ Shih p.sh. nenin 135 (vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën) dhe nenin 176 (kontrabanda e vlerave kulturore), të cilat parashikojnë dënim me burgim gjer në dhjetë vjet, apo nenin 289 §2 të K. Penal (shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë), i cili ka diskrecionin më të gjerë në K. Penal pasi parashikon dënim me burgim jo më pak se pesë vjet (deri në 35 vite).

penale në disa paragrafë, apo edhe në nene më vete¹¹¹. Megjithëse kjo teknikë e ndarjes së veprave penale është zbatuar në disa raste në K. Penal shqiptar, në vlerësimin tonë ajo akoma nuk është e plotë¹¹² dhe ka nevojë për shtrirjen e saj në mjaft vepra të tjera penale. Edhe fakti se nga një krahasim i K. Penal shqiptar me shumë kode të tjera penale të rajonit dhe të vendeve kryesore evropiane¹¹³ konstatohet se ai është më i kursyer në ndarjen e veprave penale në disa nene dhe nenet në disa paragrafë (Nikolli, 2015a: 303), sugjeron nevojën për kufizimin e diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit, përmes ndarjes së figurave të veprave penale.

3.3.2. Vështrim krahasues i diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit

Megjithëse sigurimi i diskrecionit gjyqësor është një praktikë e të gjitha vendeve demokratike, gjerësia e tij varion nga vendi në vend në varësi të traditës juridike dhe vullnetit legjislativ nga i cili buron. Në vendet e sistemit të së drejtës penale të kodifikuar, diskrecioni gjyqësor shpërndahet mes normave të pjesës së përgjithshme dhe asaj të posaçme. Kështu në pjesën e përgjithshme gjenden normat që përcaktojnë llojet e dënimeve që ka në dispozicion gjyqtari dhe kohëzgjatjen e tyre, ndarjen e tyre në kategori¹¹⁴ dhe specifikimet ligjore për rastet dhe mundësitë e aplikimit të tyre. Më tej në pjesën e përgjithshme përcaktohen edhe kriteret ligjore të cilat duhet të mbajë parasysh gjyqtari në caktimin e dënimit. Këto lloj normash përbëjnë kuadrin ligjor të individualizimit gjyqësor të dënimit në kuptimin e ngushtë dhe kufizojnë caktimin arbitrar të dënimit. Së treti një peshë të madhe në përcaktimin e shkallës së diskrecionit gjyqësor zë hapësira e përzgjedhjes së dënimit e lejuar nga çdo nen i pjesës së posaçme, i cili përcakton veprat penale dhe sanksionet e lejuara për atë vepër. Dispozitat konkrete përcaktojnë hapësirat e përzgjedhjes së llojit të dënimit më të përshtatshëm për rastin konkret si dhe vëllimin e tolerancës së sasisë së dënimit që mund të caktohet nga gjyqtari.

K. Penal gjerman siç u trajtua në kapitullin II parashikon një hapësirë të gjerë të zgjedhjes së dënimit për një vepër konkrete. Në shumicën e veprave penale parashikohen vetëm dënimet maksimale, por ka dhe një numër dispozitash që parashikojnë minimum të dënimit (zakonisht për

¹¹¹ Shembuj të lavdërueshëm të kufizimit të diskrecionit gjyqësor përmes ndarjes së veprave penale në disa paragrafë janë nenet 134, 186, 278, 290 etj. Këto shembuj janë të lavdërueshëm sa i takon teknikës legjislative, por jo domosdoshmërisht në lidhje me ashpërsinë e sanksioneve që ato parashikojnë. Ndërkohë që ndarja e veprave penale të ndryshme në disa nene duhet të bëhet për të gjitha ato vepra të cilat për shkak të elementëve të ndryshëm kualifikues, shfaqin një rrezikshmëri të ndryshme shoqërore. Kështu p.sh. veprat penale të vrasjes apo të vjedhjes janë ndarë në disa figura krimi më vete në varësi të formave të fajit, të objektit specifik të goditur, mënyrës së kryerjes së veprës etj.

¹¹² P.sh. neni 76 i K. Penal duhet të ndahet në së paku 2 paragrafë, neni 134 duhet të ndahet përsëri duke parashikuar si vepra penale më vete vjedhjen e automjeteve, vjedhjen e banesave, apo vjedhjen me dhunë me pasoja të lehta (si p.sh. vjedhjen e një celulari apo të një çante nga dora dhe largimin me vrap), neni 283 (prodhimi dhe shitja e narkotikëve), duhet të ndahet në disa vepra të reja duke ndarë më vete drogat e forta nga ato të buta dhe po ashtu mbajtjen e lëndëve narkotike për konsum personal nga mbajtje për qëllime shitjeje. Më tej nenet e dala nga neni 283 aktual, mund të ndahet përsëri në paragrafë të tjerë, në varësi të sasisë së lëndës narkotike të sekuestruar.

¹¹³ Shembuj të tillë janë K. Penale të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Rusisë, Spanjës, Italisë, Francës, Gjermanisë etj.

¹¹⁴ Si p.sh. ndarjen në dënime kryesore dhe plotësuese apo ndarje të tjera si dënime komunitare, masa për toksikopendentët dhe të sëmurët mendorë, vërejtje gjyqësore etj.

krime të rënda). Neni 38 i kodit parashikon dënimin minimal prej një muaji burgim, por sipas nenit 47 dënimet deri në 6 muaj burgim duhet të aplikohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, duke iu qasur gjobave ditore apo dënimeve të tjera alternative (Nestler, 2004: 112).

Në Francë veprat penale ndahen në 3 kategori dhe më tej për secilën prej tyre parashikohet një shkallëzim i dënimeve në disa gradë¹¹⁵. Më tej në nenet 132-1 deri në 132-77 parashikohet një rregullim tjetër tepër i detajuar për kriteret e përzgjedhjes së dënimit, për rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe dënimet e ndryshme alternative. Pjesa e posaçme e kodit parashikon dënimin maksimal, ndërsa dënimi konkret caktohet duke zbatuar rregullat e mësipërme. Kjo lloj ndarjeje e veprave dhe detajimi i madh i rasteve të aplikimit të dënimeve të shumta të parashikuara e bën K. Penal francez unik në aspekt të rregullimit të diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit.

K. Penal italian parashikon pushtetin diskrecional të gjykatës në caktimin e dënimit në nenin 132. Sipas këtij neni, brenda kufijve të fiksuar nga ligji, gjyqtari cakton dënimin në mënyrë diskrecionale, por duhet të tregojë gjithnjë motivet që justifikojnë përdorimin e një pushteti të tillë (Fiandaca & Musco, 2009: 753-756). Në rritjen apo uljen e dënimit nuk mund të tejkalohen limitet e vendosura për secilin lloj dënimi, përveç rasteve shprehimisht të parashikuara nga ligji. Neni 133 parashikon se dënimi konkret përzgjidhet në varësi të rëndësisë së veprës (e cila përfshin shumë elementë të listuar nga ky nen)¹¹⁶ dhe aftësinë për të kryer vepra penale të personit fajtor (e cila po ashtu përcaktohet nga disa elementë të listuar në këtë nen¹¹⁷). Në nenet 61-79 parashikohen në detaje rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe ndikimi konkret i tyre në caktimin e dënimit¹¹⁸. Sa i takon marzheve të dënimit në pjesën e posaçme të K. Penal, ato gëzojnë një tolerancë të gjerë mes minimumit dhe maksimumit.

Në vendet e sistemit *common law*, përveç kufizimeve ligjore të vendosura në statute është ndjekur edhe praktika e miratimit të udhëzuesve të caktimit të dënimit *sentencing guidelines*. Arsyeja e adaptimit të udhëzuesve është t'u sigurojë gjyqtarëve udhëzime mbi faktorët që gjykata duhet të mbajë në konsideratë kur të dënojë një të pandehur, promovojë transparencën dhe të sigurojë që gjykatat në të gjithë vendin të jenë konsistente në dënimin e të pandehurve. Natyra detyruese dhe shkalla e kufizimit të diskrecionit gjyqësor ndryshon ndjeshëm brenda vendeve të kësaj tradite. Kështu në Angli dhe Wells është e detyrueshme ndjekja e udhëzuesit të caktimit të dënimeve, përveçse kur gjyqtari arsyeton se devijimi nga udhëzimi është në interes të drejtësisë (Coroners

¹¹⁵ Shih nenet 131-1 deri në 131-36-8 të K. Penal francez.

¹¹⁶ 1) nga natyra, lloji, mjetet, objekti, koha, vendi dhe çdo modalitet i veprimit; 2) nga graviteti i dëmit apo rreziku i shkaktuar personit të dëmtuar dhe 3) nga intensiteti i dashjes apo shkalla e fajit.

¹¹⁷ 1) nga motivet e kryerjes së veprës dhe nga karakteri i kriminelit; 2) nga precedentët penal e gjyqësor dhe në përgjithësi nga sjellja dhe jeta e kriminelit përpara krimit; 3) nga sjellja e përkohshme apo pasuese e krimit dhe 4) nga kushtet e jetës individuale, familjare dhe sociale të kriminelit.

¹¹⁸ K. Penal italian parashikon konkretisht efektin e matshëm të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në dënimin përfundimtar, në rastet kur ato paraqiten të vetme apo të kombinuara me njëra-tjetrën në një vepër konkrete.

and Justice Act 2009). Në SHBA udhëzuesit e caktimit të dënimit kanë filluar të implementohen që në vitet '70 në disa shtete dhe në rang federal. Këto udhëzime kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në caktimin e dënimit nga gjykatat amerikane, megjithëse shumica e shteteve nuk i ka miratuar ato dhe në ato shtete ku praktikohen, nuk kanë të njëjtën natyrë detyruese (Chanenson, 2013: 3). Miratimi i udhëzuesve të caktimit të dënimit në sistemin federal dhe në disa shtete me peshë ka bërë që këto udhëzues të konsiderohen në SHBA si një burim i fuqishëm i kufizimit të abuzimit të pushtetit gjyqësor në caktimin e dënimit¹¹⁹. Australia, megjithëse pjesë e kësaj familje ligjore e ka parë me dyshim implementimin e udhëzuesve, duke u konsideruar nga gjyqtarët si një praktikë tepër kufizuese për parimin e individualizimit të dënimit. Megjithë tentativën për të implementuar udhëzues, ajo nuk ka gjetur mbështetje të gjerë, duke i lënë hapësirë metodave të tjera të kufizimit të diskrecionit si vendimet unifikuese (guideline judgments), përcaktimi i minimeve të detyrueshme, apo puna e këshillave të caktimit të dënimit (Krasnostein & Freiberg, 2013).

Së fundmi, meriton të përmendet se teknika e udhëzuesve për caktimin e dënimit e kombinuar me zhvillimet e teknologjisë informatike, ka bërë që të fillojë të eksperimentohet individualizimi i dënimit nga programe kompjuterike. Kështu fillimisht në vitin 1994 shteti i Floridës implementoi një bazë të dhënash kompjuterike të quajtur SAGES (Sentencing Analysis and Guidelines Entry Systems), i cili shërbente për të ruajtur pikëzimet e të pandehurve (Florida Department of Corrections, 2001). Më tej edhe shtete të tjera amerikane, si Minnesota kanë përdorur në një masë të kufizuar programe kompjuterike për ndihmuar për të llogaritur dënimin me burgim që u caktohet të pandehurve (governing.com, 2015). Rasti më i spikatur i caktimit të dënimit nga programe kompjuterike ka qenë në provincën lindore të Kinës, Shandong, ku rreth 1500 të pandehur janë dënuar (një pjesë e të cilëve edhe me vdekje) nga një program kompjuterik i quajtur “llogaritësi i dënimit”. Ky program i pajisur me një bazë të dhënash të sofistikuar, ndihmon gjyqtarët për të caktuar dënimet për 100 krime të rënda (dailymail, 2006).

3.3.3. Qëllimet e ndryshme të dënimit, si një pengesë e kufizimit të diskrecionit gjyqësor

Çështja e përcaktimit të qëllimit që ndjek dënimi penal nuk është thjeshtë një çështje filozofike, morale apo humanizmi, por së pari një çështje esenciale e caktimit të dënimit. Qëllimi i dënimit penal është boshti kryesor i cili përcakton jo vetëm politikën legjislative të caktimit të dënimit, por edhe atë gjyqësore dhe të organeve të tjera të ekzekutimit të dënimeve (ku më kryesoret janë ato penitensiare dhe të mbikëqyrjes së provës). Në varësi të teorisë dominuese për justifikimin e dënimit penal, konturohet dhe mënyra e përllogaritjes së dënimit penal në çdo rast konkret (Sporer

¹¹⁹ Për të krijuar një ide konkrete mbi kufizimin që i bëjnë diskrecionit gjyqësor këto udhëzues mund të sjellim në vëmendje se sipas Sentencing Reform Act të vitit 1984, maksimumi i dënimit sipas këtyre udhëzuesve nuk mund të ishte më shumë se 25% mbi minimumin (Robinson, 1988: 406).

& Goodman, 2009: 379). Teoritë retribucioniste të dënimit të drejtë, përqendrojnë caktimin e dënimit në bazë të shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer dhe fajësisë së kryerësit. Nga ana tjetër teoritë utilitariste e drejtojnë dënimin kah e ardhmja. Ato fokusohen respektivisht në qëllime të tilla, si: frikësimi i të lëkundurve për të mos përsëritur të njëjtën sjellje, paaftësimi i fajtorit për të mosrrezikuar shoqërinë, edukimin dhe risocializimin e tij, apo edhe përmirësimin e raporteve mes tij dhe të dëmtuarve nga vepra. Ekzistenca e njëkohshme e disa qëllimeve, megjithëse në dukje e dëshirueshme, sjell konflikte të mëdha në momentin e caktimit të dënimit. Këto konflikte shfaqen për shkak se secili prej tyre kërkon që gjykata t'u referohet kriterëve të ndryshme për të bërë individualizimin e dënimit¹²⁰.

Siç jemi shprehur dhe më lart, ky është problemi më i madh i individualizimit të dënimit dhe një sfidë teorike dhe praktike përballë nevojës për barazi dhe parashikueshmëri të dënimit eventual penal. Ndarja e procesit të caktimit të dënimit në fazën e kërcënimit, caktimit dhe vuajtjes, e ka komplikuar edhe më tej çështjen e parashikueshmërisë dhe efektivitetit të dënimit penal, pasi shpesh herë mes tyre ka një dallim shumë të madh¹²¹. Mes neneve të ndryshme të K. Penal ka një kontradiktë konceptuale, pasi në disa vepra penale dënimi justifikohet nga shkalla e fajësisë së autorit¹²², në disa të tjera nga dëmi që ka ardhur, në disa nga heqja e mundësisë për të rikryer vepra penale e në raste të tjera nga tendenca për të frikësuar të tjerët. Kjo larmi e kriminalizimit dhe penalizimit të sjelljeve me përparësi të natyrave të ndryshme, pamundëson caktimin e dënimit vetëm mbi bazën e një qëllimi¹²³. Dallimet e mëdha të njohura me ligj (për zbatimin e njëkohshëm

¹²⁰ Kështu p.sh. sipas teorisë së dënimit të drejtë, një vjedhësi mund t'i caktohet një dënim i shkurtër me burgim, apo një gjobë nëse ka vjedhur disa sende me vlerë të vogël, por sipas teorisë së parandalimit të përgjithshëm mund t'i caktohet një dënim më i rëndë me burgim nëse kjo vepër ka një përhapje të gjerë në komunitet. Nga ana tjetër, sipas qëllimit paaftësues mundet t'i caktohet një monitorim elektronik, ndërsa sipas qëllimit rehabilitues këtij të pandehuri mund t'i caktohet një dënim alternativ me detyrimin që ai të ndjekë një formim arsimor apo profesional të caktuar, apo të kryejë një punë në shërbim të komunitetit. Së fundmi sipas qëllimit restaurues të pandehurit mund t'i kursehen të gjitha këto opsione dhe të mjaftohet me pajtimin e të pandehurit me të dëmtuarin dhe shpërblimin e drejtë të këtij të fundit nga i pari. Hendeku mes rezultateve të dala nga ndjekja e qëllimeve të ndryshme të dënimit mund të rritet, nëse merren në testim vepra me një rrezikshmëri të lartë shoqërore si vrasja, grabitja me armë, trafiku i narkotikëve etj.

¹²¹ Kështu p.sh. neni 88 §1 i K. Penal parashikon dënim nga 3-10 vite burgim për plagosjen e rëndë me dashje, mirëpo jo rrallë gjykata mund të caktojë vetëm 2 vite burgim, pas aplikimit të nenit 406/1 të K. Pr. Penale dhe në aplikim të nenit 59 të K. Penal ta pezullojë ekzekutimin e këtij dënimi me burgim, duke e vënë të dënuarin në provë. Ndërkohë që për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore, profesionale, teknike apo ligjore të shërbimit të provës, mundet që kjo periudhë mbikëqyrjeje të mos ketë asnjë efekt kufizues dhe edukues tek i dënuari. Pra nga gjithë ky proces i komplikuar ligjor, gjyqësor dhe administrativ, vështirë të thuhet se mes këtij individi dhe një tjetri i cili për të njëjtën vepër ka vuajtur në një qeli të ngushtë 5 apo 6 vite burgim, është zbatuar parimi i barazisë dhe i sigurisë në caktimin e dënimit.

¹²² P.sh. ligji dallon në bazë të këtij parimi vrasjen me paramendim nga vrasja me pakujdesi, por nuk e dallon nga plagosja e lehtë me dashje.

¹²³ Kështu p.sh., dënimi i një të mituri për vjedhje të thjeshtë me logjikën e dënimit të një të rrituri për vjedhje duke shpërdoruar detyrën, do të prodhonte rezultate të papranueshme logjike dhe morale. Më tej do të tingëllonte imorale nën këndvështrimin retribucionist, dënimi i rëndë i personave të papunë dhe me probleme familjare, sepse për këto shkaqe ata kanë një predispozitë të lartë rikriminalizimi. Nga ana tjetër shoqëria do të tronditej nëse një narkoman që ka kryer një vjedhje me pasojë vdekjen e viktimës dënohet vetëm me një dënim alternativ, duke u mjaftuar vetëm me detyrimin që i pandehuri t'i nënshtrohet trajtimit për varësinë ndaj drogës.

të disa qëllimeve të dënimit penal) e bëjnë të pamundur ndërtimin e një konsekuence gjyqësore për të gjitha veprat dhe të vështirë shmangien e arbitraritetit në caktimin e dënimit për vepra konkrete.

Në përpjekje “për ta mbajtur në rrugë të drejtë” këtë “mjet me shumë timonë” janë hedhur propozime të ndryshme, si: harmonizimi i qëllimeve, miksimi i qëllimeve, apo ekuilibrimi i tyre (Cohen, 1981: 73). Doktrina italiane (Fiandaca & Musco, 2009: 756; Dolcini, 1979: 16) propozon ngritjen e një hierarkie mes qëllimeve që duhet të ndjekë dënimi penal dhe pas identifikimit të qëllimit superior, të analizohen ato fakte që janë përcaktuese sipas këtij qëllimi. Në realitetin shqiptar kjo doktrinë kërkon përcaktimin me ligj ose së paku me një vendim unifikues të rregullave dhe kriterëve të përcaktimit të qëllimit prioritar që duhet të ndiqet në rastin e një veprë apo grup veprash penale të caktuara.

Një teori e ngjashme e quajtur parimi i shpërndarjes hibride të dënimit (hybrid distributive principle) synon të gjejë mekanizmat e pajtimit mes teorive retribucioniste dhe atyre utilitariste (Robinson, 1987). Sipas këtyre ideve, rol parësor duhet të marrë dënimi i merituar në raport me synimet utilitare, me përjashtim të rastit kur kjo do të shkaktonte një rritje të krimit, të cilën mund ta shmangte një dënim sipas kësaj teorie (Robinson, 1987: 38). Pra dënimit të drejtë mund t’i bëhen korrigjime utilitariste me kushtin që ky korrigjim të mos prodhojë një dënim patolerueshmërisht të padrejtë. Në këtë mënyrë, kufizimi utilitarist i dënimit të drejtë për “rritjen e patolerueshme të krimit”, kufizohet përsëri nga teoria e dënimit të drejtë.

Nën dritën e studimeve mbi efektin e dyshimtë parandalues të dënimit dhe rivitalizimit të idealit rehabilitues, ky autor e ka riparë teorinë e tij. Sa i takon përcaktimit të masës së dënimit, ai lë në qendër të qëllimeve të dënimit atë ndëshkues të meritës së drejtë, por matja e tij duhet të bëhet sipas intuitës së komunitetit mbi drejtësinë dhe jo mbi një vlerësim filozofik të saj (Robinson, 2008: 195). Ndërkohë sa i takon llojit të dënimit, Robinson propozon një diskrecion të gjerë gjyqësor, i cili nuk duhet të udhëhiqet nga qëllimi ndëshkues, por nga mjeti më efektiv për të parandaluar krimet e së ardhmes. Gjyqtarëve u duhet siguruar një gamë e gjerë zgjedhjesh, si: gjogat, programet e trajtimit të të dënuarve, vuajtjet e dënimit me burgim në fundjavë apo në shtëpi, puna në komunitet, masat restauruese, mbikëqyrja intensive në kusht dhe çdo lloj mase tjetër që do të ndihmojë në interesin e shoqërisë, me kusht që të mos tejkalojë masën sipas shpërndarjes hibride të dënimit (Robinson, 2008: 199).

Duke u kthyer në kontekstin shqiptar, siç është trajtuar në kapitullin e parë të këtij punimi, mungesa e një parashikimi të shprehur në K. Penal, ka bërë që praktika gjyqësore të jetë e metë dhe

inkonsistente në referimin ndaj qëllimeve të dënimit penal¹²⁴. Megjithëse qëllimi ndëshkues është në thelb të nenit 47 të K. Penal shqiptar, dhe qëllimet paaftësuese dhe restauruese janë poashtu qëllime të pamohueshme, moscitimi i tyre i shprehur në praktikën gjyqësore, bën që në shumë raste, masat e dënimit që caktojnë gjykatat të jenë në rastin më të keq të padrejta dhe në rastin më të mirë të paarsyetuara. Në mungesë të një plotësimi ligjor, vlerësojmë imperativ një vendim unifikues të GJL, i cili jo thjeshtë duhet të interpretojë frymën e kodit mbi qëllimet e dënimit penal, por dhe të përcaktojë hierarkinë e secilit prej tyre, kriteret e përzgjedhjes së kësaj përparësie dhe ndikimin e tyre në përzgjedhjen e llojit dhe të masës së dënimit nga gjykatat shqiptare. Pa një unifikim të praktikës gjyqësore mbi arsyet përse duhet të dënohet një person me një lloj dhe masë dënimi të caktuar, debati mbi barazinë, drejtësinë dhe konsekuencën gjyqësore në individualizimin e dënimit do të jetë shterpë dhe i paaftë të ndikojë praktikën gjyqësore.

3.3.4. Justifikimi i besimit të pushtetit diskrecional nga gjyqtari

Megjithë dyshimet dhe kritikën ndaj diskrecionit gjyqësor në caktimin e dënimit, ai mbetet zgjidhja më e mirë praktike për individualizimin e drejtë të dënimit. Mirëpo, siç jemi shprehur më lart, ky pushtet diskrecional nuk është i pakufizuar, pasi qëllimi i njohjes së tij nga Ligjvënësi është pikërisht zbatimi i ligjit me drejtësi për raste të ndryshme (Robinson, 1988: 459). Nga ky kufizim lind detyrimi për gjykatën që të justifikojë ndjekjen e qëllimeve të ligjshme gjatë ushtrimit të pushtetit diskrecional në caktimin e dënimit. Mënyra e vetme e kontrollit të ligjshmërisë në caktimin e dënimit është përmes verifikimit të arsyeve që e kanë shtyrë gjykatën në përzgjedhjen e një lloji dhe mase konkrete dënimi. Duke qenë se caktimi i dënimit është një nga pjesët më të rëndësishme të vendimit penal të fajësisë, prej saj buron rëndësia e madhe e arsyetimit të ushtrimit të pushtetit diskrecional të gjykatës në caktimin e dënimit penal.

Detyrimi për arsyetimin i vendimeve gjyqësore është tashmë një çështje jo vetëm e së drejtës procedurale penale¹²⁵, por edhe kushtetuese. Detyrimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore është parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 142/1 të Kushtetutës sonë, sikurse në nenin 111 të Kushtetutës italiane. Siç është shprehur edhe GJK dhe GJEDNJ, arsyetimi i vendimeve gjyqësore është pjesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe pjesë strukturore e së drejtës të aksesit në gjykatë (Shehu, et al, 2013: 99). Në vendimin e saj nr. 39 datë 18.07.2012, GJK shprehet se pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është një sintezë e këtyre përfundimeve. Megjithëse ky standard

¹²⁴ Shkurtimisht kemi përmendur për ilustrim vendimet nr. 978 (134) datë 16.05.2012, Nr. 751 (149), datë 30.05.2012 dhe nr. 1123 (142) datë 23.05.2012 të KPGJL. Nga këto vendime e mijëra të tjera të shqyrtuara, gjykatat shqiptare nuk përmendin qëllimin retributiv (ndëshkues), paaftësues dhe atë restaurues të dënimit penal.

¹²⁵ Sipas nenit 112 §3 të K. Pr. Penale: “Vendimi dhe urdhri arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm”. Po ashtu indirekt edhe neni 383/1.ç i K. Pr. Penale parashikon detyrimin e gjykatës për të arsyetuar vendimet gjyqësore. (Islami et al, 2011: 498).

kushtetues nuk imponon vendosjen e një raporti sasior fjalësh mes pjesës urdhëruese me pjesën arsyetuese, logjika e shëndoshë të shtyn në përfundimin se arsyetimi duhet të jetë (disa herë) më i madh se sinteza e tij në urdhërimin e vendimit. Nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore konstatohet se, megjithëse pjesa e disponimit mbi caktimin e dënimit zë pjesën më të madhe të dispozitivit të vendimeve penale, pjesa arsyetuese që i korrespondon këtij disponimi, në shumicën e rasteve zë më pak se një faqe dhe jo në pak raste vetëm një fjali.

Megjithëse gjykojmë se një arsyetim i detajuar i gjithë procesit që ka shpënë gjykatën në atë lloj dhe masë dënimi nuk është i domosdoshëm në çdo rast, vlerësojmë se minimalisht duhet të paraqiten parimet dhe rrethanat që gjykata ka pasur parasysh në marrjen e vendimit. Vlerësimi i mjaftueshmërisë së arsyetimit të vendimeve gjyqësore duhet të analizohet në raport me kompleksitetin e çdo çështjeje konkrete (Shehu, et al, 2013: 123), një prej të cilëve është edhe rëndësia e veprës penale që gjykohej. Ashtu siç është shprehur edhe GJEDNJ në çështjen *Taxquet v. Belgium*¹²⁶, arsyetimit të caktimit të dënimit duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë në rastet e caktimit të një dënimi të rëndë me burgim. Po ashtu në respektim të së drejtës së ankimit (si pjesë e të drejtës së aksesit në gjykatë), gjykata duhet të japë arsye të qarta për rrëzimin e kërtimeve të palëve në lidhje me caktimin e dënimit (kur vendimi i saj është ndjeshëm i ndryshëm). Ndonëse konstatojmë se në përgjithësi cilësia e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është shumë më e lartë se ajo e 15 e më shumë viteve më parë¹²⁷, ajo ka përsëri nevojë për një fokusim më të madh në lidhje me momentin e caktimit të dënimit. Diskrecioni i gjerë gjyqësor, që i është njohur nga ligji gjykatave shqiptare në caktimin e dënimit penal, duhet të justifikohet me vendime transparente të arsyetuara mirë, të cilat të bindin palët dhe opinionin publik se nuk janë produkt i arbitraritetit gjyqësor, por i zbatimit të ligjeve në fuqi. Parashikimi në K. Penal apo në K. Pr. Penale e një dispozite të ngjashme me nenin 132 §1 të K. Penal italian¹²⁸ do të rriste ndjeshëm, transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e gjykatës në ushtrimin e pushtetit diskrecional për caktimin e dënimit.

3.4. Kriteret ligjore të caktimit të dënimit sipas K. Penal shqiptar

K. Penal shqiptar ashtu si shumë kode të tjera penale evropiane bën pjesë në një grup të madh i cili i parashikon shprehimisht kriteret ligjore të caktimit të dënimit. Mirëpo, nga një vështrim krahasues i kodit tonë me shumë kode të tjera evropiane, konstatohet se ashtu si në shumë institute

¹²⁶ Application no. 926/05, datë 16 Nëntor 2010.

¹²⁷ Në një botim të vitit 2006, OSBE shprehet se: “Vendimet argumentohen në mënyrë shumë të dobët dhe japin përshtypjen se vendimet për caktimin e masave të sigurisë shpeshherë lëshohen pa pasur arsye ligjore” (61).

¹²⁸ Kjo dispozitë (Potere discrezionale del giudice nell'applicazione della pena-limiti), parashikon shprehimisht: “Brenda kufijve të parashikuar me ligj, gjyqtari e cakton dënimin në mënyrë diskrecionale; ai duhet të tregojë arsyet që e justifikojnë ushtrimin e një pushteti të tillë diskrecional”. Detyrimi i gjykatave italiane për arsyetimin e caktimit të dënimit sipas kësaj norme dhe nenit 111 të Kushtetutës italiane është bërë objekt i jurisprudencës së GJK dhe GJL italiane në disa raste (Lariccia, 2011).

të tjera të pjesës së përgjithshme të tij, kodi ynë karakterizohet nga një konçizitet unik. Formulimi gjuhësor i terminologjisë së përdorur në përshkrimin e kriterëve është përgjithësisht i ngjashëm me shumë kode të tjera penale evropiane¹²⁹, por lakonizmi i saj e bën atë më shumë të ngjashëm me kodet tona penale të vitit 1952 dhe 1977. Po të zhvishen nga formulimet ideologjike komuniste, nenet 41 të K. Penal të vitit 1952 dhe 29 të K. Penal të vitit 1977, janë pothuajse identike me nenin 47 të kodit aktual.

Kriteret mbi të cilat duhet të mbështetet gjykata në individualizimin e dënimit në çdo rast konkret skicojnë konturet e kufizimit të diskrecionit gjyqësor në lidhje me të. Procesi i individualizimit të dënimit ndjek disa hapa, në të cilët hapësira e manovrimit të gjykatës vjen duke u ngushtuar gjithnjë e më tepër, deri në përcaktimin e dënimit konkret për autorin e veprës. Neni 47 i K. Penal (Mënyra e caktimit të dënimit) është ndarë në dy paragrafë. Paragrafi i parë përcakton se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale.”*. Le t’i trajtojmë më vete këto dy referenca ligjore.

3.4.1. Dispozitat e pjesës së përgjithshme të K. Penal që kanë lidhje me caktimin e dënimit

Megjithëse gjatë individualizimit të dënimit gjykata duhet të mbajë parasysh pothuajse të gjitha dispozitat e pjesës së përgjithshme të K. Penal (Nikolli, 2003: 41), një pjesë e tyre gjen zbatim më të shpeshtë. Dispozita e parë kryesore e caktimit të dënimit është vetë neni 47, i pasuar nga të gjitha dispozitat e tjera (nenet 48-57), si rrethanat lehtësuese dhe rënduese, caktimi i dënimit për të miturit, ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, caktimi i dënimeve për disa vepra penale¹³⁰ etj. Dispozita të tjera të cilat duhen respektuar në çdo rast të caktimit të dënimit, janë neni 29 i tij (i cili përcakton dënimet kryesore) dhe nenet 1/a, 1/b, 1/c, 2 dhe 3 të kodit, të cilat përcaktojnë parimet e së drejtës penale. Po njësoj, gjejnë zbatim dhe duhen respektuar në çdo rast nga gjykata, edhe dispozitat mbi fajin dhe format e tij (të parashikuara në nenet 14, 15 dhe 16 të kodit). Më tej me një frekuencë të shpeshtë, në caktimin e dënimit gjen zbatim neni 30 (i cili përcakton listën e dënimeve plotësuese) dhe nenet 31-44, të cilat shpjegojnë dënimet kryesore dhe plotësuese një për një, rastet e aplikimit, kohëzgjatjen dhe mënyrën e vuajtjes së tyre. Po ashtu, si pjesë e sistemit sanksionator me një zbatim tepër të gjerë, gjejnë zbatim dhe dispozitat mbi dënimet alternative (nenet 58-63).

¹²⁹ Shumica e kodeve të cilat përcaktojnë shprehimisht kriteret të caktimit të dënimit, mbështeten në referenca të tilla si rrezikshmëria e veprës së kryer dhe e të pandehurit, shkalla e fajësisë si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

¹³⁰ Të gjitha këto institute do të trajtohen veçmas më poshtë si pjesë e këtij kapitulli.

Një dispozitë tjetër, e cila gjen zbatim për veprat penale materiale është dhe neni 23 §2, i cili rregullon caktimin e dënimit për veprat penale të mbetura në tentativë¹³¹. Megjithatë sipas paragrafit të parë të nenit 23, vepra penale e mbetur në tentativë dënohet sipas së njëjtës dispozitë (pra me të njëjtat mazhe dënimi) sikurse vepra penale e kryer plotësisht (Kaçupi, 2007: 139; Muçi, 2012: 218), sipas paragrafit të dytë të këtij neni, dënimi për të caktohet duke marrë në konsideratë edhe dy elementëve të tjerë (specifik për tentativën), që janë shkalla e afërsisë së ardhjes së pasojave dhe shkaqet për të cilat krimi mbeti në tentativë (Elezi et al, 2013: 187). Vlerësimi i drejtë i këtyre dy rrethanave mbart një rëndësi të madhe praktike në të gjitha veprat penale materiale e sidomos për veprat ndaj jetës, ku marzhet e dënimit janë të larta¹³². Duke qenë se neni 23 §2 i njeh Gjykatës një diskrecion të gjerë dhe të panevojshëm, vlerësojmë se kjo dispozitë duhet të bëjë një detajim më të plotë të caktimit të dënimit për tentativën e plotë dhe atë të metë (Kaçupi, 2007: 141). Për të parën, ulja e dënimit nën minimum mund të parashikohet si përjashtim në varësi të afërsisë së ardhjes së pasojave, ndërsa për tentativën e metë¹³³ ligji duhet të jetë më i arsyeshëm dhe të parashikojë ulje të dënimit ndjeshëm nën minimum (p.sh. nga 1/3 deri në 2/3 poshtë minimumit të dënimit), apo caktimin e një lloji dënimi tjetër më të butë.

Tjetër dispozitë e pjesës së përgjithshme që ka të bëjë me caktimin e dënimit është neni 17 §2 i K. Penal. Sipas kësaj norme, personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e veta, nuk përjashtohet nga përgjegjësia penale, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Duke e shqyrtuar në aspektin e politikës së dënimit, vlerësojmë se kjo dispozitë paraqet probleme të mëdha në skaje të kundërta, si përsa i takon nga njëra anë ngushtësisë së alternativave të dënimit dhe nga ana tjetër papërcaktueshmërisë së zbutjes së dënimit¹³⁴. Një problematikë tjetër në lidhje me zbatimin e kësaj

¹³¹ Ky nen parashikon se: "Gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbetet në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloji dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj".

¹³² Me vendimin nr. 18 (663), datë 23.01.2013 GJL ka lënë në fuqi vendimin e GjRREGJ Berat dhe GJA Vlorë për të dënuar me 10 vite burgim të pandehurin P.S. për veprën penale të "Vrasjes me dashje" të mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 e 22 i K. Penal. Dy prej anëtarëve të trupit gjykues, kanë dalë në pakicë, duke arsyetuar se plagosja me armë zjarri në kofshën e majtë, nuk është shumë e afërt me ardhjen e vdekjes, pasi kofsha nuk është një organ jetik si zemra, mushkëritë, koka, etj., prandaj ndaj tij duhej caktuar një dënim nën minimumin e parashikuar nga neni 76 i K. Penal.

¹³³ Në tentativën e plotë autori i kryen të gjitha veprimet e përshtatshme për ardhjen e pasojës kriminale, mirëpo këto pasoja nuk vijnë për shkak të pavarura nga vullneti i tij, për pasojë në këtë rast autori meriton një masë dënimi e cila në varësi të shkallës së afërsisë së ardhjes së pasojave i afrohet veprës së konsumuar. Tek tentativa e plotë shkalla e fajësisë është e njëjtë me veprën e konsumuar, por megjithatë ndryshon rrezikshmëria objektive e veprës, pasi pasojat nuk kanë ardhur të plota. Në ndryshim nga tentativa e plotë, tentativa e metë mund të mbetet pa u realizuar edhe për shkak që varen nga vetë autori, prandaj ajo paraqet një rrezikshmëri akoma më të ulët shoqërore. Kjo lloji tentative dallon nga vepra e konsumuar jo vetëm për shkak të mungesës së pasojës, por edhe për shkak të një niveli më të ulët fajësie të autorit të veprës, prandaj meriton një dënim akoma më të butë se tentativa e plotë.

¹³⁴ Kodi ynë penal parashikon caktimin e masave mjekësore vetëm ndaj personave të papërgjegjshëm, mirëpo për ata që kanë qenë pjesërisht të përgjegjshëm për shkak të uljes së ekuilibrit mendor, parashikohet caktimi i të njëjtave lloje

dispozite është dhe mungesa e zbatimit praktik të saj, pasi nga aktet e ekspertimit psikiatrik, në shumicën e rasteve kryerësi i veprës penale ose vlerësohet tërësisht i papërgjegjshëm ose plotësisht i përgjegjshëm¹³⁵, ndërkohë që si pjesërisht të përgjegjshëm vlerësohen fare pak persona.

Një dispozitë tjetër e ngjashme me të mësipërmen, është neni 18 i K. Penal. Kjo dispozitë nuk përjashton nga përgjegjësia penale personin që kryen veprë penale në gjendje të dehur (të rastësishme) nga alkooli apo lëndët narkotike, por kjo rrethanë mbahet parasysh për zbutjen e dënimit ndaj tij. Në vlerësimin tonë edhe kjo dispozitë paraqet probleme të arsyetueshmërisë së politikës së dënimit, pasi nuk përcakton masën e ndikimit zbutës të dehjes së rastit dhe mundësinë e zbatimit të dënimeve alternative specifiku për këtë shkak. Duke qenë se dehja mund të ulë në masë të madhe aftësinë gjyquese të subjekteve, trajtimi i saj në çdo rast thjesht si rrethanë e zakonshme lehtësuese (Muçi, 2012: 159) është në kundërshtim me parimin e dënimit proporcional në raport me fajësinë dhe me nevojat edukuese. Nëse trajtimi i dehjes së qëllimshme si rrethanë rënduese ka sens logjik, dehja e rastësishme duhet të trajtohet në mënyrë të shkallëzuar¹³⁶, duke njohur mundësinë e uljes së dënimit nën minimum, caktimit të një lloji dënimi tjetër, apo aplikimin e një dënimi alternativ (Nikolli, 2003: 43).

Në caktimin e dënimit ndaj bashkëpunëtorëve gjykata duhet të mbajë parasysh nenin 28 të K. Penal, i cili parashikon se gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale. Edhe kjo dispozitë është tepër e përmblodhur dhe nuk detajon në mënyrë të qartë masën se sa ndikon shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe roli dytësor i luajtur, në zbutjen e dënimit¹³⁷. Në rastin e kundërt kur autori ka marrë pjesë aktivisht dhe ka pasur

dënimi sikurse ndaj personave të shëndetshëm mendërisht. Nisur nga specifikat e fajësisë së tyre të kufizuar dhe nga nevoja krejtësisht të ndryshme përmirësuese-edukuese në raport me personat e shëndetshëm mendërisht, vlerësojmë se për këtë kategori keqbërësish është më e drejtë dhe e përshtatshme një qasje më e madhe në drejtim të një trajtimi mjekësor sesa penal. Mbështetur në këtë arsyetim vlerësojmë se për këtë kategori të pandehurish duhet të ofrohen alternativa si masat mjekësore apo mbikëqyrja nga shërbimi i provës me detyrimin për t'iu nënshtruar një trajtimi mjekësor. Nga ana tjetër neni 17 §2 nuk specifikon peshën që ka prezenca e një turbullimi psikik në uljen e dënimit. Në literaturën juridike është shfaqur mendimi se kjo rrethanë duhet trajtuar vetëm si rrethanë lehtësuese (Muçi, 2012: 157), por në vlerësimin tonë kjo është tërësisht disproporcionale, pasi ndikimi që ka një sëmundje mendore në uljen e aftësisë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve dhe pasoja të tyre mund të jetë shumë e madh dhe mund ta ulë shumë nivelin e fajësisë së autorit dhe për pasojë edhe shkallën e meritës së dënimit të tij.

¹³⁵ Në vlerësimin tonë ky lloj konkluzioni është tërësisht alogjik, pasi ndërmjet papërgjegjshmërisë totale dhe shëndetit të plotë mendor ka një hapësirë të madhe e cila duhet të jetë shumë më e madhe se dy ekstremet. Megjithatë shkenca e psikiatrisë ligjore nuk është një shkencë ekzakte dhe metodat e saj të ekzaminimit klinik kanë akoma shumë rrugë për të bërë për të dhënë rezultate kategorike, gjithsesi në përputhje me frymën e nenit 17 §2 të K. Penal duhet që dhe matja e uljes së ekuilibrit mendor të pasqyrohet në një shkallë numerike të kuptueshme dhe jo vetëm me terma evazivë (pasi nga një ekuilibër i ulur vetëm 10 % ka një dallim shumë të madh me një ekuilibër të ulur 90%).

¹³⁶ Neni 18 §2 nuk përcakton për dehjen e rëndë të rastit nëse mund të caktohet një lloj dënimi më i butë apo të ulët dënimi nën minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale të kryer, megjithatë në vlerësimin tonë kjo do të ishte e drejtë dhe në përputhje me qëllimin e dënimit penal. Sikur dehja e rastit (apo më lart ulja e ekuilibrit mendor nga një turbullim psikik) të kishte të njëjtën vlerë me çdo rrethanë tjetër lehtësuese, kjo do të ishte parashikuar në nenin 48 të K. Penal dhe nuk do të kishte qenë e nevojshme parashikimi në një dispozitë më vete.

¹³⁷ Duke qenë se ligji nuk e parashikon mundësinë e uljes së dënimit nën minimum, atëherë ashtu si për rrethanat e tjera të trajtuara më lart (dehja dhe turbullimi psikik) edhe shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe roli dytësor i bashkëpunëtorit do të trajtohen thjesht si një rrethanë lehtësuese. Ky kufizim e bën zero nga pikëpamja ligjore efektin

rol parësor drejtues, kjo shkon në harmoni me frymën e nenit 49/gj të K. Penal, duke i shtuar asaj peshën si rrethanë rënduese. Në caktimin e dënimit ndaj anëtarëve të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, përveç dispozitave që aplikohen në përgjithësi për caktimin e dënimit, gjykata duhet të mbajë parasysh dhe nenin 28 §5 dhe §7 të K. Penal¹³⁸.

3.4.2. Respektimi i kufijve të dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale

Në caktimin e dënimit gjykata duhet të respektojë kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Ky kufizim rrjedh nga parimi i ligjshmërisë së caktimit të dënimit *nulla poena sine lege*, i parashikuar nga nenet 1 §1 dhe 2 §2 të K. Penal. Nga interpretimi logjik i këtyre dispozitave, kuptohet se termi kufij nuk i referohet vetëm marzheve të dënimit, por edhe llojeve të dënimit kryesor që parashikon dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal. Sipas këtij kufizimi, gjykata nuk mundet që të aplikojë ndaj personit fajtor një lloj dënimi të ndryshëm nga ato që parashikon dispozita dhe as të caktojë një masë dënimi më të lartë apo më të ulët, jashtë marzheve të parashikuara në atë dispozitë. Vetëm përjashtimisht, sipas nenit 53 të K. Penal gjykata mund të ulë dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji, kur plotësohen disa kushte njëkohësisht, por nuk mund ta rrisë atë mbi maksimumin e parashikuar.

Marzhet e dënimit me burgim për veprat penale janë të përcaktuara në minimum dhe në maksimum. Këto kufij në disa raste përcaktohen nga vetë dispozita e pjesës së posaçme që parashikon figurën e veprës penale dhe në rast mosparashikimi prej saj, gjykata duhet t'u referohet kufijve minimalë dhe maksimalë të parashikuara nga ligji për atë lloj dënimi¹³⁹. Çështja e

zbutës të këtyre rrethanave po të mbahet parasysh se nga ana tjetër pavarësisht rolit të luajtur, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale përbën një rrethanë rënduese. Ulja e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji është në përputhje me shkallën e fajësisë dhe rrezikshmërinë e veprës konkrete, në rastet kur bashkëpunëtori nuk ka ndikuar në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës, apo ka qenë në një rol dytësor (si ndihmës periferik), mirëpo kjo ndalohej shprehimisht nga neni 53 i K. Penal (i ndryshuar), pasi bashkëpunimi në çdo lloj roli konsiderohet si rrethanë rënduese.

¹³⁸ Kjo dispozitë është ndryshuar e tëra me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 duke marrë një formulim të ri. Paragrafi i pestë i këtij neni parashikon se: "5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizata terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.". Ndërsa paragrafi i shtatë parashikon se: "7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur, ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë që gjykohej vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejtë ose jo prej tyre si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.". Ndërkohë me ligjin 144/2013 është shfuqizuar neni 284/b (ndihma në zbulimin e krimeve), një dispozitë e cila megjithëse kishte një karakter të përgjithshëm, ishte përfshirë në pjesën e posaçme të K. Penal.

¹³⁹ Sa i takon dënimit me burgim, Legjislatori ka ndjekur teknikën e përcaktimit të marzheve në minimum dhe në maksimum në dispozitën konkrete, vetëm për vepra me rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, si p.sh. nenet 76, 86, 87, 88, 100, 134/2, 137/2, 278/4, 283, 290/2,3 etj. Për shumicën e veprave penale të cilat paraqesin një rrezikshmëri të ulët, apo jo shumë të theksuar shoqërore, Legjislatori ka përcaktuar vetëm maksimumin e dënimit në dispozitën konkrete, duke i sugjeruar gjykatës që për minimumin t'i referohet kufijve ligjorë të dënimit konkret. Ky është padyshim numri më i madh i dispozitave të pjesës së posaçme dhe në mjaft raste kjo teknikë është aplikuar në paragrafët e parë të dispozitave të pjesës së posaçme. Shembuj të tillë me maksimum të përcaktuar janë nenet 82, 83, 88/a, 88/b, 89, 113, 134/1, 135, 186, 248, 290/1 etj. Në rastin e veprave penale shumë të rënda, legjislatori ka përcaktuar vetëm minimumin e dënimit, duke lënë si kufi maksimal atë të parashikuar nga neni 32 i K. Penal, prej 35 vitesh burgim. Dispozita të tilla janë nenet 73, 74, 75, 77, 78/2, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c etj.

shqyrtimit të arsyetueshmërisë së niveleve të marzheve konkrete të dënimit me burgim është shumë e gjerë dhe komplekse, por shkurtimisht mund të përsërisim se në shumë dispozita këto marzhe dënimi janë të kritikueshme. Legjislatori shqiptar nuk ka ndjekur një ligjësi të identifikueshme sesi ka përcaktuar marzhet për një vepër në raport me një tjetër vepër të ngjashme¹⁴⁰. Në shumë dispozita penale gjejmë paradokse dënimesh ku një vepër që rrezikon dënohet më rëndë se një vepër që dëmton (Elezi, 2013: 66)¹⁴¹, apo një pasojë e ardhur nga pakujdesia dënohet më rëndë se një e shkaktuar me dashje (Elezi, 2005: 65).

Në ndryshim nga teknika e përdorur për dënimin me burgim, në rastin e dënimit me gjobë, Legjislatori nuk përcakton marzhet e gjobës për çdo vepër konkrete (Milla, 2008: 34), duke i lënë hapësirë gjykatës të zgjedhë masën konkrete brenda kufijve të përcaktuara nga neni 34 i K. Penal. Vlerësojmë se ky diskrecion i gjerë gjyqësor është tërësisht i panevojshëm dhe i pajustificuar, pasi nuk ka asnjë arsye të shëndoshë që të aplikohet një politikë e ndryshme diskrecionale për burgimin në raport me gjobën. Përcaktimi i kufijve të marzheve të dënimit me gjobë nga Legjislatori, në varësi të rrezikshmërisë së veprës konkrete penale, do t'i kontribuonte një aplikimi më uniform dhe të drejtë të këtij dënimi nga gjykatat.

Siç jemi shprehur edhe më parë, një çështje tjetër problematike e kufijve të dënimeve, është mosparashikimi i dënimit me gjobë si dënim alternativ, në shumë vepra penale me një rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore¹⁴². Kodi ynë penal duhet të gjejë mënyrat për t'i besuar më shumë eksperiencave të suksesshme të aplikimit të gjerë të dënimit me gjobë si një dënim shumë efektiv (nëse aplikohet drejtë) në kontrollin e kriminalitetit ordiner, në përmirësimin dhe edukimin e të dënuarve, në zgjidhjen e çështjes së mbipopullimit të burgjeve dhe në uljen e kostove të dënimeve panevojshëmrisht të ashpra. Po ashtu, në gjykimin tonë, dënimet kryesore duhet të hapen edhe në

¹⁴⁰ Kriteret bazë të meritokracisë dhe proporcionalitetit të dënimit janë rëndësia e së mirës së cenuar dhe shkalla e fajit, mirëpo në K. Penal ka shumë vepra të cilat nuk marrin përgjigje nga këto dy kriteret (Elezi, 2005: 68).

¹⁴¹ P.sh., thjeshtë mbajtja e një arme zjarri (neni 278/5) dënohet më rëndë se plagosja e rëndë me dashje me këtë armë zjarri (neni 88), apo vrasja me dashje dhe tortura me pasojë vdekjen (nenet 76 dhe 89) dënohen më lehtë se trafikimi i një personi të rritur në bashkëpunim (neni 110/a §4). Po ashtu në disa dispozita gjenden dënime më të ashpra për pasojat të ardhura me pakujdesi se për të njëjtat pasojat të ardhura nga një veprim me dashje, si p.sh. vrasja me dashje apo tortura me pasojë vdekjen dënohen nga 10-20 vite burgim, ndërkohë që trafikimi i një njeriu me pasojë vdekjen dënohet jo më pak se 20 vite dhe me burgim të përjetshëm. (Elezi, 2005: 65). Njësoj dënohet me një burgim jo më pak se 15 vite, ose burgim të përjetshëm dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve të një individi, i cili humb jetën gjatë kësaj përpjekjeje për të kaluar kufirin. Një shembull tjetër tregues i mungesës së konsekuencës dhe arsyetueshmërisë së kufijve të dënimeve janë neni 124/1, i cili për braktisjen e fëmijëve të mitur nga prindi parashikon dënim deri në 3 vite burgim, ndërkohë që dërgimi i të miturve për të ruajtur bagëtitë sipas nenit 124/b §2 (pra një punë e detyruar) dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Më tej, nëse nga vepra e parë vjen si pasojë vdekja dënohet nga 3-10 vite burgim, ndërkohë që e njëjta pasojë e ardhur nga vepra e dytë dënohet nga 10-20 vite burgim.

¹⁴² P.sh. është e paarsyeshme pamundësimi i dënimit me gjobë për një vjedhje të thjeshtë vetëm se është kryer në bashkëpunim, apo "pornografia" (neni 117 §1), e cila megjithëse është një vepër e parrezikshme dhe përbën kundërvajtje, nuk parashikon dënim me gjobë; po njësoj "keqtrajtimi i të miturit" (neni 124/b §1) nuk parashikon dënim me gjobë, megjithëse është kundërvajtje. Siç kemi cituar në kapitullin e dytë, studimet e zhvilluara mbi eksperiencën gjermane kanë provuar se personat e dënuar me gjobë kanë një shkallë rikriminalizimi më të ulët se ato të dënuar me burg me kusht dhe akoma më tepër se ata me burg (Jehle et al, 2010).

drejtim të pranimit të dënimeve të tjera alternative si puna në shërbim publik, izolimi në shtëpi, vërejtja gjyqësore etj.

3.4.3. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale

Paragrafi i dytë i nenit 47 të K. Penal¹⁴³ parashikon “rrezikshmërinë e veprës penale” si rrethanën e parë që duhet të mbajë në konsideratë gjykata në caktimin e dënimit ndaj personit fajtor për kryerjen e një veprë penale. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është rrethana kryesore (Muçi, 2012: 291) e cila duhet të udhëheqë jo vetëm Ligjvënësin (në përcaktimin e marzheve të dënimit), por në shumë raste edhe gjykatën në individualizimin e dënimit në çdo rast konkret. Përcaktimi nga neni 47 i K. Penal i rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer së bashku me shkallën e fajësisë, si kritere kryesore të caktimit të dënimit, është tregues i pastër i qëllimit ndëshkues të dënimit penal (Von Hirsch, 2009: 142) në vendin tonë. Në mënyrën se si është formuluar neni 47 §2, rrezikshmëria e veprës penale përfshin çdo lloj rrethane që ka të bëjë me anën objektive të veprës penale (Salihu, 2012: 496) dhe duhet dalluar nga qëndrimi psikik dhe rrethanat personale të të pandehurit. Po ashtu, nuk është objekt i vlerësimit gjyqësor rrezikshmëria abstrakte e veprës penale (pasi kjo është vlerësuar nga ligjvënësi përmes përcaktimit të llojeve dhe marzheve të dënimit), por është vetëm përcaktimi i nivelit të rrezikshmërisë konkrete brenda hapësirës së diskrecionit të njohur nga ligji.

Çështja e përcaktimit të rrezikshmërisë shoqërore të një veprë konkrete është relativisht e vështirë, pasi jo vetëm që nuk ka një definicion zyrtar të saj, por as një metodologji apo kritere strikte se si mund të matet¹⁴⁴. Gjithsesi, vështirësitë për të pasur një qëndrim unanim apo një mënyrë të standardizuar matjeje, nuk mund të përbëjnë argument për të hequr dorë nga përpjekjet për të vendosur disa kritere gjerësisht të pranueshme për matjen e saj.

Elementi i parë dhe në vlerësimin tonë më i rëndësishëm i përcaktimit të rrezikshmërisë së një veprë penale konkrete është vlera shoqërore e së mirës së cenuar prej saj. Të mirat e mbrojtura nga ligji penal janë disa dhe janë cituar nga neni 1/b i K. Penal¹⁴⁵. Megjithatë kjo dispozitë ka bërë një listë të të mirave të mbrojtura nga ligji penal, nuk duket se renditja e tyre pasqyron me rigozitetet rëndësinë e tyre si vlera. Një renditje e arsyeshme e të mirave të mbrojtura nga ligji penal do të

¹⁴³ Ky paragraf parashikon se: “Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo (gjykata) merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.

¹⁴⁴ Shumë kode penale si për shembull ai italian (në nenin 133) kanë përcaktuar elementët mbi të cilët duhet të referohet gjykata në përcaktimin e rëndësisë së veprës penale, madje disa shtete të sistemit anglosakson kanë shkuar edhe më tej, duke bërë një renditje të rëndësisë së veprave penale. Kështu komisionet e caktimit të dënimeve të Minesotas, Uashingtonit, apo Oregonit (Von Hirsch et al, 1985: ch5), kanë bërë një renditje të të gjitha veprave penale, për t’i përdorur në udhëzimet numerike (me pikë) të caktimit të dënimit.

¹⁴⁵ Ky nen parashikon se: “Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.

ishte: pavarësia e shtetit dhe tërësia e tij territoriale, rendi kushtetues, të drejtat dhe liritë e njeriut, duke filluar nga e drejta e jetës, e shëndetit dhe e dinjitetit njerëzor, ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike, mbrojtja e pronës, mjedisit, dhe bashkëjetesës mes qytetarëve të vendit. Më tej brenda një të mire mund të ketë ndarje të mëtejshme, nisur nga rëndësia apo madhësia e pasojës¹⁴⁶.

Një element tjetër i rëndësishëm i përcaktimit të rrezikshmërisë shoqërore të një veprë janë dëmtimi i një objekti dytësor (Muçi, 2012: 137), i cili ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale¹⁴⁷. Shkalla e dëmtimit të objektit dytësor ndikon në rrezikshmërinë e veprës njësoj si dëmtimi i objektit kryesor.

Rrethanë tjetër që ndikon në rrezikshmërinë e veprës është lidhja shkakësore e qartë mes veprimit dhe pasojës. Në rastin kur pasoja (apo të gjitha pasojat) është rrjedhojë e drejtpërdrejtë dhe ekskluzive e veprimit të pandehurit, kjo sugjeron një rrezikshmëri maksimale të veprimit të tij. Pavarësisht se cila nga teoritë e kauzalitetit mund të aplikohet (Salihu, 2012: 219), në rastet kur pasoja ka ardhur si kombinim edhe i veprimeve të personave të tjerë, përfshirë edhe vetë të dëmtuarin, rrezikshmëria e veprës penale është më e vogël¹⁴⁸.

Rrethana të tjera që ndikojnë në përcaktimin e rrezikshmërisë së veprës janë: intensiteti i veprimeve, mjetet apo mënyra e përdorur, koha dhe vendi i kryerjes së veprës apo çdo rrethanë tjetër objektive, e cila logjikisht vlerësohet se ndikon në rritjen apo uljen e rrezikshmërisë shoqërore të një veprë penale¹⁴⁹. Një rrethanë e tillë e arsyeshme e cila duhet të mbahet në konsideratë nga gjykata në uljen e dënimit, është aktualiteti i veprës penale¹⁵⁰. Në rastin kur nga

¹⁴⁶ Kështu p.sh. megjithëse jeta e njeriut mbrohet njëlloj nga ligji, humbja e jetës së një të mituri apo të riu konsiderohet si më e rëndë se e një të moshuari, gjymtimi i një këmbë është më e rëndë se fraktura e saj, vjedhja e makine është më e rëndë se vjedhja e një biçiklete, djegia e një pylli është më e rëndë se prerja e një kamioni me dru etj.

¹⁴⁷ Vepra të tilla janë vjedhja me dhunë, goditja për shkak të detyrës, marrëdhëniet seksuale me dhunë (me pasoja të rënda), shkelja e rregullave të sigurisë në punë, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, etj. Në raste të caktuara kryerja e një veprë penale, mund të bëhet shkak edhe për pasoja të tjera që nuk rrjedhin drejtpërdrejtë nga veprimet e të pandehurit, si p.sh. shkaktimi i vetëvrasjes, rënia në depresion, zgjidhja e martesës, largimi nga puna, shkaktimi i trazirave në një komunitet, prishja e marrëdhënieve me një shtet tjetër etj., të cilat shtojnë rrezikshmërinë e veprës së kryer nga i pandehuri.

¹⁴⁸ Rast i tillë mund të jetë p.sh. aksidentimi për shkak të shpejtësisë së lëvizjes me autoveturë, duke plagosur apo vrarë një drejtues çiklomotori, i cili lëviz pa kaskën mbrojtëse. Në këtë rast, megjithëse drejtuesi i mjetit autoveturë duhet deklaruar fajtor për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, vepra e tij paraqet një rrezikshmëri më të ulët shoqërore.

¹⁴⁹ Intensiteti i veprimeve është tregues i këmbënguljes së autorit për kryerjen e veprës, p.sh. qëllon të gjithë karikatorin e fishekëve mbi viktimën, dhe pasi afrohet e qëllon përsëri në kokë; hyn në një banesë për të vjedhur dhe lëviz nga vendi çdo mobilje, rrobë dhe objekt tjetër etj. Rrethana të tilla si mjetet, mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës etj. duhet vlerësuar nga pikëpamja logjike dhe arsyetuar mirë në vendim, pasi vlera e tyre e veçantë, apo kombinimi me njëra-tjetrën ndryshon nga rasti në rast. P.sh. armët e zjarrit janë një mjet i rrezikshëm, por në vlerësimin tonë vrasja me thikë me prerje në fyt paraqet rrezikshmëri më të madhe, vjedhja e kryer natën, jo në çdo rast tregon rrezikshmëri më të lartë, pasi mund të tregojë dhe frikën e autorit në raport me një vjedhje të hapur të kryer ditën. Me të njëjtin arsyetim, megjithëse ambienti publik mund të cilësohet si një rrethanë përgjithësisht më e rrezikshme e kryerjes së veprave penale, në raste të caktuara ajo mund të jetë tregues i padijenisë së autorit për ligjin, apo i nevojës së madhe të tij për të kryer veprën penale (p.sh. vjedh bukë, apo ushqime për të ngrënë).

¹⁵⁰ GJL me vendimin nr. 986 (192), datë 04.07.2012 ka ndryshuar vendimet e dy shkallëve më të ulëta ndaj të pandehurit A.Q për veprën penale të “Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/3 i K. Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim, me arsyetimin se Shqipëria ka vendosur liberalizimin e

kryerja e veprës ka kaluar një kohë e gjatë (afat i cili ndryshon në raport me rrezikshmërinë e saj) dhe autori i saj nuk ka kryer vepër tjetër penale, kjo është një tregues i një rrezikshmërie më të ulët të saj (Elezi, 2013: 260). Kjo shkon në përputhje me frymën e instituteve të tilla të së drejtës penale si parashkrimi i ndjekjes penale dhe i dënimit, të cilat njohin efektin dekriminalizues dhe depenalizues të kohës së kaluar.

Duke qenë se rrezikshmëria e një vepre ka të bëjë me perceptimin logjik të një fakti të caktuar, gjykata mundet të vlerësojë si rrethanë që shton apo ul rrezikshmërinë e veprës, çdo lloj rrethane që ajo e çmon si bindëse, mjafton që ta arsyetojë vendimin e saj. Në teori (Elezi, 2013: 260) dhe në praktikën gjyqësore¹⁵¹ ndeshim shpesh të përmenden si rrethana që tregojnë për një rrezikshmëri më të lartë të veprës, fakte të cilat nuk kanë një bazë të shëndoshë logjike (apo nuk arsyetohen mjaftueshëm) për t'u vlerësuar si të tilla.

Gjatë vlerësimit të rrezikshmërisë së një vepre, në praktikë mund të ndeshen plot raste kur gjykata vlerëson se vepra konkrete nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore, apo paraqet një rrezikshmëri shumë të ulët (Muçi, 1989: 84), megjithëse formalisht veprimi parashikohet si vepër penale. Kodi

vizave me vendet e BE-së dhe kjo dispozitë për të cilën i gjykuari është dënuar, ka humbur aktualitetin që ka pasur në kohën kur është kryer vepra (para 4 vjetësh). Me vendimin nr. 1223 (209), datë 11.07.2012, KPGJL ka ndryshuar vendimin e GJA Vlorë (për masën e dënimit) ndaj të pandehurit G. Ll., duke u shprehur se në caktimin e masës së dënimit duhet të merret parasysh koha e gjatë e kaluar nga kryerja e veprës penale deri në momentin aktual, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe ajo e personit të akuzuar, kushtet dhe rrethanat familjare e shoqërore të tij.

¹⁵¹ P.sh. shpesh gjykatat konsiderojnë përhapjen e një vepre penale, si rrethanë që tregon rrezikshmëri më të lartë të veprës. Kështu, në vendimin nr. 1672 (347), datë 19.12.2012 KPGJL shprehet se: *"Fakti që një vepër është shumë e përhapur nuk duhet konsideruar si një tregues i rëndësisë së veprës"*, ndërkohë që me vendimin nr. 1610 (290), datë 13.11.2013, ky kolegji mban qëndrim diametralisht të kundërt, duke u shprehur se: *"Veprat penale ndaj rendit dhe sigurisë publike si dhe ndaj personit kanë marrë përhapje të gjerë si në rang lokal ashtu edhe në të gjithë vendin, e në këto kushte duhet të ketë një reflektim nga organet e drejtësisë lidhur me ashpërsimin e qëndrimeve ndaj autorëve të këtyre veprave penale, si për të ndikuar në parandalimin e përgjithshëm ashtu edhe në atë të posaçëm."* Në vlerësimin tonë përhapja e veprës penale nuk duhet konsideruar si një rrethanë rënduese sepse s'ka të bëjë me veprimet e të pandehurit. Nisur nga parimi i përgjegjësisë individuale, nuk është i merituar dënimi i rëndë i një personi për shkak të gabimeve të pandëshkuara të të tjerëve. Përhapja e një vepre penale mund të ketë ardhur për shkaqe të ndryshme (ku ndër më kryesorët është mosndëshkimi i tyre për një kohë të gjatë), por jo për faj të të pandehurit, i cili duhet të përgjigjet vetëm për aktin e tij të paligjshëm.

Një rrethanë tjetër që shpeshherë ndikon në rëndimin e dënimit ndaj të pandehurit është qëndrimi armiqësor i të dëmtuarit, i familjarëve të viktimës, apo më gjerë qëndrimi i opinionit publik dhe mediave në lidhje me një çështje të caktuar. Këto janë raste kur gjykata duhet të tregojë pavarësi dhe paanësi dhe ta zbatojë ligjin me profesionalizëm dhe drejtësi. Prirja për të ushtruar ndikim nga këto grupe ka një natyrë më së shumti emotive (e në raste të caktuara edhe interesi) dhe nuk drejtohen nga arsyeja e shëndoshë, prandaj nuk zgjasin në kohë, pasi shoqëria ka prioritetë të tjera më të rëndësishme. Mungesa e interesimit afatgjatë të tyre mbi dënimin vërehet në rastin e lirimit para kohe me kusht, ku pakkush interesohet më për vendimin gjyqësor. Disa nga këto qëndrime, mund të jenë tifoza dhe pse jo hipokrite, pasi nëse fajtori do të ishte një i afërm i tyre, qëndrimi i tyre mund të ndryshonte tërësisht. Në qendër të procedimit penal dhe të caktimit të dënimit është i pandehuri dhe jo viktimja, prandaj do të ishte e padrejtë dhe jo logjike që t'i kushtohet një vëmendje më e madhe opinionit të viktimës (apo familjarëve të tyre) se rrethanave individuale të të pandehurit. Në mjaft raste duhet pranuar me dhimbje se është objektivisht e pamundur të bëhet drejtësi penale njëkohësisht edhe për të pandehurin edhe për viktimën (Hudson, 2009: 369). Në një shtet ligjor, është gjykata organi që përcakton nivelin e dëmit që ka shkaktuar i pandehuri me veprimin e tij dhe jo qëndrimi emocional i të dëmtuarit.

aktual penal nuk ia ka njohur gjykatës të drejtën për të pushuar çështjen penale, apo për ta përjashtuar të pandehurin nga dënimi për këtë shkak, duke lejuar vetëm disa hapësira të pamjaftueshme diskrecioni¹⁵². Mënyrat e zgjidhjes ligjore për përjashtimin nga dënimi të veprave pa rrezikshmëri shoqërore janë të shumta dhe fillojnë me mundësinë që vetë prokuroria të vendosë mosfillimin e ndjekjes penale (në vlerësimin tonë kjo do të ishte zgjidhja më e mirë dhe më e dobishme në praktikë, për të ekonomizuar kohën) dhe shkojnë në fund me të drejtën e gjykatës (me vendim përfundimtar) për ta përjashtuar autorin nga dënimi apo për të caktuar ndaj tij vetëm një vërejtje gjyqësore.

3.4.4. Shkalla e fajit

Shkalla e fajit me të cilën është kryer vepra penale është elementi i dytë i vlerësimit të rrezikshmërisë së një akti kriminal (Von Hirsch, 2009: 142). Parashikimi saj heq çdo lloj dyshimi se dënimi penal në Shqipëri ka një karakter të theksuar retrospektiv dhe ndëshkues, pasi mënyra e caktimit të tij lidhet fort me momentin e kryerjes së veprës (rrezikshmërinë e veprës dhe shkallën e fajit të autorit). Faji si pjesë thelbësore e anës subjektive të figurës së veprës penale, paraqet në vetvete qëndrimin psikik që mban autori ndaj veprës së tij. Sipas nenit 14 §2 të K. Penal një person konsiderohet se ka vepruar me faj nëse e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi¹⁵³.

Rëndësia e përcaktimit të shkallës së fajit vërehet në ato figura veprash penale të cilat mund të kryhen me të dy format e fajit ose të paktën me të dy nënformat e tyre respektive (përkatësisht dashje direkte apo eventuale dhe vetëbesim i tepruar apo neglizhencë). Në figurat në të cilat forma e fajit është unike, ky element ka një peshë më të vogël në caktimin masës së dënimit¹⁵⁴. Në të tilla raste duhet shqyrtuar elementi intelektual i fajësisë për të bërë një shkallëzim të saj, pasi elementi

¹⁵² Edhe K. Penal i vitit 1977 në nenin 3 §3 të tij nuk e konsideronte si vepër penale, një akt i cili ndonëse parashikohej nga një dispozitë e ligjit penal, nuk ishte shoqërisht e rrezikshme për shkak të rëndësisë së saj të vogël. Më tej neni 33 i këtij kodi (përjashtimi nga dënimi për mungesë rrezikshmërie shoqërore), parashikonte mundësinë e mosdënimit të të pandehurit edhe në rastin kur megjithëse formalisht fakti (në kohën e kryerjes së saj) parashikohej si vepër penale, gjatë hetimit ose shqyrtimit gjyqësor të çështjes e kishte humbur karakterin shoqërisht të rrezikshëm për shkak të ndryshimit të rrethanave politiko-shoqërore, si edhe kur personi nuk paraqiste më rrezikshmëri shoqërore. Institute të tilla depenalizuese janë të njohura edhe nga kode të tjera moderne penale (si ai i Kosovës) dhe janë një domosdoshmëri për të përqendruar efektivisht të drejtën penale dhe strukturat e zbatimit të ligjit penal vetëm ndaj veprimeve të rrezikshme shoqërore. Hapësirat që aktualisht njeh K. Penal për trajtimin e veprave pa rrezikshmëri shoqërore janë të pamjaftueshme (si caktimi i një dënimi alternativ, apo i një dënimi plotësues) si nga pikëpamja procedurale (pasi harxhojnë kohën e këtyre organeve) ashtu edhe nga pikëpamja substanciale.

¹⁵³ Një person e kryen veprën me dashje kur ai i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre (dashja direkte), ose megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre (dashja indirekte). Quhet se vepra është kryer me pakujdesi kur personi megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato (vetëbesim i tepruar), ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte (neglizhencë).

¹⁵⁴ Si vepra penale që kryhen me dashje dhe me pakujdesi mund të përmendim nenet 97 (Mosdhënia e ndihmës), neni 98 (Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes), neni 201 (Ndotja e ajrit), neni 203 (Ndotja e ujërave) etj. Si vepër që kryhet me të dy nënformat e dashjes mund të përmendim nenin 76 (Vrasja me dashje), apo 88 (Plagosja e rëndë me dashje) dhe me dy nënformat e pakujdesisë mund të përmendim nenin 85 (Vrasja nga pakujdesia), apo nenin 290 (Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor). Vepra të cilat kryhen vetëm me dashje të drejtpërdrejtë janë neni 78 (Vrasja me paramendim), neni 308 (Përkthimi i rremë) etj.

volitiv është i përcaktuar. Ky është një nga rastet kur personat që kanë një nivel më të lartë dijes për çështjen në fjalë, legjitimohet të dënohen më rëndë. Në individualizimin e dënimit, ndihmojnë dhe ndarje të tjera të dashjes të bëra nga teoria dhe praktika gjyqësore, si: dashja e përcaktuar *dolus determinatus* dhe ajo e papërcaktuar *dolus indeterminatus*, dashja e menjëhershme *dolus repentinus* apo dashja e paramenduar *dolus premeditatus* (Elezi, 2013: 130).

Megjithëse K. Penal nuk ka bërë një rregullim të gabimit në fakt¹⁵⁵, duhet pranuar se kur personi nuk ka mundur të parashikojë dhe nuk ka qenë i detyruar të parashikojë pasojat e dëmshme të veprimeve të tij, ai nuk ka përgjegjësi penale pasi mungon elementi faj. Në rastet e tjera të gabimit në fakt, personi mban përgjegjësi për veprën e kryer, por në varësi të shkallës së parashikueshmërisë së pasojave të veprës penale, gjykata mund ta zbusë dënimin ndaj personit konkret duke e argumentuar këtë si një shkallë e ulët faji (Nikolli, 2003: 52).

3.4.5. Rrezikshmëria e autorit të veprës penale

Në ndryshim nga dy kriteret e mësipërme të cilat fokusohen në meritën retributive të dënimit, rrezikshmëria shoqërore e autorit shërben për të udhëzuar dënimin e tij penal nga e ardhmja. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit është e dhëna bazë për të matur nevojat paaftësuese (Bottoms & Brownsword, 2009: 84) dhe të parandalimit të posaçëm të tij (Doob & Webster, 2009: 72). Matja e rrezikshmërisë shoqërore dhe e personalitetit të të dënuarit (Halili, 2014: 150) shërben poashtu për të udhëzuar përzgjedhjen edhe të masave riedukuese dhe përmirësuese ndaj tij¹⁵⁶. Për arritjen e këtyre qëllimeve është e nevojshme që dënimi t'i përshtatet personalitetit të fajtorit d.m.th. t'i përshtatet tërësisë së karakteristikave individuale që e shoqërojnë atë. Nëse individualizimi i dënimit sipas veprës së kryer është dhënia e drejtësisë së ftohtë për veprën e ndodhur në të shkuarën, individualizimi sipas cilësive të autorit të veprës është dhënie e drejtësisë aktuale për individin, autor të saj.

Natyra dhe rrethanat e kryerjes së krimit konkret, nxjerrin në pah vetëm në vija të trasha karakteristikat penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të autorit (Muçi, 1989: 115), pasi një rëndësi të posaçme merr sjellja e të pandehurit para dhe pas veprës së kryer¹⁵⁷. Personaliteti i kryerësit të

¹⁵⁵ Gabimi në fakt *error facti* është përfytyrimi i gabuar i rrethanave faktike të kryerjes së veprës penale. Në të drejtën penale njihen dy lloj gabimesh në fakt. Gabimi në objekt është kur personi ka përfytyrim të gabuar të objektit ndaj të cilit drejtohet vepra penale dhe mund të jetë në lidhje me cilësitë e vetë objektit, me numrin e tyre, mjetet me të cilat goditet ky objekt etj. Gabim tjetër në fakt është dhe gabimi në lidhjen shkakësore ku autori i veprës ka një përfytyrim të gabuar në lidhje me procesin e lidhjes shkakësore që zhvillohet pas veprimeve apo mosveprimeve të tij.

¹⁵⁶ Shih nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

¹⁵⁷ Vlerësimi i rrezikshmërisë së të pandehurit për një kohë më të gjatë se momenti i kryerjes së veprës është i domosdoshëm, pasi shumë vepra penale mund të jenë gabime momentale, apo reagime impulsive ndaj një situatë të pazakontë, e cila nuk ka ndodhur dhe nuk ka gjasë t'i ndodhë më në ardhmen. Në rrethanat më të rëndësishme që kanë rëndësi para kryerjes së veprës penale janë rekordet e tij të mëparshme kriminale dhe të respektimit prej tij të ligjeve dhe normave administrative si dhe çdo angazhim i tij për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në komunitet, ndërsa pas

veprës penale (zakonet e tij të sjelljes, ndërveprimi social, aftësitë konjitive dhe emocionet) dhe rrezikshmëria e tij shoqërore janë shumë të rëndësishme, por tejet të vështira për t'u analizuar dhe çmuar me objektivizëm nga gjykata në caktimin e dënimit, pasi provat me të cilat mund të merren të dhëna në lidhje me këto fakte janë të kufizuara (Nikolli, 2003: 49)¹⁵⁸. Hulumtimi i jetës familjare dhe i angazhimit social, i punësimit, arsimimit dhe formimit kulturor, historikut të tij me zbatimin e rregullave shoqërore etj., janë indikatorë që ndihmojnë për të kuptuar nëse vepra penale që ai ka kryer është pasojë logjike e botëkuptimit, karakterit dhe prirjeve të tij, apo është një akt i pamenduar mirë, shprehje e një reagimi ndaj rrethanave të rastit.

Duke qenë se rrezikshmëria e ndryshme shoqërore e të pandehurve që kanë kryer të njëjtën vepër penale të çon në dënime të ndryshme, është detyrim esencial i gjykatës që të arsyetojë në çdo rast shkaqet që e kanë shtyrë në marrjen e atij vendimi dhe peshën e tyre specifike. Vlerësimi i rrezikshmërisë së të pandehurit është një nga momentet ku gjykatës i njihet një diskrecion i gjerë, prandaj vetëm dhënia e arsyeve bindëse në vendim heq/ul dyshimet për arbitraritet dhe trajtim të pabarabartë¹⁵⁹.

kryerjes së veprës penale kanë rëndësi qëndrimi psikik i mbajtur prej tij ndaj veprës, përpjekjet për pajtim me të dëmtuarit, riparimi i dëmeve dhe angazhimi i tij për t'u përmirësuar. K. Penal italian (neni 133) dhe ai kosovar (neni 73 pikat 3, 5, 6, 7) parashikojnë shprehimisht si rrethana që gjykata duhet të mbajë në konsideratë në caktimin e dënimit, sjelljen e mëparshme të autorit të veprës, pranimin (apo jo) e fajit, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Me vendimin nr. 1684 (326), datë 05.12.2012 KPGJL ka prishur vendimin e GJA Vlorë për të gjykuarin A.K. dhe ka lënë në fuqi vendimin e GjRRGJ Fier me arsyetimin se rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe qëndrimi i tij pas kryerjes së saj, tregojnë për shkallë rrezikshmërie jo të vogël të vetë të gjykuarit. Sipas GJL, GJA Vlorë nuk ka pasur në konsideratë se i gjykuari është hetuar e gjykuar me masën e sigurimit "arrest në burg", dhe gjatë shqyrtimit të çështjes kjo masë nuk është ekzekutuar, çfarë dëshmon për një rrezikshmëri të veçantë të këtij të gjykuari.

¹⁵⁸ Neni 178/2 i K. Pr. Penale nuk lejon kryerjen e ekspertimeve për të përcaktuar profesionalizmin në kryerjen e veprës penale, prirjet kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike. Megjithatë ky kufizim mund të jetë bërë me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të të pandehurit, në vlerësimin tonë është jologjik, pasi përjashton profesionistët psikologë nga bërja e vlerësimeve të tilla, ndërkohë që detyron gjykatën të bëjë vlerësime të tilla për t'i përdorur në caktimin e dënimit. Kufizim tjetër është neni 153 i K. Pr. Penale, i cili ndalon që dëshmitari të shprehet për qëndrimin moral të të pandehurit, përveçse kur çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë e tij shoqërore (Islami et al, 2003: 219). Duke qenë se personaliteti i të pandehurit ka rëndësi për caktimin e dënimit në çdo rast, në vlerësimin tonë rregulli duhet kthyer në përjashtim, duke shmangur nga dëshmia vetëm ato vlerësime morale që janë të panevojshme për përcaktimin e personalitetit dhe të rrezikshmërisë së të pandehurit (si p.sh. jeta seksuale, besimi fetar, bindjet politike etj.).

¹⁵⁹ Shumë rrethana personale në varësi të rastit mund të shërbejnë si rrethana që tregojnë për një rrezikshmëri më të lartë apo më të ulët të të pandehurit dhe kjo mund të mbështetet në studimet kriminologjike dhe në eksperiencën e kaluar njerëzore. P.sh. mosha e re e të pandehurit (deri në 21 vjeç) sugjeron për një trajtim më tolerant sepse ai nuk është maturuar plotësisht, ndërsa mosha e tretë sepse rrezikshmëria e tyre për shoqërinë është përgjithësisht më e ulur. Me të njëjtin arsyetim, nga eksperiencia njerëzore gjinia femërore paraqet një rrezikshmëri më të pakët për shoqërinë për mjaft vepra penale të dhunshme (të cilat edhe kur i kryejnë, rrallë herë i përsërisin), por nuk mund të gjejë të njëjtën përkrahje për vepra të tjera, për të cilat duhet një trajtim i barabartë me meshkujt. Po ashtu personat me një edukim solid arsimor, me një profesion mbi të cilin kanë investuar shumë energji jetësore, apo që kanë një familje të shëndetshme për të cilën kanë detyrime të përkujdesen, paraqesin një rrezikshmëri më të ulët shoqërore dhe një prirje më të madhe për riedukim dhe riintegrim social. Megjithatë mund të tingëllojë e padrejtë në aspektin social dhe

3.4.6. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Numri i rrethanave që ndikojnë në rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe të autorit është i madh, por me qëllim ngushtimin e diskrecionit gjyqësor, Legjislatori i ka parashikuar disa prej tyre në mënyrë specifike si rrethana lehtësuese apo rënduese. Siç edhe sugjeron emërtimi i tyre, rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese duhet të mbahen parasysht nga gjykata në zbutjen apo rëndimin e dënimit ndaj autorit të saj. Disa prej rrethanave lehtësuese dhe rënduese kanë të bëjnë me veprën penale dhe shkallën e fajësisë së kryerjes së saj, disa të tjera me rrezikshmërinë e autorit dhe disa mbartin elementë të të dyjave. Megjithëse K. Penal është treguar relativisht i detajuar në trajtimin e një numri të madh rrethanash si lehtësuese dhe rënduese, në të nuk është parashikuar vlera e peshës specifike të secilës prej tyre në zbutjen/rëndimin e dënimit¹⁶⁰.

Mendimi i hedhur në doktrinë se këto rrethana nuk kanë një peshë të njëjtë me njëra tjetrën (Muçi, 2012: 301) është i drejtë, pasi në të kundërt vetë Ligjvënësi do ta kishte parashikuar një vlerë të tillë. Në vlerësimin tonë pabarazia e rrethanave lehtësuese/rënduese nuk shtrihet vetëm në raport me njëra-tjetrën, por edhe e njëjta rrethanë s'mund të ketë gjithnjë të njëjtën peshë në çdo rast, për shkak se intensiteti i paraqitjes së saj (siç do ta ilustrojmë më poshtë) s'mund të jetë gjithnjë i njëjtë. Rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese nuk merren në konsideratë vetëm kur ato janë pjesë përbërëse e dispozitës së pjesës së posaçme, apo shërbejnë si rrethana cilësuese për ta dalluar një vepër nga një tjetër (Muçi, 2012: 306), pasi në këto raste pesha dhe ndikimi i tyre në dënim është vlerësuar nga vetë Legjislatori, me qëllim ngushtimin e diskrecionit gjyqësor.

Së fundmi, megjithëse neni 50 i K. Penal bën një trajtim shterues, duke ndaluar zgjerimin e numrit të rrethanave rënduese, madje dhe neni 373 i K. Pr. Penale shkon më tej duke ndaluar përdorimin edhe të rrethanave rënduese që nuk janë përmendur në aktakuzë (Muçi, 2012: 305), në vlerësimin tonë gjykata mund të vlerësojë për llogari të rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj, çdo lloj rrethane tjetër që ajo e çmon si të rëndësishme¹⁶¹.

njerëzor, por personat me boshllëqe të mëdha kulturore, pa një profesion dhe punë të qëndrueshme, pa një banesë dhe një familje të rregullt, me varësi ndaj fenomeneve negative, si: lojërat e fatit, alkooli, droga, lypja, parazitaria, etj. paraqesin rrezikshmëri më të lartë shoqërore, pasi paraqesin një rezistencë më të madhe ndaj procesit riedukativ. Procesi i tyre risocializues është tepër i vështirë dhe kërkon impenjime disa herë më të mëdha jo vetëm në rrafshin penal, por edhe në rrafshin social dhe mjekësor. Ky është rasti për të pranuar se edhe e drejta penale moderne zotëron një natyrë të pashmangshme dhune dhe padrejtësie sociale (Giunta, 2004: 152).

¹⁶⁰ K. Penal italian parashikon në nenet 64 dhe 65 se prania e një rrethane rënduese apo lehtësuese e rrit apo e zbut dënimin me 1/3 e dënimit që do të caktohej pa prezencën e tyre. Më tej nenet 66, 67 dhe 68 të këtij kodi parashikojnë dhe mënyrën e llogaritjes së dënimit kur janë prezent disa rrethana rënduese, disa rrethana lehtësuese, apo ka një kombinim mes atyre rënduese dhe lehtësuese.

¹⁶¹ P.sh. vlerësojmë se fshehja e autorit të veprës penale dhe injorimi prej tij i hetimit dhe gjykimit, megjithëse nuk është rrethanë rënduese, është një tregues logjik se ai paraqet një rrezikshmëri më të shtuar shoqërore, nëse gjendet fajtor për veprën për të cilën akuzohet. Shpërfillja e organeve të drejtësisë dhe e efektit edukues të procesit penal, është manifestim i njëkohshëm i shpërfilljes së të pandehurit ndaj forcës shtrënguese të ligjit penal.

3.4.6.1. Rrethanat lehtësuese

Sipas nenit 48 të K. Penal lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë:

a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive, morale e shoqërore.

Duke vlerësuar natyrën imorale të veprës penale, kjo rrethanë mund të gjejë zbatim shumë rrallë, pasi s'mund të ketë justifikim moral për kryerjen e një akti imoral¹⁶². Gjithsesi kjo rrethanë mund të gjejë zbatim në ato raste kur autori niset nga motive të vlerësueshme morale, por që më pas kapërcen masën e proporcionalitetit dhe kryen një vepër penale. Në të tilla raste gjykata duhet t'i mbajë parasysh këto shtysa në zbutjen e dënimit. Si motive me vlera pozitive, morale e shoqërore, mund të cilësohen dhembshuria, dashuria, mëshira, etj. (Elezi et al, 2013: 262), pasi ato tregojnë për një shkallë më të ulët rrezikshmërie shoqërore të autorit të saj. Kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicionin gjenetik ose aftësinë e kufizuar, neni 48 nuk lejon zbatimin e kësaj rrethane lehtësuese.

b) Kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër.

Kjo është një nga rrethanat me peshën më të madhe në zbutjen e dënimit pasi tregon për mungesën e një prirjeje të pandehurit për të kryer vepër penale me iniciativën e tij¹⁶³. Tronditja psikike ndodh atëherë kur për shkak të ngacmimeve të jashtme, si dhuna apo provokimi i viktimës, autori i veprës humbet në një shkallë të madhe kontrollin mbi veprimet e tij. Megjithatë efektin e saj të madh zbutës, duhet pranuar se kjo rrethanë lehtësuese gjen zbatim vetëm në rastet e marrëdhënieve ndërpersonale, kryesisht vetëm në ato pak vepra penale që drejtohen ndaj shëndetit apo jetës së personit, pasi zbatimi i saj në vepra të tjera do të tingëllonte absurd.

c) Kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit.

Kjo rrethanë mund të gjejë zbatim vetëm në veprat penale që kryhen gjatë ushtrimit të detyrës dhe në vlerësimin tonë duhet të ketë një peshë më të vogël zbutëse se rrethanat e tjera lehtësuese, pasi secili nga funksionarët publik është (ose së paku duhet të jetë) i vetëdijshëm për ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe të shmangë ato veprime që shkelin ligjin¹⁶⁴.

¹⁶² Cilësimi i një motivi si "me vlera pozitive, morale e shoqërore", ndryshon në periudha, vende, dhe njerëz të ndryshëm, prandaj gjykata duhet të ketë kujdes në çmimin e tyre. P.sh. nuk mund të konsiderohet si vepër e kryer për motive me vlera pozitive e morale vrasja për hakmarrje apo gjakmarrje.

¹⁶³ Megjithatë nenet 82 dhe 88/a të K. Penal i referohen "tronditjes së fortë psikike të çastit", dallimet që kanë këto dy nene në marzhet e dënimit përkatësisht me nenet 76 dhe 88 janë aq të mëdha, sa sugjerojnë edhe për "tronditjen e thjeshtë psikike" një zbutje të ndjeshme të dënimit. Dallimi mes "tronditjes së fortë psikike të çastit" dhe "tronditjes së thjeshtë psikike" është vetëm në anën sasiore dhe kufiri ndarës i tyre është i vështirë për t'u përcaktuar në praktikë.

¹⁶⁴ Kështu p.sh. në veprën penale të mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme, nëse kjo vepër është kryer nga udhëzimet e padrejta të eprorit, kjo rrethanë duhet që mbahet parasysh në zbutjen e dënimit ndaj vartësit.

c) Kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë.

Kjo është rrethana më e zakonshme lehtësuese që aplikohet në praktikën gjyqësore dhe ashtu si rrethanat e tjera pasuese, ka të bëjë me qëndrimin psikik të autorit *post factum* ndaj veprës së tij të paligjshme. Format e shfaqjes së pendimit të thellë janë disa, por kryesisht manifestohen përmes pranimi të plotë të faktit që i atribuohet nga prokuroria¹⁶⁵, dhënies së shpjegimeve të plota dhe të sakta të rrethanave të kryerjes së veprës penale, në tregimin e bashkëpunëtorëve etj. (Elezi et al, 2013: 265). Vlerësimi i pendimit të thellë si rrethanë lehtësuese është tregues i synimeve riedukuese të dënimit penal, prandaj gjykata duhet të tregojë kujdes të madh në zbatimin e saj, pasi kjo rrethanë shërben shpesh për diferencimin e llojeve dhe të masave të dënimit për të pandehur të cilët kanë kryer të njëjtën vepër¹⁶⁶.

d) Kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale.

Kjo rrethanë ka një lidhje logjike dhe organike me rrethanën pararendëse dhe është tregues i pendesës së sinqertë dhe të thellë të autorit për veprën dhe dëshirës së tij për rivendosjen e marrëdhënieve të prishura mes tij dhe të dëmtuarit. Kur këto dy rrethana lehtësuese shoqërohen bashkë (dhe më tepër kur prezent është dhe pajtimi me viktimën), gjykata duhet të shmangë zbatimin e dënimeve represive dhe të orientohet drejt dënimeve më të buta, pasi edukimi i të pandehurit është më i lehtë për t'u arritur. Sa i takon kuptimit të kësaj rrethane, vlerësojmë se ai është i qartë dhe s'ka nevojë për komentim të mëtejshëm.

dh) Kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale.

Kjo rrethanë trajtohet si lehtësuese për faktin se jo vetëm tregon një lloj reflektimi dhe gatishmërie të autorit të veprës penale për t'u përballur me pasojat e veprimit të tij antiligjor, por edhe lehtëson punën e organeve ligjzbatuese në zbardhjen sa më të shpejtë të çështjes. Pavarësisht aktit të kryer,

¹⁶⁵ Në vlerësimin tonë pranimi i kualifikimit ligjor të bërë nga prokuroria nuk është kusht *sine qua non* për konsiderimin si të penduar të autorit të veprës, pasi prokuroria mund të mos besojë thëniet e tij dhe të bëjë një kualifikim më të rëndë se ai që ka ndodhur në të vërtetë.

¹⁶⁶ Pendimi i thellë i të pandehurit tregon se riedukimi dhe përmirësimi i tij është me i lehtë prandaj dhe lloji dhe masa e dënimit duhet të jenë më të buta. Vlerësimi i saktë i shkallës së pendesës së të pandehurit, has në vështirësi praktike për provueshmërinë e saj, pasi ka të bëjë me reflektimin në ndërgjegjen e tij. Shpeshherë është vështirë të dallohet pendimi i thellë dhe i sinqertë nga një pendim sipërfaqësor dhe i shtirur, prandaj gjykata duhet të çmojë me kujdes të gjitha veprimet e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale. Pendimi i thellë i personit, që ka kryer veprën penale ndryshon sasiorisht dhe cilësisht nga pohimi që bën i pandehuri në gjykatë, kur ndodhet para provave të pakundërshtueshme që provojnë fajësinë e tij. Besueshmëria e pendimit të thellë është më e madhe kur ajo fillon të shfaqet menjëherë pas kryerjes së veprës penale dhe vjen e zbehet sa më shumë kohë kalon nga kryerja e saj. Duhet konsideruar si të gabuara vendimet gjyqësore të cilat pranojnë si pendim të thellë të autorit të veprës, pranimin e fajësisë në fund të marrjes së provave, megjithëse gjatë hetimit dhe gjykimit nuk e ka pranuar faktin e atribuar. Prandaj deklarimi i të pandehurit se është penduar thellë, është mirë të shoqërohet me të dhëna të tjera me qëllim që të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Megjithëse është e qartë se për ta konsideruar rrethanë lehtësuese ligji kërkon një pendim “të thellë”, duhet pranuar matja proporcionale në varësi të intensitetit të shfaqjes së tij.

dorëzimi në polici rrit besueshmërinë se i pandehuri ka vullnet t'i bindet ligjit penal dhe në këtë mënyrë paraqet një lehtësi më të madhe për t'iu nënshtruar procesit riedukativ.

e) Kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar.

Së bashku me zëvendësimin e dëmit të shkaktuar, kjo rrethanë i jep një tonalitet të fortë restaurues dënimit penal në Shqipëri. Megjithatë kjo rrethanë mund të gjendet shpesh së bashku me pendimin e thellë, ato dallojnë nga njëra-tjetra si nga substanca ashtu edhe nga motivimi i tyre¹⁶⁷. Meqenëse dënimi penal ka si funksion të vendosjes së paqes shoqërore, pajtimi mes kryerësit të veprës penale dhe viktimës apo familjarëve të tij meriton të merret parasysh në zbutjen e dënimit ndaj personit fajtor. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 144/2013, kjo rrethanë nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje. Në vlerësimin tonë ky ndryshim vjen në kontradiktë me frymën e kësaj dispozite dhe për shkak se është tërësisht disproporcionale me synimin që e ka shtyrë, duhet riparuar përsëri¹⁶⁸.

Nisur nga pamundësia për të parashikuar në mënyrë shteruese të gjitha rrethanat lehtësuese, neni 49 i K. Penal parashikon hapësirën që gjykata të vlerësojë si të tilla edhe rrethana të tjera, të cilat justifikojnë lehtësimin e dënimit. Rrethana të tilla mund të kenë lidhje me rrezikshmërinë e veprës apo të pandehurit. Elementi esencial i kualifikimit të një rrethane si lehtësuese, duhet të jetë arsyetueshmëria e saj, pra fuqia bindëse se prania e saj është tregues i rrezikshmërisë më të pakët të veprës apo të pandehurit, apo i faktin se për shkak të saj është e arsyeshme caktimi i një dënimi më të butë¹⁶⁹.

¹⁶⁷ Një person mund të jetë penduar për veprën por nuk ka shlyer dëmin, sikurse mund të ketë shlyer dëmin, por nuk është penduar për veprën. Po ashtu, mund të jetë penduar, por nuk është pajtuar, sepse nuk pranon i dëmtuari, apo mund të jetë pajtuar me të dëmtuarin, pasi këtij të fundit nuk i intereson më ngjarja, por në vetvete i pandehuri nuk është penduar për veprën e kryer. Pendimi i thellë ka të bëjë me përmirësimin e të pandehurit për t'ju bindur ligjeve në të ardhmen, ndërsa pajtimi me të dëmtuarin, kanë të bëjnë me rivendosjen e marrëdhënieve sociale të prishura mes tyre.

¹⁶⁸ Familja është qeliza bazë e shoqërisë dhe mbrohet nga Kushtetuta dhe K. Familjes, prandaj nuk mundet që dënimi i ashpër i një pjesëtari të saj të dalë prioritar. Në vetvete, dënimi i një pjesëtari të familjes, është në funksion të mbrojtjes së vlerave të familjes kur kjo është e domosdoshme. Prandaj tingëllon cinike që ligji penal të pretendojë të dojë më shumë pjesëtarët e një familjeje sesa vetë këta pjesëtarë njëri-tjetrit. Pajtimi i marrëdhënieve mes pjesëtarëve të një familjeje është shumë herë më i dëshirueshëm për të mirën e krejt shoqërisë, sesa i dy personave të largët, prandaj ky ndryshim tingëllon i pamenduar mirë. Në vlerësimin tonë, nevoja për të eliminuar një pajtim të dhunshëm, apo fiktiv, nuk justifikon mospranimin as të pajtimit të vërtetë dhe të shëndetshëm për familjen. Prandaj Ligjvënësi mund të vendosë kritere më të rrepta për vlerësimin e pajtimit mes familjarëve (si p.sh. pranimin e fajësisë, monitorimin për një kohë të caktuar, marrjen e një vlerësimi psikologjik apo social etj.), por s'duhet ta përjashtojë atë kategorikisht.

¹⁶⁹ Rrethana që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë e ulët të veprës mund të përmenden vlera e ulët e dëmit, rrethanat e vështira ekonomike që e kanë shtyrë në kryerjen e veprës etj. Si rrethana që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë e paktë të pandehurit janë mosha e thyer, gjendja e rëndë shëndetësore, kontributi i njohur në shërbim të komunitetit etj. Rrethana që nuk tregojnë për rrezikshmëri më të vogël të veprës dhe as të pandehurit, por që megjithatë janë në përputhje me parimet dhe me qëllimet e dënimit penal dhe si të tilla meritojnë të vlerësohen në zbutjen e dënimit janë nevojat e veçanta për përkujdesje familjare, rastet e fatkeqësive familjare (Elezi et al, 2013: 267), nevojat që ka autori i veprës për shkolim etj. Nga ana tjetër zbutja e dënimit se i pandehuri rrjedh nga një familje me reputacion të mirë,

3.4.6.2. Rrethanat rënduese

Sipas nenit 50 të K. Penal rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë:

a) Kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta.

Megjithëse kryerja e veprës penale është në çdo rast i pajustificueshëm moralisht, kryerja e saj për motive të dobëta tregon një rrezikshmëri më të madhe të pandehurit. Si motive të dobëta praktika dhe teoria kanë cilësuar kryerjen e veprës nisur nga egoizmi, mendjemadhësia, karrierizmi, xhelozia, zilia, hakmarrja, kapadailëku etj. (Muçi, 2012: 315). Gjykata duhet të tregohet e matur në kualifikimin e një shtyese si “motiv i dobët”, pasi nëse ky term interpretohet tepër gjerë rrezikon që ai të zbatohet në çdo vepër penale ndaj personit.

b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një vepër penale tjetër ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material.

Në vlerësimin tonë kjo rrethanë përfshin katër motive të cilat paraqesin nivele rrezikshmërie të ndryshme dhe për pasojë duhen diferencuar nga njëra-tjetra. Rrethana më e rëndë është kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë penale dikë tjetër, pas saj vjen kryerja e saj për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri dhe më pas kryerja e veprës për të shmangur përgjegjësinë e tij penale. Rrethana e katërt, kryerja e veprës për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, në vlerësimin tonë duhet zbatuar vetëm në veprat penale të cilat nuk kanë objekt të saj përfitimin material,¹⁷⁰ dhe sigurisht kur kjo rrethanë nuk përbën rrethanë cilësuese.

c) kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori.

Kjo rrethanë i referohet mjeteve dhe mënyrave që përdor autori për kryerjen e veprës penale, të cilat nuk janë të zakonshme dhe as të domosdoshme për kryerjen e saj dhe dëshmojnë për një rrezikshmëri veçanërisht të theksuar të autorit të saj. Kjo rrethanë rënduese takohet në krimet kundër njerëzimit apo ato kundër personit të cilat kryhen me dashje të drejtpërdrejtë (Nikolli, 2003: 58).

ç) Kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë.

Një nga qëllimet e dënimit penal është parandalimi i posaçëm, dhe në rastin e recidivistëve dënimi i mëparshëm ka dështuar në arritjen e këtij funksioni. Për këtë arsye Ligjvënësi ka arsyetuar se për krimin e dytë duhet ashpërsuar dënimi, sepse i pandehuri nuk është përmirësuar nga dënimi i parë. Megjithëse përsëritja e një krimi konsiderohet formalisht si rrethanë rënduese, duhet të dallojmë

apo se ai është një person me kulturë dhe inteligjencë të lartë janë të paargumentuara dhe jashtë qëllimit të nenit 49 të K. Penal (Nikolli, 2003: 58).

¹⁷⁰ Nuk mund të përbëjë rrethanë rënduese një rrethanë që është pjesë përbërëse e veprës penale, e në rastin konkret nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese qëllimi për të përfituar pasuri në vepra të tilla si vjedhjet, mashtrimet, falsifikimet, korrupsioni, etj. Prandaj kjo rrethanë mund të vlerësohet si rënduese, vetëm në ato vepra të cilat nuk kanë si qëllim të tyre normal apo prioritar fitimin e pasurive.

disa lloj recidivistësh të cilët paraqesin specifika të ndryshme dhe meritojnë një trajtim të ndryshëm penal në rrafsh ligjor dhe gjyqësor. Kështu recidivistët mund t'i ndajmë në recidivë të përgjithshëm, në recidivë speciale dhe në recidivë habitualë¹⁷¹. Në vlerësimin tonë përsëritja nuk duhet parë domosdoshmërisht si mungesë vullneti i të pandehurit për t'u përmirësuar, pasi kushtet dhe mënyra e jetesës së tij mund të jenë të tilla që ta promovojnë kryerjen e veprave penale. Përsëritja mund të sugjerojë rritjen e dënimit me burgim vetëm kur më parë kanë dështuar aplikimi i dënimeve më të buta ndaj tij (Morris, 1974: 60) dhe kur çdo masë tjetër në dispozicion është e papërshtatshme dhe e paefektshme.

ç/1) Kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike.

Kjo është një rrethanë e re rënduese e shtuar me ligjin nr. 144/2013 dhe ka për qëllim forcimin e efektshmërisë së mbikëqyrjes elektronike. Në ndryshim nga përsëritja e cila zbatohet vetëm për krime, kjo rrethanë rënduese zbatohet pa dallim për krimet dhe për kundërvajtjet penale.

d) Kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale.

Kjo rrethanë është tepër e vështirë të vërtetohet në praktikë pasi nga njëra anë pasojat e një veprë janë pjesë përbërëse e saj¹⁷² dhe nga ana tjetër pasojat që s'kanë të bëjnë me veprën e parë, përbëjnë elementë të një veprë të re penale.

dh) Kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar.

Kjo rrethanë rënduese zbatohet vetëm ndaj subjekteve të posaçme (funksionarë publikë ose fetarë), të cilët duhet të rrezatojnë një lloj morali dhe besueshmërie më të lartë se njerëzit të cilët nuk i ushtrojnë këto funksione. Kryerja e veprave penale nga punonjës që ushtrojnë një shërbim fetar, vlerësohet veçanërisht e rëndë, pasi kjo kategori punojnë për kultivimin e vlerave morale të

¹⁷¹ Recidivistët gjeneralë, janë ata persona të cilët pas dënimit të parë (para ose pas vuajtjes së tij të plotë) kryejnë një vepër tjetër penale. Në këtë rast gjykata duhet të vlerësojë arsyet se përse ky individ ka kryer përsëri vepër penale, pasi mundet që krimi i ri të jetë kryer me pakujdesi apo në rrethana krejtësisht rastësore në prani të disa rrethanave lehtësuese (për pasojë në këtë rast recidivizmi duhet të ketë ndikim të vogël). Recidivistët specifikë janë ata persona të cilët janë dënuar më parë për kryerjen e të njëjtit krim, apo lloj krimi. Tek kjo kategori personash nuk ka vend më për rastësi dhe rrezikshmëria e të pandehurit dukshëm meriton një dënim më të lartë. Recidivistët habitualë, janë një kategori personash të cilët e kanë kryer një vepër 3 ose më shumë herë (në praktikë ndodh shpesh me dhjetëra, apo qindra herë) dhe dënimi penal ndaj tyre jep pak ose aspak efekt, për t'i përmirësuar. Të tillë persona janë kryesisht narkomanët, të alkoolizuarit, personat pa një banesë të qëndrueshme, por edhe të miturit, të cilët kryejnë në vijimësi vepra të tilla, si: vjedhje të vogla, shpërndarje substancash narkotike, mashtrime të vogla, etj. Këta persona kërkojnë një qasje më të kujdesshme dhe të diferencuar, pasi në shumicën e rasteve dënimi i ashpër penal i tyre nuk jep asnjë rezultat ndërkohë që është tejet joekonomik. P.sh. në vlerësimin tonë është tërësisht joefikase mbajtja për 2, 3 apo më shumë vite në burg e një individi, i cili megjithëse mund të ketë vjedhur disa herë, shuma e sendeve të vjedhura nuk e kalon shumën prej 100.000 lekësh dhe me siguri që edhe pas këtij burgimi ai do t'i rikthehet këtij vesi, për shkak të problemeve të tij sociale, mjekësore apo psikologjike. K. Penal rus ka bërë një rregullim të detajuar në nenet 18 dhe 68 të tij, duke bërë një ndarje në tre shkallë të recidivizmit dhe duke përcaktuar peshën dhe ndikimin në ashpërsimin e dënimit.

¹⁷² Ashtu si Shefqet Muçi (2012: 318) dhe në ndryshim nga disa autorë të tjerë (Elezi et al, 2013: 272), ne vlerësojmë se kjo rrethanë nuk i referohet pasojave të rënda të vetë veprës, pasi ato janë pjesë e vlerësimit të rrezikshmërisë së saj shoqërore, por pasojave të tjera jashtë asaj figure krimi.

qytetarëve, dhe kjo do të dëmtonte shumë besimin e njerëzve tek cilësitë e mira të njeriut. Ashtu si në rastet e tjera, kjo rrethanë nuk zbatohet në rastet kur shpërdorimi i detyrës është pjesë e vetë figurës së veprës penale (si shpërdorimi i detyrës, vjedhja duke shpërdoruar detyrën etj.).

e) Kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen.

Kjo është një rrethanë kuptimplote dhe synon të vendosë nën një mbrojtje më të madhe këtë kategori viktimash potenciale për shkak të cilësive të tyre. Është e qartë se për të pasur këtë rrethanë rënduese, duhet patjetër që autori i veprës të dinte ose të ishte i detyruar të dinte se viktimë ishte i mitur, grua shtatzënë apo person i paafte për t'u mbrojtur (invalid, i sëmurë, i moshuar etj.).

e/1) Kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje.

Edhe kjo rrethanë është shtuar me ligjin nr. 144/2013, dhe ka për qëllim të mbrojë më fort zbatimin e urdhrave të mbrojtjes. Megjithatë kjo dispozitë nuk e parashikon literalisht, në vlerësimin tonë vepra penale e kryer duhet të ketë lidhje me vendosjen e urdhrit të mbrojtjes dhe s'mund të zbatohet për çdo lloj veprë penale¹⁷³.

f) Kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera.

Përfaqësuesit e shteteve të huaj gëzojnë imunitet dhe mbrojtje të veçantë kur ndodhen në territorin shqiptar, prandaj kryerja e veprave penale ndaj tyre është më e rëndë, pasi mund të ndikojë në marrëdhëniet e vendit tonë me shtetin të cilin ai përfaqëson.

g) Kur vepra është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes.

Kjo trajtohet si rrethanë rënduese për faktin se cenon vlerat e shoqërisë shqiptare të respektit për familjen dhe mikpritjen. Për shkak të shpërdorimit të besimit të të dëmtuarve, kryerja e veprave penale duke shfrytëzuar këto raporte merr një përbuzje nga e gjithë shoqëria dhe si e tillë meriton një dënim më të rëndë.

gj) Kryerja e veprës penale në bashkëpunim.

Kryerja e veprës penale në bashkëpunim, meriton një dënim më të rëndë, pasi ka një predispozitë që ajo të kryhet më lehtë dhe në mënyrë më të sofistikuar, të sjellë pasoja më të rënda dhe të vështirësojë zbulimin e autorëve. Problemi i vlerësimit të kësaj rrethane del në rastet kur bashkëpunimi nuk tregon për ndonjë rrezikshmëri më të shtuar të veprës, madje për shkak të shkallës së ulët të pjesëmarrjes dhe rolit të luajtur, mund të tregojë edhe një rrezikshmëri më të ulët sesa ta kishte kryer këtë vepër i vetëm. Në vlerësimin tonë në këto raste, mbështetur në nenin

¹⁷³ Nga interpretimi i saj logjik kuptohet se nuk jemi para një rrethane rënduese nëse personi ndaj të cilit është vendosur një urdhër mbrojtjeje, kryen një vjedhje, një falsifikim, vetëgjyqësi apo çdo lloj veprë që s'ka lidhje me këtë urdhër mbrojtjeje.

28 §2 të K. Penal, thjesht fakti i të qenit bashkëpunëtor nuk duhet të shërbejë si rrethanë për rëndimin e dënimit, madje mund të shërbejë si rrethanë që duhet të mbahet në konsideratë për zbutjen e tij.

h) Kryerja e veprës penale më shumë se një herë.

Megjithëse ngjan me përsëritjen, kjo rrethanë dallon prej saj për faktin se personi nuk është dënuar për asnjërën nga veprat të cilat ka kryer. Po ashtu kjo rrethanë i referohet kryerjes së të njëjtës veprë dhe nuk konsideron si rënduese kryerjen e dy ose më shumë veprave të ndryshme.

i) Kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive.

Megjithëse kjo rrethanë ka sens logjik, ajo gjen fare pak zbatim në praktikë, pasi mbajtja dhe përdorimi i armëve, municioneve, lëndëve plasëse, apo radioaktive parashikohen si vepra penale më vete. Në këtë mënyrë kjo rrethanë mund të reduktohet dhe të gjejë zbatim vetëm në veprat penale të cilat kryhen duke përdorur lëndë djegëse apo helmuese¹⁷⁴ dhe në rastet kur armët apo municionet mbahen me leje.

j) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

Kjo rrethanë rënduese është parashikuar për të diferencuar kryerjen e veprave penale për këto motive, duke sanksionuar një dënim më të rëndë. Në rastin e kryerjes së veprës penale për shkak të aftësive të kufizuara të viktimës, ky fakt nuk mund të cilësohet si rrethanë rënduese edhe sipas pikës e) të këtij neni.

3.4.7. Zbatimi praktik i kriterëve të caktimit të dënimit

Teoria e caktimit të dënimit ka vlerë vetëm nëse arrin të ndihmojë praktikën gjyqësore në zgjedhjen e llojit dhe të masës së dënimit të drejtë në një rast konkret. Teoritë e caktimit të dënimit¹⁷⁵ të para më vete dhe pa u thelluar, duken shumë bindëse dhe fitojnë menjëherë simpatinë e lexuesit për mbështetjen e tyre logjike, mirëpo zbatimi i tyre në praktikë ka ndeshur në vështirësi të mëdha. Renditja dhe prioriteti i qëllimeve të dënimit në të drejtën penale shqiptare jo vetëm nuk është bërë nga K. Penal, por as nga GJL me një vendim unifikues. Praktika e Kolegjit Penal, megjithëse ka cituar sipas rasteve disa nga qëllimet e dënimit penal, nuk ka mbajtur ndonjë qëndrim në lidhje me prioritetin e një qëllimi apo rregullat e përzgjedhjes së qëllimit prioritar. Ndërkohë, GJK në vendimet nr. 19, datë 01.06.2011 dhe nr. 47 datë 26.07.2012 është shprehur se dënimi penal ka qëllim edukues, mirëpo me vendimin nr. 55, datë 21.07.2015,

¹⁷⁴ Edhe në këto raste kur këto dy rrethana nuk janë pjesë konstituive apo të përbëjnë rrethanë cilësuese të veprës, siç është p.sh. neni 151, nenet 206/a, 206/b, 230, 232, 234, 281, 282/a, 323 etj.

¹⁷⁵ Qoftë ajo retribucioniste, e paaftësimi, e parandalimit, e riedukimit, apo ajo restauruese.

ka rrëzuar kërkesën për shpallje antikushtetuese të dënimit nga 7-15 vite burgim të mbajtjes së lëndëve narkotike për konsum personal¹⁷⁶.

Në doktrinën vendase vetëm autori Shefqet Muçi i ka kushtuar vëmendje çështjes së prioritetit të qëllimeve të dënimit penal. Ai është shprehur se asnjëri nga kriteret e caktimit të dënimit nuk duhet mbivlerësuar në raport me të tjerët (1989: 106). Në punimin e tij të fundit, megjithëse ai rithekson rëndësinë e madhe të shqyrtimit në unitet të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës dhe të autorit të saj, ai shprehet se kriteri përcaktues në caktimin e dënimit është rrezikshmëria shoqërore e veprës (2012: 296, 301). Në vlerësimin tonë ky qëndrim nuk është tërësisht i mbështetur në frymën e dispozitave ligjore penale dhe në parimet e caktimit të dënimit të analizuara më lart. Individualizimi i dënimit bëhet ndaj një autori konkret dhe për pasojë fokusi i dënimit është ai dhe jo vepra e tij. Rrezikshmëria e veprës dhe shkalla e fajësisë janë një pjesë shumë e rëndësishme e caktimit të dënimit, pasi ato orientojnë gjykatën në përcaktimin e limiteve të meritës së dënimit për veprën e kryer, mirëpo e drejta penale moderne ka funksione më largpamëse sesa thjesht ndëshkimi i fajtorëve. Shembujt e parashikimit të gjyqimit të shkurtuar, përjashtimit apo uljes së dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë, apo viktimat e krimit, apo marrëveshjet e fajësisë *guilty pleas*, janë tregues i qartë se ndëshkimi i fajtorit vetëm sipas meritës së veprës është utopi dhe se qasja utilitare është më e logjikshme (Frase, 2009: 141). Dënimet alternative, parimi i humanizmit, parimi i ekonomisë së dënimit, cilësimi si lehtësuese i disa rrethanave të sjelljes së të pandehurit pas kryerjes së veprës etj., sugjerojnë përfundimin se retribucioni duhet të skicojë vetëm kufijtë e lartë të dënimit, pasi dënimi konkret në shumicën dërrmuese të rasteve duhet të orientohet nga e ardhmja përmirësuese e të pandehurit.

Ashtu siç është shprehur Morris (1977: 142) brenda marzheve të gjera të dënimit të cilat kufizojnë meritën e dënimit (retribucionin), duhet të ndiqen edhe parime të tjera udhëzuese si kufizimi i burgimit, humanizmi, parandalimi, paaftësimi dhe riedukimi.

Mbështetur në këtë arsyetim vlerësojmë se në shumicën e veprave të lehta dhe jo të dhunshme, gjyqtarët duhet të përzgjedhin gjithnjë llojin e dënimit më të lehtë (gjobën) dhe vetëm kur ajo është e papërshtatshme, mund të caktojnë dënim me burgim. Sa i takojnë këtij të fundit, gjyqtarët duhet të fillojnë matjen e dënimit nga minimumi i tij (Morris, 1977b: 269) dhe mund të ngrihen drejt ashpërsimit të masës së tij vetëm nëse qëllime të tjera e kërkojnë një ashpërsim të tillë. Sa i takon dënimit me gjobë, përveç rrethanave individualizuese të vlefshme edhe për burgimin, masa e saj duhet të jetë e lidhur ngushtësisht me mundësitë ekonomike të të pandehurit, ndërsa sa i takon dënimeve alternative masa e tyre përveç të tjerave duhet të përcaktohet nga nevojat specifike për riedukim të të pandehurit.

¹⁷⁶ Në vlerësimin tonë është vështirë e pranueshme që të thuash se është mënyra më e mirë për të përmirësuar dhe edukuar një toksikopendent, duke e dënuar me së paku 7 vite burgim.

Për shkak të justifikimit më të madh të qëllimeve paaftësuese, ndëshkuese dhe parandaluese dhe mbetjes më në hije të parimeve të humanizmit dhe të riedukimit, vlerësojmë se në veprat e dhunshme të kryera me dashje, gjykata duhet të fillojë matjen e dënimit nga mesi i marzheve të dënimit dhe të lëvizë brenda tyre në varësi të rrethanave konkrete, të cilat sugjerojnë për një zbutje apo një ashpërsim të dënimit. Megjithëse e paartikulluar dhe jouniforme, ky është një qëndrim përgjithësisht i mbajtur edhe nga praktika gjyqësore, ku për vepra penale si vrasja me paramendim dënimet konkrete janë mbi mesataren e marzheve që parashikon kjo dispozitë, ndërkohë që për kundërvajtje dhe krime të lehta, shumica e dënimeve janë afër minimumit.

3.4.8. Përfshirja ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat

Ky institut u shtua në nenin 52/a me ligjin nr. 144/2013 dhe është tregues i faktit se zbulimi i të gjitha veprave dhe autorëve është më i rëndësishëm se dënimi i rëndë i një apo disa autorëve të zbuluar. Bashkëpunimi i strukturave ligjzbatuese me personat e përfshirë në krim, është shpesh mënyra e vetme për të zbardhur gjithë mekanizmin dhe autorët e një aktiviteti të caktuar kriminal. Neni 52/a është një dispozitë përshkruese dhe zbatohet si për rastin e viktimave të akteve korruptive¹⁷⁷, ashtu edhe të viktimave të trafikut njerëzor, për pjesën e veprimtarisë së tyre që përbën veprë penale. Paragrafi i fundit i këtij neni parashikon zbutjen apo përjashtimin e dënimit për personat që ndihmojnë organet e ndjekjes penale në zbulimin e autorëve dhe veprave që kanë të bëjnë me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale. Parashikimi i dënimit të bashkëpunëtorit të drejtësisë jo më shumë se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij, jo vetëm që nuk është një zbutje e ndjeshme (pasi nuk parashikon mundësinë e uljes së dënimit nën minimum), por vjen në kundërshtim edhe me frymën e përdorur për të njëjtin fakt në nenin 28 §7 të K. Penal. Nga ana tjetër, fjalia e fundit e këtij neni, parashikon mundësinë për përjashtimin e autorëve të këtyre veprave penale nga dënimi nëse konkurrojnë edhe disa rrethana lehtësuese në favor të tij.

3.4.9. Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar në ligj

Rrethanat lehtësuese, përveçse lehtësojnë dënimin brenda marzheve të parashikuara nga dispozita konkrete, në raste të caktuara mund të shërbejnë për ta ulur atë nën këta kufij, apo për të caktuar një lloj dënimi më të butë. Neni e 53 i K. Penal e kushtëzonte fillimisht zbatimin e këtij instituti me rrezikshmërinë e paktë të veprës dhe të pandehurit dhe me prezencën e më shumë se dy rrethanave lehtësuese. Rrezikshmëria e veprës penale dhe në mënyrë të posaçme pasojat e ardhura prej saj duhet të jenë aq të vogla sa zbritja nën minimumin e parashikuar nga ligji të mos jetë disproporcionale. Rrezikshmëria e vogël e të pandehurit nënkupton pranimin e fajësisë, mosqenien e tij i dënuar më parë etj., ndërkohë që rrethanat lehtësuese duhet të jenë së paku 2 (nga ato të

¹⁷⁷ Nenet 164/a, 244, 244/a, 245, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c dhe 328 të këtij kodi.

parashikuara nga neni 48 apo 49 i K. Penal). Me ligjin nr. 144/2013, kushtet e zbatimit të këtij instituti human dhe të arsyeshëm të së drejtës penale, u rënduan duke ndaluar zbatimin e tij¹⁷⁸ në rast se prezent është ndonjë rrethanë rënduese. Megjithëse për shumicën e situatave, prezenca e një rrethane rënduese është një justifikim i shëndoshë për të mohuar uljen e dënimit nën minimum, në praktikë mund të ndeshen plot raste në të cilat pesha e një rrethane rënduese mund të jetë aq e vogël sa tejkalohet disa herë nga prania e disa rrethanave lehtësuese.

3.4.10. Caktimi i dënimit për të miturit

Dënimi penal i të miturve meriton një trajtim të veçantë, të ndryshëm nga të rriturit, për shkak se nga njëra anë ata nuk kanë arritur pjekurinë e plotë intelektuale (duke treguar kështu një nivel më të ulët fajësie) dhe nga ana tjetër për shkak se paraqesin specifika në lidhje me nevojat e tyre për edukimin dhe zhvillimin e tyre psiko-fizik. Megjithë nevojën për një trajtim thelbësisht të ndryshëm (Latifi, 2013: 261), kodi ynë penal nuk reflekton mjaftueshëm zhvillimet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale për të miturit (Sufaj, 2011: 67) dhe modelet më të mira të K. Penale të vendeve të ndryshme evropiane¹⁷⁹. Në vlerësimin tonë, dënimi i të miturve duhet të bëhet në një seksion më vete, ku të përshihen jo vetëm parimet e drejtësisë penale për të miturit (Elezi & Hysi, 2006: 68.), por edhe institute specifike, si: masat edukuese, mbikëqyrja intensive familjare dhe shkollore, parashikimi dënimit me burgim si dënim përjashtues, dhe shumë dënime të tjera alternative (si gjoba, dënimet plotësuese, pezullimi me kusht i dënimit, dënimi me burg në shtëpi, puna në shërbim publik, mbikëqyrja elektronike etj.). Fryma e përgjithshme ligjore, politike dhe publike pro burgimit dhe shtrirja e saj edhe ndaj të miturve, ka bërë që edhe politika penale e gjykatave shqiptare të jetë tepër e ashpër (CRCA, 2007: 48), duke hezituar të aplikojnë edhe ato pak hapësira që lejon neni 52 i K. Penal. Nga të dhënat statistikore rezulton jo vetëm se dënimi me burgim i të miturve është i shpeshtë, por se edhe masat e dënimit janë të rënda (Xhafo, 2012: 54). Nga një shqyrtim i shpejtë i të dhënave statistikore mbi dinamikën e të arrestuarve të mitur dhe recidivizmin e tyre (DPB, 2014), arrihet në përfundimin se qasja aktuale ndaj kësaj kategorie keqbërësish është tërësisht e gabuar.

Po ashtu, mbështetur në praktikën e shumë legjislacioneve të tjera të mëdha evropiane (si Franca, Gjermania, Rusia etj.), është tërësisht e arsyeshme që K. Penal të parashikojë një trajtim special edhe për të rinjtë e moshës 18-21 vjeç, pasi edhe kjo grupmoshë e ndërmjetme paraqet në një masë

¹⁷⁸ Siç jemi shprehur më lart kryerja e veprës për të sjellë përfitim material, në bashkëpunim, apo më shumë se një herë, nuk paraqesin në çdo rast rrezikshmëri të lartë shoqërore, për pasojë mohimi kategorik i uljes së dënimit nën minimum nuk është tërësisht i mbështetur.

¹⁷⁹ Trajtimi i të miturve në K. Penal nuk respekton plotësisht objektivat e Konventës së OKB për të drejtat e fëmijëve (e miratuar nga Asambleja e OKB me 20 nëntor 1989), Rezolutën e OKB nr. 1997/30, “Për administrimin e drejtësisë për të mitur, dhe Rekomandimin 87 (20) të KE “Mbi reagimin social ndaj kriminalitetit të të miturve”. Të gjitha këto dokumente kërkojnë që masat e marra ndaj të miturve duhet të kenë karakter edukues dhe kufizimi lirisë së tyre duhet shmangur. Kode penale të cilat reflektojnë këto kërkesa janë të shumtë, si p.sh.: ai i Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Italisë, Francës, Rosisë etj.

më të vogël karakteristika të ngjashme me të miturit (shkallë më të ulët faji, reagim më emocional ndaj ngacmimeve të jashtme dhe nevoja të veçanta edukuese). Aktualisht K. Penal ka një rregullim shumë të cekët për të miturit, duke i dedikuar dënimit të tyre vetëm dy dispozita të shkurtra, përkatësisht dënimit me burgim dhe përjashtimit të tyre nga dënimi.

3.4.10.1. Dënimi me burgim për të miturit

Neni 51 i K. Penal parashikon se për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për madhorët. Neni 51 bën përgjysmimin e marzheve vetëm për dënimin me burgim, por nuk e zbaton këtë rregull për dënimin me gjobë apo dënimet alternative, të cilat duhet të jenë dënimet më të zakonshme që duhet t'u caktohen të miturve. Marzhet e dënimit me burgim për të miturit përgjysmohen si në maksimum ashtu dhe në minimum dhe brenda këtyre marzheve speciale, gjykata zbaton nenin 47 të K. Penal. Në këtë kuptim, mund të thuhet se neni 51, bën një "pjesë të posaçme të K. Penal për të miturit" (Nikolli, 2003: 60), ku sanksionet janë të përgjysmuara dhe dënimi për ta caktohet vetëm një herë sipas këtyre marzheve specifike (jo siç vazhdon të kërkohej nga shumë prokurorë dhe vendoset nga jo pak gjyqtarë, caktimi fillimisht i një dënimi si për të rriturit dhe më pas ky dënim pjesëtohet me dy). Përgjysmimi i marzheve të dënimit me burgim, megjithëse përbën një masë humane dhe të arsyeshme, në jo pak raste nuk ka dhënë efektin e duhur, pasi duke zgjedhur maksimumin e dënimit për këtë kategori, gjykatat kanë caktuar një dënim të përafërt me të rriturit¹⁸⁰.

Duke qenë se mituria përfshin moshën 14-18 vjeç, duhet që ligjvënësi dhe Gjykata të bëjnë një trajtim të diferencuar brenda kësaj grupmoshe. I pandehuri 14 vjeç sapo ka prekur kufirin e përgjegjësisë penale, ai 16 është më i pjekur, ndërsa ai afër 18 vjeç, është ligjërisht thuajse i rritur.

3.4.10.2. Përjashtimi i të miturit nga dënimi

Neni 52 i K. Penal parashikon se gjykata mund të përjashtojë të miturit nga dënimi, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale dhe nga sjellja e tij e mëparshme. Kjo është një dispozitë me karakter human dhe shton mundësitë për aplikimin më të arsyeshëm të ligjit penal ndaj të miturve. Kur gjykata përjashton të miturin nga dënimi, ajo mundet që të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi. Megjithëse kuptimi i kësaj dispozite është i qartë, mosdetajimi i saj për rrethanat konkrete¹⁸¹ dhe sidomos mungesa e infrastrukturës për zbatimin në praktikë të masave

¹⁸⁰ Kështu p.sh., me vendimin nr. 1181, datë 26.09.2013, KPGJL ka vendosur mospranimin e rekursit, duke lënë në fuqi vendimin nr. 280, datë 30.12.2011, të GJA Shkodër, e cila ka deklaruar fajtor të pandehurin S. H. për kryerjen e veprës penale të 'Vjedhjes me armë', parashikuar nga nenet 140-25 të KP-së dhe në aplikim të nenit 51 të K. Penal e ka dënuar me 10 vjet burgim. Nga ana tjetër, për të njëjtën vepër penale të kryer nga të rriturit, rrallëherë gjykatat caktojnë dënime mbi 12 vite burgim.

¹⁸¹ Në K. Penal të viti 1952, përjashtimi i të miturit nga dënimi bëhej për rrethana të përcaktuara qartësisht si kur i pandehuri nuk kishte qenë në gjendje të vlerësonte se vepra e tij ishte shoqërisht e rrezikshme, ka kryer një vepër penale të parëndësishme nën influencën e rastit ose për shkak të një fatkeqësie personale apo familjare etj.

edukuese (Xhafo, 2012: 59), ka bërë që ky institut të aplikohet pak ose aspak nga gjykatat shqiptare. Detajimi i kësaj dispozite duhet të kufizojë veprat veçanërisht të rënda, për të cilat nuk mund të aplikohet ky institut, duke i lejuar gjykatës vlerësimin e veprave të tjera më të lehta rast pas rasti. Po ashtu duhet të bëhet dhe një detajim i rrethanave konkrete të cilat justifikojnë përjashtimin e të miturit nga dënimi. Ndërhyrja legjislative është mënyra e vetme për jetësimin e kësaj dispozite, pasi për shkak të mungesës së aplikimit të saj nga shkallët më të ulëta, është e pamundur sqarimi dhe detajimi i zbatimit të saj me një vendim unifikues të GJL.

3.4.11. Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë

Megjithëse dënimi me burgim konsiderohet nga e drejta penale bashkohore si një dënim *extrema ratio* (Pavarini, 2001: 400), ai vazhdon të jetë dënimi dominues që parashikojnë dispozitat e pjesës së posaçme të K. Penal. Në përpjekje për të zbutur këtë supremaci të dënimit me burgim, Legjislatori shqiptar ka parashikuar dy nene (institute) të zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë.

Neni 53/a i K. Penal, i shtuar me ligjin nr. 98/2014, ka parashikuar mundësinë që gjykata të mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit, duke llogaritur një ditë burgim me pesë mijë lekë. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë kërkon plotësimin e njëkohshëm të 5 kushteve: 1) që gjykata të vlerësojë se vepra penale paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore; 2) që autori i saj paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore; 3) kur gjykata ka caktuar një dënim deri në dy vjet burgim; 4) kur ky zëvendësim parashikohet shprehimisht nga dispozita e pjesës së posaçme; dhe 5) kur ky zëvendësim është kërkuar nga vetë autori, i cili shpreh gatishmërinë për pagimin e kësaj shume brenda 10 ditëve. Nëse shuma e të hollave e vendosur nga gjykata nuk paguhet brenda 10 ditëve nga momenti që vendimi merr formë të prerë, (me kërkesë të prokurorisë) gjykata vendos revokimin e vendimit për zëvendësimin e dënimit me burgim.

Në vlerësimin tonë kjo dispozitë është tërësisht e gabuar dhe përbën shprehjen e saj më të qartë të ndjekjes së një politike ligjore paarsyetueshmërisht të ashpër penale. Në mënyrë të qartë kjo dispozitë pranon gabimin për heqjen apo mosparashikimin e dënimit me gjobë si dënim alternativ të dënimit me burgim për shumë dispozita të pjesës së posaçme të K. Penal dhe nga ana tjetër vendos disa kritere tepër të rrepta për konvertimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë¹⁸². Kjo dispozitë vjen jo vetëm në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të dënimit sipas meritës,

¹⁸² Sikur kjo dispozitë të gjente zbatim praktik në gjithë spektrin e saj, duhet që një i pandehur të paguajë brenda 10 ditësh shumën prej 3.65 milionë lekë (të rinj) për konvertimin e një dënimi prej 2 vitesh burgim në dënim me gjobë. Padyshim që pagesa e një shume të tillë për një person me rrezikshmëri të ulët shoqërore, i cili kryen një vepër me rrezikshmëri të ulët shoqërore, është vështirë të ndodhë në praktikë, nisur nga niveli mesatar i të ardhurave të qytetarëve shqiptar dhe aq më tepër nga niveli i pritshëm i dënimit eventual që do të caktonte gjykata normalisht.

por edhe me parimin e caktimit të dënimit me gjobë sipas të ardhurave të të pandehurit¹⁸³. Duke shkelur këto parime, kjo dispozitë legjitimon dënimin me burgim të të varfërve. Një vështirësi tjetër e zbatimit të kësaj dispozite vjen nga fakti se aktualisht është vetëm një dispozitë në pjesën e posaçme e (neni 291) cila lejon konvertimin e dënimit me burg në dënim me gjobë.

Një alternativë tjetër e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë është neni 54 i K. Penal, i cili është një formë e transformuar e marrëveshjeve të fajësisë *plea bargaining* në sistemin anglo-amerikan, apo *patteggiamento* në Itali. Ky nen parashikon se gjykata mund të pranojë në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, kërkesën e të pandehurit të akuzuar për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, që ai të paguajë në moment 1.5 milionë lekë në favor të shtetit. Megjithëse duket sikur qëllimi i kësaj dispozite është ekonomia gjyqësore, ky institut dallon nga marrëveshjet e fajësisë, të cilat bëhen në hetim paraprak mes prokurorit dhe të pandehurit (dhe jo në gjykim). Në vlerësimin tonë ashtu si dispozita e mësipërme, edhe ky nen mbart probleme të thella konceptuale dhe parimore dhe si i tillë ka qenë i destinuar të mos aplikohet asnjëherë në praktikë¹⁸⁴. Në teori janë hedhur ide se kur gjykata pranon kërkesën, nuk e deklaron fajtor të pandehurin, por pushon çështjen (Muçi, 2012: 337). Në vlerësimin tonë ky është një qëndrim jo vetëm i pabazuar në nenet 387 dhe 388 të K. Pr. Penale, por edhe në frymën e këtij instituti, i cili nënkupton pranimin e kryerjes së veprës penale. Është pa kuptim që një person të pranojë të paguajë 1.5 milionë lekë, ndërkohë që mendon se është i pafajshëm. Duke qenë se ky institut nuk ka gjetur asnjëherë zbatim në praktikë, vlerësojmë se është e tepërt zgjatja me trajtimin e tij teorik.

3.4.12. Bashkimi i dënimeve për disa vepra penale

Neni 55 i K. Penal parashikon rregullat për bashkimin e dënimeve në rastin kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim. Doktrina e së drejtës penale i diferencon në dy grupe rastet kur veprimet e paligjshme penalizohen nga dy norma penale, përkatësisht konkurrimi i veprave penale i quajtur ndryshe si bashkim i veprave penale dhe konkurrimi i normave penale apo bashkimi fiktiv (Nikolli, 2014b: 46). Kemi konkurrim të veprave penale në rastet kur veprimet kriminale cenojnë dy të mira juridike të ndryshme, të mbrojtura nga norma të veçanta penale. Në këto raste autori i veprës penale do të dënohet në mënyrë të veçantë për secilën prej figurave të veprave penale të konsumuara dhe më pas bëhet bashkimi i dënimeve. Në rastin e konkurrimit të

¹⁸³ I manifestuar nga shumë legjislacione përmes sistemit të gjobave ditore dhe në legjislacionin tonë i parashikuar (ngushtësisht) në nenin 34 §6 të K. Penal. Ky parim kërkon që gjykata të marrë në konsideratë aftësinë paguese të të pandehurit në momentin e caktimit të dënimit me gjobë.

¹⁸⁴ Së pari nuk arrihet të kuptohet *ratione* mbas këtij instituti, pasi nuk justifikon as ekonominë gjyqësore as zbutjen e dënimit. Së dyti ky institut është i pazbatueshëm për shkak se shumica që duhet të paguajë i pandehuri është tejet e lartë dhe e papranueshme për nivelin ekonomik të një qytetari mesatar shqiptar. Së treti ky nen mbart probleme dhe paqartësi procedurale, për mënyrën sesi duhet të disponojë gjykata në rast të pranimit të kërkesës dhe si do të paguhet shumica e parashikuar nga ky nen.

normave penale (apo bashkimit fiktiv), veprimi kriminal pavarësisht se parashikohet nga dy (ose më shumë) norma të ndryshme penale, ai dënohet vetëm nga njëra prej tyre, e cila specifikisht tregon në mënyrë të hollësishme padrejtësinë kriminale dhe kërkesën për dënim¹⁸⁵.

Ashtu siç parashikon neni 55, bashkimi i veprave penale është ideal kur me një veprim apo mosveprim kryhen dy ose më shumë vepra penale dhe real kur autori kryen disa vepra penale me disa veprime të ndryshme (Muçi, 2012: 341). Kjo ndarje ka vlerë teorike dhe praktike për të përcaktuar përgjegjësinë penale të autorit, por nuk ndonjë ndikim në mënyrën e caktimit të dënimit. Sipas kësaj dispozite fillimisht gjykata cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar. Dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën aritmetikore të dënimeve të caktuara veç e veç dhe as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë (Elezi et al, 2013: 287). Me ligjin nr. 144/2013, në këtë nen u shtua një paragraf i cili parashikon se kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, dënimi përfundimtar është sa shuma aritmetikore e dënimeve për secilën vepër penale. Në vlerësimin tonë edhe shtimi i këtij paragrafi nuk ka një justifikim shkencor. Ashpërsimi galopant i masave të dënimit si për vrasjet ashtu edhe për mbajtjen pa leje të armëve dhe municionit luftarak i ka bërë këto dy vepra penale më të rënda se krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit apo aktet terroriste.

Duhet pranuar, se përveç rastit të paragrafit të dytë të cituar më lart, në rastet e tjera të aplikimit të sistemit të dënimit më të rëndë të shtuar, ka një vështirësi në përcaktimin e një rregulli se si do të aplikohet diskrecioni gjyqësor i njohur. Legjislatori ka përcaktuar hapësirën e diskrecionit, por nuk ka përcaktuar rregullat e zbatimit të tij. Në përpjekje për të gjetur një kriter logjik të zbatimit të sistemit të dënimit më të rëndë të shtuar, do të shqyrtojmë më parë sistemin e thithjes, i cili zbatohet në rastet kur gjykata çmon se kryerja e shumë veprave penale nuk tregon rrezikshmëri të madhe të fajtorit. Në këtë rast gjykata mjaftohet t'i japë autorit si dënim përfundimtar dënimin më të rëndë që ka caktuar për një nga veprat penale. Megjithatë as në këtë rast ligji nuk përcakton kriteret referuese se në çfarë situatash kryerja e një apo disa veprave penale shtesë (përveç veprës më të rëndë) nuk tregon për një rrezikshmëri të madhe të fajtorit, vlerësojmë se ajo duhet të aplikohet në rastet kur vepra kryesore është ndjeshëm më e rëndë se vepra e dytë¹⁸⁶. Prej këtij arsyetimi nxjerrim

¹⁸⁵ Shembull i bashkimit të veprave penale është vrasja me përdorim arme zjarri pa leje, ku në këtë rast nga ligji vjen kërkesa për ndëshkimin e secilit prej cenimeve të të mirave juridike (në rastin konkret për vrasje dhe për mbajtje pa leje të armëve luftarake). Raste të bashkimit fiktiv (apo konkurrimit të normave penale) janë vjedhja e energjisë elektrike (neni 137) dhe vjedhja (neni 134), vjedhja duke shpërdoruar detyrën (neni 135) dhe shpërdorimi i detyrës (neni 248), korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259) dhe korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260) etj.

¹⁸⁶ GJL, me vendimin nr. 945 (144), datë 24.4.2013, ka lënë në fuqi vendimin e GJRRGJ Korçë, e cila kishte dënuar të pandehurin B. T. sipas nenit 283/1 të K. Penal me 5 vjet burgim, sipas nenit 242 me 1 muaj burgim dhe në bazë të nenit 55 të K. Penal, dënimin e vetëm me 5 vjet burgim; GJL me vendimin nr. 1274 (118) ka lënë në fuqi vendimet e dy shkallëve të tjera për të pandehurin I. GJ., i cili është dënuar me 6 vite burgim sipas nenit 139-22, 6 muaj burgim

edhe përfundimin se në rastin e zbatimit të dënimit më të rëndë të shtuar, shuma përfundimtare është afër dënimit më të rëndë (pra një lloj përthithje e pjesshme), kur vepra më e lehtë nuk tregon ndonjë rrezikshmëri të madhe shtesë¹⁸⁷ dhe shkon drejt bashkimit matematikor në rastin kur veprat kanë një rrezikshmëri të ngjashme dhe që njëkohësisht prej tyre i shtohet në mënyrë të ndjeshme dhe rrezikshmëria e autorit. Në vlerësimin tonë është vështirë që në praktikë të justifikohet një bashkim matematikor, pasi edhe nëse rrezikshmëria e dy veprave dyfishohet, kjo nuk mund të thuhet edhe për autorin, pasi rrezikshmëria e tij nuk mund të dyfishohet apo trefishohet. Një element tjetër kufizues i bashkimit matematikor është qasja utilitariste, në lidhje me përshtatshmërinë e një dënimi, i cili do të rezultonte panevojshmërisht i rëndë për qëllimet e dënimit. Për pasojë në vlerësimin tonë dënimi më i rëndë i shtuar, duhet të zbatohet vetëm përjashtimisht si bashkim matematikor i dënimeve të veçanta dhe në shumicën e rasteve dënimi përfundimtar duhet të jetë mes hapësirës së dënimit më të rëndë dhe bashkimit matematikor të dy apo më shumë dënimeve.

Kusht i veçantë për bashkimin e veprave penale është që për asnjë nga veprat penale të mos jetë dhënë vendim gjyqësor. Nëse për njërën nga veprat është dhënë vendim dënimi i formës së prerë, atëherë duhet të bëhet bashkimi i dënimeve sipas nenit 56 të K. Penal. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, kur i dënuari para vuajtjes së plotë të dënimit, dënohet për një vepër penale të kryer para dhënies së vendimit, zbatohen rregullat e nenit 55 dhe pjesa e vuajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri. Përveç faktit se dënimet e veçanta janë vendosur në procese të ndryshme gjyqësore, ky rast nuk ka dallim nga bashkimi i veprave penale. Në ndryshim nga paragrafi i parë, kur pas dhënies së vendimit (por sigurisht para vuajtjes së plotë të tij), i dënuari kryen një vepër penale të re, gjykata bën bashkimin e dënimit të ri me pjesën e mbetur pa vuajtur të dënimit të mëparshëm, duke ndjekur rregullat e parashikuara nga neni 55 i këtij Kodi. Diferencimi mes dy paragrafëve të nenit 56 është dhe një argument më tepër, se bashkimi matematikor i dënimeve është përjashtim, pasi në të kundërt, nëse ai do të aplikohet gjerësisht, dallimi mes tyre nuk do të kishte asnjë efekt matematikor. Bashkimi i dënimeve nuk dallon në thelb nga bashkimi i veprave penale, në rastin kur gjatë dhënies së dënimit për veprën e dytë nuk ka filluar ekzekutimi i dënimit për veprën e parë, p.sh. për shkak se i dënuari nuk kapet nga policia.

sipas nenit 134 dhe në aplikim të nenit 55/3 është dënuar me 6 vjet burgim. Në këtë vendim të fundit KPGJL citon pikërisht diferencën e marzheve të dënimit mes dy veprave, si një argument për të aplikuar sistemin e përthithjes së dënimit më të lehtë nga dënimi më i rëndë.

¹⁸⁷ Kjo logjikë është ndjekur në praktikën e GJL në shumicën e vendimeve, ku për ilustrim mund të përmendim vendimin nr. 341, datë 14.04.2010 të KPGJL, i cili ka lënë në fuqi vendimin e GJRRGJ Shkodër për dënimin e të pandehurit F. B. sipas nenit 79/dh-22 me 20 vite burgim, për nenin 278/2 me 2 vite burgim dhe në aplikim të nenit 55 e ka dënuar përfundimisht me 21 vite burgim; vendimin nr. 979(185), datë 28.06.2012 GJL ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 109, datë 22.04.2009 të GJA Shkodër, i cili e ka dënuar të pandehurin T. K. sipas nenit 76 të K. Penal me 11 vjet burgim, për nenin 278/2 2 vite burgim dhe në bashkim të dënimeve e ka dënuar me 12 vite burgim.

KAPITULLI IV: DËNIMET ALTERNATIVE

4.1. Roli i dënimeve alternative në sistemin sanksionator

Dënimet alternative janë sanksione relativisht të reja, të cilat janë inkorporuar në legjislacionet bashkohore penale, në përpjekje për të zgjidhur problemet e paefektshmërisë dhe ashpërsisë së panevojshme të sanksioneve penale klasike me natyrë represive (Salihu, 2012: 442). Në origjinën e tyre këto dënime i janë kundërvënë dënimit me heqje lirie, i cili megjithë aplikimin e tij të gjerë, nuk ka arritur të ndikojë në uljen e shkallës së kriminalitetit në shoqëri. Me rritjen e studimeve kriminologjike, penalogjike, sociologjike, dhe ekonomike të efekteve të dënimit me burgim, kritikët ndaj tij janë bërë shumëplanëshe, duke nxitur domosdoshmërinë e hulumtimit të alternativave më efikase dhe të drejta penale. Në aspektin filozofik, dënimet alternative janë mënyra më e drejtë për t'i dhënë kuptim praktik idealit rehabilitues (Cullen & Gilbert, 2009: 28); në aspektin penal dhe kriminologjik janë mënyra më efektive për të parandaluar recidivizmin (Leskoviku & Pieplow, 2009: 261) dhe për të shmangur infektimin kriminal në burgje (Cid, 2009: 460); në aspektin social dhe psikologjik ndihmojnë të dënuarin për të mbajtur lidhjet me familjen, punën dhe ambientin shoqëror dhe për të shmangur traumën psikike që shkakton burgimi; në aspektin ekonomik ulin barrën e shoqërisë për të mbajtur të burgosurit (Islami, 2009: 39), duke i orientuar këto fonde drejt programeve të parandalimit, përmes edukimit, përkrahjes sociale, punësimit, mjekimit etj. (Kantorowicz, 2015: 2); në planin njerëzor rrisin respektin për dinjitetin e njeriut dhe për patjetërsueshmërinë e kësaj të drejte themelore.

Megjithë këto avantazhe të dënimeve alternative, është fakt i pamohueshëm se dënimi me burgim vazhdon të mbajë një pozitë qendrore në shumicën e legjislacioneve botërore (UNDOC, 2013: 25) dhe debati mbi reformimin e së drejtës penale vazhdon të jetë i nxehtë, njësoj si 50 vite më parë. Reformimi i sistemit të sanksioneve penale të bazuara mbi burgimin ka ndjekur dy qasje. E para është vazhdimi i besimit tek efekti përmirësues i burgimit dhe orientimi i reformës vetëm në drejtim të shtimit të disa alternativave të këtij dënimi (Margara, 1986). Kjo është një formë më e butë e qëndrimeve “zero tolerancë” ndaj krimit, e njohur më së shumti në SHBA. Qasja e dytë, duke qenë shumë kritike ndaj sistemit burgosës të drejtësisë penale, kërkon një ndërhyrje më radikale në themelet e së drejtës penale duke u bazuar në zbatimin e parimit të një të drejte penale minimale, e cila nënkupton dënime alternative, të përshtatshme me natyrën njerëzore dhe me idealin edukues dhe përmirësues (Giunta, 2004: 151). Megjithëse idetë abolicioniste ekstreme për shfuqizimin e së drejtës penale janë akoma utopike, mendimet e tyre kritike ndaj filozofisë së tolerancës zero ndaj krimit kanë gjetur mbështetje nga shumë legjislacione penale evropiane. Disa nga vendet evropiane (vendet nordike, Gjermania, Sllovenia etj.) janë vënë në pararojë të braktisjes së pozitës dominuese të burgimit në sistemin sanksionator, ndërkohë që shumica e vendeve të tjera të Evropës Perëndimore i ndjekin shumë afër (ICPS, 2013: 5).

Në këtë këndvështrim, e drejta penale shqiptare ka ndjekur një trajektore të çrregullt, nga njëra anë duke imituar stilin amerikan të tolerancës zero me krimin, në përcaktimin e sanksioneve penale në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme të K. Penal dhe nga ana tjetër, duke hedhur hapa të avasthtë në drejtim të europianizimit të dënimeve alternative. Rendja pas politikave populiste ndëshkuese ka bërë që popullimi i burgjeve të rritet nga viti në vit dhe në nëntor 2014 të arrijë shifrën rekord prej 6022 të dënuarish (Komiteti Shqiptar i Helsikit, 2014: 35). Me miratimin e K. Penal u parashikua një kre i posaçëm me alternativat e dënimit me burgim, mirëpo zbatimi i tyre në praktikë për vite me radhë ka qenë tepër i varfër (Elezi, 2009: 39), për shkak të frymës dominuese pro burgimit, mungesës së trajnimit të gjyqtarëve për vlerat e këtyre masave dhe sidomos për shkak të mangësive ligjore dhe institucionale për t'i zbatuar këto institute. Kështu në vitin 2003, në rang vendi janë vendosur vetëm 796 pezullime të dënimit me burgim, ndërkohë që nuk referohet asnjë rast i aplikimit të dënimeve të tjera alternative (Ministria e Drejtësisë, 2005: 56).

Një hap i madh pozitiv në aplikimin e këtyre alternativave u hodh me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, ku u përmirësuan dispozitat që lidhen me alternativat e dënimit me burgim dhe sidomos me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, i cili miratoi krijimin e Shërbimit të provës (Leskoviku, 2009: 78). Dispozitat e dënimeve alternative i janë nënshtruar ndryshimeve të mëtejshme dhe bashkë me rritjen e trajnimeve të gjyqtarëve, filloi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore në drejtim të aplikimit më të gjerë të alternativave të dënimit me burgim. Një kontribut të pamohueshëm nxitës dhe inkurajues në drejtim të aplikimit të dënimeve alternative në vitet e fundit ka dhënë GJK dhe GJL me jurisprudencën e tyre¹⁸⁸. Megjithë faktorët nxitës të mësipërm, ndikimi i tyre në praktikën gjyqësore ka qenë përsëri i pamjaftueshëm për të kundërbalancuar presionin politik dhe publik pro burgimit¹⁸⁹. Megjithëse siç do të shihet më poshtë, aplikimi i dënimeve alternative ka ardhur duke u rritur, kjo rritje vetëm sa ka mbuluar ekspansionin që pësuar K. Penal përmes shtimit të veprave të reja penale, uljes së zbatimit të dënimit me gjobë, apo rritjes së shkallës së ndjekjes penale.

¹⁸⁸ GJK me vendimet nr. 19, datë 01.06.2011 dhe nr. 47 datë 26.07.2012 e ka konsideruar dënimin me burgim si një dënim *extrema ratio*. Po ashtu edhe KPGJL në disa vendime të saj (ato nr. 224 (28), datë 26.01.2012, nr. 1325 (194), datë 04.07.2012 dhe nr. 1535 (278), datë 30.10.2013) ka referuar në Rekomandimin nr. R (99) 22, të KE, në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, për të argumentuar se përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Për këto arsye GJL në këto vendime arsyeton se: "...burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës, dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë ato të cilat nuk e bëjnë këtë.".

¹⁸⁹ Megjithëse në vlerë absolute nga grafiku nr. 2 më poshtë duket sikur numri i pezullimeve është rritur, po të krahasohet në përqindje me numrin total të të dënuarve deri në 5 vite burgim, këto shifra janë thuajse stabël, duke pësuar një rritje të vogël vetëm në vitin 2014 (Ministria e Drejtësisë, 2015: 108).

Ndonëse, konstatojmë se dënimet alternative janë një nga momentet e vetme ku reflektohet një frymë pozitive për reformimin e sistemit të sanksioneve penale, në vlerësimin tonë ato janë përsëri të pjesshme dhe të pamjaftueshme. Reformimi i dënimeve alternative duhet të bëhet pjesë e një reforme tërësore të sistemit të sanksioneve penale, hapi i parë i së cilës duhet të jetë ndryshimi i terminologjisë nga “alternativa të dënimit me burgim në “dënime alternative” dhe përfshirja e tyre në kreun e dënimeve¹⁹⁰, siç i kanë dhe disa legjislacione penale të rajonit¹⁹¹. Momenti i dytë i reformimit të dënimeve alternative, duhet të jetë shtimi i tyre në numër dhe në modalitete të aplikimit të tyre. Alternativat janë të shumta, por në mënyrë të veçantë vlerësojmë se duhet të ketë një qasje më të madhe në drejtim të dënimit me gjobë, garancisë pasurore apo dorëzanisë personale, mbikëqyrjes personale apo familjare, drejtësisë restauruese (Elezi, 2008: 42; Gjoka, 2009: 48), punës në shërbim publik, apo vërejtjes gjyqësore si dënime mjaft efikase në raste të caktuara. Së treti dhe më e rëndësishmja, reformimi i dënimeve alternative duhet të kalojë përmes një procesi serioz të analizimit të fizibilitetit të tyre, pasi mungesa e kuadrit të përshtatshëm ligjor dhe nënligjor dhe e angazhimit të strukturave administrative të mjaftueshme, rrezikon të sabotojë objektivin riedukativ të tyre¹⁹². Pyetjes se “çfarë dënimi funksionon më mirë?” nuk mund t’i jepet një përgjigje e thjeshtë teorike, mbështetur vetëm në përmbajtjen e ligjit, por pasi të analizohen të gjitha mundësitë praktike të zbatimit të tij. Më në thellësi, reformimin e dënimeve alternative do ta trajtojmë më poshtë gjatë trajtimit të dënimeve aktuale alternative në fuqi në K. Penal.

4.2. Shërbimi i provës

Shërbimi i Provës është një organ shtetëror i centralizuar, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është krijuar me ligjin 10024, datë 27.11.2008 dhe ka për objekt të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative (Elezi, 2009: 45). Ngritja e shërbimit të provës ka sjellë një ndryshim rrënjësor në jetësimin në praktikë të dënimeve alternative, duke ngritur besimin e gjyqtarëve për efektshmërinë e dënimeve alternative. Pas një periudhe tranzitore 5 vjeçare, ku zyrat e këtij shërbimi funksiononin fillimisht vetëm në Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër (OSBE,

¹⁹⁰ Ndryshimi i terminologjisë dhe i pozicionit strukturor të dispozitave të dënimeve alternative nuk ka thjesht vlerë simbolike, por së pari një vlerë të padiskutueshme parimore dhe funksionale. Këto dënime nuk duhet të aplikohen vetëm përjashtimisht si alternativa të dënimit me burgim, por përkundrazi ato së bashku me dënimin me gjobë duhet të jenë rregullit dhe burgimi duhet të jetë përjashtimi. Pozicioni aktual i dënimeve alternative (pas kreut të caktimit të dënimit) nuk lejon hapësira konceptuale që ato të kenë një pozitë qendrore në të gjithë sistemin sanksionator, pasi që ato të mund të aplikohen, duhet fillimisht që gjykata të caktojë një masë dënimi me burgim dhe vetëm më pas të shqyrtojë nëse plotësohet ndonjë nga kushtet për aplikimin e alternativave të këtij dënimi. Struktura aktuale e këtyre dënimeve ka bërë që në mjaft raste prokuroria dhe gjykata të gjenden para dilemave për të vlerësuar nëse është më i rëndë dënimi me gjobë apo pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim. Në vlerësimin tonë pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim është më i rëndë se gjoba, jo vetëm sepse është rrjedhojë e një dënimi me burgim (i cili qëndron i pezulluar gjatë periudhës së kushtit), por edhe për faktin se edhe vetë gjendja e mbikëqyrjes nga shërbimi i provës e shoqëruar me detyrime të tjera, kufizon më shumë lirinë e të dënuarit sesa gjoba.

¹⁹¹ Shih p.sh. K. Penal të Kosovës dhe Malit të Zi.

¹⁹² Mangësitë e ekzekutimit të përshtatshëm të dënimeve alternative (të cilat nuk kontribuojnë në edukimin e të dënuarve) përdoren si një justifikim doktrinar dhe gjyqësor, për të kufizuar aplikimin e tyre.

2010: 82), më pas në 12 qendra urbane qarqesh, aktualisht ky shërbim është shtrirë në të gjithë vendin¹⁹³. Mbulimi i plotë territorial dhe rritja e ndjeshme e stafit, krijon mundësitë efektive për një zbatim korrekt në praktikë të këtyre dënimeve.

Shërbimi i Provës ka si detyrë funksionale të tij, mbajtjen e kontakteve me të dënuarin, zhvillimin e takimeve me të afërm dhe me mjedisin social të tij si dhe me organizata jofitimprurëse apo individë të ndryshëm, me qëllim ndihmimin e tij në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social¹⁹⁴. Shërbimi i Provës duhet të synojë të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social¹⁹⁵. Ky shërbim dokumenton veprimtarinë e tij nëpërmjet krijimit të dosjes personale të të dënuarit¹⁹⁶, mbajtjes së regjistrave të veprimtarisë dhe hartimit të raporteve të vlerësimit për rastet e kërkuara. Një nga aktet kryesore që harton shërbimi i provës është programi individual i të dënuarit, i cili në zbatim të dënimit alternativ konkret të caktuar, duhet të mbajë parasysh personalitetin dhe nevojat konkrete të tij për risocializim dhe riedukim¹⁹⁷.

Ashtu si për shumë institucione të reja, një çështje prioritare mbetet rritja e efektivitetit të shërbimit të provës (Leskoviku & Pieplow, 2009: 256) në realizimin e objektivave ligjorë që ka ky institucion. Duke qenë se ky shërbim është akoma i ri, nuk ka studime konkrete të detajuara në lidhje me vlerësimin e punës së tij, për suksesin e zbatimit të programeve të riintegritit social të të dënuarve dhe kontributit të këtij institucioni për ndërmjetësimin mes viktimave dhe të dënuarve. Megjithatë shërbimi i provës është organi qendror për realizimin e funksionit rehabilitues dhe risocializues të dënimeve alternative, duhet pranuar se suksesi i realizimit të tyre është i varur edhe nga funksionimi i shumë mekanizmave të tjerë socialë, si: familja, shkollat, agjencitë e punësimit, qendrat shëndetësore dhe rehabilituese, OJF e ndryshme, apo deri tek solidariteti dhe angazhimi komunitar në përgjithësi. Roli i shërbimit të provës në secilin prej dënimeve alternative do të trajtohet në vijim.

¹⁹³ Në zbatim të nenit 31 të ligjit, dhe urdhrit nr. 100 datë 21.02.2014 të Kryeministrit, shërbimi i Provës aktualisht shtrihet në çdo qendër të vendit e cila përfshin një rreth gjyqësor.

¹⁹⁴ Neni 31/7 §3 i ligjit.

¹⁹⁵ Neni 3 i VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin e funksionimit të shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative.

¹⁹⁶ Dosja personale e të dënuarit përmban një numër të madh aktesh, që nga vendimi gjyqësor i dënimit, urdhri i ekzekutimit, raporti i vlerësimit, raporte mjekësore, procesverbali i kontakteve me të dënuarin, programi i mbikëqyrjes; paralajmërimet e bëra prokurori, ankesat, raporti përfundimtar i shërbimit etj.

¹⁹⁷ Elementët e domosdoshëm të një programi individual përcaktohen në nenin 28, pika 4 e VKM-së nr. 302 datë 25.3.2009, Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimit të shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

4.3. Gjysmëliria

Neni 58 është dispozita e parë e këtij kreu dhe lejon gjykatën që për dënimet deri në një vit burgim, nisur nga detyrimet e personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare, apo nevojat për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri. Në thelbin e saj gjysmëliria, nuk përbën një alternativë të dënimit me burgim (e aq më pak një dënim alternativ në kuptimin e gjerë), por vetëm një alternativë të ekzekutimit të dënimit me burgim. Përveç ndryshimit të terminologjisë dhe formulimit gjuhësor të shkaqeve, ajo nuk sjell ndonjë ndryshim substancial nga formulimi i mëparshëm i saj “Copëzimi i dënimit me burgim”. Nisur nga mungesa e një justifikimi të kënaqshëm logjik për zbatimin e tij si dhe vështirësitë praktike të ekzekutimit¹⁹⁸, ky institut nuk ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore¹⁹⁹. Prandaj në vlerësimin tonë ky institut duhet të reformohet ose të shfuqizohet si jofunksional.

4.4. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

Nenet 59, 60, 60/a, 61 dhe 62 parashikojnë rregulla për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, masat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës dhe rastet e revokimit të këtij vendimi. Kur gjykata jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë (për një afat nga 18 muaj deri në 5 vjet), duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, pas ndryshimeve të ligjit nr. 10023, pezullimi i dënimit me burgim vendoset nga gjykata qoftë dhe vetëm për njërën nga arsyet e cituara prej këtij neni, pa qenë e nevojshme bashkëzistenca e njëkohshme edhe e rrezikshmërisë së paktë të veprës²⁰⁰.

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim është dënimi më i rëndësishëm alternativ dhe më i


¹⁹⁸ Në vlerësimin tonë është vështirë e justifikueshme që gjykata të vendosë vuajtjen e dënimit me burgim deri në një vit, përmes copëzimit të tij, pasi nëse verifikohen detyrimet e të dënuarit për arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare, apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, është më e përshtatshme pezullimi i dënimit me kusht ose detyrimi për të kryer një punë në interes publik. Gjysmëliria mbart të gjithë problematikën e një dënimi të zakonshëm me burgim, me përjashtim të faktit se nuk shkëput tërësisht lidhjet e të dënuarit me jetën jashtë burgut. Nga ana tjetër ky avantazh i tij, kundërbalancohet nga vështirësitë praktike të zbatimit të tij, për shkak të distancës së banesave, vendeve të punës, shkollave, apo spitaleve me institucionet penitensiare dhe nga mungesa e ndonjë interesi të veçantë të të dënuarve me burgim për këtë alternativë ekzekutimi (dhe në mungesë të shfaqjes së një interesi të tillë nga i pandehuri, mbetet pa sens caktimi i kësaj alternative të ekzekutimit të dënimit).

¹⁹⁹ Nga të dhënat e Shërbimit të provës, nga viti 2008 deri në fund të vitit 2013, “gjysmëliria” është zbatuar nga gjykata vetëm ndaj një personi (2014: 11).

²⁰⁰ Para ndryshimeve, neni 59 kërkonte si kushte kumulative për aplikimin e tij, rrezikshmërinë e pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, ndërkohë që pas ndryshimeve, pezullimi jepet për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale.

zbatuar në praktikën gjyqësore (Shërbimi i provës, 2014: 11). Për shkak të mungesës së një institucioni për të mbikëqyrur të dënuarit e vënë në provë si dhe mentalitetit ligjor dhe gjyqësor pro burgimit, deri në vitin 2008 (kur u miratuan ndryshimet e K. Penal me ligjin nr. 10023 dhe u vu në jetë shërbimi i provës), aplikimi i këtij instituti ka qenë i ulët. Siç vërehet nga grafiku më poshtë tendenca e aplikimit të këtij dënimi alternativ nuk ka ndryshuar shumë në vite²⁰¹.

Grafiku nr. 2. Dinamika e pezullimit të dënimit me burgim 2003-2014.



Burimi: Vjetarët statistikor të Ministrisë së Drejtësisë 2004-2014.

Megjithë synimin e ndryshimeve ligjore të vitit 2008 për rritjen e aplikimit të këtij instituti, ai ka vazhduar një trend të lehtë rritës vetëm në vlerë absolute (si numër total pezullimesh), ndërkohë që aplikimi i tij në raport me totalin e të dënuarve (me burgim nga 5 ditë deri në 5 vite) sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë ka vijuar pothuajse konstant në nivelin e 21-26 %²⁰². Vetëm në vitin 2014 vërehet një rritje e konsiderueshme e përqindjes së pezullimeve duke arritur në 31% të totalit të dënuarve deri në 5 vite burgim. Megjithëse nuk kemi të dhëna në nivel kombëtar, por nisur nga indikacionet e GJRRGJ Shkodër, trendi i aplikimit të këtij instituti për vitin 2015 ka

²⁰¹ Megjithëse nga të dhënat e këtyre vjetarëve, në vitin 2004 aplikimi i këtij dënimi alternativ ka arritur kulmin dhe më pas deri në vitin 2007 ka ardhur përsëri në rënie, nga shqyrtimi më vëmendje i vjetarëve 2004, 2005 dhe 2006, vlerësojmë se ato duhet të merren me rezervë, pasi me gjasë duhet të ketë një gabim material ose metodologjik në pasqyrimin e të dhënave për GJRRGJ Durrës. Janë pikërisht të dhënat tërësisht disproporcionale të këtij rrethi gjyqësor në raport me rrethet e tjera që kanë rritur shifrat e pezullimeve për vitet 2004, 2005 dhe 2006. Kështu në vitin 2004 referohet se Durrësi ka 457 pezullime dënimi me burgim, më shumë se Tirana, Shkodra, Korça, Fieri, Elbasani dhe Vlora të marra së bashku. Nëse pesha e Durrësit hiqet apo barazohet me rrethet e ngjashme me të, atëherë konkludohet se deri në vitin 2009 numri i pezullimeve në rang vendi ka variuar nga 700-900 pezullime në vit.

²⁰² Nga kryqëzimi i këtyre të dhënave me Raportin Vjetor të Shërbimit të Provës 2013, vërehet se Vjetarët Statistikor për periudhën 2009-2013, paraqesin në total 33% të dënuar me kusht më pak se Shërbimi i provës. Kjo diferencë në "cilësinë" e të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se numri i të dënuarve, ndaj të cilëve është aplikuar neni 59 i K. Penal rritet nga vendimet e GJA dhe GJL, të cilat ndryshojnë vendimet e shkallës së parë. Gjithsesi ky gabim është riparuar në grafik për vitin 2013 me të dhënat e marra nga vjetari statistikor 2014.

vijuar të jetë rritës²⁰³. Gjithsesi, niveli i aplikimit të dënimit me kusht në vendin tonë është dukshëm më i ulët se në shumë vende të tjera të zhvilluara evropiane²⁰⁴ dhe pozicioni i burgimit është përsëri larg të qenit “mjete i fundit” në dorën e gjyqtarit. Intensifikimi i aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim, krahas dënimeve të tjera alternative, dhe përmbysja e raportit të tyre me dënimin me burgim bëhet më imediate po të mbahet parasysh paradoksi i theksuar mes faktit se nga njëra anë Shqipëria ka një shkallë shumë të ulët të shpalljes fajtor (*conviction rate*)²⁰⁵, dhe nga ana tjetër ka një normë shumë të lartë të burgosurish (Nikolli, 2015c: 528).

Po të analizojmë aspektin jurisprudencial, praktika e GJL në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ka konsoliduar disa kritere për aplikimin e këtij instituti²⁰⁶. Duhet pranuar se në shumicën dërrmuese, GJL ka qenë në favor të aplikimit të nenit 59 të K. Penal duke lënë në fuqi, apo ndryshuar vendimet e shkallëve më të ulëta, të cilat nuk e kishin aplikuar një institut të tillë²⁰⁷. Janë shumë të rralla rastet kur GJL ka ndryshuar vendimet e shkallëve më të ulëta duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim. Qëndrimi i GJL ka qenë nxitës për aplikimin e nenit 59, madje në raste të rralla edhe për vepra të rënda, të cilat parashikojnë marzhe të larta dënimi²⁰⁸.

²⁰³ Është për t'u nënvizuar se GjRREGJ Shkodër ka një shkallë ndjeshëm më të lartë të aplikimit të nenit 59 se ajo kombëtare. Kështu në vitin 2013 kjo gjykatë ka aplikuar këtë dënim alternativ për 43% të gjithë të dënuarve, në vitin 2014 për 42.2% dhe në 6 mujorin e parë të vitit 2015, për 48.8% të të dënuarve.

²⁰⁴ P.sh., mbështetur në të dhënat e raportit të vitit 2013 të Shërbimit të provës dhe të dhënave të DPB për të njëjtin vit, konkludohet se raporti i personave që janë nën mbikëqyrje nga shërbimi i provës me ata që vuajnë dënimin me burgim është përafërsisht 1 me 2, ndërkohë që në Gjermani dhe Britani është i përmbysur afërsisht 3 me 1 (McNeill, 2013: 1). Në shkallë panevropiane në vitin 2008 ky raport është referuar të jetë 1.75 me 1 (Durnescu, 2008).

²⁰⁵ Për të ilustruar mund të përmendim faktin se ndërsa Finlanda dhe Danimarka kanë shkallën më të lartë të personave të shpallur fajtorë, në të njëjtën kohë ata kanë shkallën më të ulët të të burgosurve në Evropë (përkatesisht 56 dhe 74 për 100,000 banorë). Nga ana tjetër Shqipëria ka pasur 1/20 e normës së të deklaruarve fajtorë në raport me Finlandën, ndërkohë që paradoksalisht ka një normë burgosjeje e cila është katër herë më e madhe (Council of Europe, 2010).

²⁰⁶ Me vendimin nr. 1609 (318), datë 26.11.2012 KPGJL është shprehur se kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte. Kushti i parë që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata të çmojë se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim dhe kushti i dytë që të ekzistojnë rrethanat të posaçme të cilat në vetvete GJL i ka ndarë në tre drejtime:

1. detyrimin e të dënuarit ndaj punës, arsimit, kualifikimit ose aftësimit profesional;
2. përgjegjësitë thelbësore familjare të të dënuarit;
3. nevojën e të dënuarit për trajtim apo rehabilitim mjekësor.

Të njëjtin qëndrim KPGJL e ka vijuar edhe me praktikën e mëpasshme ku mund të citojmë vendimin nr. 244 (23), datë 30.01.2013. Ky vendim sjell një risi shumë interesante dhe të vlefshme për politikën gjyqësore të dënimit, pasi sugjeron justifikimin e aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim për shkak të caktimit të një dënimi plotësues (në rastin konkret, heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për 6 vjet).

²⁰⁷ P.sh. vendimi nr. 1625 (319), datë 26.11.2012, nr. 1728 (322), datë 05.12.2012, apo ai nr. 1672 (347), datë 19.12.2012.

²⁰⁸ Me vendimin nr. 1123 (142), datë 23.05.2012, KPGJL ka pezulluar ekzekutimin e dënimit prej 5 vitesh burgim ndaj të pandehurit të mitur G.C. për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje mbetur në tentativë (goditjen me thikë dhe shkaktimin e 17 plagëve prerëse të dëmtuarit TH.K.) me argumentin se i pandehuri ka qenë nën 18 vjeç, i padënuar më parë, normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarin, faktin që vepra mbeti në tentativë, afërsinë e ardhjes së pasojës, etj. Ky vendim mund të bëhet objekt debati jo vetëm për aplikimin apo jo të nenit 59, por edhe për faktin se kohëzgjatjen e provës ndaj të pandehurit G.C. e ka caktuar vetëm për një afat prej 3 vitesh.

Mbështetur në frymën e nenit 59 të K. Penal dhe në praktikën e GJL, vlerësojmë se neni 59 (nëse nuk aplikohen nenet 59/a dhe 63) duhet të aplikohet në çdo rast (dhe jo përjashtimisht) ndaj të gjithë të miturve dhe personave të padënuar më parë, të cilët e pranojnë fajësinë dhe nuk shfaqin një rrezikshmëri të veçantë shoqërore që do ta bënte të domosdoshëm ekzekutimin e dënimit me burgim. Në mënyrë të veçantë neni 59 duhet të aplikohet masivisht për dënimet deri në një vit burgim, si dhe për rastet kur kjo është pjesë e mbetur pa vuajtur nga dënimi i caktuar. Vënia në provë kursen ekzekutimet e panevojshme të burgimit duke mos ndaluar nga ana tjetër vuajtjen e dënimit të plotë nga ata të dënuar që abuzojnë me mundësinë e dhënë për riedukim jashtë burgut. Për këtë arsye pezullimi duhet të jetë rregull dhe ekzekutimi të bëhet përjashtim.

Me qëllim mundësimin e një risocializimi dhe riedukimi sa më të plotë, gjykata mund të caktojë ndaj të dënuarit një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij kodi²⁰⁹. Gjykata duhet të tregojë vëmendje për të caktuar në çdo rast një nga detyrimet e parashikuara nga neni 60, kur ato janë të përshtatshme me natyrën e veprës dhe rrethanat e të dënuarit²¹⁰, pasi këto detyrime nxisin dhe zhvillojnë tek i dënuari ndjenjën e përgjegjshmërisë ndaj komunitetit dhe të dëmtuarve. Një nga detyrimet specifike i cili me ligjin nr. 144/2013 është parashikuar më vete në nenin 60/a, është “Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës”. Megjithëse kjo dispozitë ka një efekt pozitiv për të plotësuar masat rehabilituese ndaj personave të varur nga alkooli dhe droga, ekzekutimi i saj në praktikë varet veç të tjerave nga hapja e qendrave të tilla ku mund të trajtohen këto kategori dependentësh.

Sipas nenit 61, i dënuari duhet të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata. Sipas neneve 59 §4 dhe 62 §4 (ky i dyti përsërit pjesërisht të parin), nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës, apo nuk përmbush detyrimet e vendosura (të parashikuara në nenet 60, 60/a dhe 61), gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër²¹¹, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Megjithëse modeli i sistemit të përzier të dënimit me kusht (Salihu, 2012: 457), i adaptuar nga K. Penal shqiptar është sistemi më i mirë dhe i plotë²¹², në vlerësimin tonë do të ishte e arsyeshme që për rastet e veprave të lehta dhe kur nuk është e përshtatshme caktimi i asnjë detyrimi ndaj të dënuarit, të mund të aplikohet një lloj dënimi alternativ në formën e *probation*, pezullimit pa mbikëqyrje, vërejtjes gjyqësore, apo përjashtimit nga dënimi. Megjithëse mbajtja nën mbikëqyrje

²⁰⁹ Për efekte hapësire nuk mund t'i citojmë.

²¹⁰ Shih nenin 60 §2 të K. Penal.

²¹¹ Kjo alternativë vlerësohet si e pazbatueshme, pasi aktualisht sipas nenit 59 lejohet pezullimi i ekzekutimit vetëm të dënimit me burgim dhe jo i atij me gjobë, siç parashikojnë disa legjislacione të tjera.

²¹² Sistemi i përzier është produkt i bashkimit mes sistemit anglo-amerikan *probation*, (ku gjykata nuk cakton fare dënim me burgim, por e pezullon caktimin e dënimit duke e vënë të pandehurin në mbikëqyrje) dhe sistemit të hershëm kontinental belgo-francez të pezullimit të dënimit me burgim (pa u vënë në mbikëqyrje).

nga shërbimi i provës ka kosto më të ulëta se burgimi, sistemi ligjor duhet të shmangë mbingarkimin e panevojshëm edhe të këtij institucioni²¹³, me qëllim të mbajtjes nën kontroll të kostove dhe fokusimit të tij në rastet më të nevojshme për mbikëqyrje.

4.5. Qëndrimi në shtëpi

Qëndrimi në shtëpi është një alternativë e re e vuajtjes së dënimit me burgim në Shqipëri, e parashikuar në nenin 59/a të K. Penal me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 dhe përbën një zgjidhje të ndërmjetme mes nevojës për kufizimin e lirisë për shkak të kryerjes së një vepre penale dhe nevojave të veçanta të të pandehurit, apo familjarëve të tij. Kjo alternativë synon të mbrojë nga vuajtja e dënimit me burgim subjekte të caktuara (Muçi, 2012: 369), duke mundësuar vuajtjen e tij me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, apo në një qendër të kujdesit a të shëndetit publik. Ky lloj dënimi aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

Së pari kur gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se dy vjet burgim, ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi; Së dyti kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet njëra nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur, apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paafte nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësiive familjare.

Megjithëse, ky institut parashikon rregullin e qëndrimit konstant të të dënuarit në shtëpi, në paragrafin e tretë të nenit 59/a parashikohet mundësia që gjykata të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord. Në vitet e para të miratimit të këtij neni ka pasur një aplikim të ulët të tij²¹⁴, por gjatë vitit të fundit besojmë se ai ka filluar të aplikohet më

²¹³ Në raportin për vitin 2013, Shërbimi i provës paraqet si një nga problemet e tij më shqetësuese çështjen e mungesave në staf dhe të mungesës së fondeve për pagat e tyre (:2-22). Kërkesa për shtimin e stafit të këtij shërbimi është rekomanduar edhe nga prezenca e OSBE në Shqipëri (2013: 24).

²¹⁴ Sipas raportit vjetor 2013 të Shërbimit të provës nga koha e miratimit të tij deri në fund të vitit 2013 (pra për 5 vite) ky institut është aplikuar vetëm në 181 raste (:11), ndërkohë që në vitin 2014 ky dënim alternativ është caktuar ndaj 56 personave (Ministria e Drejtësisë, 2015: 107). Tendencë rritëse vihet re edhe nga të dhënat e marra në GJRRGJ Shkodër, ku në vitin 2014 ky dënim është aplikuar vetëm në 2 raste, ndërkohë që në 6 mujorin e parë të vitit 2015 është aplikuar në 12 raste.

gjerë. Një kontribut të mëtjshëm për inkurajimin e zbatimit të këtij neni ka sjellë shtrirja e monitorimit elektronik në të gjithë vendin.

4.6. Monitorimi elektronik

Monitorimi elektronik është shkalla më e lartë e kufizimit të lirisë së një individi që nuk është burgosur. Megjithatë mbikëqyrja në distancë e të dënuarit përmes pajisjeve elektronike nuk pamundëson tërësisht rikryerjen nga i pandehuri të veprave të reja penale (Nellis, 2009: 44), ajo kontrollon ekzekutimin strikt të kufizimeve të vendosura nga gjykata në lidhje me lirinë e lëvizjes²¹⁵. Mbikëqyrja elektronike u implementua në vendin tonë me ligjin nr. 10494, datë 22.12.2011 dhe gjen zbatim për masat shtrënguese të sigurimit, për alternativat e dënimit me burgim, për dënimet plotësuese dhe për monitorimin e urdhrave të mbrojtjes. Vendosja e ME bëhet nga gjykata vetëm në rastet kur personi shfaq pëlqimin për mbajtjen e saj. Sa i takon dënimeve alternative ME vendoset për monitorimin e gjysmëlirisë, pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, qëndrimit në shtëpi dhe lirimit para kohe me kusht.

Nisur nga shkalla e lartë e kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe shtrirja e madhe që kjo praktikë ka marrë në disa vende, ajo është konsideruar si një formë moderne e burgut virtual (Roberts, 2004). Për këtë shkak si dhe të kostove më të larta financiare dhe njerëzore që kërkon ME, ajo duhet të përdoret vetëm në rastet e personave të cilët paraqesin një rrezikshmëri më të lartë shoqërore²¹⁶, pra si një formë e ndërmjetme mes burgimit dhe pezullimit të tij pa asnjë kusht. Po ashtu, e njëjta logjikë duhet të përdoret edhe në dënimet e tjera alternative si gjysmëliria, qëndrimi në shtëpi, apo lirimi para kohe me kusht. Kufizimi i aplikimit të panevojshëm të ME parashikohet në nenin 5 §1 pikat “dh” dhe “e” të ligjit, të mishëruara në parimin e proporcionalitetit të ME-së me rrethanat e rastit dhe personalitetin e subjektit si dhe në parimin e objektivitetit dhe të efektivitetit të ME.

Në praktikë deri në shtator 2013 ME është aplikuar vetëm në 8 raste në rang vendi (OSBE, 2013: 16), por pas muajit qershor 2014²¹⁷ është krijuar mundësia e një aplikimi më të gjerë të saj. Çështja e nivelit të shtrirjes së ME si dënim alternativ është akoma në diskutim në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore²¹⁸, pasi akoma ajo është më shumë një çështje zgjedhjeje e shteteve të ndryshme sesa një politikë e mbështetur në prova dhe studime të pakundërshtueshme (Øster &

²¹⁵ Neni 3 §1.a i ligjit nr. 10494 parashikon se mbikëqyrja elektronike (ose ME) është mekanizmi që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

²¹⁶ Si kategori më prioritare për të aplikuar ME, janë përsëritësit habitualë, ata që kanë kryer vepra në bashkëpunim, ata që kanë lidhje apo prije për të kryer vepra në vende të caktuara, etj.

²¹⁷ Me miratimin e VKM nr. 406, datë 18.6.2014 “Për shtrirjen e mbikëqyrjes elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë” janë siguruar edhe pajisjet elektronike të monitorimit për të gjitha rrethet gjyqësore.

²¹⁸ P.sh. Gjermania ka një nivel shumë të ulët të aplikimit të ME, ndërkohë që Britania e madhe dhe vendet nordike kanë reflektuar një besim shumë më të madh ndaj efektivitetit të këtyre masave. Debatimi mbi shkallën e aplikimit është jo vetëm për efikasitetin e ME në raport me masat e tjera, por edhe në nivel etik, mbi rrezikun që mund t'i vijë privatësisë dhe lirisë së individit nga një kontroll masiv përmes aplikimit të teknologjive të reja.

Beumer, 2014: 6) për përparësitë e saj në raport me alternativat e tjera të burgimit. Ajo që nuk ka më vend të diskutohet, është se monitorimi elektronik është më i lirë se burgimi, por më i kushtueshëm se alternativat e tjera të dënimit me burgim. Ajo që mbetet për t'u provuar nga studimet e ardhshme është se sa efektive është ME në uljen e recidivizmit dhe mbrojtjen e shoqërisë nga të dënuarit me potencial të lartë kriminal.

4.7. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

Në ndryshim nga neni 59 i K. Penal, ku i dënuari vihet në provë me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale, sipas nenit 63 dënimi me burgim zëvendësohet me kryerjen e një pune pa shpërblim në interes publik. Megjithatë ky lloj dënimi alternativ është relativisht i ri në të drejtën penale²¹⁹, ai ka marrë një shtrirje të gjerë në Evropë dhe në Amerikë. Puna e papaguar aplikohet gjerësisht si dënim alternativ në Britaninë e Madhe, Spanjë, Holandë, vendet Nordike, Hungari, Letoni (Dükel & Lappi-Seppälä, 2014: 427) dhe më pak në të gjitha vendet e tjera perëndimore. Puna e papaguar merr një rëndësi të madhe për t'u caktuar ndaj personave të cilët nuk janë të aftë të paguajnë një dënim me gjobë, por poashtu edhe si një alternativë e dënimit me burgim për vepra të lehta. Nëse zbatohet drejtë ajo ka një efekt pozitiv jo vetëm për shoqërinë, por edhe për përmirësimin e të dënuarit (Salihu, 2012: 473)²²⁰.

Vendi ynë ka pasur një traditë ligjore të hershme në aplikimin e dënimit me punë të papaguar që në vitin 1952, duke e parashikuar si dënim kryesor²²¹. Në kodin e ri, puna e papaguar (në shërbim publik) u parashikua vetëm si dënim alternativ i dënimit me burgim, mirëpo për vite me radhë ajo nuk ka gjetur zbatim në praktikë, si pasojë e pamundësive ligjore dhe institucionale për ta zbatuar (Islami, 2005: 68). Aplikimi i saj filloi pas vitit 2008 me krijimin e Shërbimit të provës dhe ka ardhur duke u shtuar çdo vit²²².

²¹⁹ Si dënim alternativ ky dënim është parashikuar për herë të parë në Britani në vitin 1972 (Salihu, 2012: 473).

²²⁰ Nga njëra anë ajo ul kostot financiare të dënimit me burgim dhe nga ana tjetër ndikon në edukimin dhe aftësimin e të dënuarit për një jetë sociale në përputhje me ligjin, duke kontribuar kështu në uljen e recidivizmit. Duke pasur edhe një natyrë represive, ajo plotëson njëkohësisht disa nga funksionet e dënimit penal, si: ndëshkimi, parandalimi dhe edukimi i të dënuarit.

²²¹ Në K. Penal të vitit 1952, puna korrektonjëse, parashikohej si dënim kryesor, ndërsa në K. Penal të vitit 1977 riedukimi nëpërmjet punës parashikohej si dënim kryesor vetëm për kundërvajtjet penale. Këto dispozita parashikonin se të dënuarit mund t'i ndalohej deri në ¼ e shpërblimit për punën e kryer, e cila mund të zgjaste nga 2 javë deri në 1 vit.

²²² Sipas Raporti Vjetor të Shërbimit të Provës 2013, nga data 01.06.2009-20.12-2013, gjykatat shqiptare kanë zbatuar nenin 63 të K. Penal në 798 raste, apo 8.53 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative (: 11), ndërkohë që kjo situatë ka ndryshuar ndjeshëm në vitin 2014, ku ky dënim është aplikuar në 694 raste (Ministria e Drejtësisë, 2015: 115).

Nisur nga natyra e këtij dënimi, neni 63 kërkon si domosdoshmëri dhënien e pëlqimit të të dënuarit për kryerjen e punës, pasi në të kundërt ajo nuk mund të ekzekutohet²²³. Paragrafi i parë e kufizon zëvendësimin e dënimit me burgim me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, vetëm për dënime deri në një vit burgim. Nisur nga marzhet e larta të dënimeve që parashikojnë shumë nene të pjesës së posaçme, nga karakteri cilësisht ndëshkues i këtij dënimi dhe efektet pozitive që ai sjell në edukimin e të dënuarit, në vlerësimin tonë ai duhet shtrirë së paku edhe për dënime deri në dy vite burgim. Një zgjidhje e arsyeshme mund të jetë, që bashkë me rritjen e masës së dënimit me burgim për të cilin mund të aplikohet ky dënim alternativ, të rritet edhe maksimumi i numrit të orëve të punës nga 240 në 500 orë²²⁴ dhe i afatit të kryerjes së saj nga 6 muaj në një vit²²⁵. Proporcionaliteti i konvertimit të dënimit me burgim në punë të papaguar dhe rritja e fleksibilitetit të aplikimit të saj, do t'i shërbente më mirë arritjes së qëllimeve të dënimit penal.

Neni 63 i K. Penal parashikon një rregullim unikal në të gjithë sistemin sanksionator, duke konsideruar të paqenë dënimin nëse i dënuari kryen punën në shërbim publik (Gjonçaj & Gjonçaj, 2009: 150). Pra kryeja e punës fshin në gjendjen gjyqësore, faktin se personi ka qenë i dënuar për atë vepër. Në vlerësimin tonë ky është një lapsus ligjor²²⁶, pasi ky rregullim është në kundërshtim me frymën e konceptit të rehabilitimit dhe gjendjes gjyqësore si dhe të vlerës që kanë rekordet gjyqësore në vlerësimin e rrezikshmërisë së një personi të dënuar më parë. Në aspektin krahasimor, rezulton i papranueshëm dhe alogjik që një person që ka kryer një kundërvajtje të lehtë penale dhe është dënuar me 50 000 lekë gjobë, me një dënim plotësues, apo është përjashtuar nga dënimi sipas nenit 52 të K. Penal, të konsiderohet i dënuar më parë, ndërkohë që sipas nenit 63 §6 konsiderohet i padënuar një person që është dënuar me një vit burgim për kryerjen e një krimi (megjithëse, ky dënim është konvertuar në punë në interes publik). Për rrjedhojë vlerësojmë se formulimi i kësaj fjalie duhet ndryshuar, duke u bërë “dënimi konsiderohet i vuajtur”.

Pas shfuqizimit nga GJK²²⁷ të paragrafit të 8 të nenit 34 të K. Penal, me ligjin nr. 23/2012 u shtuan dy paragrafë të cilët parashikojnë mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në një punë në shërbim publik, në rast se i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e saj. Në këtë rast zbatohen rregullat e nenit 63 të këtij kodi. Nisur

²²³ Vetë neni 63 §7 parashikon se nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën, e cila vendos sipas nenit 62 të këtij kodi.

²²⁴ Megjithëse në shumë vende të Evropës kohëzgjatja e punës së papaguar varion nga 40 deri në 240 orë, në SHBA varion nga 100-500 orë pune (Dünkel & Lappi-Seppälä, 2014: 428).

²²⁵ K. Penal i Kosovës parashikon në nenin 60 afatin një vjeçar për kryerjen e punës në shërbim publik.

²²⁶ Pasi duket sikur legjislatori ka dashur të thotë që “dënimi i dhënë konsiderohet i vuajtur”, në rast se personi kryen punën në shërbim publik, por jo të konsiderohej “tërësisht i paqenë” edhe për efekt të dëshmisë së penaltetit.

²²⁷ Me vendimin nr. 19, datë 01.06.2011.

nga ky parashikim i ri ligjor, vlerësojmë se do të ishte më logjike që puna në shërbim publik të parashikohej si një dënim kryesor, krahas dënimit me burgim dhe me gjobë.

E drejta jonë penale nuk mund të mbesë peng e klisheve të vjetra dhe as të dorëzohet para sfidave dhe dështimeve të aplikimit të ideve të reja për rritjen e humanizmit, eficensës dhe barazisë thelbësore në trajtimin e kryerësve të veprave penale. Në mënyrë të veçantë e drejta jonë penale duhet të përqendrohet në shqyrtimin e alternativave efikase të cilat ngushtojnë hendekun mes një të drejtë “klasike” penale për shtresat e ulëta të shoqërisë (si të varfrit, të paarsimuarit, të pastrehët, narkomanët, etj.) dhe një drejtësie “moderne”, apo “humane” vetëm për shtresat më të larta shoqërore. Në këtë drejtim, duhen eksploruar dënime të përshtatshme alternative edhe për kategoritë e marxhinalizuara shoqërore, duke kontribuar kështu jo vetëm në uljen e ndjeshme të popullatës së burgjeve, por edhe në ndryshimin e raportit të shtresave sociale në këtë popullatë.

Ashtu siç jemi shprehur në kapitullin e dytë, është më se e arsyeshme dhe efektive, aplikimi i dënimit me gjobë ndaj personave jo shumë të rrezikshëm për shoqërinë të cilët kanë mundësi financiare ta shlyejnë atë, ndërkohë që aktualisht nuk parashikohet një mundësi trajtimi të barabartë për të varfrit (të cilët e kanë të pamundur pagesën e një gjobe), duke lënë burgimin si dënimin e vetëm kryesor të zbatueshëm ndaj tyre²²⁸. Mbështetur në këtë arsyetim, parashikimi i punës së papaguar si një dënim kryesor do ta bënte të drejtën tonë penale më humane, më të barabartë dhe më efektive. Në ndryshim nga gjoba e sheshtë apo burgimi (në masë më të vogël), puna e papaguar shkakton tek të gjitha kategoritë sociale të të dënuarve të njëjtën dhimbje²²⁹. Me parashikimin e punës në shërbim publik si dënim kryesor, e drejta jonë penale do të eliminonte varësinë ndaj burgimit për të varfrit jo të rrezikshëm, duke u siguruar edhe atyre një dënim të përshtatshëm për rrezikshmërinë e tyre dhe një trajtim të barabartë me ata me mundësi ekonomike. Mbështetur në studimet e kryera në vende të ndryshme, të cilat kanë një eksperiencë të gjatë të zbatimit të saj, puna në komunitet ka rezultuar një eksperiment i suksesshëm (Dünkel & Lappi-Seppälä, 2014: 427) dhe për rrjedhojë duhet të përbëjë një alternativë premtuese edhe për realitetin shqiptar. Eksperienca spanjolle është një shembull provues se ndryshimet e duhura ligjore dhe ato që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të saj në praktikë, mund të sjellin ndryshime të jashtëzakonshme në nivelin e zbatimit të këtij lloji dënimi²³⁰.

²²⁸ Duhet sjellë në vëmendje se K. Penal kosovar në nenin 60 e parashikon punën në shërbim publik si një dënim alternativ edhe të dënimit me gjobë deri në shumën € 2500.

²²⁹ Pasi ajo ka të bëjë me shpenzimin e kohës së tyre për një aktivitet për të cilin nuk do të paguhet. Në këtë aspekt puna e papaguar është shumë e ngjashme me gjobat ditore dhe përbën dënimin e vetëm i cili mund të konvertohet lehtësisht me njëri-tjetrin, pasi kanë emërues të përbashkët vlerën proporcionale monetare të një dite pune.

²³⁰ Nga viti 2006 deri në vitin 2008, aplikimi i punës në shërbim publik në Spanjë pothuajse u njëzetëfishua, duke arritur 25.88% të të gjithë dënimeve kryesore (ku më parë nga viti 1996-2003 ky dënim zinte vetëm rreth 0.008 % të të gjithë të dënuarve). Në vitin 2009, 76% e këtij dënimi alternativ është aplikuar ndaj veprave penale të qarkullimit rrugor, 16% ndaj dhunës familjare dhe gjinore dhe 8% për gjithë veprat e mbetura (Blay, 2010: 72).

Në këtë kontekst, përveç ndryshimeve ligjore dhe konceptuale për shtrirjen e mëtejshme të aplikimit të punës së papaguar (Elezi et al, 2013: 312), mbetet akoma një punë e madhe për t'u bërë në drejtim të procedurave të përzgjedhjes së punës konkrete, mundësive reale që Shërbimi i Provës ka në dispozicion për punë të përshtatshme sipas cilësive individuale të të dënuarit dhe monitorimit efektiv të ekzekutimit të saj. Nëse këtyre elementëve praktikë të ekzekutimit të punës së papaguar nuk u kushtohet vëmendje maksimale, ajo do të humbë efektin e saj ndëshkues dhe rehabilitues dhe bashkë me to edhe besimin e gjyqtarëve për aplikimin e saj të gjerë në praktikë.

4.8. Lirimi me kusht

Nenet 64, 65 dhe 65/a janë dispozitat e fundit të këtij kreu dhe parashikojnë lirimin para kohe me kusht. Megjithëse ky institut nuk ka të bëjë me caktimin e dënimit²³¹ si moment procedural, ai ka një lidhje të drejtpërdrejtë me politikën penale që ndiqet në një vend. Lirimi para kohe me kusht përbën një përjashtim nga rregulli se dënimi i caktuar nga gjykata duhet të vuhet i plotë. Ky përjashtim zbatohet vetëm ndaj dënimit me burgim, për shkak të natyrës së tij thellësisht kufizuese në lirinë personale dhe të lëvizjes së të dënuarit. Nëse sistemi penal fokusohet tek qëllimi retributiv i dënimit, të dënuarit duhet ta vuajnë të plotë të gjithë dënimin e caktuar nga gjykata, por nëse e drejta penale e një vendi vlerëson qëllimin edukues dhe rehabilitues të dënimit, atëherë me arritjen e edukimit dhe përmirësimit psiko-social të të dënuarit, ai duhet të lirohet pavarësisht kohës së mbetur pa vuajtur.

K. Penal shqiptar ka vendosur kritere kohore se kur mund të jetë afati më i afërt i kualifikimit të një të dënuari me burgim, për të aplikuar për lirim para kohe me kusht, nëse ai me sjelljen dhe punën e tij ka treguar se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Fillimisht K. Penal i ri shqiptar parashikonte si afatin minimal për t'u kualifikuar për lirim para kohe me kusht, vuajtjen e gjysmës së dënimit të caktuar, por me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, këto afate u zgjatën²³², duke kërkuar tashmë vuajtjen e jo më pak se dy të tretave të dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim dhe jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim (Elezi et al, 2013: 313). Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Më tej edhe këto mundësi kufizohen nga paragrafi i tretë i nenit 64, i cili ndalon lirimin para kohe me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

²³¹ Pasi ky institut aplikohet pas vuajtjes së pjesës më të madhe të dënimit dhe jo në momentin e caktimit të dënimit. Ndonëse në K. Penal shqiptar, lirim para kohe me kusht parashikohet në kreun e dënimeve alternative, në thelb ai nuk është i tillë. Ai ka ngjashmëri të madhe me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, por dallon prej tij në shumë elementë, ndër me kryesorët janë koha kur aplikohen dhe gjykata që i vendos secilën prej tyre.

²³² Me përjashtim të afateve të dënimeve me burgim për kundërvajtje penale, i cili mbeti si më parë, vuajtja e ½ të dënimit të caktuar.

Kritereve të ashpra të cituara më sipër, neni 64 i K. Penal i shton një kufizim të përgjithshëm, se i dënuari me burgim mund të lirohet nga vuajtja e dënimit të mbetur, vetëm për arsye të veçanta²³³. Sikur të mos mjaftonin afatet dhe kriteret e rrepta të vendosura në dispozitat e sipërcituara, me ligjin nr. 23/2012, datë 01.03.2012 u shtua neni 65/a, i cili parashikon mundësinë që Gjykata, në dhënien e vendimit mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij kodi. Kjo dispozitë parashikon se periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata, deri në vuajtjen e plotë të tij. Megjithëse rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 65/a për vendosjen e aplikimit të periudhës së sigurisë janë të zakonshme²³⁴, është për t'u përmendur se për shkak të ashpërsisë së kufizimeve të tjera të aplikimit të lirit para kohe me kusht, periudha e sigurisë është aplikuar fare pak në praktikën gjyqësore.

Neni 65 i K. Penal ndalon lirimin me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm. Sipas kësaj dispozite, i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht vetëm në raste të jashtëzakonshme kur ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim dhe kur gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Duke i marrë në tërësi gjithë kriteret mohuese të parashikuara në nenin 64 dhe 65, mund të themi arrijmë në përfundimin se dënimi me burgim të përjetshëm në vendin tonë përfundon me vdekjen e të dënuarit në burg. Megjithëse paradoksalisht afati i lirit para kohe me kusht është më i afërt për burgimin e përjetshëm se për atë me 35 vite burgim²³⁵, me kriteret e rrepta të vendosura deri më tani për këtë dënim, jo vetëm që nuk ka pasur asnjë rast të aplikimit të tij në praktikë, por vështirë se do të ketë edhe në të ardhmen. Nga ana tjetër GJK të vendeve të tjera si të Francës²³⁶, Italisë²³⁷, Gjermanisë²³⁸, apo edhe Namibisë²³⁹ kanë njohur të drejtën substanciale të të dënuarve përjetë për t'u liruar para kohe (Van Zyl Smit, 2002: 213).

²³³ Sipas jurisprudencës së GJL (shih vendimet nr. 93 (10), datë 10.01.2012, apo nr. 1121 (75), datë 12.03.2014 të KPGJL), "arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal për edukimin e të dënuarit, duke treguar se ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.

²³⁴ Pika a) parashikon se ajo mund të caktohet për çdo vepër penale, e cila parashikon si masë dënimi mbi pesë vjet burgim, ndërsa katër gruprrethanat e tjera përfshijnë disa rrethana të cilat konsiderohen njëkohësisht edhe si rrethana rënduese (si kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori; kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen; kur vepra është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; apo kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale).

²³⁵ Për të cilin duhen vuajtur së paku 26 vite e 3 muaj nga burgimi i caktuar.

²³⁶ Décision n° 93-334 DC du 20 janvier 1994 de la Conseil Constitutionnel.

²³⁷ Corte costituzionale. sentenza, N. 274, Foro Italia . 1, 233327. 27 September 1987.

²³⁸ Namibia: Supreme Court. S v Tcoib (SA 4/93) [1996] NASC 1; 1996 (1) SACR 390 (NmS) (6 February 1996)S. v. Tcoib 1996 (1) S.A.C.R. 390 (NmS).

²³⁹ GJK gjermane në vendimin nr. BverfGE 45 187 ka vendosur se dënimi me burgim të përjetshëm duhet të parashikojë me patjetër mundësinë e lirit para kohe me kusht.

Parashikimi i afateve strikte dhe tepër të rënda për t'u kualifikuar për lirim para kohe me kusht (Sufaj, 2011: 8) jo vetëm konfirmon qëllimin ndëshkues dhe paaftësues të dënimit me burgim në Shqipëri, por vë në dyshim të madh sinqeritetin e ndjekjes së qëllimit edukues dhe rehabilitues të tij. Gjithë këto kufizime ligjore na shtojnë në përfundimin se ndryshimet ligjore të dispozitave që kanë të bëjnë me të, e kanë bërë praktikisht lirimin para kohe me kusht për vepra të rënda, një mundësi shumë të rrallë dhe për vepra më të lehta një mundësi të vështirë. Sipas vjetarit statistikor 2014 (Ministria e Drejtësisë, 2015: 107), në raport me numrin total të të dënuarve me burgim, numri i personave që kanë përfituar nga lirimi para kohe me kusht është i papërfillshëm²⁴⁰. Për rrjedhojë, kjo situatë ligjore kërkon ndërhyrje imediate për uljen drastike të afateve të lirimit para kohe me kusht, në nivelet e K. Penale të vendeve të tjera evropiane²⁴¹.

Po ashtu për jetësimin dhe humanizimin e këtij instituti, duhet të bëhet një diversifikim i rrethanave dhe modaliteteve të lirimit, duke shtuar mbikëqyrjen intensive elektronike, punën në komunitet, apo vuajtjen e dënimit në shtëpi²⁴².

²⁴⁰ Kështu në vitin 2011 janë liruar me kusht 206 të dënuar me burgim, në vitin 2012-188, në vitin 2013-146 dhe në vitin 2014 vetëm 64 të dënuar me burgim.

²⁴¹ Shih nenin 79 §3 të k. Penal rus, atë italian, kosovar, malazez, francez, gjerman etj. të cilët kanë afate më të shkurtra.

²⁴² Siç parashikon p.sh. neni 80 i K. Penal rus.

KAPITULLI V: POLITIKA E CAKTIMIT TË DËNIMIT PENAL NË SHQIPËRI DHE KRIMINALITETI. PARANDALIMI I PËRGJITHSHËM, SI JUSTIFIKIM POLITIK I DËNIMEVE TË ASHPRA

5.1. Orientimi i politikës së dënimit në Shqipëri

Kriminaliteti përbën një çështje me rëndësi të madhe për jetën e një vendi, pasi ndikon drejtpërdrejtë në ekonominë, sigurinë dhe cilësinë e jetës së përditshme të qytetarëve. Për këtë arsye shteti dhe shoqëria i kushtojnë një rëndësi të veçantë studimit dhe zbatimit të strategjive sa më efikase për ndikuar në uljen dhe kontrollin e sjelljeve kriminale. Megjithatë vendi ynë trashëgoi nga sistemi komunist një ekonomi të rrënuar dhe një varfëri masive të tejskajshme, kjo nuk është përkthyer në rëndim të situatës së kriminalitetit. Për shkak të natyrës represive të regjimit, të mungesës së qarkullimit të lirë ekonomik, izolimit kulturor dhe rreptësisë së zbatimit të ligjeve të kohës, vendi ynë trashëgoi një nivel të ulët të kriminalitetit. Kështu, edhe 5 vite pas rrëzimit të regjimit komunist (në vitin 1995), Shqipëria kishte përsëri një normë të ulët të kriminalitetit me vetëm 7 institucione penitensiare në funksion (Council of Europe, 1999) dhe me normën më të ulët në Evropë të të burgosurve, vetëm 36 të burgosur për 100,000 banorë (Council of Europe, 2003). Me hapjen e vendit ndaj ekonomisë së tregut të lirë dhe modeleve të shoqërive perëndimore, krahas rimëkëmbjes së ekonomisë u paraqitën edhe forma të reja të kriminalitetit dhe u rigjallëruan forma të vjetra të tij, të cilat ishin zhdukur, apo ulur në nivele të papërfillshme²⁴³.

Në vitin 1995 u miratua K. Penal i ri, por për shkaqe të shumta ai nuk arriti të reflektonte kënaqshëm shumë forma të reja të kriminalitetit të cilat u shfaqën rishtaz në sajë të transformimeve social-ekonomike që shoqëria shqiptare pësoi në vitet në vijim. Për të plotësuar këto boshllëqe dhe për reaguar ndaj niveleve të paparashikuara të këtij kriminaliteti të ri, Legjislativi shqiptar ka ndërmarrë ndërhyrje të shpeshta në K. Penal. Ashtu siç do të trajtohet hollësisht më poshtë, në masën më të madhe këto ndërhyrje janë orientuar në drejtim të miratimit të veprave të reja penale dhe ashpërsimit të dënimeve për veprat ekzistuese. Këto ndryshime ligjore kanë qenë të ngutura dhe të pastudiuara, jo vetëm sa i takon teknikës legjislative dhe konceptimit të K. Penal si një korpus dispozitash të harmonizuara, por së pari në aspektin substancial, sa i takon thelbit dhe qëllimit të kryerjes së tyre.

Duke u fokusuar në ndryshimet që ka pësuar K. Penal në sanksionet penale (qoftë në pjesën e përgjithshme, qoftë në pjesën e posaçme, vihet re se ashpërsimet e dënimeve janë argumentuar nga Ligjvënësi me synimin e tij për luftimin e kriminalitetit. Ky justifikim politik është zbatuar me fushata periodike, sa herë që në opinionin publik dhe mediatik është ngritur shqetësimi për rritjen

²⁴³ Pas viteve '90 u paraqitën vepra të reja kriminale, si ato në fushën e narkotikëve, të trafikeve të qenieve njerëzore dhe të armëve, të qarkullimit rrugor, të tatimeve dhe taksave, të ndërtimeve të paligjshme etj. dhe u rishfaqën me një intensitet të ri vepra të vjetra penale, si: vrasjet për hakmarrje dhe gjakmarrje, korrupsioni etj.

apo përhapjen e madhe të një fenomeni të caktuar kriminal. Maxhorancat politike, në përpjekje për të bindur opinionin publik për vullnetin e tyre të qartë për të luftuar kriminalitetin (Bianchi, 1994: 334) dhe për të mbrojtur shoqërinë prej tij, kanë ndërmarrë nisma të tilla ligjore për ashpërsimin e sanksioneve penale. Këto qëndrime thellësisht populiste, mund të kenë arritur të japin rezultat në aspektin politik, pasi në afat të shkurtër kanë mundur që të fashisin kritikën publike për mungesë efikasiteti në luftën ndaj kriminalitetit, mirëpo, në afat të gjatë ato nuk kanë arritur të justifikojnë efektin parandalues të tyre për uljen e kriminalitetit. Rendja e të gjitha formacioneve politike në pushtet pas politikave të tilla të “tolerancës zero me krimin”, e ka shndërruar mbështetjen për dënime të ashpra, në etalonin matës të qëndrimit publik për vullnetin qeveritar për të luftuar krimin.

Megjithëse politikat populiste të trajtimit të çështjeve të kriminalitetit kanë pasur ndikim në shumë vende demokratike (Pratt, 2007: 12) dhe në mënyrë të veçantë në ato anglosaksone²⁴⁴ (Kury & Ferdinand, 2009), intensiteti me të cilin ato janë aplikuar në vendin tonë është i pakrahasueshëm me ndonjë vend tjetër evropian. Eksperienca evropiane dhe botërore ka treguar se lufta ndaj një fenomeni shqetësues kriminal mund të zhvillohet në dy qasje apo drejtime të ndryshme. Qasja e parë është serioze dhe kalon në dy faza. Faza e parë kërkon impenjimin e energjive për të studiuar në thellësi arsyet dhe shtratin social të zhvillimit dhe përhapjes së atij fenomeni kriminal, në mënyrë që në fazën e dytë të ndërmerren masat e duhura për t’i eliminuar ato me sukses. Kjo formë e reagimit ndaj krimit e ka bazën ideologjike në shkollën e mbrojtjes së re shoqërore dhe ka gjetur zbatim praktik në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore. Ajo ka në themel të saj ndërgjegjësimin se krimi është një fenomen social dhe se shoqëria ka përgjegjësinë për luftimin e tij me masa profilaktike²⁴⁵ (Latifi, 2013: 11). Në ndryshim nga ky reagim multidimensional dhe afatgjatë, qasja e dytë e luftimit të kriminalitetit e sheh zgjidhjen e kësaj problematike shoqërore përmes mekanizmave represivë, duke u orientuar në parashikimin e dënimeve të ashpra për kryerësit e veprave penale. Megjithëse siç është trajtuar më lart kjo qasje e politikës kriminale është braktisur nga shumica e vendeve demokratike perëndimore, ajo ka qenë qasja dominuese e cila ka udhëhequr shumicën e reformave dhe masave të luftimit të kriminalitetit në vendin tonë. Në këtë kapitull do të përpiqemi të analizojmë në thellësi efektivitetin dhe arsyetueshmërinë e reformave ligjore në lidhje me politikën penale të dënimit të ndjekur në vendin tonë që nga miratimi i K. Penal deri në ditët që flasim. Analizimi i suksesit të politikës së ashpër penale në

²⁴⁴ Vendet anglishtfolëse kanë një debat të gjallë shkencor për politikat populiste penale të ndërmarra nga shumicat parlamentare dhe ku SHBA është padyshim përfaqësuesja më e spikatur e këtyre tendencave dhe më e kritikuara nga opinioni shkencor.

²⁴⁵ Masa të tilla të cilat kontribuojnë në uljen e kriminalitetit janë ndihma dhe solidariteti social ndaj personave në vështirësi të mëdha ekonomike, masat për uljen e injorancës dhe papunësisë, masat për trajtimin e të alkoolizuarve dhe narkomanëve, masat mjekësore ndaj personave me probleme të shëndetit mendor etj.

vendin tonë në drejtim të parandalimit të përgjithshëm, do të bëhet përmes shqyrtimit të të dhënave statistikore të publikuara nga institucionet vendase dhe të huaja, si dhe përmes analizës kualitative të rasteve apo fenomeneve të veçanta kriminale. Nga ana tjetër, në këtë kapitull do të përpqemi që të analizojmë edhe arsyetueshmërinë e sanksioneve penale, nëse ato janë në përputhje me parime dhe objektiva të tjerë të rëndësishëm shoqëror. Pretendimet politike për të kontrolluar fenomene të caktuara antiligjore përmes dënimeve të ashpra penale, do të analizohen në mënyrë teorike dhe empirike, për të gjykuar mbi seriozitetin e motivimit të tyre. Trajtimi i dënimit të ashpër penal si “shkopi magjik” i rregullimit të problemeve të shumta social-ekonomike, e zhvendos atë nga një mjet “ultima ratio” në një mjet “prima ratio” (Jareborg, 2005: 524), duke lënë kështu qëllimisht në hije detyrimet primare të shtetit dhe shoqërisë për të ndërmarrë masa efikase parandaluese, për të eliminuar faktorët kriminogjenë (Latifi, 2013: 165).

Megjithëse ulja e nivelit të kriminalitetit është një objektiv i dëshirueshëm për një vend të orientuar nga shteti ligjor, ai nuk legjitimon sakrifikimin e parimeve dhe interesave të tjera të rëndësishme shoqërore. Në këtë aspekt edhe lufta ndaj kriminalitetit duhet të kalojë testin e përzgjedhjes së kostove sa më efektive për të arritur maksimumin e përfitimeve të synuara. Për një luftë të singertë dhe afatgjatë me krimin, përpara inflacionit të retorikës populiste të mbështetur në dënime të ashpra, lind e nevojshme të shqyrtohen në mënyrë të koordinuar masa të tjera alternative me natyrë preventive²⁴⁶ dhe masa të zbatimit kapilar dhe të barabartë të ligjit për të gjithë.

Përveç mbështetjes së vazhdueshme politike, tendenca për ashpërsimin e dënimeve ka gjetur mbështetje edhe në doktrinë dhe jurisprudencën gjyqësore. Qëndrimi doktrinar ka qenë pak kontrovers, pasi megjithëse nga njëra anë janë kritikuar marzhet e larta të dënimeve me burgim (Elezi et al, 2013: 16), nga ana tjetër është vlerësuar se reformat e ndërmarra në K. Penal e kanë kthyer atë një armë efektive për luftimin e kriminalitetit (17). Po ashtu siç jemi shprehur në kapitujt e mëparshëm, në jo pak raste edhe praktika gjyqësore ka justifikuar dënimet e ashpra si një mjet për të arritur parandalimin e përgjithshëm. Politikat populiste mbi çështjet e kriminalitetit dhe interpretimi i papërshtatshëm mediatik mbi punën e prokurorisë dhe të sistemit gjyqësor për raste specifike, ka bërë që në shumë raste prokurorët dhe gjyqtarët të lënë mënjanë kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit²⁴⁷, me qëllim që ata të mos identifikohen si subjekte që po pengojnë luftën e ashpër të qeverisë ndaj krimit (Nikolli, 2015c: 532). Caktimi i masave të rënda të sigurimit (arrest në burg dhe arrest në shtëpi) detyrojnë indirekt gjykatat që gjykojnë çështjet në themel, që në caktimin e dënimit përfundimtar të mbajnë parasysh gjendjen faktike të burgimit të vuajtur nga

²⁴⁶ Si përpjekjet për arsimimin dhe ngritjen kulturore të gjithë shtresave të shoqërisë, uljen e papunësisë, strehimin, kujdesin shëndetësor, drejtësinë dhe solidaritetin social etj.

²⁴⁷ Megjithëse ligjërisht masa e sigurimit “Arrest në burg” është një masë ekstreme, e cila duhet të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, që në vitin 2014, numri i personave të hequr liria sipas kësaj mase e ka tejkaluar numrin e personave të dënuar me burgim me vendim të formës së prerë.

i pandehuri²⁴⁸. Në masë më të vogël sesa në caktimin e masave të sigurimit, fryma pro burgimit dhe mbështetja në efektin e tij parandalues, është transmetuar edhe në caktimin e dënimit për vepra penale me një përhapje të madhe, si: ndërtimi i paligjshëm, vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike, mbajtja pa leje të armëve të zjarrit, vrasjet etj.

Trajtimin e këtyre çështjeve do ta fillojmë me paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të panoramës së ashpërsisë së dënimeve në vendin tonë, për të vijuar me analizimin e realizimit të efektit parandalues të dënimeve të ashpra penale.

5.2. Niveli i dënimeve penale në Shqipëri

Analiza e dispozitave penale që kanë të bëjnë me dënimin, duke filluar nga ato që përcaktojnë llojet e dënimeve dhe klasifikimin e tyre, kohëzgjatjen, mënyrën dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre, dënimet alternative dhe modalitetet e ekzekutimit të tyre, janë detaje të rutinës së punës së profesionistëve të fushës penale (kryesisht prokurorë, avokatë dhe gjyqtarë), por vështirë se mund të jenë objekt i analizave të personave të zakonshëm ndaj të cilëve këto dispozita do të zbatohen. Një person që vendos të kryejë me paramendim një vepër të caktuar penale, mundet që të shqyrtojë apo llogarisë edhe rrezikun e dënimit që mund t'i caktohet për të vuajtur në rast zbulimi nga policia dhe deklarimi të tij fajtor nga gjykata, por analiza që ai mund të kryejë mbi dënimin penal eventual është shumë e thjeshtë dhe sipërfaqësore dhe s'ka të bëjë me kompleksitetin ligjor dhe jurisprudencial që rrethon procesin e caktimit të dënimit për një profesionist.

Në këtë këndvështrim, gjithë korpusi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me dënimin penal dhe interpretimi që atyre u bëjnë gjykatat, përçohet tek kryerësit eventual të veprave penale si një mesazh i thjeshtë se sa lehtë apo sa rëndë dënohet një veprim i caktuar i parashikuar si vepër penale. Njerëzit e zakonshëm mundet që të krijojnë një ide të përgjithshme, se sa rëndë mund të dënohet një vrasje me paramendim, një plagosje e rëndë me dashje, një vjedhje banese, një armëmbajtje pa leje etj., por asnjë qytetar i zakonshëm nuk mund të dijë me siguri se ç'lloj dhe masë dënimi mund të caktojë gjykata për çdo vepër konkrete dhe për çdo autor të mundshëm. Prandaj masat ligjore që ndërmerr legjislatori dhe mënyra sesi ato zbatohen nga sistemi gjyqësor transmetohen tek qytetarët e lëkundur si një lloj fryme për nivelin e ashpërsisë së dënimeve në përgjithësi dhe për një kategori vepre penale në veçanti.

Në 20 vitet e fundit, legjislacioni penal është orientuar në masë dominuese drejt dënimeve të ashpra, si një reagim ndaj fenomeneve të caktuara antiligjore të shfaqura në vendin tonë. Po të trajtohet në aspektin historik, K. Penal shqiptar i është nënshtruar 16 ndërhyrjeve legislative, shumica e të cilave në një mënyrë apo në një tjetër kanë ashpërsuar sanksionet penale për vepra të

²⁴⁸ Duke caktuar një dënim me burgim, së paku të barabartë me kohën e vuajtur në paraburgim dhe duke pamundësuar kështu caktimin e dënimit me gjobë, apo aplikimin e një dënimi tjetër alternativ.

ndryshme (Nikolli, 2014a: 306). Ndryshimi i parë dhe më radikal i sistemit të sanksioneve penale u bë me ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996, me të cilin u ngritën ndjeshëm masat e dënimit dhe u vendosën sanksione fikse për 45 vepra penale²⁴⁹. Ndryshimet e bëra me këtë ligj u shfuqizuan me vendimin nr. 13, datë 29.05.1997 të GJK, me arsyetimin se ato cenonin parimet e procesit të rregullt ligjor, të mbrojtjes dhe të individualizimit të dënimit.

Edhe me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998 u ashpërsuan dënimet për 3 vepra penale, por me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 krahas shtimit të shumë veprave të reja penale, u ashpërsuan dënimet për rreth 40 vepra penale ekzistuese. Po ashtu në pjesën e përgjithshme të K. Penal u rrit masa e gjobës për krimet dhe për kundërvajtjet penale (duke dhjetëfishuar minimumin e saj). E njëjta tendencë ashpërsuese vihet re edhe me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003 (ku u ashpërsuan dënimet për 2 vepra penale dhe u vendos në pjesën e përgjithshme caktimi i njëkohshëm i dënimit me burgim me dënimin me gjobë), me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004 (ku u ashpërsuan dënimet për 9 vepra penale), me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004 (ku u ashpërsuan dënimet për 12 vepra penale, duke shtuar caktimin e njëkohshëm edhe të dënimit me gjobë krahas dënimit me burgim), me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007 (ku u ashpërsuan dënimet për 14 vepra penale), apo me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008 (ku u ashpërsua dënimi për 1 vepër penale).

Me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 krahas shtimit të shumë veprave të reja penale dhe ashpërsimit të dënimit për 3 vepra ekzistuese, u shtuan disa nene në pjesën e përgjithshme të K. Penal të cilat shtojnë dhe qartësojnë aplikimin e dënimeve alternative. Pavarësisht kësaj reforme në drejtim të zbutjes dhe humanizimit të së drejtës penale, në vijim me ligjet nr. 23/2012 u ashpërsuan dënimet për 20 vepra penale, me ligjin nr. 144/2013 u ashpërsuan dënimet për 22 vepra penale dhe u ngrit në pjesën e përgjithshme maksimumi i dënimit me burgim për krimet nga 25 në 35 vite, me ligjin nr. 98/2014 u ashpërsuan dënimet për 4 vepra penale, ndërsa me ndryshimin më të fundit me ligjin nr. 176/2014 u ashpërsua sanksioni për 1 vepër penale dhe u miratua një vepër tjetër e re penale.

Nga paraqitja e mësipërme kronologjike e ndryshimeve të kryera në K. Penal vërehet se në pjesën e tyre më të madhe ato kanë ashpërsuar dënimet ekzistuese. Për të krijuar një ide më konkrete për këtë tendencë mund të paraqesim evoluimin e dënimeve që nga viti 1995 e deri me sot për disa vepra penale konkrete. Kështu vepra penale e “vrasjes me paramendim” (neni 78) dënohej në vitin 1995 me burgim nga 15-25 vite, ndërkohë që sot dënohet nga 20-35 vite burgim ose burgim të përjetshëm; vepra penale e “mbajtjes së armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dënohej me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet, ndërsa aktualisht kur arma mbahet në banesë

²⁴⁹ P.sh vrasja me dashje dënohej me 25 vite burgim, vrasja me paramendim me burgim të përjetshëm ose me vdekje, shfrytëzimi i prostitucionit me 15 vite burgim etj.

dënohet me burgim nga një deri në pesë vite²⁵⁰ (neni 278/3), kur mbahet në ambiente publike nga 7-15 vite burgim (neni 278/5) dhe nëse mbahet në bashkëpunim, apo më shumë se një herë dënohet nga 15-20 vite burgim (neni 278/6); vepra penale e “prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armëve të ftohta” (neni 279) dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet, ndërsa aktualisht mbajtja e tyre në vende publike (279/2) dënohet me burgim nga 3-8 vite burgim; vepra penale “fshehja e të ardhurave” (neni 180) përbënte kundërvajtje penale (vetëm pasi më parë ishte marrë një masë administrative) dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në 2 vite burgim, ndërsa aktualisht jo vetëm që nuk kërkohet më ndëshkimi administrativ, por është bërë krim, duke u dënuar deri në 3 vite burgim sipas paragrafit të parë, nga dy deri në pesë vite sipas paragrafit të dytë dhe nga katër deri në tetë vite sipas paragrafit të tretë.

Ashpërsia e dënimeve në legjislacionin shqiptar konstatohet qartë edhe nga trajtimi krahasimor me legjislacione të tjera evropiane. Krahasimi i parë dhe më i thjeshtë është krahasimi agregat i rezultatit sanksionator të së drejtës penale. Duke qenë se në Evropë dënimi më i ashpër është dënimi me burgim, njësia matëse e ashpërsisë agregate të së drejtës penale të një vendi matet me shkallën e burgosjes. Siç jemi shprehur në kapitullin e dytë, Shqipëria kishte në vitin e shkuar një shkallë prej 203 të burgosurish për 100.000 banorë (Nikolli, 2015c: 527), shkallë kjo më e lartë se të gjitha vendet e rajonit dhe pothuajse sa dyfishi i mesatares së Evropës Perëndimore. Ashpërsia e dënimeve për njësi të veprave penale sipas legjislacionit shqiptar, del akoma më në pah po të mbahet parasysh fakti se nga ana tjetër vendi ynë ka shkallën më të ulët të deklarimit fajtor nga gjykatat (conviction rate) në raport me vendet e tjera evropiane (ESB, 2014: 150). Megjithatë nga vjetarët statistikor të MD vihet re se si pasojë e forcimit të shtetit ligjor dhe shtrirjes së zbatimit të së drejtës penale edhe në drejtim të veprave më të lehta penale, konstatohet një rritje konstante e shkallës së deklarimit fajtor nga gjykatat shqiptare²⁵¹, përsëri vendi ynë është akoma larg mesatares evropiane prej 909 të dënuarish në vit/ 100 000 banorë. Ashtu siç ka ndodhur deri tani, vijimi i së njëjtës politikë të ashpër penale pro burgimit, do të bënte që rritja e zbulueshmërisë dhe e shkallës së deklarimit fajtor të sillte pashmangshmërisht një rritje të mëtijshme të shkallës së burgimit në vendin tonë.

Nga të dhënat e KE vërehet se mesatarja e kohëzgjatjes së një dënimi me burgim në Shqipëri në vitin 2008 ishte më shumë se dyfishi i mesatares evropiane (2011: 85)²⁵². Nga të dhënat më të përditësuara të KE rezulton se Shqipëria ka një aplikim ndjeshëm më të gjerë (në raport me numrin

²⁵⁰ Nëse është bombë, minë ose lëndë plasëse edhe pse mbahet në banesë, dënohet sipas paragrafit të katërt me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

²⁵¹ Në vitin 2007 nga gjykatat e shkallës së parë janë dënuar 5678 persona sipas K. Penal Civil, ndërkohë që në vitin 2013 janë dënuar 8578 persona, pra një rritje prej 51%, ndërkohë që në vitin 2014 janë dënuar 13618 persona (Ministria e Drejtësisë, 2015:49), apo 471 të dënuar për 100.000 banorë.

²⁵² Sipas këtij buletini në vitin 2008 Shqipëria kishte një kohëzgjatje mesatare të burgimit prej 18.4 muajsh, ndërkohë që mesatarja evropiane është 8.4 muaj.

e popullsisë) të dënimeve të rënda 5-10 vite, 10-20 vite, mbi 20 vite dhe burgimit të përjetshëm (2014: 110)²⁵³. Këto të dhëna pasqyrojnë qartë ashpërsinë e politikës penale të ndjekur në vendin tonë, në raport me vendet demokratike evropiane.

Mënyra e dytë e krahasimit të ashpërsisë së sanksioneve është krahasimi i çdo veprë penale në mënyrë të veçantë me sanksionet që legjislacione të tjera evropiane parashikojnë. Për të krijuar një ide të përgjithshme, po paraqesim në tabelën më poshtë mazhet e dënimeve që parashikojnë disa legjislacione penale evropiane, për një kategori veprash penale më të zakonshme.

Tabela nr. 1. Krahasimi i marzheve të dënimit për disa vepra penale.

Neni	Shqipëria	Mali i Zi	Kosova	Italia	Gjermania	Spanja
Neni 76	10-20 vite	5-15 vite	5-25 vite	21-24 vite	5-15 vite	10-15 vite
78/2 79, 79/a	20-35 vite, përjetë 20-35 vite, përjetë	10-30 10-30	10-25 vite	24-30 ose i Përjetshëm	I Përjetshëm (15 vite)	15-20 vite
88	3-10 vite	6m-5 vite	6m-5 vite	3-7 vite	6m-5vite 1-10 vite	2-5 vite
290/3 290/4	2-10 5-20	1-8 2-12	6m-5 vite 1-8 vite	6m-5 vite +1/3-15 vite	Burgim deri në 5 vite.	Gjobë ose burgim nga 2-5 vite
278/3,5	1-5 7-15	6m-5 vite	Gjobë deri në 7500€ ose burgim deri në 5 vite	Burgim deri 1 vit.	3m-5 vite 6m-10 vite	1-3 vite
291	0-3 vite	-	Gjobë ose burgim deri në 3 vite	-	Gjobë ose burgim deri në 1 vit	Gjobë ose burgim nga 3m-6m

²⁵³ Sipas këtij buletini, në vitin 2013 Shqipëria kishte një normë dy herë më të lartë se Italia dhe Gjermania, 7 herë më të lartë se Franca dhe 12 herë më të lartë se Zvicra në caktimin e burgimit të përjetshëm (i cili gjithsesi siç kemi argumentuar në kapitullin e dytë ka një natyrë shumë të ashpër në vendin tonë). Hendeuku është akoma më i madh për dënimet mbi 20 vite burgim, ku Shqipëria ka një normë 3 herë më të lartë se Italia dhe Franca dhe 6 herë më të lartë se Sllovenia (ndërkohë që Gjermania dhe Zvicra nuk kanë asnjë rast me dënime të tilla). Shqipëria ka një normë më të lartë se këto vende edhe për dënimet me burgim nga 10-20 vite burgim. Kështu vendi ynë e aplikon këtë dënim rreth 40% më shumë se Franca dhe Italia, 2.6 herë më të lartë se Sllovenia, 6 herë më të lartë se Zvicra dhe 15 herë më të lartë se Gjermania.

134/1,2,3	3 m- 3 vite 6m-5 vite 4-10 vite	Gjobë ose burgim deri 3 vite	Gjobë ose burgim deri në 3 vite 3-7 vite	6m-3 vite 1-6 vite	Gjobë ose burgim deri në 5 vite. 3m-10 vite	6-18m 1-3 vite
139	5-10 vite	1-8 vite 2-12 vite	3-10 vite	3-10 vite	1-10 vite	2-5 vite
140	10-20 vite	2-12 vite 3-15 vite	5-12 vite 7-12 vite	4 vite e 6 m -20 vite	3-10 vite 5-10 vite	3.5-5 vite

Burimi: Kodet respektive penale të këtyre vendeve.

Siç vërehet nga kjo tabelë, në pjesën më të madhe të rasteve, legjislacioni shqiptar parashikon dënime më të rënda se legjislacionet e tjera të shqyrtuara. Nga ana tjetër, duhet mbajtur në konsideratë se krahasimi i thjeshtë i masave të dënimeve në letër që parashikojnë dispozitat e pjesës së posaçme të K. Penal shqiptar në raport me ato të vendeve të tjera evropiane nuk arrin ta thotë gjithë të vërtetën, për diferencën reale të dënimeve që caktojnë gjykatat respektive. Kjo për faktin se nga njëra anë këto sisteme ligjore kanë një korpus ligjor më liberal në pjesën e përgjithshme të kodeve respektive në drejtim të uljes së dënimit nën minimum, caktimit të dënimit me gjobë, apo të aplikimit të dënimeve alternative dhe nga ana tjetër sistemet e tyre gjyqësore gëzojnë një pavarësi më të konsoliduar dhe për pasojë ndikohen më pak nga ndonjë presion apo frymë politike apo publike për dënime të ashpra shembullore. Fakti se të njëjtat vepra penale dënohen më rëndë sipas legjislacionit tonë penal, se nga legjislacionet penale të vendeve të ndryshme evropiane provohet edhe nga vendimet e njohjes së vendimeve penale të dhëna nga gjykatat e huaja. Nga praktika gjyqësore vendase (kryesisht e shkallës së parë) në jo pak raste konstatohet se masat e dënimit të caktuara nga gjykatat e huaja janë poshtë minimumit të dënimit që parashikon dispozita homologe e K. Penal shqiptar²⁵⁴.

5.3. Dënimet e ashpra penale si një strategji për frenimin e krimit

Parandalimi i krimeve të ardhshme ka qenë një nga synimet më të hershme të dënimit penal dhe vazhdon të jetë përsëri pjesë e shumë kodeve penale moderne në dispozitat që deklarojnë qëllimet e dënimit penal. Frenimi, apo përmbajtja (deterrence) në kryerjen e krimeve të ardhshme bazohet në logjikën se njerëzit me vetëdije, përpiqen për të shmangur dhimbjen që vjen nga dënimi penal për veprën që kanë ndërmend të kryejnë. Aplikimi i kësaj perspektive në shoqërinë si e tërë do të

²⁵⁴ P.sh. vetëm autori i këtij punimi është ndeshur me një situatë të tillë gjatë njohjes së vendimeve të gjykatave italiane, kosovare apo britanike për vepra të ndryshme si “shfrytëzimi i prostitucionit me të mitura”, “vrasja me paramendim”, apo “shitja e narkotikëve”.

sillte përfundimin se niveli i kriminalitetit do të ishte më i ulët në ato vende ku kryerja e krimit dënohet më rëndë dhe më i lartë në ato vende ku kryerja e krimeve sjell kënaqësi më të lartë. Nëse teoria e frenimit të krimit ka të drejtë, atëherë duhet që sistemi penal të maksimizojë dhimbjen ndaj kryerësve të veprave penale, duke ashpërsuar dënimet dhe duke ndikuar që burgjet të shkaktojnë nivelin më të lartë të dhimbjes. Sipas kësaj logjike, përmes shkaktimit të dhimbjes, të pandehurit frikësohen të kryejnë më në të ardhmen vepra të reja (parandalimi i posaçëm) dhe të tjerët të cilët kanë pasur ndërmend të kryejnë në të ardhmen, do të përmbahen nga frika e dënimit (parandalimi i përgjithshëm).

Sipas Nagin, teoria e frenimit të kriminalitetit ngjan me mësimin që nëse prekim stufën e nxehtë do të digjemi (2012: 68). Pra nëse kryerja e krimeve do të ishte si prekja e një stufe të nxehtë, atëherë të gjithë personat e shëndetshëm mendërisht nuk do të kryenin më krime. Mirëpo në realitet, frenimi i krimit nuk funksionon njësoj si frenimi nga prekja e stufës së nxehtë, pasi dënimi penal nuk është i menjëhershëm, i sigurtë dhe jo në çdo rast shumë i dhimbshëm (Miethe & Lu, 2005: 204). Po ashtu frenimi për të kryer krime logjikisht ka një farë gjase të jetë efektiv vetëm në veprat penale të kryera me paramendim dhe gjakftohtësi, në bazë të një plani paraprak si dhe për personat të cilët nuk kanë një prije habituale për të kryer atë lloj krimi (Chambliss, 1967: 704), ndërsa për veprat e tjera ai nuk ka gjasë të funksionojë.

Teoria e frenimit paraqet një mori të metash të cilat vështirësojnë implementimin e saj në praktikë. Së pari dënimi i ashpër penal ka një efekt të ulët frenues (zero ose të papërfillshëm) për shkak të kompleksitetit të funksionimit të tij në praktikë. Në mënyrë që një dënim i ashpër të shërbejë për frenimin e disa krimeve të tjera të ngjashme në të ardhmen duhet që të gjithë personat që kanë ndërmend të kryejnë atë lloj veprë të marrin dijeni për kryerjen e saj dhe për dënimin e ashpër që ka caktuar gjykata. Në kushtet aktuale qytetarët marrin dijeni mjaftueshëm për krimet e ndodhura, por në vlerësimin tonë ata kanë dijeni minimale për dënimin që kryerësi i saj merr. Qytetarët marrin pjesë përditë e më pak në seancat gjyqësore që zhvillohen në shkallë të parë, për të cilat nuk kanë interes të drejtpërdrejtë dhe kjo pjesëmarrje shkon drejt zeros në shkallët më të larta (ku vendimi merr formë të prerë). Nga ana tjetër media vendase është e orientuar drejt lajmeve sensacionale, të cilat tërheqin vëmendje momentale të audiencës, si: vrasjet, korrupsioni, skandalet e personave publikë etj., por nuk fokusohet tek lajmet e zakonshme të përditshme, pjesë e të cilave është edhe dënimi i personave që kryejnë vepra penale.

Shumica e mediave audiovizive dhe të shkruara i kushtojnë me ditë dhe javë vëmendje një akti më të rrallë apo të parëndësishëm për të drejtën penale (si p.sh. një pafajësi për një vepër të lehtë), ndërkohë që është vështirë të ndeshet ndonjë sekuencë e shkurtër televizive, apo ndonjë rresht gazete për dënimet që caktojnë çdo ditë gjykatat ndaj shumë të pandehurve. Nga kjo perspektivë, megjithëse Shqipëria ka prej vitesh një shkallë shumë të lartë të burgosurish, ajo nuk ngjan aspak

me panoramën për një situatë masive pandëshkueshmërie që paraqet media në publik. Në këtë aspekt, duke qenë se media është një ndikuese dhe strukturuese shumë e fuqishme e opinionit publik, mënyra se si ajo e transmeton të vërtetën rreth dënimit, ka shumë më shumë impakt në parandalimin e përgjithshëm sesa dënimet që japin gjykatat.

Një pengesë tjetër e transmetimit të frikës së dënimit tek personat e lëkundur, është procedura e komplikuar e hetimit dhe gjykimit dhe veçanërisht zgjatja e saj e madhe në mjaft raste (sidomos në rastet e krimeve të rënda). Duke qenë se procedurat gjyqësore zgjaten dhe komplikohen, nga njerëzit e zakonshëm shpeshherë kjo situatë përkthehet në rastin më të mirë në humbjen e lidhjes kronologjike mes lajmit të kryerjes së një veprë të caktuar penale dhe një dënimi të përshtatshëm të caktuar nga gjykata për të dhe në rastin më të keq si një mesazh se sistemi i drejtësisë nuk funksionon dhe se keqbërësit arrijnë t'ia hedhin gjithnjë drejtësisë.

Së dyti, dënimi penal ka një efekt të ulët frenues, sepse jo në çdo rast ai arrin t'i caktohet të gjithë personave që kryejnë vepra penale dhe për më tepër që perceptimi popullor mbi këtë raport është akoma më pesimist se realiteti (Lappi-Seppälä, 2008: 51). Në disa raste kryerësit e veprave penale nuk arrihen të zbulohen për shkak të profesionalizmit të tyre dhe eliminimit të provave²⁵⁵ dhe në disa të tjera sepse shteti nuk ka kapacitete njerëzore (policore, të prokurorisë, gjyqësore dhe të ekzekutimit të dënimeve), financiare dhe teknike për të trajtuar të gjitha shkeljet e ligjit penal. Qytetarët shohin dhe dëgjojnë çdo ditë për veprime të paligjshme, por dëgjojnë fare pak për dënime të përshtatshme dhe frikësuese për ta (Lappi-Seppälä, 2008: 20).

Së treti, dënimi penal ka një efekt të ulët frenues, sepse ai nuk mundet asnjëherë të jetë mjaftueshëm i ashpër sa të thyejë çdo lloj shtyse, apo prirjeje kriminale. Megjithatë një vend mund të ketë dënime të ashpra penale (si p.sh. SHBA, Kina apo Arabia Saudite), përsëri ato nuk kanë arritur ta zhdukin tërësisht kriminalitetin (madje SHBA nuk ka arritur as ta ulë përmes mekanizmit frikësues të dënimit). Për më tepër që me rritjen e standardeve të të drejtave të njeriut, shumica e vendeve demokratike, jo vetëm që ka hequr dorë nga ekzekutimi i dënimit me vdekje, por edhe dënimin me burgim përpiqet ta përdorë në funksion të riedukimit të të dënuarve. Në këtë mënyrë dënimet e ashpra penale moderne, nuk janë më për çdo keqbërës, një pasojë e cila duhet të shmanget me çdo kusht. Kjo vlen sidomos për personat me një status të ulët shoqëror dhe me një histori të mëparshme burgimi.

Së katërti teoria e frenimit ka një të metë të madhe në mosvlerësimin si duhet të shkaqeve të kriminalitetit dhe të psikologjisë së keqbërësit. Të dënosh ashpër fajtorët në mënyrë që të tjerët të mos kryejnë të njëjtën vepër, nënkupton se njerëzit kryejnë çdo lloj veprë antisociale që nuk ndëshkohet, mirëpo kjo nuk është e vërtetë. Në të vërtetë njerëzit kanë motive dhe shtysa të tjera

²⁵⁵ Si p.sh. në rastet e vrasjeve me pagesë.

për kryerjen e veprave penale dhe pengesa më të forta se dënimi për të mos i kryer ato. Teoria bashkohore kriminologjike sugjeron me forcë se bindja ndaj ligjit shpjegohet më së shumti nga motivet e brendshme sesa nga frika (Bottoms, 2006b: 30). Shumica e njerëzve kufizohen në kryerjen e veprave të paligjshme jo për shkak të frikës së ndëshkimit, por për shkak se ajo sjellje konsiderohet së brendshmi si moralisht e papranueshme, apo për shkak të zakoneve që njerëzit kanë. Një ilustrim i këtij mekanizmi frenues është p.sh. se përse në vendin tonë ka një numër të lartë vrasjesh për gjakmarrje apo hakmarrje, (megjithëse ligji parashikon një dënim nga 20-35 vite burgim), ndërkohë që nuk ka asnjë rast të torturës (për të cilën ligji parashikon dënim nga 4-10 vite burgim). Me të njëjtën logjikë mund të deduktojmë se është i paarsyeshëm dhe krejtësisht joefektiv për synimin frenues, dënimi i ashpër i krimit në familje. Njeriu i shëndetshëm mendërisht ka pengesa të tjera shumë më të forta sesa frika e dënimit, për ta frenuar atë për të vrarë fëmijët e tij, apo e kundërta që një fëmijë të mos vrasë prindërit e tij.

Në vitet e fundit janë zhvilluar studime të shumta kriminologjike mbi matjen e efektit frenues të dënimit penal të cilat nuk kanë arritur të provojnë ndikimin pozitiv të politikave të dënimeve të ashpra në uljen e kriminalitetit (Doob & Webster, 2009). Nga një studim i kryer nga Wicharaya (1995: 161) mbi ndikimin e reformave ashpërsuese të dënimeve në 45 shtete të SHBA për një periudhë 28 vjeçare²⁵⁶, është konkluduar se nuk arrihet të provohet se rritja e ashpërsisë së dënimeve është një masë efikase antikrim. Madje sipas këtij studimi, mungesa e efektit frenues është konsistent në të gjitha veprat e analizuara prej tij. Rezultate të njëjta për një mungesë efekti frenues të reformave ashpërsuese të dënimeve në Australi (të quajtura minimumet e detyrueshme) janë konstatuar edhe nga Morgan në studimin e tij mbi këtë çështje (2000: 172). Më tej Kovanondzic në studimin e tij të doktoraturës²⁵⁷ nuk ka gjetur ndonjë efekt frenues të shtimit të masës së dënimit tek kriminelët habitualë (1999). Sipas tij të burgosësh për një kohë më të gjatë kriminelë habitualë nuk provohet se ka ndonjë efekt afatshkurtër, apo afatgjatë në uljen e kriminalitetit (1999: viii). Studime të tjera kanë konfirmuar mungesën e provave të dënimit të ashpër në frenimin marginal²⁵⁸, ndërkohë që kanë gjetur prova bindëse për një raport të zhdrejtë mes rritjes së sigurisë së dënimit dhe frenimit marginal (Von Hirsch et al, 2009: 60).

Në një përmbledhje analitike më reçente të studimeve mbi efektin frenues të dënimit, është konkluduar se provat nuk mbështesin ndonjë përfitim domethënës të sigurisë publike nga praktika e ngritjes dhe ashpërsimit të dënimeve (Wright, 2010). Madje sipas tij, efekti frenues i dënimeve

²⁵⁶ Wichara ka analizuar vrasjet, përdhunimet, grabitjet dhe plagosjen e rëndë me dashje.

²⁵⁷ Ku analizo i burgosjen e kriminelëve habitualë në të gjitha rajonet e shtetit të Floridës për periudhën nga 1981-1997.

²⁵⁸ Padyshim që dënimi penal ka një efekt frenues tek shumica e njerëzve, por në këtë kapitull nuk po diskutohet domosdoshmëria e dënimit, por ashpërsia e tij. Frenimi marginal është masa e frenimit shtesë që arrihet tek të lëkundurit nëse rritet masa e dënimit apo siguria e dënimit.

të gjata nuk do të ulej nëse dënimet do të uleshin poshtë nivelit aktual (: 10). Nga ana tjetër autori i këtij studimi gjen prova bindëse se rritja e sigurisë së dënimit, përmes përmirësimit të gjasave të zbulimit të autorëve të veprave penale ka një efekt më të madh frenues. Nëse politikat penale do të braktisnin mbështetjen për dënime të ashpra dhe burgosëse, padyshim që do të mbeteshin më shumë burime në dispozicion për të ndjekur iniciativa të tjera shumë më efektive parandaluese dhe trajtuese (Waller, 2006: 79). Eksperienca amerikane e sistemit të ndëshkimeve të ashpra²⁵⁹ është shembulli më i mirë i mungesës së efektshmërisë së dënimeve të rënda në uljen e kriminalitetit. Pikërisht kjo pamundësi praktike për ta bërë ndëshkimin e ashpër penal eficient, ka bërë që shumë vende demokratike të braktisin prirjen ndaj dënimeve të ashpra dhe t'i orientojnë politikat penale drejt mekanizmave të tjerë më efektiv. Duke kuptuar efikasitetin më të lartë frenues të mekanizmave të tjerë formalë dhe joformalë²⁶⁰ në kryerjen e krimeve, këto vende kanë arritur të kenë një sukses më të lartë në uljen dhe kontrollin e kriminalitetit²⁶¹. P.sh. përfitimet e shumta që sjellin zhvillimet teknologjike²⁶² duhet të shtrihen me shpejtësi dhe pa hezitim në drejtim të rritjes së sigurisë së zbulimit të veprave penale. Implementimi i përshtatshëm i risive teknologjike për rritjen e zbulueshmërisë (siç do të analizohet më poshtë për disa vepra penale) ka një efekt të menjëhershëm në uljen e kriminalitetit, efekt të cilin nuk mund ta japë asnjë dënim sado i rëndë të jetë.

5.4. Analizimi i ndikimit të dënimeve të ashpra në uljen e kriminalitetit në Shqipëri

Megjithëse mes kriminologëve nuk ka më dyshim për mungesën e efektit frenues shtesë të dënimeve më të rënda, duhet pranuar nga ana tjetër se akoma kjo përbën një teori mjaft tërheqëse për masat e gjera, për shkak të qenies së saj lehtësisht e asimilueshme nga pikëpamja intuitive. Për këtë shkak kjo teori vazhdon akoma të gjejë mbështetje politike të gjerë (Bottoms, 2006a: 14). Për shkak të frikës së reagimit të votuesve, është vështirë që në vendin tonë të gjesh politikanë të cilët deklarojnë se ata mbështesin zbutjen e dënimeve, madje shpesh herë në opinionin publik shpaloset

²⁵⁹ SHBA janë vendi i vetëm demokratik perëndimor i cili vazhdon të zbatojë dënimin me vdekje dhe në të njëjtën kohë ka shkallën më të lartë botërore të aplikimit të burgimit, ndërkohë që niveli i kriminalitetit është shumë më i lartë se në mjaft vende evropiane me një politikë penale të orientuar drejt humanizimit dhe rehabilitimit të të dënuarve.

²⁶⁰ Nga ata formalë duhen nënvizuar investimi për të rritur sigurinë dhe shpejtësinë e zbulimit dhe ndëshkimit të çdo shkeljeje të ligjit jashtë dhe brenda së drejtës penale, ndërsa në ata informalë duhen përmendur mekanizmat e shumtë të ndërhyrjes sociale, që nga familja deri tek masat për ngritjen arsimore dhe kulturore, uljen e papunësisë, mbrojtjen sociale apo kujdesin shëndetësor.

²⁶¹ Shumë vende të Evropës Perëndimore ku më të spikaturat janë vendet Skandinave, Gjermania, Holanda, Zvicra etj, por dhe vende të rajonit, si: Sllovenia, Maqedonia dhe Kosova kanë arritur që të kenë norma shumë të ulëta të krimeve të rënda, megjithëse kanë dënime shumë më të buta se legjislacioni shqiptar (ESB, 2014: 270).

²⁶² Teknologji të tilla janë që nga instalimi i një sistemi monitorimi kamerash publike, prodhimi i dokumentave të identitetit të sigurta me të dhëna biometrike, kontrolli i kufijve, kontrolli i transfertave bankare, digjitalizimi i pronave, monitorimi elektronik i personave të rrezikshëm (të liruar me kusht apo me dënim me burgim të pezulluar), kontrolli më i thjeshtuar i pasurive dhe i të ardhurave vjetore etj.

një konkurrencë e dukshme mes atyre që kërkojnë dënime më të rënda sesa kundërshtari politik. Thirrjet publike të politikanëve më të lartë vendas për masa më të ashpra penale ndaj kryerësve të veprave të caktuara penale janë një fenomen normal i debatit mbi krimin dhe mekanizmat e frenimit të tij (Halimi, 2013; Rama, 2014; Naço, 2015). Këto qëndrime janë shprehur jo vetëm në rrafshin legjislativ, në drejtim të ashpërsimit të dënimeve në K. Penal, por edhe si kritika ndaj sistemit gjyqësor për “dënimet tepër të buta” që ato caktojnë sipas tyre.

Në këtë seksion do të përpiqemi që përmes metodave statistikore dhe atyre cilësore të analizojmë efektin faktik të dënimeve të ashpra penale në uljen e nivelit të kriminalitetit. Nëse efekti i ashpërsimit të dënimeve analizohet në raport me totalin e krimeve të parandaluara, duhet t’i referohemi numrit tërësor të veprave penale të raportuara nga policia dhe personave të dënuar nga gjykatat. Sipas ESCCJS (ICPC, 2014: 32) nga viti 2007-2011, në Shqipëri ka pasur një dyfishim të numrit të veprave penale të raportuara në polici, ndërkohë që në 20 vende të tjera të Evropës ky raportim ka pasur ulje. Megjithëse më të lehtë, por një trend të ngjashëm rritës ka pasur edhe numri i personave të deklaruar fajtorë nga gjykatat e shkallës së parë. Kështu nga përpunimi i të dhënave të publikuara nga KE (2003; 2006) dhe vjetarëve statistikorë të MD konstatohet se nga viti 2000-2011 ka pasur pothuajse rritje prej 2.5 herë të numrit të të dënuarve. Nga këto shifra vërehet se ashpërsimet e dënimeve, jo vetëm që nuk kanë sjellë uljen e nivelit total të kriminalitetit, por vetëm sa kanë kontribuar në rritjen e personave të dënuar dhe të shkallës së burgosjes së shtetasve tanë. Duke qenë se analizimi i efektit frenues të dënimeve më të rënda në raport me shumën totale të veprave të referuara dhe të personave të dënuar ka një të metë metodologjike²⁶³, pasi nuk arrin të izolojë variablin e shtimit të veprave të reja penale në K. Penal, më poshtë do të analizojmë efektin frenues të dënimeve të rënda për disa kategori specifike veprash penale.

5.4.1. Efekti frenues i dënimeve të ashpra tek vrasjet me dashje

Veprat penale të vrasjeve janë një nga veprat më të rënda penale pasi jo vetëm që drejtohen kundër së drejtës së jetës së viktimës, por edhe më gjerë sjellin një klimë të lartë pasigurie dhe frike në publik. Për një njeri të zakonshëm, vrasja është krimi më i rëndë dhe vrasësi është personi më i rrezikshëm për shoqërinë. Duke i shtuar këtyre arsyeve edhe përhapjen e tyre në vendin tonë,

²⁶³ Duke qenë se rritja e numrit të veprave të regjistruara nga policia, apo e numrit të personave të dënuar nga gjykatat mund të ketë ardhur si rezultat i shtimit të numrit të veprave penale dhe jo si tregues i dështimit të efektit frenues të dënimeve të rënda.

vrasjet me dashje²⁶⁴ meritojnë vëmendjen më të madhe ndër të gjitha krimet e rënda²⁶⁵. Megjithëse gjatë regjimit komunist veprat penale të vrasjeve pësuan një ulje të konsiderueshme, pas viteve '90 këto vepra penale morën një përhapje të madhe.

Kështu, ndonëse në vitin 2013 veprat penale kundër jetës të kryera me dashje zinin vetëm 2.7% të totalit të procedimeve penale (Prokuroria, 2014: 46), për shkak të ashpërsisë së sanksioneve penale që caktohen ndaj autorëve të këtyre veprave, të burgosurit për këto kategori veprash në maj 2015 zinin 42% të totalit të burgosurve (DPB, 2015). Nga të dhënat e publikuara në ESCCJS (ICPC, 2014: 34) vërehet se në vitet 2007-2011 vendi ynë ka një përhapje të vrasjeve me dashje mbi dy herë më të lartë se mesatarja e vendeve evropiane²⁶⁶, rreth 4 herë më lartë se Anglia, Spanja, Sllovenia, Sllovakia, etj., apo rreth 10 herë më të lartë se Austria, apo Rusia. Nga ana tjetër, sipas buletinit të OKB mbi vrasjet (UNODC, 2013a: 131), provohet se vendet me një zbulueshmëri të madhe të autorëve të vrasjes, kanë një shkallë të ulët vrasjesh²⁶⁷, ndërkohë që ato me një shkallë të lartë, kanë një zbulueshmëri dhe shpallje fajtor prej vetëm 24%. Kjo provon qartazi se shkalla e zbulueshmërisë ka një efekt të drejtpërdrejtë parandalues në kryerjen e kësaj vepre, ndërkohë që dënimet më të ulëta që përgjithësisht parashikon sistemi evropian nuk promovojnë rritjen e numrit të vrasjeve.

Ashtu siç është shprehur edhe institucioni i avokatit të popullit (2013), përhapja ndjeshëm më e madhe e këtyre veprave në vendin tonë, është e lidhur ngushtë me shtratin kulturor dhe temperamentin e shqiptarëve si dhe me shkallën e ulët të besimit që njerëzit kanë tek shteti dhe organet e tij. Mirëpo, ashtu si shumë aktorë të tjerë të përfshirë në dhënien e opinioneve rreth kriminalitetit, edhe ky institucion rendit ndër faktorët (e fundit) të këtij niveli të lartë edhe dënimet sipas tij të buta të caktuara nga gjykatat ndaj autorëve. Megjithëse më lart kemi provuar se dënimet ndaj vrasësve me dashje në vendin tonë kanë qenë ndër më të lartat në Evropë, më poshtë do të analizojmë statistikisht nëse ashpërsimi i dënimeve ka pasur ndonjë efekt frenues në këto vepra. Për të analizuar tendencën e vrasjeve me dashje të kryera në vendin tonë po paraqesim kryerjen e tyre në grafikun më poshtë.

²⁶⁴ Tek vrasjet me dashje përfshijmë të gjitha vrasjet që kryhen me dashje, duke përfshirë nenin 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, dhe 79/c. Kemi zgjedhur termin vrasje me dashje jo vetëm për shkaqe metodologjike krahasimore me vendet e tjera, por dhe për faktin se termi krime kundër jetës me dashje sipas K. Penal shqiptar përfshin dhe shumë vepra të tjera penale si kanosjet, vrasja e foshnjës, sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje etj.

²⁶⁵ K. Penal parashikon edhe vepra më të rënda penale se vrasjet, si p.sh. krimet kundër njerëzimit apo aktet terroriste, mirëpo për fat të mirë ato nuk janë konsumuar në vendin tonë.

²⁶⁶ Shqipëria ka pasur në këto vite në total (të konsumuara dhe të mbetura në tentativë) një shkallë prej rreth 11 vrasjesh për 100 000 banorë, ndërkohë që mesatarja evropiane ka qenë rreth 5 vrasje për 100 000 banorë.

²⁶⁷ Në Evropë ka një zbulueshmëri mesatare prej 85 % të vrasjeve (: 92), ndërkohë që në vendet me një shkallë të lartë vrasjesh (si vendet e Amerikës Latine) kjo zbulueshmëri zbret deri në 24% (: 94).

Grafiku nr. 3. Dinamika e vrasjeve me dashje të konsumuara në vitet 1991-2014.



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme.

Treguesi i parë i mungesës së efektit frenues të dënimeve të ashpra, në përhapjen e vrasjeve është niveli i lartë (rreth 10 herë më i lartë se mesatarja) i kryerjes së tyre në vitin 1997 dhe rënia e ndjeshme e tyre me rivendosjen e ligjit dhe funksionimit të institucioneve ligjzbatuese. Gjyshtëfishimi i vrasjeve në vitin 1997 (në raport me vitin 1996) nuk ka ndodhur se këtë vit janë zbutur dënimet për këto vepra, por sepse siguria e zbulimit të tyre dhe në përgjithësi situata e rendit publik ka qenë në nivelet më të ulëta të mundshme. Sanksionet penale janë ashpërsuar në vijimësi për vrasjet me paramendim dhe ato të kryera për shkak të cilësive të veçanta të viktimës që në vitin 2001²⁶⁸, por ulja e lehtë e kryerjes së këtij krimi nuk shpreh ndikimin e këtij faktori, por të trendit të mëparshëm të forcimit të institucioneve. Siç vërehet nga këto të dhëna, numri i vrasjeve (të konsumuara) ka pasur një rritje galopante në vitin 1997 dhe më pas deri në vitin 2005 ka ardhur duke u ulur. Pas këtij viti kryerja e kësaj vepre ka ruajtur një përhapje relativisht konstante, duke variuar në nivelin nga 82-131 vrasje. Asnjë efekt frenues nuk provohet as nga eksperimenti legjislativ i shtimit në vitin 2008 të dënimit me gjobë si një dënim i njëkohshëm me burgimin në nenin 78 §2 të K. Penal.

Të dhënat e mësipërme paraqesin vrasjet në kuptimin mjekësor dhe viktimologjik, por nuk paraqesin tërësisht numrin e vrasjeve në kuptimin juridik, pasi nuk përfshijnë veprat e mbetura në tentativë. Nga të dhënat e edicioneve të ESCCJS për vrasjet në vendin tonë në vitet 2001-2011 (ICPC, 2006; 2010; 2014) vërehet se vrasjet e mbetura në tentativë janë 2-3 herë më shumë se vrasjet e konsumuara. Sipas këtyre buletinëve, numri total i vrasjeve të regjistruara nga policia e shtetit paraqitet kështu grafikisht.

²⁶⁸ Duke rritur minimumin e dënimit në 20 vite burgim. Po ashtu rritja e minimumit të afatit për t'u kualifikuar për lirim para kohe me kusht, nga $\frac{1}{2}$ në $\frac{3}{4}$ e dënimit të caktuar është një ashpërsim real i politikës penale ndëshkimore, pasi ndikon drejtpërdrejtë në kohën efektive që një autor i këtyre veprave do të vuajë në burg.

Grafiku nr. 4. Shkalla e vrasjeve me dashje në total për 100.000 banorë për vitet 2001-2011.



Burimi: ESCCJS 2006, 2010 dhe 2014.

Edhe nga këto të dhëna nuk provohet asnjë efekt frenues i ashpërsimit të dënimeve tek vrasjet me dashje për vitet për të cilat këta buletinë sjellin informacion, duke ndjekur të njëjtën tendencë kryerjeje njësoj si vrasjet e konsumuara që kanë sjellë pasojë vdekjen. Duke qenë se popullsia e vendit tonë ka ardhur duke u ulur si pasojë e emigracionit masiv, shkalla e vrasjeve për 100 000 banorë rezidentë, paraqet një nivel më të saktë të përhapjes së këtyre veprave. Pra edhe sikur asnjë faktor frenues të mos kishte ndikuar në uljen e këtyre veprave, ato duhet të kishin pësuar ulje si pasojë e uljes së numrit të popullsisë rezidente të vendit tonë (INSTAT, 2015).


Pandikueshmëria e ashpërsimit të dënimeve tek vrasjet me dashje provohet qartë edhe nga të dhënat e publikuara nga MB në buletinët mujorë të saj për vitin 2014. Kështu megjithëse në një publikim të Kryeministrit Rama në rrjetin social Facebook (2015) deklarohet se në vitin 2014 në vend janë kryer vetëm 98 vrasje (me pasojë vdekjen), nga shumatorja e vrasjeve të deklaruar në faqen zyrtare të MB në 12 buletinët mujorë të vitit 2014, kjo shifër është 118 të vdekur (apo 44% më i lartë se në vitin 2009) dhe numri total i vrasjeve të regjistruara (duke përfshirë edhe ato të mbetura në tentativë) është 300, apo 10,5 vrasje për 100.000 banorë. Në vend që ashpërsimet drastike të sanksioneve të bëra me ligjin nr. 144/2013²⁶⁹ të ulnin ndjeshëm numrin e vrasjeve në vend siç ishte justifikuar nga ligjvënësit gjatë miratimit të këtyre ndryshimeve, ato nuk dhanë asnjë efekt zbritës, madje numri i viktimave të këtyre veprave pësoi një rritje të lehtë.

Shifrat e mësipërme paraqesin referimet e bëra nga policia për vrasjet, prandaj me qëllim analizimin e ecures së ndëshkimit të fajtorëve për këto vepra, më poshtë po paraqesim tendencën e numrit të të dënuarve për tre veprat kryesore të vrasjeve dhe për totalin e vrasjeve me dashje²⁷⁰.

²⁶⁹ Me këtë ligj dënimi maksimal me burgim u rrit nga 25 në 35 vite burgim dhe u ndalua lirimi para kohe me kusht për kryerësit e 4 figurave të reja vrasjesh. Këto nene, përkatësisht neni 78/a (vrasja për gjakmarrje), neni 79/a (vrasja e funksionarëve publikë) dhe neni 79/b (vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit), të cilat u miratuan rishtaz në K. Penal, parashikojnë si dënim minimal 30 vite burgim ose burgim të përjetshëm dhe neni 79/c (vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare) parashikon si dënim minimal 20 vite burgim deri në burgim të përjetshëm.

²⁷⁰ Në totalin e vrasjeve me dashje janë përfshirë edhe të dënuarit sipas neneve 77, 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82 dhe 83 të K. Penal.

Grafiku nr. 5. Dinamika e personave të dënuar për vrasje me dashje nga gjykatat e shkallës së parë.



Burimi: Vjetarët statistikorë të MD 2004-2014.

Sic vërehet nga paraqitja grafike, numri i personave të dënuar nga gjykatat e shkallës së parë sipas neneve 76 dhe 78 ka pësuar një rënie të lehtë, ndërkohë që numri i të dënuarve sipas nenit 79 (megjithë luhatjet) ka një tendencë rritëse. Duke mbajtur në konsideratë se kualifikimi gjyqësor i veprës penale të kryer mund të ndryshojë nga ai që bën fillimisht policia apo prokuroria në momentin e regjistrimit të çështjes, krahasimi më i vlefshëm mes vrasjeve të ndodhura dhe personave të dënuar do të ishte vetëm për totalin e këtyre veprave. Në këtë mënyrë nëse krahasojmë të dhënat e grafikut të mësipërm me ato të grafikut nr. 4, vërehet se tendenca e të dënuarve për vrasje nga viti 2004 është ulur më shumë sesa është ulur numri i vrasjeve të regjistruara. Megjithëse duhet pranuar se ky krahasim nuk është tërësisht i saktë²⁷¹, gjithsesi ai është i vlefshëm për të analizuar me një shkallë të ulët gabimi këto dy tendenca. Kështu, nga grafiku nr. 4 vërehet se nga viti 2007 numri i vrasjeve të regjistruara ka qëndruar thuhet konstant për disa vite, madje duke pësuar një rritje të lehtë pas vitit 2009, ndërkohë që tendenca e personave të dënuar nuk ka ndjekur këtë tendencë. Kjo është veçanërisht e dukshme në vitet 2011-2013 ku numri i të dënuarve është ulur, megjithëse numri i vrasjeve është shtuar. Përgjigja e vetme që mund të sugjerohet është se në këto vite është ulur zbulueshmëria dhe deklarimi fajtorë i autorëve të tyre nga gjykatat.


Një argument tjetër i mungesës së efektit frenues të ashpërsimit të dënimeve janë të dhënat e publikuara nga prokuroria e përgjithshme në raportin për gjendjen e kriminalitetit në vend për vitin 2014. Sipas këtij raporti gjatë vitit 2014 është rritur numri i vrasjeve në familje me 15% (Panorama, 2015), megjithëse dënimet për këtë vepër janë ashpërsuar shumë, ndërkohë që ka një rënie prej 30% të vrasjeve me dashje (vrasjes së thjeshtë me dashje, parashikuar nga neni 76 i K. Penal),

²⁷¹ Pasi nga regjistrimi i një vrasjeje nga policia deri në dënimin e autorëve në gjykatën e shkallës së parë mund të kalojë mesatarisht nga 8 muaj deri në 3-4 vite (nëse çështja prishet nga GJL dhe kthehet për rigjykim në shkallë të parë). Për këto arsye mund të pranohet si periudhë e zakonshme diferenca kohore mes regjistrimit të vrasjes dhe dënimit të autorit nga disa muaj (së paku 8 muaj) deri në 2 vite.

vepër e cila ka marzhet më të ulëta në të gjitha vrasjet me dashje dhe niveli i sanksionit penal për të nuk ka ndryshuar që nga viti 1952.

Duke qenë se fatkeqësisht nuk kemi arritur të sigurojmë të dhëna në rang vendi për numrin e vrasjeve të pezulluara për moszbulim autori dhe po ashtu për numrin e vendimeve të pushimit të prokurorisë dhe të pafajësisë së dhëna nga gjykatat për këto vepra, analizën e kësaj hipoteze do ta kryejmë duke përdorur të dhënat lokale të Prokurorisë Shkodër. Nga ana tjetër, megjithëse Shqipëria është një vend i vogël dhe unitar, shtrirja e analizës së efektit frenues të dënimeve të ashpra në nivel lokal, ka një përparësi metodologjike, pasi arrin të izolojë ndikimin e variablave të tjerë si konteksti social-kulturor dhe performanca e strukturave policore dhe e prokurorisë. Po ashtu nisur nga mekanizmi (i pretenduar) i funksionimit të frenimit në kryerjen e krimeve, individët e lëkundur kanë mundësi më të mëdha për të ngritur një perceptim sa më të saktë mbi nivelin e zbulueshmërisë dhe ndëshkueshmërisë së një sjelljeje të caktuar penale, duke u mbështetur mbi ngjarje kriminale të ndodhura më parë në nivel lokal. Në këtë mënyrë këta të lëkundur do t'i përshtatin sjelljet e tyre sipas kalkulimeve që bëjnë në nivel lokal, më shumë sesa ato në nivel kombëtar. Dinamika e çështjeve të regjistruara në Prokurinë Shkodër për vrasjet me dashje paraqitet në grafikun më poshtë.

Grafiku nr. 6. Dinamika e çështjeve të vrasjeve me dashje në Shkodër.



Burimi: Prokuroria pranë GjRREGJ Shkodër.

Siç vërehet nga këto të dhëna, mungesa e efektit frenues të ashpërsimeve të dënimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013 është i dukshëm. Megjithëse në vitin 2013 ka një rënie të menjëhershme të totalit të vrasjeve me dashje, kjo ardhur ekskluzivisht si rezultat i uljes së vrasjeve të thjeshta me dashje (neni 76), i cili nuk ka pësuar asnjë ndryshim në sanksion. Në kontrast me pritshmëritë e ashpërsimit të dënimeve për këto vepra, është rritur numri i vrasjeve me paramendim dhe vrasjes në rrethana cilësuese (nga të cilat dy vrasje për gjakmarrje dhe një vrasje e një punonjësi policie).

Shpjegimin më të mirë për këtë tendencë të ndryshme të kryerjes së nenit 76, në raport me nenet 78 dhe 79 e bën paraqitja e numrit të çështjeve të pezulluara dhe të pushuara nga prokuroria dhe pafajësitë e dhëna nga gjykata.

Kështu nga grafiku i mësipërm vërehet se në territorin që mbulon Prokuroria Shkodër, nga viti 2005-2014 janë regjistruar 295 vrasje me dashje (nenet 76, 78 dhe 79), ndërkohë që nga të dhënat statistikore të marra në GJRRGJ Shkodër rezulton se gjatë kësaj periudhe për këto vepra janë dënuar vetëm 232 autorë. Duke marrë në konsideratë se në realitet shumica e vrasjeve kryhen në bashkëpunim mes disa bashkëautorëve²⁷², mund të konkludojmë se më shumë se gjysma e autorëve të vrasjeve me dashje të kryera në vitet 2005-2014 nuk janë zbuluar dhe dënuar. Efekti i mungesës së sigurisë së dënimit është më i madh në vrasjet të cilat kanë mbetur pa asnjë autor dhe më i vogël në ato vrasje ku të paktën një nga ekzekutorët e saj është dënuar. Nga të dhënat statistikore të marra në Prokurorinë Shkodër vërehet se vetëm për 7 vitet e fundit për të cilat kemi arritur të sigurojmë të dhëna (2008-2014), është vendosur pezullimi i hetimeve për moszbulim autori për 52 vrasje (nga të cilat 26 vetëm për nenin 78) dhe më tej është vendosur pushimi i çështjes për 18 të tjera (në total 60 çështje, apo 28% e totalit të vrasjeve të regjistruara në këto 7 vite). Duke u shtuar këtyre vendimeve të prokurorisë, edhe pafajësitë e dhëna nga gjykata dhe sidomos numrin e madh të bashkëpunëtorëve të paidentifikuar ndonjëherë (të cilët mund të arrijnë deri në dyfishin e numrit të vrasjeve), krijohet bindja se pjesa më e madhe e vrasësve në rrethin gjyqësor Shkodër kanë mbetur të pandëshkuar për krimin e kryer.

Mungesa e efektit frikësues (dhe për rrjedhojë frenues) të dënimit të ashpër, provohet qartë nëse analizojmë individualisht disa vrasje të veçanta me ndikim publik në vendin tonë. Kështu autorët e vrasjes së komisar Dritan Lamaj kanë qenë tërësisht të vetëdijshëm se nëse zbulohen dhe kapen ata do të marrin dënimin maksimal që parashikon neni 79/c i K. Penal, (ashtu siç është dënuar më parë autori i vrasjes së komisar Gani Malushit), mirëpo kjo nuk i ka ndaluar ata në vrasjen e tij publike, pasi kanë pasur një besim se nuk do të zbulohen ndonjëherë. E njëjta logjikë ka vepruar edhe në rastin e vrasjes së deputetit Fatmir Xhindi, të gjyqtarit Skerdilajd Konomi, të bankierit Artan Santo, të shefit të kundërzbulimit të SHISH Isa Çopa, e të shumë viktimave të tjera me profil publik, apo të panjohur, vrasjet e të cilëve nuk janë zbardhur. Një vrasës me pagesë (sidomos ai që përdor lëndë plasëse) është keqbërësi tipik i cili e di më së miri se ligji penal parashikon për veprimin e tij burgim të rëndë, që në shumicën e rasteve në praktikë është burgim i përjetshëm, mirëpo në të njëjtën kohë ai mendon se për shkak të profesionalizmit të tij dhe paaftësisë së strukturave shtetërore, identifikimi dhe dënimi i tij do të jetë një mundësi e largët.

²⁷² Ku kjo është më e vërtetë në vrasjet me paramendim në të cilat marrin pjesë dy dhe më shumë persona në role të ndryshme. Në vrasjet me natyrë mafioze dhe ato të kryera me pagesë numri i bashkëpunëtorëve është 3 apo më shumë persona (porositësi, ndërmjetësi dhe ekzekutorët).

Duke marrë në konsideratë përhapjen në vitet e fundit të vrasjeve me natyrë mafioze mes grupeve kriminale, të vrasjeve me pagesë dhe të atyre me lëndë plasëse, të cilat në një pjesë të madhe janë të pazbuluara, arrihet në përfundimin se numri i personave që kanë kryer vrasje me dashje dhe që janë të pazbuluar mund të jetë edhe më i madh se i personave të dënuar. Për këto arsye, efektin negativ të të gjitha këtyre dështimeve të policisë dhe prokurorisë në zbulimin e personave të rrezikshëm që kanë marrë pjesë në kryerjen e vrasjeve, nuk mund ta kompensojë as ta riparojë asnjë rritje dënimi, sado e lartë apo frikshme qoftë ajo në letër. Studimet në vende të tjera kanë provuar se një mjet shumë efektiv për uljen e vrasjeve (me efekt shumë më të madh parandalues sesa kërcënim i formal ligjor i një dënimi të rëndë) dhe në përgjithësi të konfrontimeve fizike, janë programet e monitorimit policor dhe social për subjektet me një shkallë të lartë rrisht²⁷³.

Përqendrimi tek dënimi i ashpër i autorëve që zbulohen është një mënyrë e mirë për të qenë të ashpër me ta, por është një mënyrë shumë e keqe dhe joefikase për t'u treguar të ashpër me krimin dhe për ta çrrënjësuar atë. Të jesh i vendosur për të luftuar krimin, kërkon një përpjekje më serioze, të thellë dhe afatgjatë, duke u angazhuar maksimalisht për të eliminuar shkaqet që nxisin kryerjen e krimeve dhe për të zbuluar çdo person i cili ndërmerr veprimtari kriminale.

5.4.2. Analizimi i efektit frenues të dënimeve të ashpra tek disa vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Megjithëse vrasjet, si vepra penale kundër jetës, janë ndër veprat më të rënda, në K. Penal ka edhe mjaft vepra të tjera penale të cilat meritojnë një vëmendje të veçantë për shkak të rëndësisë së objektit të cilin mbrojnë dhe marzheve të dënimit që parashikohen për to. Në këtë kategori veprash penale kemi përfshirë krimet më të përhapura në praktikën gjyqësore²⁷⁴, për të cilat parashikohen nivele dënimi me burgim në maksimum nga 3 vite deri në burgim të përjetshëm. Tendenca e numrit të personave të dënuar për këto vepra penale paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 2. Dinamika e të dënuarve për disa vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Viti/Neni	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
88	49	51	73	67	60	64	83	100	121	94	94
139	60	87	51	49	71	60	64	68	106	108	130
140	78	80	45	34	32	25	44	55	41	46	38

²⁷³ Kështu, meritojnë një vëmendje më të madhe nga strukturat ligjzbatuese, si në aspektin e monitorimit më të afërt policor, ashtu edhe në drejtim të masave të tjera sociale, edukative apo mjekësore, personat që kanë konflikte dhe hasmëri të thella, apo kanë shfaqur një shkallë të lartë agresiviteti dhe armiqësie ndaj personave të tjerë. Këto masa kanë një efekt shumë pozitiv sidomos në rastet e marrëdhënieve të ngushta apo frekvente mes viktimës dhe autorit të mundshëm, si në rastet e marrëdhënieve të acaruar familjare, mes komshinjve, apo mes bashkëpunëtorëve të një aktiviteti. Masa të tilla të ndërmarra për 8 vite me radhë në shtetin e Massachusetts, kanë rezultuar shumë efektive, ku në një grup prej 106 personash me një nivel të lartë rrezikshmërie, 92% e tyre nuk kanë kryer asnjë akt dhune, ndërkohë që prej tyre nuk është kryer asnjë vrasje (UNODC, 2013a: 51).

²⁷⁴ Siç vërehet nga tabela, për shkak të vullnetit për të përfshirë një numër sa më të madh veprash penale në këtë analizë, referencat sasiore për veprat penale në fushën e kontrabandës dhe të falsifikimeve të dokumenteve i kemi paraqitur në grup.

171-179	142	174	195	194	146	97	85	104	108	57	91
186-192	1111	1013	968	678	835	609	531	467	571	480	343
278/2+4	347	328	431	397	368	365	452	506	591	330	329
283	83	109	171	181	224	270	254	404	422	393	432
284	51	62	165	42	44	58	40	45	129	101	57
290	243	219	243	269	326	342	330	359	344	261	244
298	66	95	105	96	138	194	107	60	17	15	33

Burimi: Vjetarët statistikorë të MD 2004-2014.

Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura më lart, për disa nga veprat penale ka një tendencë rritëse të numrit të të dënuarve, ndërsa për disa vepra të tjera ka një tendencë zbritëse. Kështu është rritur numri i personave të dënuar për “plagosje të rëndë me dashje”, “vjedhje me dhunë”, “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “kultivimi i narkotikëve” dhe “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe është ulur për veprat “vjedhje me pasojë vdekjen”, veprat e kontrabandës, veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe “dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”. Në veprat e paraqitura më lart, “mbajtja pa leje e armëve luftarake”, ka një tendencë të çrregullt me disa ulje dhe ngritje të numrit të të dënuarve.

Në lidhje me veprat për të cilat numri i të dënuarve është rritur, është e qartë se dënimi i tyre nuk ka pasur ndonjë efekt të ndjeshëm frenues për uljen në të ardhmen të kriminalitetit. Nëse do të sillej si argument se rritja e personave të dënuarve ka ardhur si rezultat i përmirësimit të fuqisë goditëse të policisë dhe prokurorisë për krime të tilla²⁷⁵, dhe jo si rezultat i rritjes së kriminalitetit për këto vepra, analizimi i ndikimit të këtij variabli në afat të gjatë e përjashton një konkluzion të tillë. Kjo pasi rritja e zbulueshmërisë së veprave penale sjell si pasojë rritjen e menjëhershme të numrit të të dënuarve, mirëpo ky numër i lartë duhet të zgjasë vetëm për një afat të shkurtër (nga 1-3 vite). Vazhdimi i tendencës së një numri të lartë të dënuarish në një afat të gjatë, e aq më tepër vijimi i tendencës rritëse, është tregues i qartë i qenies në nivele të larta të kriminalitetit në atë fushë, e për rrjedhojë provojnë se dënimet penale të mëparshme nuk kanë luajtur efektin e pritur frenues.

Për të analizuar më thellë provat për mungesën e efektit frenues të dënimeve të ashpra, mund të vërejmë ecurinë e të dënuarve për nenin 283 të K. Penal. Legjislacioni shqiptar parashikon dënimet më të rënda në Evropë (madje ndër më të lartat në botë) për mbajtësit e lëndëve narkotike, qoftë edhe me qëllim të përdorimit vetjak, mjafton që sasia e lëndës narkotike të jetë mbi sasinë ditore të konsumueshme²⁷⁶. Mirëpo, nga një studim i zhvilluar mbi efektin frenues të dënimit penal tek

²⁷⁵ Kjo mund të jetë një fakt pjesërisht i vërtetë për vepra të caktuara, por duhet të analizohet nëse ai është shkak i përcaktues.

²⁷⁶ Në fakt nga praktika gjyqësore, kjo sasi ka ndryshuar, pasi fillimisht me vendimin unifikues nr. 1 datë 27.3.2008, GJL sanksionoi si sasi të vogël për përdorim personal, vetëm sasinë e konsumueshme me një dozë të vetme, mirëpo praktika e mëvonshme e KPGJL me vendimet nr. 1114 (138), datë 16.05.2012, nr. 1480 (153), datë 25.06.2014 dhe

kjo figurë krimi është provuar se dënimi i rëndë penal nuk ka arritur të frenojë rritjen e numrit të konsumatorëve të këtyre lëndëve (Nikolli, 2015b: 32), i cili nga viti 1995 deri në vitin 2014 është dhjetëfishuar (Kakarriqi & Sulaj, 2000; EMCDDA, 2013). Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 2 provojnë se megjithëse gjatë 10 viteve janë dënuar 2860 persona sipas këtij neni, kjo nuk ka dhënë asnjë efekt në frenimin e kryerjes së kësaj veprë. Madje duhet nënvizuar se mbështetur në studimin e praktikës gjyqësore të viteve 2010-2012 për këtë vepër penale, ka rezultuar se 66% e të dënuarve për kryerjen e kësaj veprë kanë qenë mbajtës të lëndëve narkotike, 32% janë dënuar për shitje dhe vetëm 2% për transport të tyre (Nikolli, 2014a: 313). Pesëfishimi i të dënuarve në vit për këtë vepër penale (krahasuar me vitin 2004), nuk ka shërbyer aspak për uljen e numrit të konsumatorëve dhe as të shpërndarësve të lëndëve narkotike²⁷⁷.

Për shkak të ashpërsimit të paprecedent të dënimit penal për mbajtjen pa leje të armëve luftarake, kjo vepër meriton një vëmendje të veçantë për të analizuar efektin frenues të këtij dënimi. Armët e zjarrit dhe veçanërisht ato luftarake konsiderohen nga kodi ynë penal si një mjet shumë i rrezikshëm për sigurinë publike, megjithëse në vetvete armët e zjarrit nuk shkaktojnë ndonjë dëm nëse nuk përdoren (apo më saktë keqpërdoren). Është mendimi kriminal i njeriut, i cili përmes përdorimit të armëve të zjarrit dëmton një të mirë shoqërore. Nëse armët nuk përdoren për qëllime të paligjshme dhe në përputhje me disa rregulla të shmangies së rreziqeve, ato nuk sjellin ndonjë dëm ndaj shoqërisë. Ky arsyetim është pranuar nga legjislacioni ynë për lejimin e mbajtjes së armëve luftarake për qëllime profesionale dhe vetëmbrojtëse nga disa kategori individësh, si: punonjësit e policisë, ushtarakët, punonjësit e shoqërive të sigurisë fizike, gjyqtarët, prokurorët, deputetët, biznesmenët etj., por nuk është pranuar mbajtja e tyre nga kategori më të gjera të popullsisë²⁷⁸. Nga ana tjetër ligji nr. 74/2014 datë 10.7.2014 “Për armët” parashikon një liri të konsiderueshme për mbajtjen e armëve të gjuetisë nga një kategori e gjerë personash. Këto armë, megjithëse të destinuara për gjueti, paraqesin një rrezikshmëri të lartë për rendin dhe sigurinë, po aq sa armët luftarake, madje në raste të caktuara, për shkak të fuqisë së zjarrit dhe karakteristikave teknike të municionit të përdorur, disa armë gjahu mund të jenë shumë më të rrezikshme sesa pistoletat apo revolverët. Mirëpo këto fakte nuk janë mbajtur fare parasysh nga legjislatori, i cili me ligjin nr. 144/2013, ngriti marzhet e dënimit për mbajtjen e armëve luftarake në vende publike

nr. 1530 (168), datë datës 14.07.2014, ka adaptuar një qëndrim më liberal, duke përjashtuar nga përgjegjësia penale personat të cilët mbanin lëndë narkotike për përdorim ditor.

²⁷⁷ Do të ishte utopike në kushtet e veprimit të mekanizmit të kërkesë-ofertës, që për një kohë të gjatë të rritet numri i konsumatorëve, por të ulet numri i shpërndarësve, prandaj format e kryerjes së kësaj veprë do të shkojnë paralel.

²⁷⁸ Shkalla e liberalizmit në lejimin e mbajtjes së armëve të zjarrit varion nga shteti në shtet, por një numër i madh shtetesh të botës lejojnë blerjen dhe mbajtjen e armëve luftarake në banesë, si: SHBA, Brazili, Meksika, Australia, Izraeli, Çekia etj.

(qoftë dhe të një arme pistoletë) nga 7-15 vite burgim²⁷⁹, njëloj sa trafikimin e tyre për qëllime fitimi dhe më pak sesa prodhimin e tyre²⁸⁰.

Nga shqyrtimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 2 vihet re se numri i të dënuarve për këtë vepër penale është i lartë dhe përveç rritjes së viteve 2010, 2011 dhe 2012, në vitet e tjera ka një tendencë thuajse konstante. Ashtu sikurse për vrasjet, duke qenë se numri i procedimeve penale të regjistruara nga prokuroria është një referencë më e saktë për nivelin e kriminalitetit për këtë vepër, më poshtë po paraqesim ecurinë e tyre pranë Prokurorisë Shkodër për vitet 2005-2015²⁸¹.

Tabela nr. 3. Dinamika e çështjeve të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në Shkodër.

Neni 278	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Regjistruar ²⁸²	48	81	47	59	56	60	68	69	53	70
Pezulluar				8	7	13	5	28	13	20
Pushuar				3	1	2	5	4	4	2

Burimi: Prokuroria pranë GjRREGJ Shkodër.

Siç vërehet nga të dhënat e kësaj table, numri i procedimeve të filluara për mbajtje pa leje të armëve luftarake ka një tendencë të lehtë rritëse në rrethin e Shkodrës, tendencë e cila ka vijuar (madje paraqitet më e theksuar) edhe pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013. Megjithëse që nga muaji maj i vitit 2013 nuk ka kaluar një kohë e gjatë, vlerësojmë se ajo është e mjaftueshme për të filluar konstatimin e efektit eventual frenues të ashpërsimit të dënimit për këtë vepër²⁸³. Fakti se numri i procedimeve penale për këtë vepër në vitin 2014 nuk është ulur, madje ka pësuar rritje²⁸⁴, është një provë tjetër se ashpërsimi i dënime nuk luan ndonjë rol frenues në uljen e

²⁷⁹ Ndërkohë që mbajtja pa leje e armëve të gjahut është kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në 2 vite.

²⁸⁰ Duhet sjellë në vëmendje se ky ashpërsim dënimesh për këtë vepër penale nuk gjen paralelizma jo vetëm në legjislacionet penale perëndimore, por as në kodet penale të regjimit komunist. Kështu neni 273 i K. Penal të vitit 1952 parashikonte për këtë vepër dënim me heqje të lirisë gjer në pesë vjet, ndërsa K. Penal i vitit 1977 parashikonte në nenin 224 dënim me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

²⁸¹ Studimi në nivel lokal vetëm për hapësirën territoriale që përfshin Prokuroria Shkodër, bëhet së pari sepse nuk kemi arritur të sigurojmë të dhëna në nivel kombëtar dhe së dyti për arsye metodologjike të cituara më lart edhe për vrasjet.

²⁸² Sipas shpjegimeve të prokurorisë, këto shifra paraqesin vetëm procedimet ku mbajtja pa leje e armëve luftarake është si vepër kryesore dhe nuk përfshijnë edhe rastet kur kjo vepër shoqëron një vepër më të rëndë, si vrasje, apo vjedhje me armë.

²⁸³ Për shkak të thjeshtësisë së provave, në rastet e zakonshme hetimi dhe gjykimi i një vepre të tillë përfundon brenda 6-8 muajsh, prandaj përveç efektit fillestar frenues që duhet të ngjallte njohja e ndryshimeve ligjore në muajin maj 2013, efekti frenues i dënimeve të reja për këtë vepër penale duhej të fillonte në fillim të vitit 2014.

²⁸⁴ Megjithëse në nivel tremujori, por kjo tendencë konfirmohet akoma më fort në vitin 2015.

kriminalitetit. Nëse ashpërsimi i dënimeve do të kishte efekt të ndjeshëm frenues, rasti më i mirë provues do të ishte efekti në uljen e kryerjes së veprës penale të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”. Megjithëse për këtë vepër janë ashpërsuar masat e dënimit në ekstrem, nga ana tjetër, siguria e dënimit për këtë vepër ka mbetur shumë e ulët. Kjo provohet jo vetëm nga numri i madh i vendimeve të pezullimit dhe pushimit, por së pari nga fakti se numri i procedimeve të regjistruara është shumë më i vogël se numri i veprave të kryera²⁸⁵, pasi zbulimi i kësaj vepre penale është i vështirë nëse arma e zjarrit nuk përdoret.

Sa i takon veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, vlerësojmë se për shkak të formës së fajësisë me të cilën kjo vepër kryhet, qoftë dhe teorikisht është e pamundur që dënimi i ashpër penal të luajë ndonjë rol frenues. Siç u shprehëm në fillim të këtij kapitulli, pritshmëritë për një efekt pozitiv frenues të dënimit të ashpër janë tek veprat të cilat kryhen me paramendim, pasi autori i veprës ka mundësi të llogarisë dhimbjen eventuale të dënimit, si një faktor që mund ta shtyjë atë në heqjen dorë nga kryerja e veprës së paramenduar. Mirëpo vepra penale e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor kryhet me pakujdesi (Elezi, 2007: 541) dhe autori i saj jo vetëm që nuk e dëshiron ardhjen e pasojave (plagosjen, apo vdekjen e një apo më shumë personave), por me vetëbesim të tepruar mendon se do t’i shmangë ato.

Pra, në momentin që një drejtues mjetei vendos të shkelë një rregull të qarkullimit rrugor, ai nuk e mendon si të mundshme as ndodhjen e aksidentit, e jo më dënimin e tij të rëndë me burgim, i cili mund të ndikonte tek ai që të mos e kryente shkeljen e rregullave të qarkullimit. Në realitet, një drejtues mjetei ka arsye më të forta se një dënim penal që mund ta nxisin atë të sillet në përputhje me rregullat, siç janë frika për shëndetin dhe jetën e tij dhe të personave të tjerë të afërm që mund të udhëtojnë me të, respekti (apo qoftë dhe frika) që ai ka për jetën dhe shëndetin e të tjerëve, frika nga dëmtimi material i mjetit të tij, përgjegjësia civile për dëmet e shkaktuara mjeteve të tjera, apo edhe frika që ai ka nga një dënim administrativ për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Duke marrë në konsideratë se në momentin e marrjes së vendimit për kryerjen e shkeljes rrugore (vendim i cili në shumicën e rasteve mund të merret në pak sekonda) drejtuesi i mjetit shpërfill këto pasoja më të mundshme, vlerësojmë se është e pavend që të pretendohet se ai do të frenohet në kryerjen e saj nga frika e dënimit penal. Për rrjedhojë vlerësojmë se marzhet e dënimit të parashikuara nga neni 290²⁸⁶, megjithëse janë tepër të larta (Elezi, 2007: 541) nuk kanë arritur të ndikojnë në uljen e pasojave nga aksidentet rrugore.

²⁸⁵ Për shkak të hapjes së depove të armatimit në vitin 1997, shumë armë dhe municione mbahen të fshehura në vende të ndryshme dhe në masë më të vogël grupe të ndryshme kriminale kanë importuar armatim perëndimor.

²⁸⁶ Veçanërisht paragrafi i dytë sipas të cilit kur ka sjellë plagosjen e rëndë të një personi dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe paragrafi i katërt, sipas të cilit kur ka sjellë plagosjen e rëndë të disa personave dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.

Sa i takon veprave të cilat kanë pësuar ulje të numrit të të dënuarve, vlerësojmë se kjo nuk ka ardhur si rrjedhojë e dënimeve penale të ashpra, por si rrjedhojë e rritjes së sigurisë së dënimit të tyre²⁸⁷. Kështu veprat penale të kontrabandës kanë ndjekur një tendencë zbritëse që në vitin 2008 dhe në vitin 2013 kanë pësuar një ulje drastike si rrjedhojë e përmirësimit të kontrollit të kufijve, nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, forcimit të kontrollit tatimor dhe doganor, implementimit të teknologjive të reja të monitorimit dhe kontrollit si dhe shkëmbimit të informacionit me vendet e origjinës së mallit (Hyseni, 2014: 235). Po njësoj, ulja me rreth 60% e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve nuk është tregues i efektit frenues të dënimeve të ashpra, por rrjedhojë e drejtpërdrejtë e masave parandaluese të cilat kanë ulur mundësitë e kryerjes së këtyre grup veprash penale dhe zbulimin e tyre më të thjeshtë. Si faktorë të tillë mund të përmendim rritjen e elementëve të sigurisë në dokumentet e gjendjes civile, prodhimin e dokumenteve biometrike të identitetit, rritjen e elementëve të sigurisë në lejet për drejtimin e mjeteve, digjitalizimin dhe kontrollin online të mjaft veprimeve me organet shtetërore, apo mes palëve private (si p.sh. aktet noteriale, kontrolli i faturave tatimore, i pagesave bankare) etj. Shembull i qartë që mbështet uljen e kriminalitetit për faktorë të tjerë tej dënimit të ashpër penal, është neni 298 i K. Penal. Megjithë dënimet e rënda që parashikon kjo dispozitë, ajo nuk ka arritur të ulë kryerjen e kësaj vepre, e cila deri në vitin 2009 ka njohur vetëm rritje. Pas këtij viti numri i të dënuarve ka ardhur duke u ulur në mënyrë të menjëhershme, duke arritur për 4 vite në 1/13 e vitit 2009. Kjo tendencë zbritëse shpjegohet me liberalizimin e vizave me vendet e Schengen-it me 18 dhjetor 2010 (Grazhdani, 2015: 5), ndryshim i cili tkurri nevojën e qytetarëve shqiptarë për t'u larguar nga vendi, përmes kalimit të paligjshëm të kufijve²⁸⁸.

5.4.3. Analizimi i efektit frenues të dënimeve të ashpra tek veprat e përhapura

Në dy vitet e fundit pranë prokurorive dhe gjykatave të shkallës së parë ka pasur një numër të paprecedent çështjesh nga një grup i vogël veprash penale të cilat zënë pjesën më të madhe të ngarkesës në punë të këtyre organeve. Në këtë grup veprash penale bëjnë pjesë: ndërtimi i paligjshëm, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, organizimi i palejuar i lojërave të fatit, dhe vjedhja e energjisë elektrike²⁸⁹. Edhe vepra penale e vjedhjes ka pasur një peshë shumë të madhe në ngarkesën e këtyre organeve, por në ndryshim prej saj, veprat e tjera kanë pasur një rritje të

²⁸⁷ Dy grupet e veprave penale të cilat kanë një tendencë zbritëse, parashikojnë dënimet më të lehta në raport me veprat e tjera, prandaj edhe për këtë arsye ato nuk mund të shërbejnë si provë se dënimet e rënda frenojnë kriminalitetin e ardhshëm. Në shumicën e rasteve, për kryerjen e këtyre veprave gjykatat kanë caktuar dënim me gjobë, dënime të shkurtra me burgim, apo dënime alternative (MD, 2014: 59).

²⁸⁸ Në fakt pas rritjes së fluksit të kalimit tranzit të refugjatëve (kryesisht) sirianë, kryerja e kësaj vepre penale ka filluar të rritet përsëri në vitin 2014, megjithëse për vitin 2015 nuk kemi të dhëna zyrtare në rang vendi.

²⁸⁹ Pas vitit 2014 në këtë grup veprash bën pjesë dhe neni 180 “fshehja e të ardhurave”, por duke qenë se as për këtë vepër nuk kemi të dhëna zyrtare në rang vendi për vitin 2015, nuk e kemi trajtuar në këtë analizë.

menjëhershme disafish në raport me vitet pararendëse. Në tabelën më poshtë po paraqesim tendencën që këto vepra kanë pasur në praktikën gjyqësore.

Tabela nr. 4. Dinamika e personave të dënuar për disa vepra të përhapura në rang vendi.

Neni	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
134	1034	995	1138	1156	1410	1263	1586	1822	1976	1923	2006
137	169	140	130	178	308	118	309	464	189	53	566
199/a	-	-	-	-	-	-	-	25	25	35	160
291	73	99	100	137	274	353	455	396	323	465	3403
197	4	18	0	4	23	98	135	142	128	73	554

Burimi: Vjetarët statistikorë të MD 2004-2014.

Ashtu siç u analizua më lart për vrasjet, nga tabela e mësipërme vihet re qartazi se dënimi në vijimësi i vjedhësve (neni 134) nuk ka pasur asnjë efekt frenues, pasi numri i personave të dënuar për këtë vepër është dyfishuar në harkun kohor të 10 viteve. Megjithëse në vendin tonë vjedhja konsiderohet një vepër me rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore dhe në shumicën dërrmuese të rasteve dënohet me burgim nga gjykatat, kryerja e saj ka vijuar të rritet, duke provuar qartë, paefektshmërinë frenuese të masave penale të zbatuara. Sa i takon veprave të tjera të paraqitura në tabelë, për të cilat ka pasur një intensifikim të goditjes së tyre në dy vitet e fundit, vërehet qartazi shumëfishimi i menjëhershëm i numrit të të dënuarve nga viti 2013 në vitin 2014 (ku për nenin 291 është më shumë se shtatëfishuar numri i të dënuarve brenda një viti). Duke qenë se nuk disponojmë të dhëna kombëtare për dinamikën e tyre në vitin 2015, do të përdorim të dhënat e marra nga gjykata e rrethit Tiranë.

Tabela nr. 5. Dinamika e personave të dënuar për disa vepra të përhapura nga GjRREGJ Tiranë.

Viti/Neni	2010	2011	2012	2013	2014	6m 2015
134	547	572	743	710	708	323
137	41	60	10	13	51	664
199/a	7	5	4	3	48	118
291	139	140	110	107	960	475
197	1	6	14	2	108	46
Shuma	735	806	883	835	1880	1640
Pesha në %	30%	31%	34.1%	34.4%	47.6%	57.7%

Burimi: GjRREGJ Tiranë.

Siç vërehet nga kjo tabelë numri i të dënuarve për këto 5 vepra penale është rritur me 4.5 herë në harkun e 5 viteve (nëse 6 mujori i dytë i vitit 2015 ndjek të njëjtën tendencë me 6 mujorin e parë), ndërkohë që pesha që këta të dënuar zënë në totalin e të dënuarve të kësaj gjykate është rritur nga 30% në 57.7%. Rritja e menjëhershme e numrit të këtyre çështjeve në prokurori dhe gjykata në vitin 2014 dhe 2015 nuk ka ardhur si rezultat i kryerjes së tyre më të madhe në këtë periudhë, por si rezultat i fokusimit të veprimtarisë zbuluese të policisë mbi këto vepra penale. Goditja e këtyre veprave penale është bërë me fushatë njëra pas tjetrës, pas qëndrimit publik të qeverisë për luftimin e tyre²⁹⁰.

Lufta ndaj këtyre fenomeneve nuk duhet të bëhet me fushata dënimesh të ashpra frikësuese, por në çdo ditë nga strukturat përkatëse shtetërore të cilat janë të ngarkuara me këto detyra funksionale. Megjithëse frika publike e ngjallur nga operacione të tilla masive mund të duket sikur ka dhënë rezultate afatshkurtra frenuese, ajo nuk do të jetë e aftë që për një kohë të gjatë të zëvendësojë zbatimin e përditshëm dhe me rigorozitet të ligjit nga strukturat që u është ngarkuar kjo detyrë, e aq më pak në rastet kur qeveria i harron, apo i ndryshon këto prioritete. Kështu, megjithëse para një viti Kryeministri kërkoi që çdo ndërtim pa leje të konsiderohej si vrasje, me ligjin nr. 9482 datë 11.6.2015²⁹¹, maxhoranca e drejtuar prej tij, vendosi t'i legalizojë këto ndërtime pa leje të kryera deri me datë 27.06.2014 dhe me ligjin nr. 92/2015 miratoi një amnisti të re penale për të gjithë ndërtuesit pa leje për veprimet e kryera deri me 10 prill të vitit 2014; megjithëse u deklarua se aktivitetet e lojërave të fatit ishin një kancer për shoqërinë tonë dhe do të mbylleshin, apo do të largoheshin nga qendrat urbane, ato vazhdojnë njësoj si më parë; megjithëse fillimisht çdo drejtues mjetei pa patentë arrestohej, aktualisht rrugët e vendit janë plot me drejtues çiklomotorash pa leje drejtimi, apo shumica e maturantëve të shkollave të mesme festojnë diplomimin e tyre me orë të

²⁹⁰ Operacioni i parë i kësaj natyre i koduar “Fundi i marrëzisë”, nisi me 14 tetor 2013, në të cilin u angazhuan mbi 6000 forca policie, me qëllim eliminimin e paligjshëm të lojrave të fatit (Oranews, 2013). Operacioni i dytë nisi rreth dy javë më vonë me goditjen e përqendruar të drejtimit të mjeteve pa patentë, apo në gjendje të dehur, ku vetëm për pak ditë u arrestuan nga policia 220 persona (MPB, 2013: 26). Me ndryshimet e ligjit nr. 98/2014, neni 291 u ndryshua, duke e bërë këtë dispozitë krim dhe duke hequr fare dënimin me gjobë si dënim alternativ. Operacioni i tretë intensiv i policisë së shtetit u fokusua ndaj ndërtimeve pa leje. Në një fjalim publik përpara drejtuesve të policisë së shtetit, kryeministri Rama u bëri atyre thirrje ta trajtonin çdo ndërtim pa leje njësoj si një vrasje. Në këtë takim ai hodhi kritika të ashpra ndaj prokurorisë dhe gjykatave për masat e buta të sigurimit dhe dënimet e buta ndaj këtyre shkelësve të ligjit. Në vijim të reformës ligjore, më pak se 5 muaj pas ashpërsimit të dënimet për “drejtimin e mjeteve në mënyrë të parregullt”, me ligjin nr. 176/2014 Kuvendi ashpërsoi dënimet edhe për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm. Operacioni tjetër u fokusua ndaj vjedhësve të energjisë elektrike. Kryeministri Rama, në fjalën e tij para 2 mijë pjesëmarrësve në aktivitet, mes të cilëve operatorë të OSHEE dhe punonjës të Policisë së Shtetit të cilët do të realizonin aksionin, u kërkoi gjyqtarëve të dënojnë me 3 vite burgim çdo vjedhës energjie dhe me 5 vite burg çdo bashkëpunëtor të tyre. (Rama, 2014). Operacioni më i fundit i policisë së shtetit i nisur në shtator të këtij viti pritet të prodhojë një valë të re të dënuarish sipas nenit 180 të K. Penal.

²⁹¹ Ligji nr. 9482, datë 11.6.2015, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

zgjatura, duke lëvizur me autovetura me cilindratë të madhe (edhe nën efektin e alkoolit apo stimulantëve të tjerë), megjithëse shumë pak prej tyre zotërojnë leje drejtimi (top-channel, 2015). Efekti parandalues gjeneral i dënimit penal është i shtrirë në një kohë të gjatë, për shkak të mekanizmit të funksionimit të tij. Mirëpo, nëse kryerjen e një veprë penale në të ardhmen mund ta ndalojmë më shpejt me metoda jopenale (përmes kryerjes së detyrave funksionale nga inspektoriatet e ndryshme administrative, apo strukturat private në rastin e OSHEE), atëherë dënimi i atyre që kanë gabuar në të shkuarën është demagogji dhe jo arsye reale për të parandaluar në të ardhmen kryerjen e asaj lloj veprë penale. E nga ana tjetër, nëse vetë mekanizmat e shtetit nuk kanë funksionuar për të ndaluar veprimet e jashtëligjshme, madje në raste të caktuara këto veprime janë stimuluar me ligje të tjera (siç janë ligjet e vazhdueshme për legalizimin e ndërtimeve pa leje), atëherë rezulton i padrejtë edhe dënimi i tyre në bazë të meritës së fajit. Në konceptin bashkohor evropian, një shtet nuk mund të konsiderohet si ligjor, thjeshtë sepse ka ligje pozitive të shkruara, por duhet të plotësojë edhe elementë të tjerë, ndër të cilët janë parashikueshmëria, parimi i sigurisë juridike dhe ai i barazisë para ligjit (Bedner, 2010: 56). Nëse qytetarëve nuk u bëhet e qartë çdo ditë se veprime të caktuara janë të paligjshme dhe të dënueshme, por përkundrazi me ligje të tjera jepen mesazhe të kundërta, atëherë nuk mund të quhet i merituar dhe i drejtë një dënim penal i mëvonshëm për kryerjen e tyre.

Për shkak të afateve të gjata dhe mekanizmit të funksionimit të tij, në disa raste jo vetëm që dënimi penal nuk parandalon në praktikë, por e ka të pamundur edhe teorikisht që ta kryejë një funksion të tillë. Kështu, jo vetëm që nuk është detyrë parësore e dënimit penal që të ndalojë kryerjen e një ndërtimi të paligjshëm, por madje e ka tërësisht të pamundur ta bëjë atë praktikisht, nëse vetë inspektorati përkatës nuk e evidenton që në fillimet e tija. Ndërtimi i paligjshëm ndalohet që në themele nga inspektorët përkatës që mbikëqyrin kontrollin e territorit, duke pezulluar punimet dhe ndëshkuar administrativisht kundërvajtësin. Shembja e një ndërtimi pa leje (si një masë administrative), është në shumicën e rasteve një masë disa herë më e dhimbshme se dënimi penal dhe për pasojë përbën për të tjerët një shembull më frikësues sesa dënimi penal, për t'u përmbajtur në përsëritjen e asaj veprë penale.

Po njësoj, mekanizmi frenues është shumë më efektiv dhe i shpejtë edhe për drejtimin e mjeteve në gjendje të dehur apo pa patentë, ku strukturat e policisë rrugore e kanë të mundur të identifikojnë shumicën e këtyre kundërvajtësve dhe të marrin ndaj tyre masa administrative mjaftueshmërisht të ashpra (si gjoba dhe heqja e patentës). Po njësoj edhe ushtrimi i palicensuar i lojërave të fatit, apo edhe çdo aktiviteti tjetër tregtar pa licencë, duhet të jenë fokus i përditshëm i punës së strukturave administrative të tatim-taksave, të cilët nëse e kryejnë detyrën sipas ligjit, janë shumë më efektivë në parandalimin e këtyre sjelljeve të evazionit fiskal.

Në vlerësimin tonë, edhe sukcesi i deritanishëm i arritur në frenimin e ndërtimeve pa leje apo në ushtrimin e palicensuar të lojërave të fatit, nuk ka ardhur si rrjedhojë e dënimit penal të shumë personave të cilët i kanë kryer këto vepra, por si rrjedhojë e kryerjes më të mirë të punës nga inspektorët përkatës, të cilët kanë evidentuar dhe ndëshkuar më mirë që në momentet e para kundërvajtësit, duke mos i lejuar të avancojnë me paligjshmërinë e tyre. Askush nuk mund të vërë në dyshim efektin e fuqishëm parandalues që ka siguria ligjore se një objekt i ndërtuar në mënyrë të paligjshme jo vetëm që nuk do të legalizohet, por madje do të shembet dhe se ndërtuesi do të gjohet rëndë për këtë kundërvajtje, duke i ngarkuar edhe shpenzimet për shembjen dhe kthimin e territorit në gjendjen e mëparshme. Prandaj ulja e nivelit të kryerjes së veprave të analizuara më lart, s'ka të bëjë me efektin parandalues të dënimit penal (i cili për një pjesë të tyre nuk ka marrë akoma formë të prerë, e jo më të jetë ekzekutuar), por me efektin e drejtpërdrejtë të kryerjes më mirë të detyrës së tyre nga inspektoratet përkatëse. Efekti frenues i punës së këtyre inspektorateve në mos i menjëhershëm, bëhet efektiv në pak javë, ndërsa efekti parandalues i një dënimi të formës së prerë për këto raste kërkon një kohë më të gjatë (nga një deri në dy vite)²⁹².

Siç rezultoi nga tabelat më sipër, këto vepra nuk janë përhapur sepse janë dënuar pak, porse s'janë evidentuar fare (ose pothuajse fare), prandaj përhapja e tyre e madhe veç të tjerave ka ardhur jo nga dështimi i sanksioneve të buta, por nga dështimi i funksionimit të strukturave dhe mekanizmave të tjerë shtetërorë parandalues. Nëse ndërtimet pa leje janë përhapur, kjo nuk ka ndodhur për shkak të dënimeve të buta penale të autorëve nga gjykatat, por sepse strukturat mbikëqyrëse të territorit nuk e kanë zbatuar ligjin dhe më pas vetë shteti ka miratuar ligje për legalizimin e ndërtimeve të paligjshme, duke inkurajuar kështu edhe më tej ndërtime të tjera të paligjshme.

Çështja e ndëshkimit të veprave penale të përhapura ka dhe një problem tjetër të madh fizibiliteti. Duke qenë se këto vepra janë shumë të përhapura, numri i shkelësve të ligjit është aq i madh sa objektivisht është tej çdo lloj mundësie për t'u trajtuar nga organet e policisë (gjyqësore), prokurorisë dhe në fund gjykatës²⁹³. Duke qenë se kjo pamundësi është e evidente, atëherë shtrohet problemi se cilat raste do të ndiqen penalisht dhe cilat jo, pasi formalisht të gjitha aktet janë penalisht të dënueshme. Mungesa e ndonjë kriteri përzgjedhës parimor dhe të shkruar, passjell detyrimisht aplikimin e selektivitetit abuziv në fillimin e ndjekjes penale. Për shkak të zbrazëtisë

²⁹² Këtu duhet mbajtur parasysh koha e dokumentimit të rastit apo referimit të veprës, afati minimal 3 mujor i hetimit paraprak, afati i gjykimit në shkallë të parë dhe gjykimi në gjykatën e apelit, si dhe afati i ekzekutimit të dënimit. Sipas vjetarit statistikor 2013 (MD, 2014: 28), 52% e çështjeve gjykohen në shkallë të parë brenda 2 muajve, 39% brenda 6 muajve, 7% brenda 1 viti dhe vetëm 2% zgjat mbi 1 vit.

²⁹³ P.sh. vetëm numri i ndërtimeve pa leje sipas drejtorit të ALUIZNI-t deri në fillim të vitit 2015 kishte kapur shifrën e 427 mijë objekteve (Lame, 2015). Po ashtu pak a shumë e njëjta situatë është me lidhjet e paligjshme të energjisë elektrike, apo drejtimit të mjeteve në mënyrë të paligjshme. Kështu p.sh. sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Energjitikës, në vitin 2014 vidhej rreth 21% e energjisë së hedhur në rrjet (që e përkthyer në individë, mund të jenë nga 100.000-400.000 vjedhës energjie në vit).

ligjore në përcaktimin e kriterëve të fillimit të ndjekjes penale në rastet kur objektivisht nuk mund të ndiqen penalisht të gjithë shkelësit, “përzgjedhja e lirë” bëhet mbi kriterë të tjera, si: njohjet dhe miqësitë, influenca politike, pushteti ekonomik etj. Pra, në raste të tilla, ekziston rreziku potencial se ata që ndiqen penalisht (dhe që do dënohen), në të shumtën e rasteve bëjnë pjesë në shtresat më të pambrojtura dhe të marxhinalizuara shoqërore.

Kjo nismë për vendosjen e ligjshmërisë, objektivisht është e destinuar të përfundojë në dënimin vetëm të një pjese të vogël të shkelësve të ligjit²⁹⁴, veprim i cili në vetvete është jo vetëm imoral, por edhe i dënueshëm ligjërisht. Nëse mekanizmi i frenimit të kryerjes së veprave penale bazohet në sigurinë se do të dënohesh nëse shkel ligjin, ky shembull i dënimit selektiv nuk është i aftë ta ngjallë një siguri të tillë, për pasojë as të prodhojë efekt parandalues. Ky proces në vend që të vendosë në vend “dinjitetin e ligjit të nëpërkëmbur masivisht”, thjesht nëpërkëmb masivisht parimin e barazisë para ligjit dhe vendos standarde ekstraligjore në përzgjedhjen e atyre shkelësve të cilët do t’i shërbejnë synimeve të dënimeve me fushata.

Kjo analizë na çon në përfundimin se ndjekja penale e veprave penale të përhapura masivisht është një zgjedhje e gabuar dhe e dëmshme për efektin e dënimit penal. Për gjendje të tilla të paligjshmërisë masive duhet të vihen në lëvizje mekanizmat administrativë si barriera e parë e ballafaqimit me ligjin dhe vetëm për personat ndaj të cilëve nuk japin efekt masat administrative, duhet të vihet në lëvizje mekanizmi i së drejtës penale, deri në dënimin e ligj-shkelësit. Kjo sugjeron kufizimin e ndërhyrjes së të drejtës penale vetëm në raste të domosdoshme si një mjet *ultima ratio* (Melander, 2013: 43).

Kriminalizimi i sjelljeve devijante në çdo detaj (Herring, 2013: 13) dhe sidomos ashpërsimi i dënimeve penale për disa vepra penale të përhapura nuk ka efekt parandalues, por nga ana tjetër ka efekte të shumta negative si kufizimi i të drejtave të njeriut (përmes heqjes së lirisë), mbipopullimi i burgjeve, rritja e kostove të drejtësisë penale dhe shfokusimi i organeve ligjzbatuese nga veprat me rrezikshmëri të madhe shoqërore.

5.5. Arsytueshmëria e dënimeve të ashpra penale në vendin tonë.

Më lart konkludua se megjithëse Legjislatori shqiptar ka ashpërsuar dënimet për shumë vepra penale, kjo nuk ka dhënë ndonjë efekt të matshëm në uljen e kriminalitetit për këto vepra penale. Mungesa e efektit frenues marginal të ashpërsimit të dënimeve, gjithsesi nuk do të thotë që dënimi penal s’ka asnjë efekt frenues, por që ashpërsimi i dënimeve nuk duhet të përdoret si argument për uljen e kriminalitetit. Shoqëria moderne nuk ka arritur akoma ta shmangë dënimin penal si një nga mjetet që përdoren për luftimin e kriminalitetit, por si pasojë e ngritjes së standardeve të të drejtave

²⁹⁴ Ky fakt është pranuar shprehimisht edhe nga Komisioni i ligjeve në raportin për ligjin nr 92/2015 për amnistinë e ndërtimeve pa leje. (Kuvendi, 2015: 2).

të njeriut dhe falë studimeve të shumta kriminologjike të kryera, roli i tij ka ardhur duke u reduktuar, deri në kthimin e tij në një mjet *ultima ratio*. Frika e dënimeve është një element që mbahet parasysh nga personat e shëndoshë mendërisht, në kryerjen e një kategorie veprash penale, por kjo frikë nuk rritet, ose në rastin më të mirë rritet në mënyrë të papërfillshme, nëse dënimet ashpërsohen²⁹⁵. Nga ana tjetër, ashpërsimi frenetik i dënimeve, sjell pasoja të shumta negative, të cilat i bëjnë këto reforma ligjore thellësisht të paarsyeshme.

Megjithëse dënimi i ashpër dhe shembullor i personave që zbulohen, mbështetet në një teori utilitariste, në praktikë ai nuk arrin të justifikojë synimin e tij për të sjellë maksimumin e dobisë shoqërore. Vetë Bentham në teorinë e tij frymëzuese për frenimin e krimit, e ka pranuar se dënimi penal duhet shmangur në rastin kur ai është joefikas, apo shumë i kushtueshëm (2009: 56). Dënimi i rëndë dhe disproporcional i një fajtori, tej meritës së krimit të kryer, jo vetëm që është i padrejtë në aspektin moral, por është i panevojshëm edhe në këndvështrimin utilitar. Studimet mbi efektin e burgut tek të dënuarit dhe familjet e tyre (Petersilia, 2000; Travis & Waul, 2004) tregojnë se ai ka një efekt negativ në psikologjinë e të dënuarit, në ruajtjen e raporteve familjare dhe shoqërore dhe në aftësitë e tij për t'u përshtatur me jetën pas burgut. Mbi eksperiencën e tij 18 vjeçare të vuajtur në burgje të ndryshme angleze dhe amerikane, Soering ka konkluduar se burgu është një mënyrë shumë e kushtueshme për të bërë njerëzit e këqinj akoma më të këqinj (2004). Megjithëse në nivele më të ulëta se vendet e zhvilluara perëndimore, kostot vjetore për mbajtjen e një të burgosuri në Shqipëri janë shumë të larta në raport me tregues të tjerë ekonomikë, si GDP për frymë²⁹⁶, paga mesatare, pagesa e ndihmës ekonomike, shpenzimet për frymë për arsimin etj.

Në këtë aspekt shoqëria jonë duhet të fokusohet në drejtim të atyre mjeteve dhe mekanizmave preventivë të cilët janë më të drejta dhe humane, respektojnë më shumë të drejtat e njeriut, ulin kostot dhe ofrojnë një efektivitet më të lartë në uljen e krimit (Lappi-Seppälä, 2008: 20). Qeveritë kanë sot dy mënyra për t'u përballur me krimin, e para përmes politikave shumëdimensionale, të cilat fokusohen në parandalimin e shkaqeve dhe faktorëve kriminogjenë (Gjonçaj & Gjonçaj, 2013: 255) dhe në rritjen e sigurisë së zbulimit të akteve kriminale, ndërsa e dyta përmes politikave të ashpërsimit të dënimeve për personat të cilët deklarohen fajtorë nga gjykatat. Megjithëse frymëzuesit e politikave të dyta pëlqejnë të quhen “të ashpër me krimin”²⁹⁷, nga të dhënat e analizuara në këtë kapitull rezulton se ata kanë qenë më shumë “të ashpër me personat që deklarohen fajtorë” sesa me krimin. Politikat populiste të dënimit të ashpër të atyre që kapen, kanë

²⁹⁵ Siç mund të ketë disa dyshime të zbehta se mund të ketë ndikuar tek mbajtja e armëve në vende publike, apo vrasja për gjakmarrje.

²⁹⁶ Sipas një vlerësimi të OSBE kostoja mujore e një të burgosuri në Shqipëri është 439 euro në muaj, apo 5300 euro në vit (Raunig, 2014), ndërkohë që GDP për frymë në vitin 2013 ishte vetëm 4,652 \$, apo rreth 3520 euro (worldbank, 2014).

²⁹⁷ Term i rrjedhur nga politikat amerikane e quajtur “*tough on crime*”.

lënë në hije jo vetëm luftën me masa preventive jopenale të shkaqeve të krimit (Malleon & Moules, 2010: 110), por edhe aspektet penale të rritjes së sigurisë së dënimit. Shprehja e thënë para 250 vitesh nga Beccaria se: “siguria e një dënimi, edhe pse i butë, do të bëjë gjithnjë një përshtypje më të madhe sesa frika e një tjetri më të tmerrshëm, i cili shoqërohet me shpresën e pandëshkueshmërisë” (1973: 66), u provua më lart se gjen zbatim të plotë edhe në realitetin shqiptar. Rritja e sigurisë së dënimit për vepra me marzhe të buta dënimi, kanë ulur ndjeshëm numrin e krimeve të tilla, ndërkohë që ashpërsimi në ekstrem i dënimeve për vepra të tjera, në mungesë të kësaj sigurie, nuk kanë dhënë ndonjë rezultat frenues të dukshëm.

Nismat ligjore për shtime veprash të reja në K. Penal dhe sidomos ashpërsimet e dënimeve për veprat ekzistuese janë paraqitur nga të gjitha qeveritë shqiptare si reforma të suksesshme dhe shprehje e vullnetit të qartë për të luftuar kriminalitetin (Kuvendi 2013a; Këshilli i Ministrave, 2014). Këto politika dënimi të orientuara kryesisht nga dënimet me burgim me minime dhe maksimume të larta, nuk kanë ndikuar në uljen e kriminalitetit, por nga ana tjetër kanë sjellë një rritje të shkallës së burgosjes dhe eventualisht në një mbipopullim të burgjeve (Nikolli, 2015c: 532). Për të zgjidhur problemin e mbipopullimit të burgjeve në vetëm 30 muaj Parlamenti shqiptar ka miratuar tre amnisti, si pasojë e të cilave shumë të dënuar janë liruar nga burgu, apo shumë të tjerë janë përjashtuar nga ndjekja penale (ligji nr. 107/2012, ligji nr. 22/2014 dhe ligji nr. 92/2015). Megjithatë në retorikën politike këto amnisti konsiderohen si mishërime të konceptit “inovativ” se “burgimi duhet të përdoret si mjet i fundit” (MD, 2014), ato përbëjnë provën më të qartë të politikave penale populiste pa bazë shkencore dhe as morale. Nga njëra anë (gjatë 20 viteve jetë të K. Penal) maxhorancat politike kanë ashpërsuar vazhdimisht masat e dënimeve për shumë vepra penale, me argumentin se dënimet e caktuara nga gjykatat kanë qenë të buta dhe nga ana tjetër miratojnë ligje amnistie për kategori të gjera të dënuarish, pa marrë parasysh rrezikshmërinë e secilit prej tyre dhe të veprës konkrete të kryer prej tyre²⁹⁸.

Megjithatë as e drejta penale e vendeve të Evropës Perëndimore nuk ka arritur ta eliminojë tërësisht burgimin si një dënim kryesor, ajo ka reduktuar peshën që ai zë në sistemin sanksionator. Në këtë aspekt, duke marrë në konsideratë dëmet e mëdha dhe përfitimet e pakëta që vijnë prej tyre, politika e caktimit të dënimit penal duhet të orientohet veçanërisht në drejtim të kufizimit të dënimeve afatshkurtëra me burgim (për vepra të lehta) dhe të dënimeve tepër të gjata dhe të paarsyeshme me burgim (Milla, 2008: 30-31). Sa i takon veprave të lehta të kryera nga persona jo të dhunshëm, burgimi i tyre duhet shmangur maksimalisht, duke hulumtuar alternativa të tjera më të zgjuara. Në këtë linjë logjike nga ana tjetër, në vend që Ligjvënësi të abrogojë procedurën e

²⁹⁸ Mund të sjellim në vëmendje p.sh. kontradiktën mes ashpërsimit të dënimeve për vepra të lehta si nenet 137, 199/a dhe 291, duke parashikuar për to vetëm dënim me burgim, me faljen e një viti burgim për çdo të dënuar mashkull dhe 1,5 vite për çdo të dënuar femër, pavarësisht veprës së kryer dhe rrezikshmërisë së tij/saj shoqërore.

gjykimit të shkurtuar për një kategori veprash të rënda penale²⁹⁹ (që parashikojnë dënim në minimum mbi 10 vite burgim), ka ngritur në 35 vite maksimumin e dënimit me burgim, duke e kthyer praktikisht edhe këtë lloj dënimi në një lloj burgimi të përjetshëm.

Indiferenca shtetërore për dëmin që shkakton burgu tek një qytetar, manifestohet më së miri me ligjin nr. 9381, datë 28.4.2005³⁰⁰, i cili ka ulur nga 5000 në 2000 lekë shumën e dëmshpërblimit për burgim të padrejtë (të cilat përbëjnë fare pak raste), ndërkohë që mbipopullimi i burgjeve është një problem shqetësues dhe shkalla e burgosjes është 2 herë më e lartë se mesatarja evropiane. Kjo tregon qartë se kjo politikë penale, nuk shqetësohet seriozisht jo vetëm për të drejtat e të burgosurve³⁰¹ (për kushte jetese të përshtatshme dhe qëllimin riedukues të burgimit), por edhe në aspektin ekonomik nuk e konsideron mbajtjen e një individi në burg, si një humbje të ekonomisë kombëtare.

Ashpërsimi në letër i marzheve të dënimeve ka sjellë një çoroditje të praktikës gjyqësore në lidhje me principet dhe konsekuencën në caktimin e dënimeve. Parashikimi nga legjislatori i marzheve të ndryshme dënimi për vepra të ngjashme penale ka pamundësuar unifikimin e praktikave dhe definimin e shinave udhëzuese nga GJL për raste të ngjashme³⁰². Kjo pamundësi objektive dëmon rëndë parimin e drejtësisë dhe të sigurisë juridike në lidhje me caktimin e dënimit, pasi lë shteg për abuzime në caktimin e një dënimi të drejtë.

Së fundmi, kriminalizimi i panevojshëm i veprave të lehta dhe të parrezikshme dhe ashpërsimi i atyre ekzistuese, i shoqëruar me fushata masive policore, ka shpërqendruar vëmendjen e organeve ligjzbatuese tek prioritetet e këtyre organeve. Siç rezultoi nga të dhënat sasiore të paraqitura më lart, fokusimi i goditjes penale ndaj veprave shumë të përhapura, si: vjedhja e energjisë elektrike, ushtrimi i lojërave të fatit pa licencë, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, ndërtimet e paligjshme etj. ka ulur zbulueshmërinë e veprave të rrezikshme të cilat kanë një ndikim të madh në perceptimin publik për nivelin e paqes dhe të sigurisë publike. Mbingarkimi shkallë-shkallë i policisë, prokurorisë dhe më tej i gjithë sistemit gjyqësor me një numër të pazakontë çështjesh penale, do të sjellë pashmangshmërisht dëme të rënda në cilësinë e kryerjes së hetimeve të thelluara dhe profesionale dhe më e rëndësishmja në dhënien e drejtësisë. Asnjë qytetar i pafajshëm nuk

²⁹⁹ Të cilat zënë një peshë fare të vogël në ngarkesën totale të punës së gjykatave, duke mos ndikuar në rëndimin e mëtejshëm të saj për këtë shkak.

³⁰⁰ Ligji “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”.

³⁰¹ Mungesa e ambienteve të përshtatshme, mungesa e fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike, plotësimi në mënyrë formale (pa u kryer në realitet si aktivitete) i dosjeve psiko- sociale, programeve individuale të trajtimit, këshillimeve individuale e në grup, etj. (Avokati i Popullit, 2015: 30), kanë bërë që burgimi në vendin tonë të jetë vetëm një vend izolimi dhe të mos luajë asnjë rol edukues dhe rehabilitues ndaj të burgosurve.

³⁰² Kështu p.sh. gjykatat, në varësi të rrethanave të kryerjes së veprës dhe të autorëve të saj caktojnë masa të ndryshme dënimi për vrasjen me dashje (nga 10-20 vite burgim), ndërkohë që për “mbajtjen pa leje të armëve luftarake” në vende publike, në të shumtën e rasteve caktojnë dënim në minimum prej 7 vitesh burgim. Ky qëndrim i gjykatave, është një lloj rezistence, ndaj disproporcionalitetit që paraqet dënimin prej 7-15 vite burgim për mbajtjen e një arme zjarri, ndërkohë që vepra të tjera shumë më të rrezikshme parashikojnë dënime më të lehta.

meriton të dënohet si sakrificë e luftës ndaj krimit, ashtu sikurse moszbulimi i çdo krimi të rëndë është mesazh inkurajues për keqbërës të tjerë të lëkundur.

Që në shekullin XVIII Montesquieu deklaronte se një ligjvënës i mirë, nuk duhet të shqetësohet shumë për dënimin e krimeve, sesa për parandalimin e tyre (2001: 99), ndërsa Beccaria, duke kritikuar ashpërsinë e dënimeve penale, këmbëngul që nëse duam të parandalojmë krimet, duhet që ligjet penale të jenë të thjeshta, të qarta dhe që e gjithë forca e kombit të drejtohet për të mbrojtur dhe asnjë pjesë e tij për të shembur (1973: 107). Ashtu si parandalimi i sëmundjeve është mënyra më e mirë për ruajtjen e shëndetit edhe kujdesi për faktorët kriminogjen është metoda më e mirë për ruajtjen dhe forcimin e paqes sociale. Në këtë drejtim, dënimi penal në Shqipëri duhet shërbejë vetëm si ndihmës i gjithë përpjekjeve të tjera të shoqërisë për uljen e kriminalitetit, por nuk mund të shërbejë si shkopi magjik për zhdukjen e tij. Dënimi penal duhet të heqë ankthin apo alarmin publik nga kriminaliteti, por s'mund ta zhdukë atë tërësisht.

Në sintezë të analizës së mësipërme, arrihet në përfundimin se parandalimi i përgjithshëm nuk duhet të përdoret fare si një justifikim për ashpërsimin e dënimeve nga Kuvendi dhe as si argumentim për përzgjedhjen e një dënimi më të rëndë nga gjykata. Parandalimi i përgjithshëm është dhe do të vazhdojë të mbetet edhe për shumë kohë një qëllim i së drejtës penale në përgjithësi (Hysi, 2010: 52)³⁰³, por është e gabuar që ai të përdoret si argument mbështetës për caktimin e dënimeve më të rënda. Dënimi i ashpër i një pjese të vogël të kryerësve të veprave penale, jo vetëm që nuk është efektive, por vazhdon të ushqejë padrejtësinë dhe paarsyetueshmërinë e së drejtës tonë penale. Dënimi për veprimet e gabuara është i drejtë, por dënimi i tepërt është padrejtësi, veçanërisht kur ligjet kufizojnë diçka që nuk duhet të jetë fare e paligjshme. Dënimi i tepërt dhe i panevojshëm është i gabuar dhe si për çdo veprim tjetër të gabuar ai duhet konsideruar i paligjshëm dhe për pasojë duhet ndaluar.

³⁰³ Përmes të gjithë mekanizmave të së drejtës penale, si: rritja e sigurisë së zbulimit dhe dënimit, dënimit të drejtë dhe të merituar, paaftësimi të personave të rrezikshëm, edukimit të shtetasve me frymën e respektimit të ligjit, rehabilitimit dhe risocializimit të të dënuarve, drejtësisë restauruese etj.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

1. Dënimi penal është lloji kryesor i sanksionit penal dhe në thelb ai përbën arsyen kryesore të ekzistencës së vetë të drejtës penale. E drejta penale nuk mund t'i shërbejë efektivisht shoqërisë, pa dënimin penal si një mjet shtrëngues i cili ju jepet personave që kryejnë vepra penale. Megjithatë, dënimi penal nuk duhet të konsiderohet si zgjidhja e parë e aq më pak e vetme për kontrollin social ndaj sjelljeve devijante. Shoqëritë demokratike bashkëkohore të cilat vlerësojnë vlerat e çdo qenie njerëzore e konsiderojnë të drejtën penale dhe dënimin penal si një mjet *ultima ratio* për arritjen e paqes dhe të sigurisë shoqërore.
 - Megjithë dëshirën e mirë që dënimi penal të shkëputet nga natyra e tij represive dhe shtrënguese, qëllimi i tij retributiv, paaftësues dhe parandalues, mbetet prioritar akoma në ditët e sotme në shumicën e legjislacioneve penale moderne në raport me idealin rehabilitues dhe drejtësinë restauruese. Megjithëse në shumë aspekte qëllimi ndëshkues vjen në kundërshtim jo vetëm me qëllimin edukues dhe rehabilitues, por madje edhe me atë të parandalimit të përgjithshëm, të gjitha legjislacionet e botës e pranojnë akoma bashkëekzistencën e njëkohshme të tyre. Nga ana tjetër, nuancat dhe pesha që këto qëllime zënë në secilin prej legjislacioneve penale bashkëkohore, i bën në mjaft raste këto sisteme të duken sikur praktikisht s'kanë asnjë të përbashkët me njëri tjetrin.
 - Duke bërë një renditje të qëllimeve prioritare të dënimit penal në vendin tonë, mund të themi se ashtu si në vendet e tjera ai ndjek qëllimin ndëshkues, paaftësues, parandalues (frenues) të përgjithshëm, parandalues të posaçëm, rehabilitues dhe restaurues. Sa i takon qëndrimin të praktikës gjyqësore mbi qëllimin e dënimit duhet të themi se ai është i varfër dhe gjykatat i referohen si qëllime të dënimit atij të parandalimit të posaçëm, të parandalimit të përgjithshëm, të edukimit dhe rehabilitimit të autorit, kryesisht në ato raste kur shtrohet për diskutim aplikimi i dënimeve alternative.
2. Sa i takon dënimit me vdekje, kërkimet shkencore të deritanishme mbi efektin e tij në SHBA nuk provojnë se ky dënim ndikon në uljen e numrit të vrasjeve në këtë vend. Megjithëse në vendin tonë dënimi kapital është shfuqizuar prej 16 vitesh, opinioni publik ka vazhduar të jetë në dominancë pro tij. Qëndrimi dominues publik ndaj dënimit me vdekje duhet marrë seriozisht jo si shenjë e mungesës së demokracisë, por si një kampanë alarmi për nivelin e lartë të dhunës dhe të emocioneve negative që promovohen në median shqiptare.
3. Dënimi me burgim të përjetshëm është një alternativë humane e dënimit me vdekje, për të pandehur të rrezikshëm, autorë të veprave të rënda penale, por parashikimi në nenet 29, 33, 64/3 dhe 65 të K. Penal i përfundimit të vuajtjes së tij me vdekjen në burg të të dënuarit, është në kundërshtim me qëllimet e dënimit penal dhe nga ana tjetër përbën një zgjedhje të gabuar përveç

aspektit human, edhe në atë ekonomik dhe social. Nga ana tjetër, parashikimi i këtij sanksioni të rëndë edhe për vepra të kryera me pakujdesi si nenet 110/a §5, apo 298 §3 është krejtësisht i pavend.

4. Dënimi me burgim është dënimi më i rëndë pas dënimit me burgim të përjetshëm dhe zë vend parësor në sistemin e sanksioneve penale shqiptare pasi parashikohet si dënim alternativ me gjobën në 186 dispozita apo 55.7 % të tyre dhe në 140 të tjera apo 42% parashikohet si dënim i vetëm ose së bashku me dënimin me burgim të përjetshëm (pra nga 334 nene të pjesës së posaçme). Dënimi me burgim aktualisht parashikohet si dënim i vetëm jo vetëm për krime me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, por edhe për vepra jo të dhunshme të drejtuara kundër pasurisë, apo për vepra të tjera të lehta.

➤ Studimet empirike dhe ato krahasuese kanë provuar se burgimi i zakonshëm klasik bën pak ose aspak për përmirësimin e personave të dënuar. Studimet e zhvilluara mbi eksperiencën gjermane kanë provuar se personat e dënuar me gjobë kanë një shkallë rikriminalizimi (përsëritje të një veprë tjetër penale pas dënimit të dhënë) prej 28%, ato të dënuar me burg me kusht 41% dhe ata me burgim 52%. Këto studime dhe kontrasti mes vendeve nordike dhe SHBA mbështesin qëndrimin se burgimi është një mënyrë e kushtueshme për të bërë keqbërësit njerëz akoma më të këqinj.

➤ Në vitin 1995 Shqipëria kishte një shkallë prej 36 të burgosur për 100.000 banorë, ndërkohë që prej një viti ka tejkaluar 200 të burgosur (gjashtëfishuar). Përveç shtimit të aplikimit të arrestit në burg si masë sigurimi, mbipopullimi i burgjeve në vendin tonë ka ardhur si rezultat i ashpërsimit të politikës penale si në drejtim të shtimit të veprave të reja penale, ashtu dhe në rëndimin e shumicës së sanksioneve për veprat ekzistuese. Shqipëria ka një normë shumë më të lartë të të burgosurve se Italia dhe padyshim ofron standarde më të ulëta të trajtimit të tyre në institucionet korrektuese, prandaj nëse shteti shqiptar nuk ndërmerri masa të shpejta dhe efektive për të ulur numrin e të burgosurve dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të tyre, probabiliteti i dënimit edhe të Shqipërisë nga GJEDNJ është shumë i lartë në rast eventual të ankimit pranë saj nga ndonjë i dënuar me burgim.

➤ Pjesa më e madhe e të burgosurve përbëhet nga shtresat më të pambrojtura dhe më fatkeqe të shoqërisë, si të varfrit, të papunët, të paarsimuarit, të pastrehët, të sëmurët mendorë, të alkoolizuarit apo toksikopendentët, jetimët, emigrantët, apo minoritetet racore. Nga ky këndvështrim burgu përpiqet të zëvendësojë mungesën e një sistemi mirëqenieje dhe përkujdesjeje shëndetësore, e cila neglizhon shtresat më nevojtare të shoqërisë.

5. Megjithatë në mjaft vende dënimi me gjobë ka rezultuar një nga alternativat më të suksesshme, duke i rezervuar një hapësirë më të gjerë të aplikimit të saj (ku p.sh. në Gjermani prej 4 dekadash zë rreth 85 % të gjithë dënimeve), në vendin tonë ai paraqitet inferior dhe

aplikimi i tij në vitin 2014 ka qenë më pak se 20% të totalit të dënimeve. Dënimi me gjobë parashikohet aktualisht në K. Penal shqiptar si dënim alternativ i dënimit me burgim në 186 nene të pjesës së posaçme dhe si dënim i vetëm në 8 dispozita. Nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore vërehet se gjoba nuk aplikohet as për vjedhje me vlerë të vogël, ndërkohë që aplikohet për vepra të tjera kundër pasurisë me vlerë dëmi më të madhe.

- Ndryshimet e bëra në K. Penal me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 të cilat kanë dhjetëfishuar masat e dënimit me gjobë (si për krime ashtu edhe për kundërvajtje) kanë qenë të pastudiuara dhe kanë ndikuar negativisht në frenimin e aplikimit të këtij dënimi. Dënimi me gjobë ashtu si edhe dënimi me burgim kanë për qëllim edukimin e fajtorëve dhe të komunitetit dhe jo rrënimin e tyre ekonomik. Është e paarsyeshme që minimumi i dënimit me gjobë sipas legjislacionit shqiptar të jetë sa trefishi i pagës minimale mujore dhe disa herë më i lartë në vlerë absolute se i Greqisë, Italisë, Finlandës, Francës apo Gjermanisë për të cilët varion nga 1 euro deri në maksimumin e të ardhurave ditore të të pandehurit. Megjithëse në shumicën e rasteve masa e dënimit me gjobë e caktuar nga gjykata është shumë më afër minimumit të parashikuar nga neni 34 i K. Penal (në kundërshtim me interpretimin strikt të kriterëve të caktimit të dënimit), përsëri ato vlerësohen si të larta krahasuar me nivelin ekonomik mesatar të shoqërisë shqiptare.
- Masat e dënimit me gjobë në K. Penal kanë në diferencë të madhe jo vetëm me masat e dënimit me gjobë që parashikohen në K. Penal ushtarak, por vijnë në kontradiktë logjike edhe me minimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga neni 32 i K. Penal dhe konvertimin e tij në gjobë. Po ashtu masa e minimumit të gjobës ka një hendek logjik akoma më të dukshëm edhe me parashikimet e nenit 63 të K. Penal ku gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit me burgim duke detyruar kryerjen e një pune në interes publik për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë (pra nga 5 deri në 30 ditë pune).
- Megjithëse paragrafi 6 i neni 34 aktualisht parashikon detyrimin e gjykatës për të hetuar rreth aftësisë paguese të personit, ai nxjerr në pah disa probleme procedurale që kanë të bëjnë me cënimin e paanësisë së saj në rast të kalimit të saj të përhershëm në një rol aktiv dhe me shtyrjen e gjyqeve penale për të hetuar rrethana të tilla (sidomos në rastet e gjykimit të shkurtuar). Po ashtu, neni 34 nuk e lidh gjendjen pasurore dhe financiare të të pandehurit me masën e gjobës që do të caktojë gjykata, por vetëm me aftësinë për ta paguar apo jo masën e gjobës që gjykata vlerëson se duhet të caktojë.
- Sa i takon konvertimit të gjobës në burgim, rregullimi që i është bërë paragrafëve, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 34 e ka zgjidhur në një masë të madhe çështjen e mosburgosjes së shtetasve për shkak të paaftësisë së tyre paguese, megjithëse përsëri në disa raste më të rralla mund të ngrihen përsëri pretendime për antikushtetueshmëri të kësaj norme.

- Ashtu si për personat fizikë, vlerësojmë se gjobat e sheshta për personat juridikë nuk janë të përshtatshme, pasi nuk ofrojnë një fleksibilitet të përcaktimit të tyre në raport me rrezikshmërinë e veprës dhe sidomos me mundësitë financiare të personit juridik.
- 6. Sa i takon dënimeve plotësuese kuadri ligjor është përgjithësisht i plotë, por ka mangësi në zbatimin e tyre në praktikë. Kështu, megjithë faktin se neni 35 §1 e parashikon si të detyrueshëm caktimin e ndalimit për të ushtruar funksione publike, në jo pak raste gjykatat nuk e kanë aplikuar atë, megjithëse i kanë deklaruar fajtorë të pandehurit për këto vepra. Nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore vërehet se kohëzgjatja e këtij dënimi është gjithnjë në minimumin e parashikuar nga ligji (pesë vite), madje në raste të caktuara është ulur edhe nën minimum. Sa i takon paragrafit të dytë të këtij neni, megjithëse rastet e personave të deklaruar fajtorë në këto marzhe dënimi janë shumë herë më të përhapura se veprat penale të parashikuara në paragrafin e parë, lënia e caktimit të tij në diskrecion të gjykatës, ka bërë që frekuenca e aplikimit të këtij dënimi plotësues (sipas paragrafit të dytë) të jetë thuajse inekzistente.
- 7. Sa i takon masave mjekësore, nisur nga fakti se mjekimi ambulator kufizon më pak lirinë, ka kosto më të ulëta dhe ofron një ambient më të përshtatshëm psiko-social përmirësues për të sëmurin, gjykata duhet të përzgjedhë gjithnjë si prioritare këtë masë, në rastet kur nga akti i ekspertimit dhe nga rrethanat çmohet se garantohet ndjekja e rregullt e mjekimit. Sa i takon masave edukuese, neni 46 i K. Penal ka mbetur një dispozitë e vdekur teorike, pa një mundësi zbatimi në praktikë, pasi që nga viti 1993 nuk ka asnjë institucion riedukimi për të miturit. Po ashtu, K. Penal shqiptar paraqet mangësi në lidhje me masat mjekësore për personat e varur nga alkooli dhe lëndët narkotike, apo masa të veçanta trajtimi ndaj personave me delinkuencë habituale.
- 8. Në lidhje me diskrecionin gjyqësor në caktimin e dënimit, megjithëse sistemi i dënimeve të papërcaktuara (sistemi arbitrar) dhe ai i dënimeve fikse (sistemi absolut) ia kanë lënë vendin sistemit relativ (me minimum dhe maksimum të përcaktuar), përsëri në të drejtën tonë penale janë shfaqur reminishenca të dënimeve fikse. Në mjaft dispozita të pjesës së posaçme të K. Penal vihen re një diskrecion i pakët gjyqësor në përzgjedhjen e llojit të dënimit, por nga ana tjetër një diskrecion tepër i gjerë në përzgjedhjen e masës së dënimit.
- Mungesa e një pune të thellë studimore duke u bazuar pse jo edhe në praktikat ligjore të vendeve më të zhvilluara demokratike si dhe ndërhyrjet e shpeshta në sanksionet penale të shumicës së figurave të veprave penale kanë sjellë një çoroditje të sanksioneve penale të parashikuara në pjesën e posaçme të kodit. Në jo pak nene është e pamundur të identifikohet një ligjësi e qartë se mbi çfarë kriteresh logjike janë përcaktuar nivele të caktuara sanksionesh, apo përse në atë rast aplikohen sanksione të ndryshme nga vepra të tjera me rrezikshmëri të ngjashme. Në shumë dispozita penale gjejmë paradokse dënimesh ku një vepër që rrezikon dënohet më

rëndë se një vepër që dëmton, apo një pasojë e ardhur nga pakujdesia dënohet më rëndë se një e shkaktuar me dashje.

- Në rastin e dënimit me gjobë, legjislatori nuk përcakton marzhet e gjobës për çdo vepër konkrete, duke i lënë hapësirë gjykatës të zgjedhë masën konkrete brenda kufijve të përcaktuara nga neni 34 i K. Penal. Ky diskrecion i gjerë gjyqësor është i panevojshëm dhe i pajustificuar, pasi nuk ka asnjë arsye të shëndoshë që të aplikohet një politikë e ndryshme diskrecionale për burgimin në raport me gjobën.
- Diskrecioni gjyqësor për individualizimin e dënimit është i domosdoshëm, pasi ligjvënësi e ka të pamundur të parashikojë çdo lloj rrethane konkrete të çdo rasti kriminal. Prej saj rrjedh se çdo lloj hapësire diskrecioni do të vlerësohet e tepërt për rrethana të zakonshme, të cilat mund të parashikohen lehtë nga ligjvënësi. Lënia gjykatës e një hapësire diskrecioni jo të domosdoshëm vjen në kundërshtim me vetë *ratione*-n e garantimit të tij. Pra fusha e vlerësimit gjyqësor duhet të rezervohet vetëm për situata dhe rrethana të veçanta, apo kombinime të tillash, të cilat nuk janë të përditshme dhe të sigurta se do të ndodhin. Nga ky arsyetim mund të konkludojmë se ligjvënësi duhet të kufizojë diskrecionin e panevojshëm gjyqësor, duke i përshkallëzuar veprat penale në disa nivele me hapësira më të ngushta diskrecioni në varësi të rrethanave konkrete. Kjo nënkupton ndarjen e figurave të veprave penale në disa paragrafë, apo edhe në nene më vete.
- Probleme të mëdha me një diskrecion të gjerë apo një politikë e papërshtatshme dënimi hasen dhe në institutet e pjesës së përgjithshme. Duke qenë se neni 23 §2 i njeh gjykatës një diskrecion të gjerë dhe të panevojshëm, kjo dispozitë duhet të bëjë një detajim më të plotë të caktimit të dënimit për tentativën e plotë dhe atë të metë. Për të parën, ulja e dënimit nën minimum mund të parashikohet si përjashtim në varësi të afërsisë së ardhjes së pasojave, ndërsa për tentativën e metë ligji duhet të jetë më i butë dhe të parashikojë ulje të dënimit ndjeshëm nën minimum (nga 1/3 deri në 2/3 poshtë minimumit të dënimit), apo caktimin e një lloji dënimi tjetër më të butë.
- Neni 17 §2 i K. Penal paraqet probleme të mëdha në skaje të kundërta, si përsa i takon nga njëra anë ngushtësisë së alternativave të dënimit dhe nga ana tjetër papërcaktueshmërisë së zbutjes së dënimit. Kodi ynë penal parashikon caktimin e masave mjekësore vetëm ndaj personave të papërgjegjshëm, mirëpo për ata që kanë qenë pjesërisht të përgjegjshëm për shkak të uljes së ekuilibrit mendor, parashikohet caktimi i të njëjtave lloje dënimi sikurse ndaj personave të shëndetshëm mendërisht.
- Një dispozitë tjetër e ngjashme me të mësipërmen, është neni 18 i K. Penal. Duke qenë se dehja mund të ulë në masë të madhe aftësinë gjyqësore të subjekteve, trajtimi i saj në çdo rast thjesht si rrethanë e zakonshme lehtësuese është në kundërshtim me parimin e dënimit proporcional në raport me fajësinë dhe me nevojat rehabilituese.

- Edhe neni 28 i K. Penal është tepër i përmblodhur dhe nuk detajon në mënyrë të qartë masën se sa ndikon shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe roli dytësor i luajtur, në zbutjen e dënimit. Duke qenë se ligji nuk e parashikon mundësinë e uljes së dënimit nën minimum, atëherë ashtu si për rrethanat e tjera të trajtuara më lart (dehja dhe turbullimi psikik) edhe shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe roli dytësor i bashkëpunëtorit do të trajtohen thjesht si një rrethanë lehtësuese. Ky kufizim e bën zero nga pikëpamja ligjore efektin zbutës të këtyre rrethanave po të mbahet parasysh se nga ana tjetër pavarësisht rolit të luajtur, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale përbën një rrethanë rënduese.
 - Kodi aktual penal nuk i ka njohur gjykatës të drejtën për të pushuar çështjen penale, apo për ta përjashtuar të pandehurin nga dënimi në rastet kur një veprim i cili formalisht përbën vepër penale, nuk paraqet rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore.
9. Caktimi i dënimit nga gjyqtari duhet të mbështetet në disa parime të rëndësishme të së drejtës penale, respektimi i të cilave kufizon diskrecionin e tij, duke e udhëzuar në dhënien e një dënimi të drejtë dhe të parashikueshëm. Këto parime janë: parimi i ligjshmërisë (me nënparimet e tij), i proporcionalitetit (me nënparimet e tij), i barazisë, i drejtësisë si dhe parimi i humanizmit.
- Parimi i proporcionalitetit është parimi më i rëndësishëm i së drejtës penale. Ai konsiderohet sot si parimi themelor i shtetit të së drejtës dhe elementi përcaktues i kushtetueshmërisë së dënimit penal. Përcaktimi i marzheve të dënimit ligjor mbi bazën e parimit të proporcionalitetit sipas teorisë së meritës së drejtë, shërben si një udhëzues i arsyeshëm për legjislatorin, ndërkohë që brenda këtyre marzheve, gjyqtari përdor përveç meritës së drejtë edhe konceptin utilitarist evropian të proporcionalitetit për të realizuar qëllimin paaftësues, parandalues dhe edukues të dënimit konkret. Parimi i proporcionalitetit, jo vetëm që është kundër dënimeve fikse, por kërkon që legjislatori t'i lejojë gjykatës diskrecionin e mjaftueshëm për të përzgjedhur një dënim të përshtatshëm në praktikë. Me rritjen e vëmendjes së jurisprudencës kushtetuese mbi këtë parim, shumë K. Penale ballkanike si ai i Kosovës, Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Malit të zi dhe Serbisë e kanë bërë pjesë të shprehur parashikimin e parimit të proporcionalitetit apo/dhe të domosdoshmërisë së dënimit penal.
 - Sipas nënparimit të ekonomisë së dënimit, për personat që kryejnë vepra jo të dhunshme dhe tek të cilët mund të realizohen qëllimet e dënimit edhe përmes masave të tjera, duhet zgjedhur ai lloj dënimi i cili siguron raportin më të lartë kosto-përfitim. Nga këndvështrimi ekonomik, burgimi është masa penale më e kushtueshme dhe për rrjedhojë ai duhet aplikuar vetëm në rastet kur çdo dënim tjetër është i papërshtatshëm. Dy dënimet më të admirueshme sipas kërkesave të këtij parimi janë dënimi me gjobë (për personat të cilët kanë të ardhura) dhe puna në shërbim publik (për personat e papunë dhe pa të ardhura). Pas tyre vijnë burgu në shtëpi dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë.

- Parimi i barazisë. Në vlerësimin tonë, barazia formale është vetëm një udhëzues fillestar, pasi gjykata duhet të orientohet drejt një barazie substanciale dhe të vërtetë. Në mënyrë që barazia substanciale të mos jetë thjesht një pretekst abuziv për trajtimin e ndryshëm të qytetarëve, zbatimi i saj në praktikë duhet të kufizohet nga një parim tjetër që është ai i arsyetueshmërisë. Vetëm justifikimi i trajtimit të ndryshëm mbi të dhëna objektive dhe të arsyeshme, mund të legjitimojë diskrecionin gjyqësor për të zgjedhur llojin dhe masën e dënimit konkret. Në aspektin teorik ngrihen probleme të përcaktimit të rrethanave të cilat janë të arsyeshme për të bërë një trajtim të diferencuar të personave të ngjashëm, ndërkohë që në aspektin praktik ngrihet problemi i zbatimit të drejtë të këtij parimi, duke vështirësuar ndalimin në çdo rast të abuzimit me të. Për këto arsye, mekanizmi më efektiv në kontrollin e zbatimit të drejtë të parimit të barazisë në caktimin e dënimit, është detyrimi për arsyetimin e qartë të rasteve kur gjykatat caktojnë dënime të ndryshme për të pandehur në rrethana “në dukje të ngjashme”.
 - Konsistenca në caktimin e dënimit nuk ka ndonjë vlerë morale nëse trajtohet si detyrimi i gjykatës për të caktuar lloje dhe masa dënimi të njëjta për raste “dukshëm të ngjashëm”, por vetëm nëse trajtohet si zbatim i njëllotë i parimeve të mësipërme në çdo rast të caktimit të dënimit.
 - Parimi i humanizmit kërkon që gjyqtarët të mbajnë në konsideratë dhe ndjenja të tilla njerëzore si keqardhja, dhembshuria, mëshira, apo falja, të cilat duhet të ndikojnë në zbutjen e magnitudës së forcës shtrënguese të shtetit për keqbërjen e kryer.
10. Ekzistenca e njëkohshme e disa qëllimeve, megjithëse në dukje e dëshirueshme, sjell konflikte të mëdha në momentin e caktimit të dënimit. Këto konflikte shfaqen për shkak se secili prej qëllimeve kërkon që gjykata t’u referohet kritereve të ndryshme për të bërë individualizimin e dënimit, duke prodhuar kështu dënime të ndryshme. Mungesa e një parashikimi të shprehur në K. Penal për të përcaktuar qëllimin prioritar, ka bërë që praktika gjyqësore të jetë e metë dhe inkonsistente në referimin ndaj qëllimeve të dënimit penal. Megjithëse qëllimi ndëshkues është në thelb të nenit 47 të K. Penal shqiptar, dhe qëllimet paaftësuese dhe restauruese janë poashtu qëllime të pamohueshme, moscitimi i tyre në praktikën gjyqësore, bën që në shumë raste masat e dënimit që caktojnë gjykata të jenë në rastin më të keq të padrejta dhe në rastin më të mirë të paarsyetuara.
11. Duke qenë se caktimi i dënimit është një nga pjesët më të rëndësishme të vendimit penal të fajësisë, prej saj buron rëndësia e madhe e arsyetimit të ushtrimit të këtij pushteti diskrecional nga gjykata. Nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore konstatohet se, megjithëse pjesa e disponimit mbi caktimin e dënimit zë pjesën më të madhe të dispozitivit të vendimeve penale, pjesa arsyetuese që i korrespondon këtij disponimi, në shumicën e rasteve zë më pak se një faqe dhe jo në pak raste vetëm një fjali.

12. Sa i takon rrezikshmërisë së veprës penale, elementi i parë dhe më i rëndësishëm i përcaktimit të saj është vlera shoqërore e së mirës së cënuar prej saj. Më tej brenda një të mire mund të ketë ndarje të mëtejshme, nisur nga rëndësia apo madhësia e pasojës. Një element tjetër i rëndësishëm i përcaktimit të rrezikshmërisë shoqërore të një veprë janë dëmtimi i një objekti dytësor, i cili ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale. Shkalla e dëmtimit të objektit dytësor ndikon në rrezikshmërinë e veprës njësoj si dëmtimi i objektit kryesor.

➤ Rrethanë tjetër që ndikon në rrezikshmërinë e veprës është lidhja shkakësore e qartë mes veprimit dhe pasojës. Një rrethanë tjetër e arsyeshme e cila duhet të mbahet në konsideratë nga gjykata në uljen e dënimit, është dhe mungesa e aktualitetit të veprës penale.

13. Personaliteti i kryerësit të veprës penale dhe rrezikshmëria e tij shoqërore janë shumë të rëndësishme, por tejet të vështira për t'u analizuar dhe çmuar me objektivizëm nga gjykata në caktimin e dënimit, pasi provat me të cilat mund të merren të dhëna në lidhje me këto fakte janë të kufizuara. Duke qenë se rrezikshmëria e ndryshme shoqërore e të pandehurve që kanë kryer të njëjtën vepër penale të çon në dënime të ndryshme, është detyrim esencial i gjykatës që të arsyetojë në çdo rast shkaqet që e kanë shtyrë dhe peshën e tyre specifike, në arritjen e atij përfundimi. Vlerësimi i rrezikshmërisë së të pandehurit është një nga momentet ku gjykatës i njihet një diskrecion i gjerë, prandaj vetëm dhënia e arsyeve bindëse në vendim heq dyshimet për arbitraritet dhe abuzivizëm.

14. Sa i takon rrethanave të ndryshme lehtësuese dhe rënduese, jo vetëm që ato nuk kanë një peshë të njëjtë me njëra tjetrën por edhe e njëjta rrethanë s'mund të ketë gjithnjë të njëjtën peshë në çdo rast, për shkak se intensiteti i paraqitjes së saj nuk është në çdo rast i njëjtë.

15. Në shumicën e veprave të lehta dhe jo të dhunshme, në vend të burgimit, gjyqtarët duhet të përzgjedhin me prioritet gjobën dhe dënimet alternative. Nëse gjykata çmon se dënimi me burgim është i nevojshëm për qëllimet e dënimit, masa e tij për këto vepra duhet të jetë afër minimumit. Për shkak të justifikimit më të madh të qëllimeve ndëshkuese, paaftësuese dhe parandaluese dhe mbetjes më në hije të qëllimit riedukues, në veprat e dhunshme të kryera me dashje, gjykata duhet të fillojë matjen e dënimit me burgim nga mesi i marzheve të dënimit dhe të lëvizë brenda tyre në varësi të rrethanave konkrete, të cilat sugjerojnë për një zbutje apo një ashpërsim të dënimit.

16. Megjithë nevojën për një trajtim thelbësisht të ndryshëm, kodi ynë penal nuk reflekton mjaftueshëm zhvillimet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale për të miturit dhe modelet më të mira të K. Penale të vendeve të ndryshme evropiane. Kodi ynë ka një rregullim shumë të cekët për të miturit, duke i dedikuar dënimit të tyre vetëm dy dispozita të shkurtra, përkatësisht dënimit me burgim dhe përjashtimit të tyre nga dënimi.

➤ Neni 51 bën përgjysmimin e marzheve vetëm për dënimin me burgim, por nuk e zbaton këtë rregull për dënimin me gjobë apo dënimet alternative, të cilat duhet të jenë dënimet më të

zakonshme që duhet t'u caktohen të miturve. Përgjysmimi i marzheve të dënimit me burgim, megjithëse përbën një masë humane dhe të arsyeshme, në jo pak raste nuk ka dhënë efektin e duhur, pasi duke zgjedhur maksimumin e dënimit për këtë kategori, gjykatat kanë caktuar një dënim të përafërt me të rriturit.

- Sa i takon përjashtimit të të miturit nga dënimi, megjithëse kuptimi i kësaj dispozite është i qartë, mosdetajimi i saj për rrethanat konkrete dhe sidomos mungesa e infrastrukturës për zbatimin në praktikë të masave edukuese, ka bërë që ky institut të aplikohet pak ose aspak nga gjykatat shqiptare.

16. Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë. Neni 53/a i K. Penal (i shtuar me ligjin nr. 98/2014) është një dispozitë tërësisht e gabuar dhe përbën shprehjen e saj më të qartë të ndjekjes së një politike paarsyetueshmërisht të ashpër penale. Në mënyrë të qartë kjo dispozitë pranon gabimin për heqjen apo mosparashikimin e dënimit me gjobë si dënim alternativ të dënimit me burgim për shumë dispozita të pjesës së posaçme të K. Penal dhe nga ana tjetër vendos disa kritere tepër të rrepta për konvertimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë. Duke shkelur këto parime, kjo dispozitë legjitimon dënimin me burgim të të varfërve. Një vështirësi tjetër e zbatimit të kësaj dispozite vjen nga fakti se aktualisht është vetëm një nen në pjesën e posaçme (neni 291) e cila lejon konvertimin e dënimit me burg në dënim me gjobë.

- Një alternativë tjetër e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë është neni 54 i K. Penal. Në vlerësimin tonë ashtu si dispozita e mësipërme, edhe ky nen mbart probleme të thella konceptuale dhe parimore dhe si i tillë ka qenë i destinuar të mos aplikohet asnjëherë në praktikë.

17. Bashkimi i dënimeve. Sistemi i përthithjes së dënimit më të lehtë nga dënimi më i rëndë duhet të aplikohet në rastet kur vepra kryesore është ndjeshëm më e rëndë se vepra e dytë, pra kur kryerja e një apo disa veprave penale shtesë (përveç veprës më të rëndë) nuk tregon për një rrezikshmëri më të madhe të fajtorit.

- Prej këtij arsytimi nxjerrim edhe përfundimin se në rastin e zbatimit të dënimit më të rëndë të shtuar, shumta përfundimtare është afër dënimit më të rëndë (pra një lloj përthithje thuajse e plotë), kur vepra më e lehtë nuk tregon ndonjë rrezikshmëri të madhe shtesë dhe shkon drejt bashkimit matematikor në rastin kur veprat kanë një rrezikshmëri të ngjashme. Në praktikë është vështirë që të justifikohet një bashkim matematikor, pasi edhe nëse rrezikshmëria e dy veprave dyfishohet, kjo nuk mund të thuhet edhe për autorin, pasi rrezikshmëria e tij nuk mund të dyfishohet apo trefishohet. Një element tjetër kufizues i bashkimit matematikor është qasja utilitariste, në lidhje me përshtatshmërinë e një dënimi, i cili do të rezultonte panevojshmërisht i rëndë për qëllimet e dënimit.

18. Dënimet alternative. Miratimi i ligjeve nr. 10023 dhe nr. 10024, datë 27.11.2008 dhe i akteve normative të mëvonshme përbëjnë hapa pozitivë për përmirësimin e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim. Megjithë ndryshimet ligjore dhe kontributin e jurisprudencës së GJK dhe GJL, ndikimi i tyre në praktikën gjyqësore ka qenë përsëri i pamjaftueshëm për të kundërbalancuar presionin politik dhe publik pro burgimit. Megjithëse aplikimi i dënimeve alternative ka ardhur duke u rritur, kjo rritje vetëm sa ka kompensuar ekspansionin që ka pësuar K. Penal nga shtimi i veprave të reja penale, braktisja e dënimit me gjobë si dhe nga rritja e personave të proceduar nga prokuroria.

- Megjithëse pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim është dënimi më i rëndësishëm alternativ dhe më i zbatuar në praktikën gjyqësore, niveli i aplikimit të tij në vendin tonë është dukshëm më i ulët se në shumë vende të tjera të zhvilluara evropiane. Megjithë synimin e ndryshimeve ligjore të vitit 2008 për rritjen e aplikimit të këtij instituti, ai ka vazhduar një trend të lehtë rritës vetëm në vlerë absolute, ndërkohë që aplikimi i tij në raport me totalin e të dënuarve me burgim deri në 5 vite (në përqindje) ka vijuar pothuajse konstant (në nivelin e 21-26 % dhe vetëm në vitin 2014 ka arritur në 30.7%).
- Nisur nga mungesa e një justifikimi të kënaqshëm logjik të gjysmëlirisë dhe vështirësitë praktike të ekzekutimit të saj, ky institut nuk ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore. Prandaj në vlerësimin tonë ky institut duhet të reformohet ose të shfuqizohet si jofunksional.
- Aplikimi si dënim alternativ i punës së papaguar (në shërbim publik) ka filluar me ngritjen e shërbimit të provës, mirëpo megjithëse frekuenca e caktimit të saj ka ardhur duke u shtuar çdo vit, ajo paraqitet përsëri shumë e ulët në raport me vlerat pozitive që ka ky dënim për edukimin dhe përmirësimin e të dënuarve (kryesisht pa të ardhura).
- Zgjatja e afateve të lirimit para kohe me kusht ka qenë një hap antishkencor dhe ka kontribuar në rritjen e mbipopullimit të burgjeve. Rregullimi i tij aktual është një tjetër tregues i ashpërsisë së paarsyeshme të politikës sonë penale.

19. Në masën më të madhe, ndërhyrjet e shumta të kryera në K. Penal janë orientuar drejt miratimit të veprave të reja penale dhe ashpërsimit të dënimeve për veprat ekzistuese. Këto ndryshime ligjore kanë qenë të ngutura dhe të pastudiuara, jo vetëm sa i takon teknikës legislative dhe konceptimit të K. Penal si një korpus dispozitash të harmonizuara, por së pari në aspektin substancial, sa i takon thelbit dhe qëllimit të kryerjes së tyre. Në shumicën e rasteve ashpërsimet e sanksioneve penale (qoftë në pjesën e përgjithshme, qoftë në pjesën e posaçme) janë argumentuar nga ligjvënësi me synimin e tij për luftimin e kriminalitetit. Ky justifikim politik është zbatuar me fushata periodike, sa herë që në opinionin publik dhe mediatik është ngritur shqetësimi për rritjen apo përhapjen e madhe të një fenomeni të caktuar antisocial. Nga njëra anë maxhorancat politike kanë ashpërsuar vazhdimisht masat e dënimeve për shumë vepra

penale, me argumentin se dënimet e caktuara nga gjykatat kanë qenë të buta dhe nga ana tjetër kanë miratuar disa ligje amnistie për kategori të gjera të dënuarish, pa marrë parasysh rrezikshmërinë e tyre dhe të veprës së kryer.

- Ashpërsimet e vazhdueshme të dënimeve kanë bërë që Shqipëria të ketë sot dënime më të ashpra në Evropë. Shkalla e lartë e burgosjes dhe të dhënat e publikuara nga KE për nivelin e dënimeve me burgim pasqyrojnë qartë ashpërsinë e politikës penale të ndjekur në vendin tonë, në raport me vendet demokratike evropiane. Nga të dhënat e KE vërehet se mesatarja e kohëzgjatjes së një dënimi me burgim në Shqipëri në vitin 2008 ishte më shumë se dyfishi i mesatares evropiane (2011: 85) dhe nga të dhënat më të përditësuara të KE rezulton se Shqipëria ka një aplikim ndjeshëm më të gjerë (në raport me numrin e popullsisë) të dënimeve të rënda 5-10 vite, 10-20 vite, mbi 20 vite dhe të burgimit të përjetshëm (2014: 110).

20. Nga ana tjetër, nga studimet e shumta (të huaja) mbi efektin frenues të dënimit, është konkluduar se provat nuk mbështesin ndonjë përfitim domethënës marginal të sigurisë publike nga praktika e ngritjes dhe ashpërsimit të dënimeve.

- I njëjti përfundim rezultoi edhe nga analizimi i efektit frenues të dënimeve të ashpra në vendin tonë. Nga analiza tërësore dhe ajo e fokusuar në disa vepra rezultoi se masat e dënimit nuk kanë ndonjë ndikim në uljen apo rritjen e kriminalitetit. Megjithëse në 20 vitet e fundit masat e dënimit kanë pësuar rritje për një numër të madh veprash penale, kjo nuk është reflektuar në një ulje të nivelit të kriminalitetit, i cili përkundrazi ka pësuar rritje për shumë kategori veprash penale.
- Nga studimi i dinamikës së veprave penale të vrasjeve me dashje rezultoi se ashpërsimet e skajshme të dënimeve për to nuk kanë sjellë asnjë efekt të matshëm frenues. Ashpërsimet e dënimeve për vrasjet me paramendim dhe ato të cilësuar, duke filluar nga viti 2001 dhe duke përfunduar në vitin 2013 nuk kanë dhënë asnjë efekt zbritës, madje numri i viktimave ka pësuar një rritje të lehtë. Nga ana tjetër nga ky studim rezultoi e qartë se në ndryshim nga ashpërsia e dënimeve, siguria e marrjes së dënimit ka një efekt të konsiderueshëm frenues në uljen e vrasjeve me dashje. Vrasja e thjeshtë me dashje ka pësuar ulje të saj megjithëse asnjëherë nuk i janë ashpërsuar dënimet, ndërkohë që vrasjet e tjera të cilat kanë dënime shumë më të rënda kanë pësuar rritje. Pra shqiptarët nuk vrasin më shumë se evropianët e tjerë sepse dënimet që kemi nuk i frikësojnë sa duhet, por përveç të tjerave sepse siguria e dënimit të tyre është e ulët, apo se perceptimi publik për këtë siguri është akoma më i ulët.
- Në lidhje me veprat e tjera penale me rrezikshmëri të lartë të analizuar në punim, për të cilat numri i të dënuarve është rritur, është e qartë se dënimi i tyre nuk ka pasur ndonjë efekt të ndjeshëm frenues për uljen e kriminalitetit. Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 2 provojnë se megjithëse gjatë 10 viteve janë dënuar 2860 persona sipas nenit 283, kjo nuk ka dhënë asnjë efekt

në frenimin e kryerjes së kësaj veprë. Pesëfishimi i të dënuarve në vit për këtë vepër penale (krahasuar me vitin 2004), nuk ka shërbyer aspak për uljen e numrit të konsumatorëve dhe as të shpërndarësve të lëndëve narkotike.

- Po njësoj, fakti se numri i procedimeve penale për mbajtjen pa leje të armëve luftarake në vitin 2014 nuk është ulur, madje ka pësuar rritje, është një provë tjetër se ashpërsimi i dënimeve nuk luan ndonjë rol frenues shtesë në uljen e kriminalitetit.
- Nga ana tjetër për shkak të formës së fajësisë, megjithëse marzhet e dënimit të parashikuara nga neni 290 janë tepër të larta, ato nuk kanë arritur të ndikojnë në uljen e pasojave nga aksidentet rrugore.
- Sa i takon veprave me rrezikshmëri të lartë të cilat kanë pësuar ulje të numrit të të dënuarve, kjo nuk ka ardhur si rrjedhojë e dënimeve penale të ashpra, por si rrjedhojë e rritjes së sigurisë së dënimit të tyre, apo e uljes së nxitjeve dhe motiveve që individët kanë për t'i kryer (falsifikimet, kontrabanda apo në mënyrë të veçantë neni 298).
- Ashtu siç rezultoi për vrasjet, nga ky studim vihet re qartazi se dënimi në vijimësi i vjedhësve (neni 134) nuk ka pasur asnjë efekt frenues, pasi numri i personave të dënuar për këtë vepër është dyfishuar në harkun kohor të 10 viteve. Mungesa e efektit frenues të ashpërsimit të politikës së dënimit provohet edhe tek veprat e tjera penale të cilat në vitet e fundit kanë pasur një përhapje shumë të gjerë. Kështu, megjithëse u deklarua se aktivitetet e lojërave të fatit ishin një kancer për shoqërinë tonë dhe do të mbylleshin, apo do të largoheshin nga qendrat urbane, ato vazhdojnë njësoj si më parë; megjithëse fillimisht çdo drejtues mjeti pa patentë arrestohej, aktualisht në rrugët e vendit ka me mijëra drejtues çiklomotorash pa leje drejtimi, apo nxënës që drejtojnë autovetura pa leje drejtimi.
- Edhe suksesi i deritanishëm i arritur në frenimin e ndërtimeve pa leje apo në ushtrimin e palicensuar të lojërave të fatit, nuk ka ardhur si rrjedhojë e dënimit të ashpër penal të shumë personave të cilët i kanë kryer këto vepra, por si rrjedhojë e kryerjes më të mirë të punës nga inspektorët përkatës, të cilët kanë evidentuar dhe ndëshkuar më mirë kundërvajtësit që në momentet e para, duke mos i lejuar të avancojnë me paligjshmërinë e tyre.
- Përhapja e madhe e kësaj kategorie veprash veç të tjerave ka ardhur jo nga dështimi i sanksioneve të buta, por nga dështimi i funksionimit të strukturave dhe mekanizmave të tjerë parandalues shtetërorë.
- Kjo analizë na çon në përfundimin se ndjekja penale e veprave penale të përhapura masivisht është një zgjedhje e gabuar dhe e dëmshme për të drejtën penale. Për gjendje të tilla të paligjshmërisë masive duhet të vihen në lëvizje mekanizmat administrativë si barriera e parë e ballafaqimit me ligjin dhe vetëm për personat ndaj të cilëve nuk japin efekt masat administrative, duhet të vihet në lëvizje mekanizmi i së drejtës penale, deri në dënimin e ligj-shkelësit.

21. Përqendrimi tek dënimi i ashpër i autorëve që zbulohen është një mënyrë e mirë për të qenë të ashpër me ta, por është një mënyrë shumë e keqe për të qenë të ashpër dhe të vendosur për të çrrënjësuar krimin. Të jesh i vendosur për të luftuar krimin, kërkon një përpjekje më serioze, të thellë dhe afatgjatë, duke u angazhuar maksimalisht për të eliminuar shkaqet që nxisin kryerjen e krimeve dhe për të zbuluar çdo person i cili ndërmerr veprimtari kriminale. Dënimi i rëndë dhe disproporcional me burgim i një fajtori, tej meritës së krimit të kryer, jo vetëm që është i padrejtë në aspektin moral, por është i panevojshëm edhe në këndvështrimin utilitar.

- Parandalimi i përgjithshëm është dhe do të vazhdojë të mbetet edhe për shumë kohë një qëllim i së drejtës penale në përgjithësi, por në gjykimin tonë është e gabuar që ai të përdoret si argument mbështetës për ashpërsimin e politikës (ligjore dhe gjyqësore) së caktimit të dënimeve. Dënimi i ashpër i një pjese të vogël të kryerësve të veprave penale, jo vetëm që nuk është efektive, por vazhdon të ushqejë padrejtësinë dhe paarsyetueshmërinë e së drejtës tonë penale.
- Në këtë aspekt shoqëria jonë duhet të fokusohet në drejtim të atyre mjeteve dhe mekanizmave preventivë të cilët janë më të drejta dhe humane, respektojnë më shumë të drejtat e njeriut, ulin kostot dhe ofrojnë një efektivitet më të lartë në uljen e krimit. Politikat populiste të dënimit të ashpër të atyre që kapen, kanë lënë në hije jo vetëm luftën me masa preventive jopenale të shkaqeve të krimit, por edhe aspektet penale të rritjes së sigurisë së dënimit.
- Politika aktuale penale është e gabuar pasi jo vetëm nuk shqetësohet seriozisht për të drejtat e të burgosurve (për kushte jetese të përshtatshme dhe qëllimin riedukues të burgimit), por as në aspektin ekonomik nuk e konsideron mbajtjen e një individi në burg si një humbje të ekonomisë kombëtare.
- Ashpërsimi ekstrem në letër i marzheve të dënimeve për disa vepra të caktuara ka sjellë një çoroditje të praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin uniform të parimeve dhe kriterëve të caktimit të dënimit dhe të parashikueshmërisë së tij. Parashikimi nga legjislatori i marzheve të ndryshme dënimi për vepra të ngjashme penale ka pamundësuar unifikimin e praktikave dhe definimin e shinave udhëzuese nga GJL për raste të ngjashme. Kjo pamundësi objektive dëmton rëndë parimin e drejtësisë dhe të sigurisë juridike në lidhje me caktimin e dënimit, pasi lë shteg për abuzime në caktimin e një dënimi të drejtë dhe të merituar.
- Së fundmi, kriminalizimi i panevojshëm i veprave të lehta dhe të parrezikshme dhe ashpërsimi i sanksioneve për ato ekzistuese, i shoqëruar me fushata masive policore, ka shpërqendruar vëmendjen e organeve ligjzbatuese tek prioritet e këtyre organeve. Fokusimi i goditjes penale ndaj veprave shumë të përhapura si vjedhja e energjisë elektrike, ushtrimi i lojërave të fatit pa licencë, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, ndërtime të paligjshme, apo fshehja e të ardhurave, ka ulur zbulueshmërinë e veprave të rrezikshme, të cilat kanë një ndikim të madh në perceptimin publik për nivelin e paqes dhe të sigurisë.

Sugjerime

A. *Sugjerime për ligjvënësin*

1. Për shkak të problemeve të mëdha dhe kaosit që paraqet gjithë sistemi sanksionator dhe politika e caktimit të dënimit penal në vendin tonë vlerësojmë se është e domosdoshme miratimi i një kodi të ri penal. Më në detaje nevojat për ndërhyrje ligjore në K. Penal në lidhje me sanksionet penale mund të përmbliidhen më poshtë.
 - a) Parashikimi me ligj i qëllimeve që ndjek dënimi penal në vendin tonë dhe mundësisht përcaktimi me ligj i qëllimit prioritar apo i rregullave të përcaktimit të tij.
 - b) Parashikimi me ligj (optimalisht në kushtetutë) i parimit të proporcionalitetit penal, duke kufizuar të drejtën e legjislativit për të miratuar në mënyrë të panevojshme vepra penale, apo për të ashpërsuar në mënyrë disproporcionale dhe të panevojshme sanksionet penale.
 - c) Reformimi tërësor i sistemit të dënimeve kryesore.
 - Duke shtuar si dënime kryesore punën në shërbim publik, izolimin në shtëpi dhe vërejtjen gjyqësore.
 - Duke rikthyer në 25 vite maksimumin e dënimit me burgim. Për të zgjidhur çështjen e dënimeve të buta për vepra të rënda penale, të hiqet gjykimi i shkurtuar për të gjitha krimet që parashikojnë dënim në minimum mbi 10 vite burgim. Po ashtu, duhet parashikuar shprehimisht në kod se burgimi duhet konsideruar si një sanksion i fundit, i cili mund të caktohet nga gjykata vetëm kur çdo lloj dënimi tjetër është i papërshtatshëm.
 - Duke ulur minimumin e gjobës për kundërvajtje dhe krime dhe duke implementuar në një afat të shpejtë (pas një periudhe tranzitore përgatitjeje) sistemin e gjobave ditore si zgjidhja më e arsyeshme për caktimin e masës së gjobës edhe sipas nivelit ekonomik të të dënuarit.
 - c) Reformimi i gjithë dënimeve alternative, hapi i parë i së cilës duhet të jetë ndryshimi i terminologjisë nga “alternativa të dënimit me burgim” në “dënime alternative” dhe përfshirja e tyre në kreun e dënimeve, siç i kanë dhe disa legjislacione penale të rajonit. Hapi i dytë i reformimit të tyre duhet të jetë shtimi i tyre në numër dhe i modaliteteve të aplikimit të tyre. Alternativat janë të shumta, por në mënyrë të veçantë vlerësojmë se duhet të ketë një qasje më të madhe në drejtim të dënimit me gjobë, garancisë pasurore dhe dorëzanisë personale, mbikëqyrjes personale apo familjare, drejtësisë restauruese, punës në shërbim publik, apo vërejtjes gjyqësore.
 - Puna në shërbim publik duhet shtrirë së paku edhe për dënime deri në dy vite burgim, duke rritur edhe numrin e maksimumit të orëve të punës nga 240 në 500 orë dhe afatin të kryerjes së saj nga 6 muaj në një vit. Po ashtu është e domosdoshme riparimi i lapsusit ligjor, që pas kryerjes së punës, dënimi të konsiderohet i vuajtur dhe jo i paqenë.
 - Sa i takon afateve të lirimit para kohe me kusht ato duhen rikthyer në nivelet e mëparshme të para ndryshimeve të vitit 2001 (si të shumicës së vendeve të tjera evropiane). Po ashtu për

jetësimin dhe rritjen e efektivitetit të këtij instituti, duhet të bëhet një diversifikim i rrethanave dhe modaliteteve të lirimit, duke parashikuar një afat prove, duke shtuar mbikëqyrjen intensive elektronike, punën në komunitet, apo vuajtjen e dënimit në shtëpi.

- d) Dënimi i të miturve duhet të bëhet në një seksion më vete në K. Penal, ku të përfshihen jo vetëm parimet e drejtësisë penale për të miturit, por edhe institute specifike si masat edukuese, mbikëqyrja intensive familjare dhe shkollore, parashikimi dënimit me burgim si dënim përjashtues, dhe shumë dënime të tjera alternative (si gjoba, dënimet plotësuese, pezullimi me kusht i dënimit, dënimi me burg në shtëpi, puna në shërbim publik, mbikëqyrja elektronike, etj.).
- Duke qenë se mituria përfshin moshën 14-18 vjeç, duhet që ligjvënësi të parashikojë një trajtim të diferencuar të moshave të ndryshme. I pandehuri 14 vjeç sapo ka prekur kufirin e përgjegjësisë penale, ai 16 është më i pjekur, ndërsa ai afër 18 vjeç, është ligjërisht thuajse i rritur.
 - Po ashtu, mbështetur në praktikën e shumë legjislacioneve të tjera evropiane (si Franca, Gjermania, Rusia etj.), sugjerojmë që K. Penal të parashikojë një trajtim special edhe për të rinjtë e moshës 18-21 vjeç, pasi edhe kjo grupmoshë e ndërmjetme paraqet në një masë më të vogël karakteristika të ngjashme me të miturit.
- dh) Modernizimi i trajtimit të personave me probleme mendore (me ulje të shkallës së përgjegjësisë penale), personave të varur nga lëndët narkotike dhe alkooli dhe personat me sjellje habituale antisociale, duke e orientuar atë drejt masave mjekësore, edukuese dhe sociale. Po ashtu në rastet e përshtatshmërisë së aplikimit të masave penale, duhet që për këto kategori personash të parashikohen ulje të dënimit nën minimum, apo në raste të veprave të lehta, përjashtim të tyre nga dënimi. Ulja e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji është në përputhje me shkallën e fajësisë dhe rrezikshmërinë e veprës konkrete, edhe në rastet kur një bashkëpunëtor nuk ka ndikuar në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës apo ka qenë në një rol dytësor (si ndihmës periferik).
- e) Rritja e vlerës së drejtësisë restauruese përmes shtimit të vlerës së pajtimit dhe rivendosjes së marrëdhënieve të prishura mes të pandehurit dhe të dëmtuarit. Kjo mund të bëhet në disa aspekte, duke shtuar veprat penale me ankim sipas nenit 284 të K. Pr. Penale, duke parashikuar mundësinë e uljes së dënimit nën minimum apo përjashtimit të të dënuarit nga dënimi për këtë shkak, duke rritur përpjekjet e gjykatës për të arritur pajtimin me të dëmtuarin etj.

2. K. Penal paraqet nevojë për ndryshim rrënjësor edhe në lidhje me caktimin e dënimit.

- a) Së pari është e nevojshme rishikimi i llojeve dhe marzheve të dënimit për të gjitha dispozitat e pjesës së posaçme të K. Penal. Përveç domosdoshmërisë për të shtuar dënimin me gjobë si dënim alternativ të burgimit në shumë vepra penale jo shumë të rrezikshme, është e domosdoshme rregullimi sipas një ligjësie logjike i diferencës mes minimumit dhe maksimumit të shumicës së dispozitave të pjesës së posaçme. Në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe

të kufizimit të diskrecionit të panevojshëm gjyqësor, legjislatori duhet fillimisht të përcaktojë një lloj shkalle të penalizimit të veprave penale në bazë të objektit kryesor që mbrojnë dispozita dhe më pas t'i ndajë ato në nëngrupe sipas veprave konkrete. Më tej edhe brenda së njëjtës figure veprave penale duhet të ketë ndarje në nene të tjera apo paragrafë, në varësi të rrezikshmërisë speciale që paraqesin situata të caktuara cilësuese të asaj veprave penale.

- b) Së dyti është e nevojshme një parashikim më i plotë dhe i detajuar të kriterëve të caktimit të dënimit dhe i vlerës që kanë rrethana të caktuara lehtësuese dhe rënduese si dhe kombinime të disa prej tyre në caktimin e masës së dënimit.
 - c) Së treti, duhet të parashikohen modalitete ligjore për përjashtimin nga dënimi të veprave pa rrezikshmëri shoqërore, duke filluar me mundësinë që vetë prokuroria të vendosë mosfillimin e ndjekjes penale (në vlerësimin tonë kjo do të ishte zgjidhja më e mirë dhe më e dobishme në praktikë, për të ekonomizuar kohën) dhe shkojnë në fund me të drejtën e gjykatës (me vendim përfundimtar) për ta përjashtuar autorin nga dënimi, apo për të caktuar ndaj tij vetëm një vërejtje gjyqësore.
 - ç) Në lidhje me kontrollin e zbatimit të drejtë nga gjykatat të kriterëve dhe të parimeve të caktimit të dënimit penal është e nevojshme parashikimi në K. Penal apo në K. Pr. Penale i detyrimit për të arsyetuar caktimin e dënimit (një dispozitë të ngjashme me nenin 132 §1 të K. Penal italian). Kjo do të rriste ndjeshëm, transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e gjykatës në ushtrimin e pushtetit diskrecional në caktimin e dënimit.
 - d) Për të përmirësuar cilësinë e hetimit gjyqësor mbi caktimin e dënimit dhe për të shmangur shfaqjen e paragjyqimit dhe të anësisë së gjykatës gjatë gjykimit, sugjerojmë të shqyrtohet mundësia që caktimi i dënimit (për disa vepra të rënda dhe kur zhvillohet gjykim i zakonshëm) të bëhet në një fazë të dytë, pas shpalljes së vendimit në lidhje me fajësinë (i ngjashëm me sistemin anglosakson dhe atë francez). Në të kundërt duhet që prokuroria të luajë me ligj një rol më aktiv në hetimin e rrethanave që ndikojnë në caktimin e dënimit.
3. Për shumë vepra penale me frekuencë të lartë, që paraqesin një rrezikshmëri të ulët, duhen hedhur hapa për dekriminalizimin e tyre, duke i bërë kundërvajtje administrative, apo duke i njohur prokurorisë pushtet diskrecional për mosfillim procedimi për këtë shkak.

B. Sugjerime për gjyqësorin

- Së pari sugjerojmë një arsyetim më të mirë të caktimit të dënimit, sidomos në rastet e caktimit të masave të ndryshme për autorë që kanë kryer të njëjtën vepër, apo për rastet e dënimeve të rënda me burgim.
- Së dyti, (deri në ndryshimet ligjore) sugjerojmë ndërhyrjen e GJL me një vendim unifikues për të përcaktuar qëllimet që ndjek dënimi penal në vendin tonë, mbi cilat kritere përzgjidhet

qëllimi prioritar, çfarë ndikimi kanë ato në caktimin e dënimit dhe nga çfarë pike duhet të fillojë gjykata në matjen e secilit lloj dënimi ndaj një të pandehuri konkret (brenda marzheve).

- Së treti sugjerojmë shtimin e aplikimit të dënimit me gjobë dhe të dënimeve alternative duke ulur zbatimin e panevojshëm të burgimit. Si një dënim i ndërmjetëm mes burgimit dhe dënimit me kusht sugjerojmë aplikim më të shpeshtë të monitorimit elektronik.
- Së katërti, ashtu sikurse legjislatori, as gjykatat nuk duhet të justifikojnë ashpërsimin e dënimit ndaj një të pandehuri, me argumentin e rritjes së efekteve të parandalimit të përgjithshëm.

LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA

A. Literaturë

1. Abdiu, F. (2012). Mbi domosdoshmërinë e hartimit të një kodi penal të ri. *Revista Avakotia*, nr. 2 Prill 2012. Botim i dhomës Kombëtare të Avokatisë.
2. Adler, M. D. & Posner, E. A. (2001). *Cost-Benefit Analysis: Legal, Economic, and Philosophical Perspectives*. University of Chicago Press, Chicago.
3. Albrecht, H.-J. (2012). Sanction policies and alternative measures to incarceration: European experiences with intermediate and alternative criminal penalties. *142nd International Training Course visiting experts' papers*. United Nations Asia and Far East Institute for the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, pp 28-51.
4. Albrecht, H.-J. (2013), Sentencing in Germany: Explaining Long-Term Stability in the Structure of Criminal Sanctions and sentencing. *Law & Contemporary Problems*; 2013, Vol. 76 Issue 1, Pp 211-236.
5. Albrecht, H.-J.(2004). Security Gaps: Responding to Dangerous Sex Offenders in the Federal Republic of Germany, *Federal Sentencing Reporter*, 16(3), 200-207.
6. Amnesty International (2013). *Death sentences and executions 2012*. Amnesty International Publications. London.
7. Amnesty International. (2015). *Amnesty International Report 2014/15. The state of the world's human rights*. London.
8. Anastasi. A. (2006). *Historia e Institucioneve*. Botimi i katërt. Tiranë.
9. Appleton, C. & Groverf, B. (2007). The pros and cons of life without parole. *British journal of criminology*, nr. 47, Pp 597– 615.
10. Aristotle (1980). *3 Ethica Nicomachea*, 112-117, 1131a-1131b, në Ackrill, J. L. and Urmson J. O. (eds.), W. Rosstranslation, Oxford University Press.
11. Ashworth, A. (1995). *Sentencing and criminal justice*, 2nd edition. Butterworths, London.
12. Auby, J.-B., Breen, E. and Perroud. Th. (2014). *Corruption and Conflicts of Interest: A Comparative Law Approach*. Edward Elgar Publishing. Cheltenham.
13. Avokati i popullit (2013). *Draftraport mbi fenomenin e gjakmarrjes*. 2013. Tiranë. E aksesueshme në: <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raporti%20per%20gjakmarrjen.pdf>.
14. Avokati i Popullit (2015). *Raport vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, 1 Janar – 31 Dhjetor 2014*. Tiranë, Shkurt 2015. E aksesueshme në : <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/RAPORTI%202014.pdf>.

15. Bala, E. (2008). Dënimi penal i personit Juridik. *Revista Jeta Juridike*, nr. 4, Dhjetor 2008. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 7-31.
16. Bala, I. (1996). Mbi ndryshimet e kodit penal të Republikës së Shqipërisë sipas ligjit nr. 8175, datë 23.12.1996. *Revista Jurisprudenca Shqiptare*. Vëllimi 6, botimi 1. Tiranë, f. 29-46.
17. Beatrix, A. (2011). *Raising awareness about the condition of inmates in France and protecting their rights*. HIA Lecture. HIA Office, Bastille, Paris. 20 June 2011.
18. Beccaria, C. (1973). *Dei delitti e delle pene*. Letteratura italiana Einaudi, Mursia, Milano.
19. Bedner, A. (2010). An Elementary Approach to the Rule of Law. *Hague Journal on the Rule of Law* / Volume 2 / Issue 01 / March 2010, Pp 48-74.
20. Bengoetxea, J., Jung, H., Nuotio, K. (2013). Ultima ratio, Is the principle at risk?: Editors' Introduction. *Oñati Socio-legal Series* [online], 3 (1), 1-5. E aksesueshme në: <http://ssrn.com/abstract=2213166>.
21. Bentham, J. (2009). Punishment and deterrence. From "An introduction to the principles of morals and legislation" (1789). In: A. Ashworth, A. von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing, Pp. 53-56.
22. Bertoli, M. (2008). *La discrezionalità del giudice nella commisurazione della pena nei paesi dell' Europa dell' Est*. Tesi di dottorato. Università degli studi di Trieste. E aksesueshme në: <http://www.openstarts.units.it/dspace/handle/10077/2649>.
23. Bettiol, G. (1964). Il mito della rieducazione, in AA.VV., *Sul problema della rieducazione del condannato*, Padova, Padova, Cedam, 15.
24. Bianchi H. & Van Swaaninger, R. (1982). *Abolitionism: Towards a non-repressive approach to crime*, Amsterdam.
25. Bianchi, H. (1994). Abolition: Assensus and Sanctuary. In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*. Oxford University press, New York, Pp. 333-351.
26. Blay, E. (2010). It could be us: Recent transformations in the use of community service as a punishment in Spain. *European Journal of Probation*, Vol. 2, No.1, 2010, Pp 62 – 81.
27. Blumstein, A. and Beck, A. J. (1999). Population Growth in U.S. Prisons, 1980-1996. In M. Tonry, J. Petersilia, eds. *Prisons, Crime and Justice. A review of research* 26. Pp 17-61.
28. Bottomley, K., Hucklesby, A., Mair, G., and Nellis, M. (2004). *Electronic Monitoring of Offenders: Key Developments Issues in Community and Criminal Justice*-Monograph 5 London: NAPO, 2004.
29. Bottoms, A. E. (2006). Crime Prevention for Youth at Risk: Some Theoretical Considerations, in "Crime and Crime Prevention in the 21st Century". *UNAFEI Resource Material Series No. 68*, March 2006, Tokyo, Japan. Pp. 21-35.

30. Bottoms, A. E. (2006a). Crime and Crime Prevention in the Twenty-first Century, in “*Crime and Crime Prevention in the 21st Century*”. UNAFEI Resource Material Series No. 68, March 2006, Tokyo, Japan. Pp 3-20.
31. Bottoms, A. E. (2006b). Crime Prevention for Youth at Risk: Some Theoretical Considerations, in “*Crime and Crime Prevention in the 21st Century*”. UNAFEI Resource Material Series No. 68, March 2006, Tokyo, Japan. Pp 21-35.
32. Bozheku, E., Elezi, I. (2014). Përputhshmëria kushtetuese e ligjit nr 9754 datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personit juridik”. *Revista Jeta Juridike*, nr. 2, Qershor 2014. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 146-174.
33. Brasiello, U. (1964). Diritto penale (diritto romano), in *Noviss. dig. it.*, V, Torino, Pp. 960 – 966.
34. Brest, P. (1976). In Defense of the Antidiscrimination Principle. *Harvard Law Review*, Vol. 90.
35. Chambliss, W. J. (1967). Types of deviance and the effectiveness of legal sanctions. *Wisconsin law review*. Summer. Pp 703-719.
36. Chanenson, S. L. (2013). Sentencing Guidelines in the United States. Villanova University School of Law. Public Law and Legal Theory. *Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice*, E. Gerben Bruinsma & David Weisburd, eds., Springer, 2013. Working Paper No. 2013-3015.
37. Cid, J. (2009). “Is Imprisonment Criminogenic?: A comparative study of recidivism rates between prison and suspended prison sanctions”. *European Journal of Criminology*. November 2009, vol. 6, no. 6. Pp 459-480.
38. Cohen S. A. (1981). An Introduction to the Theory, Justifications and Modern Manifestations of Criminal Punishment. *McGILL Law Journal*. Vol. 27. Pp. 73-91.
39. Council of Europe (1999). *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics, first edition*, Strasbourg.
40. Council of Europe (2011). *Council of Europe annual penal statistics. SPACE I. Survey 2009*. Strasbourg. E aksesueshme në: [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/cdpc/bureau%20documents/PC-CP\(2011\)3%20E%20-%20SPACE%20I%202009.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/cdpc/bureau%20documents/PC-CP(2011)3%20E%20-%20SPACE%20I%202009.pdf).
41. Council of Europe (2014). *Council of Europe annual penal statistics. SPACE I, Prison polutations. Survey 2013*. Strasbourg. E aksesueshme në: <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/PCCP%20documents%202015/SPACE-I-2013-English.pdf>.

42. Coyle, A. (2005). *Understanding Prisons: Key Issues in Policy and Practice*. Berkshire: Open University Press.
43. CRCA. (Children's Human Rights Centre of Albania). (2007). *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri*. Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri. ViSi Design, Tiranë.
44. Crewe, B. (2007). The Sociology of Imprisonment. In Jewkes, Y. (ed.). (2007). *Handbook on Prisons*. Devon: Willan Publishing. Pp 123-152.
45. Cullen, F. T. & Gilbert, K. (2009). Reaffirming rehabilitation. In: A. Ashworth, A. von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing. Pp 28-33.
46. Çiğdem, R. (2007). Corporal Punishment (Amputation of a Hand): The Concept of sariqa (Theft) in Theory and in Practice. *Ankara Law Review*, Vol.4 No.1 (Summer), Pp. 25-41.
47. dailymail (2006). *Courts use computers to decide who should face death sentence*. 13 September 2006. E aksesueshme në: <http://www.dailymail.co.uk/news/article-405001/Courts-use-computers-decide-face-death-sentence.html#ixzz3aFkiPVAR>.
48. Dammer, H. R., and Albanese, J. S. (2010). *Comparative Criminal Justice Systems*. Belmont. USA.
49. Danaj, L. (2012). *Raporti i së Drejtës Penale me të Drejtën Ndërkombëtare*. Disertacion doktore. Universiteti i Tiranës, Tiranë.
50. De Burca, G. & Gardner, S. (1990). The Codification of Criminal Law. *Oxford Journal of Legal Studies*, 10 (4), Pp 559-571.
51. DOLCINI, E. (1968). *La commisurazione della pena. La pena detentiva*, Cedam, Padova.
52. Dolcini, E. (1979). *La commisurazione della pena. La pena detentiva*, Cedam, Padova.
53. Doob, A. N. & Webster, C. M. (2009). Studies of the impact of new harsh sentencing regimes. In: A. Ashworth, A. von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing, Pp 49-53.
54. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (2014). *Të dhënat e të miturve në sistemin e burgjeve, të ndara sipas llojit të veprës penale të kryer dhe kohës së qëndrimit në institucionet e paraburgimit*. E aksesueshme në: <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=485>.
55. Drejtoria e Përgjithshme e burgjeve (2015). *Gjendja dhe Ndarja e të Dënuarve (Mosha/Veptra Penale/Masa e Dënimit) - Maj 2015*. E aksesueshme në <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=527>.
56. Drejtoria e Përgjithshme e burgjeve. (2012). *Zhvillimet kryesore të Sistemit të Burgjeve gjatë vitit 2012*. Marrë nga: www.dpbsh.gov.al.

57. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. (2015). *Të dhëna statistikore të sistemit të burgjeve – Maj 2015*. E aksesueshme në: <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=502>
58. Duff, A. R. (1999). "Punishment, Communication, and Community." in *Punishment and Political Theory*, edited by Matt Matravers. Portland, OR: Hart. Pp 48–68.
59. Dünkel, F. & Lappi-Seppälä, T. (2014). Community Service in Europe. *Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice*, 2014, Pp 426-442.
60. Durnescu, I. (2008). An exploration of the purposes and outcomes of probation in European jurisdictions. *Probation Journal*, 55, Pp 273-281.
61. Elezi, I. & Hysi, V. (2006). *Politika kriminale*. PEGI, Tiranë.
62. Elezi, I. (1997). *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, botim i parë, Tiranë.
63. Elezi, I. (1999). Vështrim historiko-juridik i dënimit me vdekje në Shqipëri, Libri: *Heqja e dënimit me vdekje në Evropë*, Tiranë.
64. Elezi, I. (2005). Disa probleme në lidhje me kodin penal. *Revista Jeta Juridike*, nr. 1, Tetor 2005. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 61-73.
65. Elezi, I. (2007). *E drejta Penale. Pjesa e posaçme*. Botimet Erik, Tiranë.
66. Elezi, I. (2008). Parandalimi, drejtësia penale dhe drejtësia restauruese, *Revista Ndërmjetësimi*, Tiranë. f.40-56.
67. Elezi, I., Kaçupi, S. dhe Haxhia, M. (2006). *Komentari i kodit penal, pjesa e përgjithshme*, Geer, Tiranë.
68. Elezi, I., Kaçupi, S. dhe Haxhia, M. (2009). *Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme*, Botimet Kumi, Tiranë.
69. Elezi, I., Kaçupi, S. dhe Haxhia, M. (2013). *Komentari i kodit penal, pjesa e përgjithshme*, Botimet Kumi, Tiranë.
70. Elliott, C. (2011). *French Criminal Law*. Routledge. New York.
71. Emisioni "Opinion", në TV Klan (2013). *Rikthimi i dënimit me vdekje*, 19 mars 2013. I aksesueshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=55buUpba148>.
72. Erikson, R. V., Baranek, P. M. & Chan, J. B. L. (1991). *Rapresenting order. Crime, law and justice in the news media*, Toronto.
73. Fiandaca, G. & Musco, E. (2009). *Diritto penale, Parte generale, sesta edizione*, Zanelli editore s.p.a, Bologna.
74. Fiandaca, G. Musco, E. (2010). *Diritto penale, Parte generale, sesta edizione*, Zanelli editore s.p.a, Bologna.

75. Florida Department of Corrections. (2001). *Florida's Criminal Punishment Code: A Comparative Assessment*, October 2001.
http://www.dc.state.fl.us/pub/sg_annual/0001/index.html.
76. Forsythe, D. and Lawson, E. (1996), *Encyclopedia of Human Rights*. Oxford University press, New York.
77. Frase, R. S. (2001). Comparative perspective on sentencing policy and research, at *Sentencing and Sanctions in western countries*, Oxford university Press, New York. Pp. 259-293.
78. Freiberg, A. and Gelb, K. (2013). *Penal Populism, Sentencing Councils and Sentencing Policy*. Second edition. Routledge press, New York.
79. Gazeta Panorama online (2015). *Raporti për krimin në vitin 2014, rriten vrasjet në familje*. Datë 23.03.2015. E aksesueshme në: <http://www.panorama.com.al/raporti-per-krimin-ne-vitin-2014-rriten-vrasjet-ne-familje/>.
80. Gazeta Shekulli. (2015). *KE-ja merr përsipër çështjen e Ilia Karelit: Greqia të dënojë vrasësit*. Artikull i botuar me datë 06 Prill 2015.
81. Giunta, F. (2004). The Punitive Metaphor: from 'Punishment Lost' to 'Punishment Found'? Cahiers de defense sociale: *Bulletin of the International Society of Social Defence and Humane Criminal Policy*, Milano.
82. Grazhdani, T. (2015). Shërbimet e riintegritimit për emigrantët shqiptarë që kthehen: Mes sfidave të parandalimit të emigracionit dhe forcimit të institucioneve. Disertacion doktorature. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i shkencave sociale, Tiranë.
83. Greenwood, P. W. Model, K., Rydell, C. P., & Chiesa J. (1996). *Diverting Children from a Life of Crime: Measuring Costs and Benefits*, Rand Corp., Santa Monica, CA.
84. Grossman. M. (1998). *Encyclopedia of Capital Punishment*. Santa Barbara. ABC-CLIO Publishers, California.
85. Gjoka, R. (2009). Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale. Drejtësia restauruese. Tek OSBE (2009). *Manual për punonjësin e shërbimit të provës*. Shtëpia botuese Pegi, Tiranë.
86. Gjonçaj, L. dhe Gjonçaj, G. (2009). *Penologjia*. Shtëpia botuese Adelprint, Tiranë.
87. Gjonçaj, L. dhe Gjonçaj, G. (2013). *Kriminologjia*. Shtëpia botuese Adelprint, Tiranë.
88. Halili, R. (2014), *Penalogjia, botimi i shtatë*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
89. Halili, R. (2014). *Penologjia, botimi i shtatë*, Prishtinë.
90. Halimi, E. (2013). *Paketa e drejtësisë, masa të ashpra kundër krimit*. Halimi: 38 vjet deri burg përjetë për vrasje. Gazeta Panorama, 11 Mars 2013.
91. Henckaerts, J.-M. (1995). *Mass Expulsion in Modern International Law and Practice*, Springer, Brill, Netherlands.

92. Henrichson C. & Delaney R. (2012). *The Price of Prisons. What incarceration costs taxpayers*. January 2012. Vera Institute of Justice's Center on Sentencing and Corrections. New York.
93. Herring, J. (2013). *E drejta penale, botimi i pestë*, vëllimi i parë, Përkthim në shqip, UET Press, Tiranë.
94. Hirst, P. Q. (1994). The concept of punishment. In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*. Oxford University press, New York, Pp. 261-281.
95. Honderich, T. (1989). *Punishment: The supposed justifications*. Polity Press, Cambridge.
96. Hudson, B. A. (1996). *Understanding Justice: An Introduction to Ideas, Perspectives and Controversies in Modern Penal Theory*. Buckingham, England: Open University Press.
97. Hudson, B. A. (2009). Justice and difference. In: A. Ashworth, A. von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing. Pp. 367-377.
98. Hyseni, A. (2014). *Veprat penale në fushën e doganave*. Disertacion doktorature. Universiteti i Tiranës, Tiranë.
99. Hysi, V. (2010). Roli i sistemit të drejtësisë penale në parandalimin e kriminalitetit. *Revista Jeta Juridike*, nr. 4, Dhjetor 2010. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë.
100. Hysi, V. (2012). *Penalogjia*, botimi i tretë, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
101. ICPS (2011). *World Prison Population List. Ninth edition*. Marrë nga: <http://www.prisonstudies.org/info/worldbrief/>.
102. ICPS (2013). *World Prison Population List. Tenth edition*. Retrieved from: <http://www.prisonstudies.org/info/worldbrief/>.
103. Ikonimi, L. (2009). Ndalimi administrativ si një nga masat kundër migracionit të paligjshëm: Analizë e kuadrit ligjor dhe sfidat e zbatimit të tij. *Revista Jeta Juridike*, nr. 2, Qershor 2009. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 66-76.
104. INSTAT (2015). *Popullsia 2001-2015 sipas qarqeve*. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>.
105. Institute for Crime Prevention and Control. (2014). *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2014*, Fifth edition, Helsinki, Finland.
106. Islami, H. (2005). Alternativat e dënimit me burgim. *Revista Tribuna juridike*. Nr. 55 (4), 2005.
107. Islami, H., Hoxha, A. dhe Panda, I. (2011). *Procedura penale*, Botimet Morava, Tiranë.
108. Islami, H. (2009). Ekzekutimi i dënimeve alternative dhe shërbimi i provës. *Revista Jeta Juridike*, nr. 1, Mars 2009. Shkolla e Magjistraturës. Tiranë. f. 39-46.

- 109.Jareborg, N. (2005).Criminalization as Last Resort (Ultima Ratio). *Ohio state journal of criminal law*. Vol 2. Pp 521-534.
- 110.Jasini, R. (2006). Regjimet e sekuestrimit dhe konfiskimit në Shqipëri. *Revista Jeta Juridike*, nr 4. Shkolla e magjistraturës. Tiranë, f. 128-140.
- 111.Jehle, J. M., Albrecht, H. J., Hohmann-Fricke, S. & Tetel, C. (2010). *Probation following criminal sanctions – A nationwide study of recidivism between 2004 – 2007*. Federal Ministry of Justice, Berlin.
- 112.Johnson, E. H. (1974). *Crime, correction, and society*. Homewood, Ill: Dorsey Press.
- 113.Kaçupi, S. (2007). *Tentativa: Fazë e kryerjes së veprës penale*. Shtëpia botuese ILAR, Tiranë.
- 114.Kadish, S. H. (1978). Codifiers of the Criminal Law: Wechsler's Predecessors", *78 Columbia Law Review*, 1098. v.78, n.5, June 1978.
- 115.Kakarriqi, E. and Sulaj, Z. (2000). *National report on the drug situation in Albania, PHARE Project on Drug Information Systems Bridging Phase*, Brussels: European Commission.
- 116.Kambovski, V. (2007). *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, përkthim në gjuhën shqipe, botimi i dytë, Shtëpia botuese Furkan, Shkup.
- 117.Kantorowicz, E. (2015). The Secret of a Cheaper Sentencing System: Lessons from Europe. *Working Paper Series. No. 2015/01*, Rotterdam Institute of Law and Economics (RILE).
- 118.Këshilli i Evropës. (2001). *Për një rend publik European*. Tiranë
- 119.Këshilli i Ministrave (2014). Relacion i Këshillit të Ministrave mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".
- 120.Kokona, Sh. (2004). Dënimi. *Revista Tribuna Juridike*, nr. 51 (6). Fondacioni për kulturë juridike. Tiranë, f. 35-41.
- 121.Komiteti Shqiptar i Helsikit (2014). *Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria*. Tiranë, dhjetor 2014. E aksesueshme në: http://ahc.org.al/web/images/publikime/al/SHqip_Raporti_MONITORIMEVE_2014.pdf.
- 122.Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2014). *Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës*. Shtëpia Botuese Vllamasi.Tiranë.
- 123.Kovandzic, T. V. (1999). *Crime Prevention Through Selective Incapacitation: An Empirical Assessment of Florida's Habitual Offender Law*. Florida State University.
- 124.Krasnostein, S. & Freiberg, A. (2013). Pursuing consistency in an individualistic sentencing. Framework: If you know where you're going, how do you know when you've got there? *76 Law and Contemporary Problems* 265-288. E aksesueshme në: <http://scholarship.law.duke.edu/lcp/vol76/iss1/12>.

- 125.Krieger, J. (2012). *The Oxford Companion to Comparative Politics*, first edition. Oxford University Press. New York.
- 126.Kronenwetter, M. (2001). *Capital Punishment: A Reference Handbook* (2 ed.). ABC-CLIO, Santa Barbara, California.
- 127.Kury, H., & Ferdinand, T. (1999). Public opinion and punitivity. *International Journal of Law and Psychiatry*, 22, Pp 373–392.
- 128.Kuvendi i Shqipërisë (2013a). Procesverbal i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, datë 03.04.2013. Tiranë.
- 129.Kuvendi i Shqipërisë (2013b). Procesverbal i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, datë 10.04.2013. Tiranë.
- 130.Kuvendi i Shqipërisë (2015). Raport i Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.22/2014 “Për dhënie amnistie”, datë 27.05.2015. Tiranë.
- 131.Lambropoulou, E. (2005). Crime, Criminal Justice and Criminology in Greece, Country survey. *European Journal of Criminology*, Volume 2 (2): Pp 211–247. London.
- 132.Lambropoulou, E. (2008). Correctional policy in Greece: law in action. Prison Policy and Prisoners. Rights, Tak, P. & Jendly, M. (eds.), *International Penal and Penitentiary Foundation*, Wolf Legal Publishers, Nijmegen 2008: Pp 391-406.
- 133.Lame, A. (2015). 427 mijë ndërtime pa leje, Lame: Nëse tallen me shtetin, ta provojnë në kurriz. Gazeta Shekulli online, 12 Shkurt 2015. E aksesueshme në: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=216290><http://www.shekulli.com.al/p.php?id=216290>.
- 134.Lappi-Seppälä, T. (2008). Crime prevention and community sanctions in Scandinavia. 135th international senior seminar visiting experts’ papers. *UNAFEI Resource Material Series No. 74*, January 2008, Tokyo, Japan. Pp 20-53.
- 135.Lariccia, N. (2011). *Potere discrezionale del giudice e obbligo della motivazione*. Università di Salento. Scuola di specializzazione per professioni legali. E aksesueshme në: https://www.unisalento.it/c/document_library/get_file?uuid=497a5918-177d-463d-b05c-62935dac5814&groupId=6113369.
- 136.Latifi, V. (2013). *Politika kriminale*, Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.
- 137.Leskoviku. M. & Pieplow, L. (2009). Vlerësimi i aktivitetit të shërbimit të provës. Tek OSBE (2009). *Manual për punonjësin e shërbimit të provës*. Shtëpia botuese Pegi, Tiranë.
- 138.Leskoviku. M. (2009). Legjislacioni shqiptar për shërbimin e provës. Tek OSBE (2009) *Manual për punonjësin e shërbimit të provës*. Shtëpia botuese Pegi, Tiranë.
- 139.Lewis, L. (2003). *The history of punishment*, Amber books, London.

- 140.Lipscombe, S. (2012). *Mandatory life sentences for murder*. E aksesueshme në:
<http://www.parliament.uk/briefing-papers/SN03626/mandatory-life-sentences-for-murder>.
- 141.Logan, Ch. H., and Gaes, G. (1993). Meta-analysis and the rehabilitation of punishment. *Justice Quarterly*, 10 (June): Pp 245–263.
- 142.Malleson, K. & Moules, R. (2010). *The Legal System*. Oxford University Press. New York.
- 143.Mantovani F. (2001). *Diritto Penale, Parte generale*. CEDAM. Padova.
- 144.Margara, A. (1986). La modifica della legge penitenziaria: una scommessa per il carcere, una scommessa contro il carcere. *Questione giustizia*, 3: Pp. 519-546.
- 145.Marinnucci, G. & Dolccini, E. (2012). *Manuale di diritto penale. 4 edizione*. Giuffrè. Milano.
- 146.Martin, J. (2013). *OCR Law for AS. Third Edition*. Hodder Arnold. London.
- 147.Mathiesen, T. (1994). General Prevention as communication, from Prison on trial (1990). In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*. Oxford University press, New York. Pp 218-238.
- 148.McNeill, F. (2013). Community Sanctions and European Penology. In Daems, T., Snacken, S and Van Zyl Smit, D. (2013). *European penology*. Hart Publishing.
- 149.Melander, S. (2013).Ultima Ratio in European Criminal Law. *Oñati Socio-legal Series* [online], 3 (1), 42-61. E aksesueshme në: <http://ssrn.com/abstract=2200871>.
- 150.Mëçalla, N. (2013). *Aspekte juridike penale dhe kriminologjike të pastrimit të parave*. Disertacion doktrature. Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- 151.Miethe, T. D. & Lu, H. (2005), *Punishment, a comparative historical perspective*, Cambridge University press, New York.
- 152.Milla, Sh. (2008). *Dënimi penal, qëllimi, mënyra e caktimit dhe individualizimi. Teoritë për dënimin penal*. Punim i mbrojtjes së titullit “Magjistrat”, pranë Shkollës së Magjistraturës, Tiranë.
- 153.Ministria e drejtësisë (2005). *Vjetari statistikor 2004*. Tiranë.
- 154.Ministria e drejtësisë (2014). *Projektligji “Për dhënie amnistie”, Ministri Naço: Risi në raport me dënimin penal*. 04 Mars 2014. Marrë nga:
<http://www.drejtesia.gov.al/al/newsroom/lajme/projektligji-per-dhenie-amnistie-ministri-naco-risi-ne-raport-me-denimin-penal&page=12>.
- 155.Ministria e Drejtësisë (2014). *Vjetari statistikor 2013*. Tiranë.
- 156.Ministria e Drejtësisë (2015). *Vjetari statistikor 2014*. Tiranë.
- 157.Ministria e Integritetit. (2012). *Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për funksionimin e Bashkimit European*. Karta e të drejtave themelore e Bashkimit European. Tiranë.

- 158.Montesquieu, C. L. (2001). *Spirit of laws*. 1748. Translated by Thomas Nugent 1752. Batoche books, Kitchener, Ontario.
- 159.Morgan, N. (2000). Mandatory Sentences in Australia: Where Have We Been and Where are We Going? *24 Criminal Law Journal*. Pp 164-183
- 160.Morris, N. & Rothman, D. J. (1998). *The Oxford History of the Prison: The Practice of Punishment in Western Society*. UK: Oxford University Press.
- 161.Morris, N. (1974). *The future of imprisonment*. University of Chicago press. Chicago.
- 162.Morris, N. and Tonry, M. (1990). *Between Prison and probation. Intermediate punishments in a rational sentencing system*. Oxford University press, New York.
- 163.Muçi, Sh. (1989). *Caktimi i dënimit*. Monografi e punimit të doktoraturës, Universiteti i Tiranës, Tiranë 1989.
- 164.Muçi, Sh. (2012). *E Drejta penale, Pjesa e përgjithshme* (edicioni i tretë), Shtëpia botuese Marin Barleti, Tiranë. Guttenberg.
- 165.Myftari, K. (2014). *Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore. Kriteri juridik në të drejtën penale*. Disertacion doktorature. Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- 166.Naço, N. (2015). Naço-gjyqtarëve: Politika më të ashpra penale. Transmetuar nga *Televizioni Top-Channel*, datë 09.03.2015. Marrë nga: top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=294583.
- 167.Nagin, D. S. (2012). Deterrence. Scaring Offenders Straight. At *Correctional Theory, Context and Consequences*. SAGE Publications, Inc, California. Pp 67-98
- 168.Nagin, D. S. and Pepper, J. V. (2012). National Research Council, "*Deterrence and the Death Penalty*", eds., The National Academies Press.
- 169.Nalla. M. K. (2010). *Crime and Punishment around the World*. Volume 1, Africa and Middle East. ABC-Clio. California.
- 170.Nappi, A. (2010). *La crisi del sistema delle sanzioni penali*. Edizioni Scientifiche Italiane, Napoli.
- 171.Nellis, M. (2009). Surveillance and Confinement: Explaining and Understanding the Experience of Electronically Monitored Curfews, *European Journal of Probation*, 1, Pp 41-65.
- 172.Nestler, C. (2004). "Sentencing in Germany", *Buffalo Criminal Law Review*. Vol 7. Pp 109-135.
- 173.New South Wales Attorney - General's Department (1994). *Sentencing Review*. Sydney: Government of New South Wales.
- 174.Newman, G. (1978). *The punishment response*. Philadelphia: J.P. Lippincot.
- 175.Newman, G. R 2010. *Crime and Punishment around the World* [4 volumes]: California.

- 176.Nikolli, A. (2003). *Caktimi i dënimit*. Punim i mbrojtjes së titullit “Magjistrat”, pranë Shkollës së Magjistraturës, Tiranë.
- 177.Nikolli, A. (2014a). Empirical survey of the Albanian judicial practice on criminal offense of “Manufacturing and sale of narcotics,” provided by article 283 of the criminal code. *European Scientific Journal*, June 2014 edition, vol.10, No.16. Pp 307-321.
- 178.Nikolli, A. (2014b). Disa probleme teorike dhe praktike rreth veprave penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të mashtrimit. *Revista Jeta Juridike*, nr. 2, Qershor 2014. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 31-61.
- 179.Nikolli, A. (2014c). Critical View of the Albanian Judicial Practice on Criminal Offences of Falsification of Documents and Fraud. *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 149 (2014). Published by Elsevier Ltd. Pp 659 – 666.
- 180.Nikolli, A. (2015a). Historical and Comparative Analysis of Changes in the Albanian Penal Code. The Criminalization of Behaviours and Severity of Punishment. *Mediterranean Journal of Social Sciences*. Vol 6 No 1. January 2015. Rome. Pp 300-308.
- 181.Nikolli, A. (2015b). The Severe Criminal Punishment of Drug Consumers in Albania. A Call for Reasonability and Reflection. *Mediterranean Journal of Social Sciences*. Vol 6 No 2. March 2015. Rome. Pp 27- 34.
- 182.Nikolli, A. (2015c). Overcrowding of Albanian Prisons. A Quantitative Analysis of Evolution and Causes. *Papers from 5-th LUMEN Conference*, Iasi. Published by Medimond s.r.l., Bologna (Italy). Pp 525-534.
- 183.Nikolli, A. (2015d). Aplikimi i dënimit penal me gjobë në Shqipëri. Vështrim teoriko-praktik. Prezantim në konferencën „Ditët e studimeve Shqiptare“, 2-26 Prill, 2015. UET, Tiranë.
- 184.Nozick, R. (1981). *Philosophical Explanations*. Cambridge, MA: Harvard University Press Pp 365-367.
- 185.Oberg, N. (2013). Sweden closes four prisons as number of inmates plummets. *The Guardian*. 11 November 2013. Marrë nga: <http://www.theguardian.com/world/2013/nov/11/sweden-closes-prisons-number-inmates-plummets>.
- 186.OSBE (2006). *Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, Raport i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë*. Tiranë. Marrë nga: <http://www.osce.org/sq/albania/22212?download=true>.
- 187.OSBE (2010). *Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim*. Shtëpia botuese Pegi. Tiranë.
- 188.OSBE (2013). Alternatives to custody in Albania and the establishment of a national probation service. *World congress on probation 8-10 October 2013*. London, United Kingdom.

- 189.Øster, M. K. and Beumer, S. (2014). Conference report. *9th European Electronic Monitoring Conference Electronic Monitoring, Probation and Human Rights*, Frankfurt/Offenbach, 11th – 13th, December 2014. E aksesueshme në: <http://cep-probation.org/wp-content/uploads/2015/03/Final-report-EM-2014.pdf>.
- 190.Padovani, T. (2006). *Diritto penale, 8^a edizione*. Milano, Giuffrè.
- 191.Palazzo, F. C. (1999). *Introduzione ai principi del diritto penale*, G. Giappichelli. Torino.
- 192.Palazzo, F. C. (2005). *Corso di diritto penale*, Giappichelli Editore srl – Torino.
- 193.Payne, B. K., and Gaaney, R. (2004). The electronic monitoring of offenders released from jail or prison: safety, control and comparisons to the incarceration experience', *The Prison Journal*, 84: Pp 423-434.
- 194.Petersilia, J. (2000). When Prisoners Return to the Community: Political, Economic, and Social Consequences. Papers From the Executive Sessions on *Sentencing and Corrections*. No. 9, November 2000.
- 195.Peza, N., Çela, A. & Elezi I. (1982). *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Tiranë.
- 196.Pogaçe, A., Lazellari, E., & Dokollari, G. (2013). A cenohet parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, kur vendim i pafajësisë i ankimuar në Gjykatën e Lartë, në rigjykim ndryshohet me vendim fajësie për të njëjtin fakt. *Revista Jeta Juridike*, nr. 2, Qershor 2005. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë. f. 7-47.
- 197.Pratt, J. (2007). *Penal populism*. London: Routledge.
- 198.Prokuroria e Përgjithshme (2014). *Raport i prokurorisë për kriminalitetin për vitin 2013*. Tiranë. I aksesueshëm në: http://www.pp.gov.al/web/raporti_2013_855.pdf.
- 199.Rama, E. (2014a). Rama: Ndërtimet pa leje, si vrasje. *Transmetuar nga televizioni Top-Channel*, datë 25.08.2014. Marrë nga: <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=283234&ref=ml>.
- 200.Rama, E. (2014b). Rama: 3 vite burg kush vjedh energjinë, *Portali Shqiptarja.com*. datë 27 Tetor 2014. E aksesueshme në: <http://shqiptarja.com/Aktualitet/2731/rama-3-vite-burg-kush-vjedh-energjin--5-bashk-pun-tor-ve-248438.html#sthash.BhUVgbj7.dpuf>.
- 201.Rama, E. (2015). Rama: Qeveria e Rilindjes dhe krimi i vrasjeve në pasqyrën e viteve. *Portali Balkanweb*, datë 06/05/2015. E aksesueshme në: <http://www.balkanweb.com/site/rama-qeveria-e-rilindjes-dhe-krimi-i-vrasjeve-ne-pasqyren-e-viteve/>.
- 202.Raunig, F. (2014). Mbipopullimi i burgjeve problematik, taksa për të paraburgosurit 439 euro në muaj. *Gazeta Shqip*. 2 korrik 2014.
- 203.Raynor, P. (2009). Assessing the research on “What Works”? In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*, Oxford University press, New York, Pp 19-27.

- 204.Roberts, J. (2004). *The Virtual Prison. Community Custody and the Evolution of Imprisonment*, Cambridge, Cambridge University Press.
- 205.Robinson, P. (1987). Hybrid Principles for the Distribution of Criminal Sanctions. *Northwestern University Law Review*, volume 82: Pp 19–42.
- 206.Robinson, P. (1988). Legality and discretion in the distribution of the criminal sanctions. *Harvard journal on legislation*. Volume 25, nr. 2. Pp 393-460.
- 207.Robinson, P. (2008). *Distributive principles of criminal law: Who should be punished, how much? 1s Edition*. Oxford University Press. New York.
- 208.Robinson, P. H. (2012) *Criminal Law: Case Studies and Controversies*, Third Edition. Aspen Publishers.
- 209.Rotman, E. (1994). Beyond punishment, In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*, Oxford University press, New York. Pp 281-306.
- 210.Rotman, E. (1995). The failure of reform: United States, 1865–1965. In *The Oxford history of prison: The practice of punishment in Western society*, edited by Norval Morris and David J. Rothman. New York: Oxford University Press.
- 211.Salihi, I. (2011). *E drejta penale ndërkombëtare*, Prishtinë.
- 212.Salihi, I. (2012). *E dehta penale, Pjesa e përgjithshme, botimi i pestë*, Universiteti Fama, Prishtinë.
- 213.Sandulli, A. (2006). Proporcionalita, in S. Cassese (a cura di), *Dizionario di diritto pubblico*, Vol V, Giufre, Milano.
- 214.Shabas, W. (2002). *The Abolition of the Death Penalty in International Law*. London: Cambridge University Press, Cambridge.
- 215.Scott, G. (2010). *The History Of Corporal Punishment - A survey of flagellation in its historical anthropological and sociological aspects*. Boughton Press, London.
- 216.Selmani, A. (2007). Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme në Shqipëri, në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në: Itali – Shqipëri: *Instrumente ligjorë dhe teknika të luftës kundër krimit të organizuar transnacional. Përballje përvojash. UNICRI*, Torino, f. 441-457.
- 217.Semini, M. (2006). *E drejta e detyrimeve dhe kontratave, Pjesa e përgjithshme*, Skanderbeg books, Tiranë.
- 218.Soering, J. (2004). *An Expensive Way to Make Bad People Worse: An Essay on Prison Reform from an Insider's Perspective*. New York: Lantern Books.
- 219.Spinellis, D. & Spinellis, C. D. (1999). *The Criminal Justice System of Greece*. Publikuar në web: <http://www-rohan.sdsu.edu/faculty/rwinslow/links/HEUNI99.htm>.

- 220.Sporer, S. L. and Delahunty, G. J. (2009). Disparities in sentencing decisions. In edited by Margit E. Oswald, Steffen Bieneckand Jörg Hupfeld-Heinemann 2009. *Social Psychology of Punishment of Crime*. John Wiley & Sons, New York.
- 221.Statistisches Bundesamt (2014). *Strafverfolgung - Fachserie 10 Reihe 3* – 2012 Statistisches, Wiesbaden.
- 222.Stefani, G., Lavasseur, G, & Jambu-Merlin, R. (1982). *Criminologie et science penitentiaire, Cinquieme edition*. Dalloz, Paris. Pp 301-302.
- 223.Sufaj, F. (2011). *Lirimi me kusht në këndvështrimin e standardeve ndërkombëtare*. E aksesueshme në: https://www.osfa.al/sites/default/files/kumtese_femi_sufaj.pdf.
- 224.Sullivan, E. TH. & Frase, R. S. (2008). *Proportionality principles in American law: controlling excessive government actions*, Oxford University Press.
- 225.Shehu, E., Pina, S., Tafa, N. dhe Smaka, S. (2013). Kufiri i kontrollit kushtetues mbi arsyetimin e vendimeve gjyqësore. *Revista Jeta Juridike*, nr. 2, Qershor 2013. f. 97-136.
- 226.Taylor, R. (2011). Why has prison emerged as a prominent form of punishment for most crime and what are its functions in relation to wider society? *Internet Journal of Criminology*. E aksesueshme në: http://www.internetjournalofcriminology.com/Taylor_Prison_and_its_Functions_IJC_August_2011.pdf.
- 227.Ten, C. L. (1987). *Crime, Guilt, and Punishment: A Philosophical Introduction*. Oxford, England: Clarendon Press.
- 228.Tonry, M. (1994). Proportionality, parsimony, and interchangeability of punishments. In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*. Oxford University press, New York, Pp. 133-160.
- 229.Toscano, A. (2012). *La funzione della pena e le garanzie dei diritti fondamentali*. Giuffre, Milano.
- 230.Totozani, I. (2014). Avokati i popullit: Të mbyllet Burgu 313, jashtë standardeve. Web page *Balkanweb.com*. 20 Gusht 2014. Marrë nga: http://www.balkanweb.com/bw_lajme2.php?IDNotizia=206688&IDCategoria=1.
- 231.Travis J. & Waul M. (2004). *Prisoners Once Removed: The Impact of Incarceration and Reentry on Children, Families, and Communities*. Urban Institute Press.
- 232.Tumminello, L. (2010). *Il volto dell reo. L'individualizzazione della pena, fra legalita ed equita*. Giuffre. Milano.
- 233.Turkeshi, E. (2011). Masat edukuese të parashikuara në Kodin penal dhe zbatimi i tyre në Shqipëri. *Revista Shqiptare për studime ligjore*. Vol 1. Tiranë, f. 35-62.
- 234.UNICEF (2009). *Assessment of juvenile justice reform achievements in Albania*. Tiranë.

- 235.UNODC (2013a). *Global Study on Homicide*. Vienna. Retrieved from: https://www.unodc.org/documents/gsh/pdfs/2014_GLOBAL_HOMICIDE_BOOK_web.pdf.
- 236.UNODC (2013b). *Handbook on strategies to reduce overcrowding in prisons*. New York. Retrieved from: http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Overcrowding_in_prisons_Ebook.pdf.
- 237.Von Hirsch, A., Bottoms, A. E., Burney E. & Wikstrom, P-O. (2009). Deterrent Sentencing as a Crime Prevention Strategy. In: A. Ashworth, A. von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing. Pp. 56-63.
- 238.Von Hirsch, A., Knapp, K. A and Tonry, M. (1985). *The Sentencing Commission and Its Guidelines*. Boston, MA. Northern University Press.
- 239.Von Hirsch, A. (2003). *Censure and sanctions*, Oxford University press, New York.
- 240.Von Hirsch, A. (2003a). Censure and proportionality, in *Censure and sanctions*, Oxford University press, New York. Pp 6-20.
- 241.Von Hirsch, A. (2003b). Penance and personalized desert, in *Censure and sanctions*, Oxford University press, New York. Pp 71-79.
- 242.Von Hirsch, A. (2009). Proportionate sentences. A desert perspective. In: A. Ashworth, A. Von Hirsch and J.V. Roberts, eds. *Principled Sentencing: Readings on Theory and Policy*. 3rd ed. Oxford: Hart Publishing. Pp 115-126.
- 243.Von Hofer, H. (2003). *Crime and Punishment in Denmark, Finland, Norway, and Sweden – A Summary*. Nordic Criminal Statistics 1950-2000 (NCS). Department of Criminology Stockholm University. Stockholm.
- 244.Von Hofer, H. (2011). Punishment and Crime in Scandinavia, 1750–2008. *Crime and Justice*, Vol. 40, No. 1 (August 2011). University of Chicago Press. Pp 33-107.
- 245.Wacquant, L. (2009). *Punishing the Poor: The Neoliberal Government of Social Insecurity*. Duke University Press. Durham and London.
- 246.Walker, N. (1991). *Why Punish?* Oxford: Oxford University Press, Oxford.
- 247.Walker, N. (1994). Reduktivism and deterrence, In A. Duff and D. Garland (Eds.), *A Reader on Punishment*, Oxford University press, New York, Pp 210-218.
- 248.Waller I. (2006). Effective Measures for the Prevention of Crime Associated with Urbanization. *UNAFEI Resource Material Series No. 68*, March 2006, Tokyo, Japan. Pp 75-88.
- 249.Washington, L. Jr. (2011). *Mass Incarceration Creates Costly Disaster Across America*, Mon, 04/04/2011. Cituar nã UNODC (2013). *Handbook on strategies to reduce overcrowding in prisons*. New York.
- 250.Welch, M. (2003). *Corrections: A Critical Approach. Second edition*. UK: McGraw-Hill.

251. Whitman, J. Q. (2003). *Harsh Justice. Criminal Punishment and the Widening Divide between America and Europe*. Oxford University Press, New York.
252. Wichara, T. (1995). *Simple Theory, Hard Reality. The Impact of Sentencing Reforms on Courts, Prisons, and Crime*. Albany, New York. State University of New York.
253. Wilson, J. Q. (1985). *Thinking about crime*. Revised edition. New York.
254. WODC (2003). *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2003*. 2nd edition. Hagë.
255. WODC (2006). *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2006*. 3rd edition. Hagë.
256. WODC (2010). *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2010*. 4th edition. Hagë.
257. Wright, V. (2010). *Deterrence in Criminal Justice, Evaluating Certainty vs. Severity of Punishment*, Washington.
258. Xhafo, J. (2012). *The Sentencing System in the Albanian Criminal Code and the Demand for Special Treatment of Juveniles*. Academicus - International Scientific Journal. Year 2012, nr. 6. Pp 47-61.
259. Zaganjori, Xh., Anastasi A. dhe Çani, E. (2011). *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. Adelprint, Tiranë.
260. Zannotti, R. (1999). Le misure alternative alla detenzione e la crisi del sistema sanzionatorio. Intervento effettuato al Convegno "*Certezza della pena per la certezza del diritto*", organizzato dal Centro Studi Valdarno Cultura, Empoli, 30-31 ottobre, in L'Indice penale, 2000.
261. Zheji, A. (2012). *Të rikthejmë denimin me vdekje?* Gazeta Mapo, 6 Shkurt 2012. E aksesueshme në: <http://www.mapo.al/2012/02/te-rikthejme-denimin-me-vdekje>.

- Burime Parësore

A. Akte Normative

262. Konventa e OKB "Kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope", datë 19.12.1988, aderuar me ligjin nr. 8722, datë 26.12.2000.
263. Konventa e OKB "Për luftën kundër financimit të terrorizmit", datë 09.12.1999, ratifikuar me ligjin nr. 8865, datë 14.03.2002.
264. Konventa e OKB e Palermos "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", datë 12.12.2000 dhe dy protokollet shtesë të saj, ratifikuar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002.
265. Konventa e OKB "Kundër korrupsionit", datë 31.10.2003, ratifikuar me ligjin nr. 9492 datë 13.03.2006.

- 266.Konventa e KE e Strasburgut “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, datë 08.11.1990 (CETS No. 141), ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000.
- 267.Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996.
- 268.Konventa e KE e Varshavës, datë 16.05.2005 “Për parandalimin e terrorizmit” (CETS No. 196), ratifikuar me ligjin nr. 9641, datë 20.11.2006.
- 269.Konventa e KE e Varshavës, datë 16.05.2005 “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” (CETS No. 197), ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.
- 270.Konventa e KE e Varshavës, datë 16.05.2005 "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, (CETS 198), ratifikuar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006.
- 271.Rekomandimi nr. R (92) 16 i Komitetit të ministrave të KE, mbi rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, e miratuar me 19.10.1992.
- 272.Rekomandimi nr. R (92) 17 i Komitetit të ministrave të KE mbi konsistencën në caktimin e dënimit, e miratuar me 19.10.1992.
- 273.Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komitetit të ministrave të KE, në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, e miratuar me 30.09.1999.
- 274.Rekomandimi nr. R (2006) 2 i Komitetit të ministrave të KE mbi rregullat evropiane të burgimit, e miratuar me 11.01.2006.
- 275.Kushtetuta Italiane, e miratuar nga Asambleja Kushtetuese me 22 dhjetor 1947, publikuar në gazetën zyrtare n. 298, hyrë në fuqi me 1 Janar 1948.
- 276.K. Penal Shqiptar i Zogut (1927). Miratuar me dekretin nr. 83-1 datë 28.05.1927, hyrë në fuqi me 1 janar 1928.
- 277.Dekreti nr. 615, datë 13.05.1948 për shpalljen e ligjit nr. 599, datë 13.05.1948 “Kodi Penal”.
- 278.K. Penal i vitit 1952, i miratuar me ligjin nr. 1470, datë 23.05.1952, hyrë në fuqi me 01.09.1952.
- 279.K. Penal i vitit 1977, i miratuar me ligjin nr. 5591, datë 15.06.1977, hyrë në fuqi më 01.10.1977.
- 280.K. Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i azhornuar.
- 281.K. Penal Ushtarak, i miratuar me ligjin nr. 8003, datë 28.9.1995, hyrë në fuqi me 15.11.1995, i azhornuar.
- 282.Kodi i Procedurës Penale, i miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, i azhornuar.
- 283.Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, i azhornuar.

- 284.K. Penal i Republikës së Kosovës, i miratuar me ligjin nr. 04/L-082, datë 20.04.2012, hyrë në fuqi me 01.01.2013.
- 285.K. Penal i Malit të Zi i vitit 2003. Gazeta zyrtare e Malit të Zi nr. 70/2003, i azhornuar.
- 286.K. Penal i Maqedonisë, i miratuar me ligjin nr. datë 23.07.1996, hyrë në fuqi me 01.11.1996. Shkup. Botim në gjuhën Shqipe nga Afrim Osmani. Furkan.
- 287.K. Penal i Spanjës, Organic Act 10/1995, datë 23.11.1995, Gazeta zyrtare nr. 281 datë 24.11.1995, i azhornuar.
- 288.Kodi penal i Italisë, Edizione Marzo 2014, Collana Codici Altalex.
- 289.K. Penal i Francës, Gazeta Zyrtare 2312.1992, hyrë në fuqi me 01.03.1994, i përditësuar korrik 2014.
- 290.Loi No. 2014-896 du 15 août 2014 relative à l'individualisation des peines et renforçant l'efficacité des sanctions pénales, LEGIFRANCE.
- 291.K. Penal i Gjermanisë, i shpallur me 13.11.1998. Gazeta ligjore federale I, p. 945, p. 3322.
- 292.K. Penal i Greqisë, i miratuar me ligjin 1492/1950, hyrë në fuqi me 01.01.1950.
- 293.K. Penal i Federatës Ruse, miratuar me 24.05.199, NO. 63-FZ OF JUNE 13, 1996, i azhornuar.
- 294.Model Penal Code (of USA), as adopted at the annual meeting of the American Law Institute, at Washington, D.C., on May 24, 1962, last updated in 1981. Philadelphia, PA.The American Law Institute, 1985.
- 295.The Crime and Disorder Act (c.37), published on 2 December 1997 and received Royal Assent in 31st July 1998, updated version.
- 296.The Criminal Justice Act 2003 (c.44). E miratuar me instrumentin statutor SI2004- 1683. E Aksesueshme me modifikime në: <http://www.legislation.gov.uk/>.
- 297.Coroners and Justice Act, 2009. (c. 25), enacted on 12.11.2009.
- 298.Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i ndryshuar).
- 299.Ligji nr. 40/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- 300.Ligji nr. 8175, datë 23.12.1996, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 301.Ligji nr. 8279, datë 15.1.1998, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 302.Ligji nr. 8733, datë 24.1.2001, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 303.Ligji nr. 9086, datë 19.6.2003, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

- 304.Ligji nr. 9188, datë 12.2.2004, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 305.Ligji nr. 9275, datë 16.9.2004, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 306.Ligji nr. 9686, datë 26.2.2007, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 307.Ligji nr. 9859, datë 21.1.2008, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 308.Ligji nr. 10023, datë 27.11.2008, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 309.Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 310.Ligji nr. 144/2013, datë 2.5.2013, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 311.Ligji nr. 98/2014, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 312.Ligji nr. 176/2014, për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- 313.Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i azhurnuar.
- 314.Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- 315.Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (Ligji anti-mafia).
- 316.Ligji nr. 107, datë 08.11.2012 “Për dhënie amnistie”.
- 317.Ligji nr. 22/2014, datë 10.3.2014 “Për dhënie amnistie”.
- 318.Ligji nr. 92/2015, datë 23.07.2015, Për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”.
- 319.Ligji nr. 9482, datë 11.6.2015, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i azhurnuar.
- 320.Ligji nr. 10024, datë 27.11.2008, për një ndryshim në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.
- 321.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.4.2004.
- 322.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores Për organizimin e funksionimit të Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

- 323.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 18.6.2014 “Për shtrirjen e mbikëqyrjes elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe sigurimin e pajisjeve elektronike të monitorimit për të gjitha rrethet gjyqësore”.
- 324.Urdhri nr. 100 datë 21.02.2014 i Kryeministrit “Për Shërbimin e Provës”.

- Burime Dytësore

A. Praktikë Gjyqësore

- 325.Vendimi i GJEDNJ në çështjen Gori kundër Shqipërisë (Aplikimi nr. 25336/04), datë 7 korrik 2009.
- 326.Vendimi i GJEDNJ në çështjen Taxquet v. Belgium (Aplikimi nr. 926/05), datë 16 Nëntor 2010.
- 327.Vendimi i GJEDNJ në çështjen Torreggiani dhe të tjerë kundër Italisë (Aplikimet nr. 43517/09, 46882/09, 55400/09, 57875/09, 61535/09, 35315/10 e 37818/10), datë 8.01.2013.
- 328.Corte costituzionale della Repubblica Italiana. N. 50 sentenza, 2-14 Aprile 1980. Pubblicazione in "Gazz. Uff." n. 112, del 23 Aprile 1980.
- 329.Corte costituzionale della Repubblica Italiana. Sentenza N. 274, Foro Italia. 1, 233327. 27 September 1987.
- 330.Corte costituzionale della Repubblica Italiana. Sentenza N. 518, 15-20 Novembre 2000.
- 331.Gjykata Kushtetuese gjermane. Vendimi 45 BVerfGE 187 (1977).
- 332.Décision n° 93-334 DC du 20 janvier 1994 de la Conseil Constitutionel. Journal officiel du 26 janvier 1994, p. 1380.
- 333.Namibia: Supreme Court. S. v Tcoib (SA 4/93) [1996] NASC 1; 1996 (1) SACR 390 (NmS) (6 February 1996).
- 334.Vendimi nr. 13, datë 29.05.1997 i Gjykatës Kushtetuese.
- 335.Vendimi nr. 65 datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese.
- 336.Vendimi nr. 13, datë 15.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese.
- 337.Vendimi nr. 15, datë 22.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese.
- 338.Vendimi nr. 12, datë 14.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
- 339.Vendimi nr. 1, datë 12.01.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
- 340.Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
- 341.Vendimi nr. 19, datë 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
- 342.Vendimi nr. 39 datë 18.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
- 343.Vendimi nr. 47, datë 26.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
- 344.Vendimi nr. 1, datë 20.01.2014 i Gjykatës Kushtetuese.
- 345.Vendimi unifikues nr. 1 datë 27.03.2008 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- 346.Vendimi unifikues nr. 2 datë 06.02.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- 347.Vendimi nr. 1516 (1032), datë 07.12.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 348.Vendimi nr. 19, datë 01.06.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 349.Vendimi nr. 93 (10), datë 10.01.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 350.Vendimi nr. 224 (28), datë 26.01.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 351.Vendimin nr. 978 (134), datë 16.05.2012 i Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
- 352.Vendimi nr. 1114 (138), datë 16.05.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 353.Vendimi nr. 1123 (142), datë 23.05.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 354.Vendimi nr. 751 (149), datë 30.05.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 355.Vendimi nr. 986 (192), datë 04.07.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 356.Vendimi nr. 1325 (194), datë 04.07.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 357.Vendimi nr. 1223 (209), datë 11.07.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 358.Vendimi nr. 1272 (261), datë 10.10.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 359.Vendimi nr. 1609 (318), datë 26.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 360.Vendimi nr. 1625 (319), datë 26.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 361.Vendimi nr. 1684 (326), datë 05.12.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 362.Vendimi nr. 1728 (322), datë 05.12.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 363.Vendimi nr. 1672 (347), datë 19.12.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 364.Vendimi nr. 18 (663), datë 23.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 365.Vendimi nr. 244 (23), datë 30.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 366.Vendimi nr. 387 (33), datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 367.Vendimi nr. 945 (144), datë 24.04.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 368.Vendimi nr. 1535 (278), datë 30.10.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 369.Vendimi nr. 1610 (290), datë 13.11.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 370.Vendimi nr. 1559 (330), datë 04.12.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 371.Vendimi nr. 1121 (75), datë 12.03.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 372.Vendimi nr. 1480 (153), datë 25.06.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 373.Vendimi nr. 1530 (168), datë 14.07.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 374.Vendimi nr. 8, datë 05.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 375.Vendimi nr. 2798, datë 23.11.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 376.Vendimi nr. 16, datë 11.01.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 377.Vendimi nr. 267, datë 05.02.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 378.Vendimi nr. 8269, datë 24.10.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 379.Vendimi nr. 38, datë 19.01.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 380.Vendimi nr. 5189, datë 21.05.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- 381.Vendimi nr. 570, datë 24.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 382.Vendimi nr. 626 (8810), datë 12.12.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- 383.Vendimi nr. 609 (4319), datë 20.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

B. Website zyrtare

- 384.DPIC. (2015). *The death penalty in 2014: Year end report*. E aksesueshme në:
<http://deathpenaltyinfo.org/documents/2014YrEnd.pdf>.
- 385.Drejtoria e përgjithshme e burgjeve. Statistika. E aksesueshme në:
<http://www.dpbsh.gov.al/newweb/index.php?fq=brenda&gj=gj1&kid=72>.
- 386.EMCDDA, (2013). *Country overview: Albania*. Retrieved from:
<http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overviews/al>. Accessed on 30 April 2015.
- 387.endcorporalpunishment.org. (2012). *Iran – Country report*. January 2012. e aksesueshme në:
<http://www.endcorporalpunishment.org/pages/pdfs/states-reports/Iran.pdf>.
- 388.FBI (2015). *White-Collar Crime. Asset Forfeiture*. E aksesueshme në:
https://www.fbi.gov/about-us/investigate/white_collar/asset-forfeiture.
- 389.forumishqiptar.com (2012). *Denimi i fundit me vdekje ne Shqiperi, Fier 1992 (foto)*. 09-09-2012. Marrë nga: [http://www.forumishqiptar.com/threads/145250-Denimi-i-fundit-me-vdekje-ne-Shqiperi-Fier-1992-\(foto\)](http://www.forumishqiptar.com/threads/145250-Denimi-i-fundit-me-vdekje-ne-Shqiperi-Fier-1992-(foto)).
- 390.Governing.com. (2015). *States turn to technology to calculate prison sentences*. March 11, 2015. E aksesueshme në: <http://www.governing.com/columns/tech-talk/gov-states-technology-compute-prison-sentences.html>.
- 391.law.jrank.org. (2015). *Criminal Procedure: Comparative Aspects – Adjudication*. Marrë nga:
<http://law.jrank.org/pages/901/Criminal-Procedure-Comparative-Aspects-Adjudication.html>.
- 392.Ministria e Drejtësisë. Statistika. Vjetarët statistikorë. E aksesueshme në:
<http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>.
- 393.Ministria e Punëve të Brendshme (2013). *Buletin informativ. Aktiviteti i Policisë së shtetit 17 tetor-17 nëntor*. E aksesueshme në:
http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/13-12-18-05-36-29Buletini_informativ_17_tetor-17nëntor_2013.pdf.
- 394.Ministria e punëve të brendshme. *Buletini i MPB-së*. E aksesueshme në:
<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/programi/buletini-i-mpb-se>.
- 395.National Audit Office (2006). *The Electronic Monitoring of Adult Offenders* [Online]. E aksesueshme në:

- http://www.nao.org.uk/publications/0506/the_electronic_monitoring_of_a.aspx [Aksesuar me 05.04.2015].
396. National Law Enforcement and Corrections Technology Center Bulletin (NLECTC) (1999). *Keeping Track of Electronic Monitoring*, Oct. 1999, Available at: <http://www.justnet.org/Lists/JUSTNET%20Resources/Attachments/859/Elec-Monit.pdf> (last visited June 7, 2014).
397. parliament.uk. (2009). *Sentencing guidelines and Parliament: building a bridge - Justice Committee*. E aksesueshme në: <http://www.publications.parliament.uk/pa/cm200809/cmselect/cmjust/715/71506.htm#note24>, Marrë me 8 Prill 2015.
398. Policia e shtetit (2014). *Analiza vjetore e policisë së shtetit për vitin 2013*. E aksesueshme në: <http://www.asp.gov.al/index.php/janar-2014/125-analiza-vjetore-e-policise-se-shtetit-2013-raporti-i-drejtorit-te-pergjithshem-te-policise>.
399. prisonreformtrust.org.uk (2014). *Prison: The facts. Bromley Briefings Summer 2014*. available at: <http://www.prisonreformtrust.org.uk/Portals/0/Documents/Prison%20the%20facts%20May%202014.pdf>.
400. Prokuroria e Përgjithshme. *Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm*. E aksesueshme në: http://www.pp.gov.al/web/Raporte_te_Prokurorit_te_Pergjithshem_353_1.php#.Vcsgo7Kqqko.
401. Shërbimi i provës (2014). *Raport vjetor i Shërbimit të provës 1 janar 2013 - 20 dhjetor 2013*. I aksesueshëm në: <http://www.sherbimiproves.gov.al/index.php/al/publikime/raportet-mujore>.
402. worldbank.org (2014). *GDP per capita*. Retrieved from: <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>.
403. worldcoalition.org (2014). *117 countries vote for a global moratorium on executions*. Available at: <http://www.worldcoalition.org/united-nations-resolution-moratorium-death-penalty-executions-general-assembly.html>.